monumentet



DO NOT COPY

52/2011 - 2014

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Monumentet

DO NOT COPY

DO NOT COPY

MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
"GANI STRAZIMIRI"
TIRANË

DO NOT COPY

Monumentet

52/ 2011 - 2014

DO NOT COPY

Redaksia

Prof. Dr.	Pirro THOMO	Kryeredaktor
	Arta DOLLANI	Anëtar
	Edlira ÇAUSHI	Anëtar
	Marsela PLYKU	Anëtar
	Elio HOBDARI	Anëtar
Ass. Prof.	Florian NEPRAVISHTA	Anëtar
	Mimoza ZERECI	Anëtar
	Anduela ARBANA	Sekretare

Copyright: Instituti i Monumenteve të Kulturës
Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës
Tiranë, 2014

Në kopertinë: David Selenicasi, figura strategësh, kisha e Shën Nikollës, Voskopojë

Shtëpia Botuese
Shtypshkronja MORAVA

Adresa: Rr. Gjon Kastrioti (ish-shtëpia e Pionierit)
Laprakë, Tiranë
Tel.: 04 22 27 202 / **Cel.:** 068 20 13 121
E-mail: botimemorava@yahoo.com
botime.morava@gmail.com
HHp: www.botimetmorava.com

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDË
ARTIKUJ

Faqe

Emin RIZA
Banesa popullore shqiptare, arritjet dhe e ardhmja 11

Nikolla CIVICI
Edlira ÇAUSHI
Ilaria CAROCCI
Stefano RIDOLFI
Ekzaminimi diagnostikues me teknika jo-shkatërruese dhe portative në pikturat murale të kishës së Shën Mërisë Vllaherna në kala, Berat 25

Klodjana GJATA
Marsela DEMAJ (PLYKU)
Ronela ÇUKU
Arkitektura, identiteti dhe fazat e ndërtimit të kishës bizantine Shën Mëri Vllaherna, Berat 35

Maksim MITROJORGJI
Joli MITROJORGJI
Elbasani - identiteti i humbur i një qyteti 53

Agron ISLAMI
Michele RICCIARDONE
MSc. Klejdi ZGURO
Ndërhyrjet konservuese në bazilikën e Shën Janit, Delvinë
(Dyshemeja me pllaka guri dhe mozaik opus sectile).....87

Andi REMBECI
Kodiku i mitropolisë së Korçës dhe Selasforit (shek. xvii-xix): Të dhëna për kulturën në zonën e Korçës.....97

Kreshnik MERXHANI
Elena MAMANI
Materialet ndërtimore në monumentet historike - Gjirokastër.....127

Ahilino PALUSHI
Afresku në narteksin e kishës e Tërëshenjta e Kukuzelit në manastirin e Laurës së Madhe në Malin Athos (1715) 139

Blerina TOÇI
Mendime mbi përdorimin e ordrit dorik tetëkëndësh në Apoloni 147

Federica POMPEJANO
Struktura e çatisë së drunjtë të banesës së Skëndulajve, Gjirokastër.....159

Kronikë e punimeve restauruese.....173

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TABLE OF CONTENT
ARTICLES

Page

Emin RIZA
Albanian vernacular architecture, achievements and its future 24

Nikolla CIVICI
Edlira ÇAUSHI
Ilaria CAROCCI
Stefano RIDOLFI
Report of the diagnostic examination of the mural paintings of the Saint Mary's church in Vllaherna, in the citadel of Berat, with the help of non-destructive and portable techniques.....34

Klodjana GJATA
Marsela DEMAJ (PLYKU)
Ronela ÇUKU
Architecture, identity and phases of construction of the byzantine church of St. Mary Vllaherna – Berat.....52

Maksim MITROJORGJI
Joli MITROJORGJI
Elbasan - the lost identity of a city 84

Agron ISLAMI
Michele RICCIARDONE
MSc. Klejdi ZGURO
Conservative interventions on the basilica of St. Jean, Delvina (Floor in Stone Tiles and Opus Sectile).....96

Andi REMBECI
The codex of the metropolis of Korça and Selasphorus (17th - 19th centuries): Information about the culture in Korça area 125

Kreshnik MERXHANI
Elena MAMANI
Construction materials used in the historic monuments – Gjirokastër 138

Ahilino PALUSHI
The fresco in the narthex of the holy church of Kukuzeli, in the monastery of Great Lawra, Mount Athos (1715) 145

Blerina TOÇI
Considerations about the octagonal doric order in Apolonia..... 158

Federica POMPEJANO
The timber roof structure of Skëndulate house, Gjirokastra..... 171

DO NOT COPY

monumentet
52/2011 - 2014

Akadamik Emin RIZA

DO NOT COPY

BANESA POPULLORE SHQIPTARE, ARRITJET DHE E ARDHMJA

Veprimtaria kërkimore në fushën e banesës shqiptare, ashtu si mbarë ajo në fushën albanologjike, për gjerësinë e tematikës dhe të rejave që i shtohen njohurive për të, është thuajse një fushë e pandalshme apo e vazhdueshme kërkimesh përzgjerimine dijevedhesaktësiminetyre.Nëkëtëkëndshikim do të pohonim se, që prej fillimit të konsiderimit të kësaj fushe të ndërtimtarisë, thuajse binjake me jetën njerëzore, objekt kërkimesh i një disipline albanologjike krahasimisht të re, lind natyrshëm bashkëveprimi i brezave pasues të punonjësve kërkimorë. Çdo brez zgjeron dhe më fort thellon shkallën e dijeve, duke shtrirë fushën e përfundimeve dhe saktësuar ato. Brezi ynë, i cili filloi këtë veprimtari rreth viteve 1960, duke pasur nismëtar konceptual dhe metodiko-praktik të kësaj veprimtarie nga shumë pikëshikime ark. Gani Strazimirin, për disa rrethana tejet pozitive kreu një veprimtari të spikatur për nga volumi, metodika dhe sistematizmi, e cila për arsye do të thoshim natyrore, po i kalon brezit pasardhës. Pa synuar marrjen e tagrit të përfaqësuesit të këtij brezi, por si bashkëpjesëtar i tij, po lejohem të trajtoj këtë temë, së pakti problematike, për ruajtjen e arritjeve pozitive si dhe për vijimin e kësaj veprimtarie me vlera të pazëvendësueshme, së pari në fushën e banesës, si burim autentik historik i mënyrës së jetesës. Brezit pasardhës, tashmë bashkëpunues me brezin nismëtar, apo përvetësues i arritjeve të tij, i bie detyra që të rrisë shkallën e rolit historiko-kulturor të banesës shqiptare, nëpërmjet ecurisë së mëtejshme studimore, për t'ia lënë radhën brezit pasardhës dhe kështu vijueshëm në rrjedhë të kohës. Është rasti për të vërejtur përdorimin e termit kompozitë: "veprimtari kërkimore" dhe jo "veprimtari shkencore" për këtë fushë. Ne jemi prej kohësh me mendimin e gjuhëtarit Selman Riza, i cili theksonte se: „një veprimtari për t'u cilësuar shkencore, duhet që saktësia e përfundimeve të saj të jetë e vërtetueshme". Mbarë "shkencat shoqërore" nuk e përmbushin këtë kërkesë, prandaj ne kemi parapëlqyer edhe për fushën e studimit të banesës, përfshirjen e hulumtimit të saj në veprimtarinë të cilësuar kërkimore.

Banesa popullore shqiptare dhe më gjerë trashëgimia e kulturës materiale dhe shpirtërore e etnosit iliro-arbëresho-shqiptar u bënë objekt i kërkimeve albanologjike pas Luftës së Dytë Botërore. E pohojmë që në krye se objekti banesa shqiptare, e cila përfshinte krijimtarinë popullore në këtë fushë, përsa i përket sistematizmit të gjurmimit dhe kritereve të vlerësimit, paraqet një rast unikal në mbarë hapësirën ballkanike dhe europiane e më gjerë. Për disa arsye bashkëplotësuese, si vlerat e rëndësishme në shembujt e banesës tradicionale shqiptare, kryesisht të shekujve XVIII-XIX, por tipologjikisht më të hershëm, ruajtja e tyre në gjendje krahasimisht të mirë, për shkak të zgjidhjeve racionale dhe zhvillimit të ngadalshëm të shoqërisë shqiptare, vënia në mbrojtje e saj, duke filluar prej viteve 1960 dhe zgjeruar sistematikisht në dy dhjetëvjeçarët pasues etj., kushtëzuan rrethanat që banesa shqiptare të shfaqet si një shembull domethënës në mbarë kulturën europiane. Në sajë të meritës madhore të ark. Gani Strazimirit, do të thoshim me intuitë inherente, Qendrat Historike të Beratit dhe Gjirokastrës dhe Pazari i vjetër i Krujës u vunë në mbrojtje shtetërore në cilësinë e monumenteve historiko-kulturore që në vitin 1961. Këto Qendra formoheshin kryesisht si bashkësi banesash tradicionale të shekujve

DO NOT COPY

XVIII-XIX, vepra të porositësve shqiptarë dhe ndërtuesish kryesisht shqiptarë. Rreth viteve 1970 fillon veprimtaria për vënien në mbrojtje të Qendrave të tjera historike si: të Korçës, Elbasanit, Shkodrës, Vlorës, në të cilat, gjithashtu, banesa zinte vendin kryesor. Krahas, rreth këtyre viteve dhe më pas, vjen veprimtaria sistematike për vënin në mbrojtje shtetërore të banesave, cilësuar monumente të kategorisë së parë, të cilat ruheshin në shkallë të ndryshme, në mbarë përbërësit e tyre kompozicionalë, arkitekturorë dhe teknikë. Fillimi i veprimtarisë për gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të shembujve përfaqësues të banesës fshatare shqiptare shënon një dukuri me vlera të rëndësishme për arsye të kuptueshme. Viti 1974 shënon një ngjarje me rëndësi kulturore, atë të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 229, datë 01.11.1974, "Mbi gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve popullore", duke caktuar si kufi përfundimtar kohor vitin 1978. Gjatë këtyre katër viteve u përshpejtua procesi i gjurmimit, i cili veçanërisht për banesën fshatare kishte filluar gjerë dhe me përfundime në pjesën veriore të vendit. Kështu, krahas qyteteve u gjurmuan fshatrat shqiptarë, duke u vrojtuar, përzgjedhur banesat me vlera historiko-tipologjike, dokumentuar paraprakisht ato dhe vijueshëm, duke u vënë në mbrojtje dëshmitë me rëndësi dokumentare dhe arkitekturore. Kuptueshëm, vënia në mbrojtje e banesës popullore shqiptare dhe e monumenteve në përgjithësi nuk mund të jetë një veprimtari me fund kohor. Për shumë arsye, përzgjedhja e vlerave për t'u mbrojtur është një proces i pafund, natyrisht, me rënie të përvijueshme të numrit të shembujve të përzgjedhur. Pas viteve 1990, kuptueshëm vërehet prirja për të vënë në mbrojtje Qendrat historike dhe banesa të shekullit XX, duke qenë këto të fundit pasqyruese të atij realiteti, i cili natyrshëm do të zërë vendin e vet në historinë shqiptare, shoqëruar me cilësorët i vjetër, i hershëm etj.

Gjurmimi i qendrave të banuara qytetare dhe fshatare, (Fig. 1) për të përcaktuar banesat me vlera historiko-kulturore dhe si të tilla për t'u vënë në mbrojtje shtetërore, parakupton qenien e një sërë kriteresh të rëndësive të ndryshme për të siguruar kryerjen e këtij procesi, sipas kërkesave profesionale të fushës. Theksojmë që në krye se baza e mbarë kritereve profesionalë për përzgjedhjen e banesave me vlera për t'u cilësuar *monument*, ashtu si e mbarë ndërtimeve, është të qenit e tyre dëshmi autentike historiko-kulturore.



Fig. 1. Banesa e fortifikuar, Mat

Kjo e vërtetë qëndron në thelbin e renditjes metodike për identifikimin e banesave popullore të cilat cilësohen *monument*.

Është momenti për të vënë në dukje se në gjininë e banesës popullore dhe në gjinitë e tjera ndërtimore monumentet ndahen në kategori, përkatësisht të parë dhe të dytë. *Monumentet e kategorisë së parë* janë shembujt më të arritur të një tipologjie të caktuar, të cilët, si të tillë ruhen në mbarë përbërësit, kompozicionalë, arkitekturorë dhe teknikë. *Monumentet e kategorisë së dytë* kryesisht bartin vlera si pjesë e bashkësive ndërtimore dhe si të tillë ruhen në volumin dhe trajtimin e pamjes së jashtme të tyre, ndërsa në brendësi mund të pësojnë ndryshime. Në këtë artikull, termi *monument* nënkupton atë të kategorisë së parë, ndërsa

DOKTORE

kur është fjala për monumente të kategorisë së dytë, atëherë termi *monument* do të shoqërohet me cilësorin e përmendur.

Kriteret për përzgjedhjen e banesave për t'u cilësuar *monument*, radhitur sipas rëndësisë janë: kriteri tipologjik, i autenticitetit, i vlerave arkitekturore, kronologjisë dhe shpërndarjes hapësinore. Kriteri tipologjik, i cili parakupton kryerjen e studimeve përkatëse për klasifikimin tipologjik është thelbësori në përzgjedhjen e banesave për t'u cilësuar *monument*. Ky kriter, natyrshëm e shtrin hapësirën e përzgjedhjes së banesave në mbarë variantet, që prej banesave të thjeshta, shpesh në një kthinë, në ato të zhvilluarat, të së njëjtës tipologji. Kështu, banesat-monument shfaqen së pari me vlerat e tyre kompozicionalë, treguesit më të prekshëm, njëherazi më të rëndësishëm të banesës, si pasqyrimi i kushteve ekonomiko-shoqërore të kohës dhe të rrethanave, që në lidhjen shkak-pasojë përcaktojnë tipin dhe më ngushtas variantin e banesës. Kjo e fundit, si *monument*, lejon kalimin e mbështetur prej saj në kushtet ekonomiko-shoqërore që ka kushtëzuar këtë apo atë kompozim dhe më ngushtas variant. Kështu, prekshëm banesa-monument shfaqet së pari si dokument historik.

Kriteret e tjerë renditen sipas përparësive relative, duke parakuptuar përmbushjen e domosdoshme të kriterit të parë, thënë ndryshe, në mbarë banesat që përmbushin kriterin e parë dhe shkallërisht të tjerët vijnë në përfillje kriteret pasues. Kriteri i dytë, ai i autenticitetit lidhet me shkallën e ruajtjes së përbërësve origjinalë të banesës, të cilat, përgjithësisht, për arsyet e njohura, vijnë me ndryshime të shkallëve të ndryshme. Kriteri i tretë është ai i vlerave arkitekturore të banesës, të cilat shfaqen në realizimin e kompozimeve sa më harmonikë, si dhe në trajtimin e elementeve të ndryshëm arkitekturorë. Kriteri kohor lidhet me kohën e ndërtimit të banesës. Megjithëse mbishkrimet që përcaktojnë kohën e ndërtimit të banesave i përkasin kryesisht shekullit XIX dhe banesave të shtresave të pasura, studiuesit e fushës, sipas të dhënave të tjera, kryesisht të trajtimit të elementeve dekorativë, janë në gjendje të bëjnë datime të përafërta dhe afër së vërtetës, si dhe të vendosin kronologji relative. Në këtë kontekst, pas renditjes sipas tre kritereve të parë hyn në fuqi konsiderimi i kriterit kohor, duke parapëlqyer banesat më të hershme. Së fundi, vjen në përfillje kriteri i shpërndarjes hapësirore të tipologjisë së banesës shqiptare. **Kështu të themi**, megjithëse në Shkodër ndeshen shembuj të arrirë të banesës me çardak, kjo nuk do të thotë se shembuj paralelë në qendra të tjera qytetare nuk duhen konsideruar. Shpërndarja hapësinore e tipologjisë mbart kuptueshëm vlera të përfillshme në cilësinë e dëshmisë historike. Është rasti për të theksuar se krahas banesave të përfshira në klasifikimet e njohura tipologjike ndeshen edhe shumë shembuj, të cilët gjithë duke pasur të njëjtin program me tipologjitë e njohura shfaqen me kompozime, të cilat mund të cilësohen raste të veçanta. Natyrisht, edhe këto banesa, apo më saktë shembujt më përfaqësues duhet të përfshihen në cilësimin *monument kulture*.

Veprimtaria sistematike gjurmuese e banesës popullore shqiptare, siç kemi përmendur për vetë karakterin e saj, asnjëherë e përmbyllur, ka pasur dendësinë më të theksuar gjatë viteve 1960-1980, periudhë gjatë së cilës janë cilësuar dhe bërë të qëndrueshme kriteret e përzgjedhjes së monumenteve. Është rasti për të pohuar se me banesë tradicionale shqiptare kuptohet mbarë kjo kategori ndërtimore e ndërtuar prej shqiptarëve për shqiptarët, në hapësirat tradicionalisht shqiptare. Rrjedhimisht, kjo banesë nuk ruhet vetëm në Shqipërinë politike por në mbarë trojet që e rrethojnë atë, pra në Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni, Greqi dhe tek arbëreshët në Itali. Në këto hapësira, banesa shqiptare është gjurmuar cektas apo aspak.

Në termat kompozitë banesë fshatare dhe banesë qytetare, cilësoret e ndryshme të tyre shfaqin dy realitete të ndryshme ekonomiko-shoqërorë, me tipare dhe bashkëlidhje të ndryshme si përsa i përket kahut, ashtu edhe shkallës së dendësisë dhe përmbajtjes së tyre. Ripohojmë mendimin, besojmë tashmë të bashkëpranuar, se njësitë e banuara fshat-qytet dallohen mes tyre, duke konsideruar së pari dhe mbi të gjitha karakterin e ekonomisë që ushtrojnë banorët e këtyre qendrave. Kështu, qendra fshatare quhen ato që ushtrojnë kryesisht ekonomitë bujqësore-blegtorale apo ashtu si përgjithësisht, të dyja këto ekonomi në bashkëmarrëdhënie të ndryshme. Qendra qytetare quhen ato në të cilat ushtrohet kryesisht zejtaria dhe tregtia. Kuptohet se banesat e këtyre qendrave pasohen përkatësisht prej cilësoreve fshatare dhe qytetare. Për periudhën e shekujve XV-XIX, për të cilën dëshmitë për banesat shqiptare janë të përfillshme, do të pohonim se gjatë shek. XVvërehet dukuria e rrënimit dhe braktisjes së qyteteve, pra banesës qytetare, për arsye të njohura historike, ndërsa shek. XVI shënon fillimin e

ripërtëritjes së qyteteve, kryesisht me banorë të fshatrave përreth, të cilët ushtronin kryesisht ekonomitë bujqësore-blegtorale dhe për pasojë ndërtonin banesa, do të thoshim fshatare. Shekulli XVII shënon rritje të përfillshme të qyteteve, për të arritur në shekullin XVIII, gjatë të cilit thuajse kristalizohet tipologjia e banesës qytetare shqiptare në zhvillim të spikatur, duke arritur të realizojë ndërtimin e shembujve më të arrirë rreth fillimit të shekullit XIX. Në këtë shekull, dallimet banesë fshatare-banesë qytetare, kuptueshëm thellohen.

Për arsyet e kuptueshme të mungesës së traditës vlerësuese dhe për pasojë asaj studimore në fushën e banesës popullore, veprimtarive të shpejta për vlerësimin e kësaj trashëgimie dhe kryesisht përbërësit të gjurmimit të këtyre pasurive kulturore, rreth dy dhjetëvjeçarëve 1960-1980, në Shqipëri u formua një bërthamë, njëherazi me studiues dhe restaurues të banesës popullore.Theksojmë, sepse jemi të bindur prej përvojës sonë në disa tregues unikalë në mbarë hapësirën europiane, se restaurimi i krijimeve arkitekturore domosdoshmërisht duhet të jetë njëherazi edhe studiues i këtyre veprave, ndarë në gjinitë e mëdha të fortifikimeve, ndërtimeve të kultit, atyre shoqërore dhe banesës.

Duke qëndruar në fushën e banesës, theksojmë, se për të arritur në qëndrime të drejta në atë proces tejet të rëndësishëm,



Fig. 2. Banesa e Toptanasve, Krujë

DO NOT COPY

DO NOT COPY

që emërtohet restaurim, i cili, siç theksohet në Kartën e Restaurimit të Venecias të vitit 1964 bazohet mbi respektin e substancës së vjetër dhe të dokumentit autentik, duhet të njohim karakteristikat kompozicionale, arkitekturore dhe teknike të monumentit, fazat e tij të ndërtimit dhe vendin në bashkësinë e ndërtimeve të së njëjtës tipologji. Sa më sipër, shpreh qartë sentencën, restauratori duhet të jetë njëherazi studiues i gjinisë së monumenteve, në të cilin përfshihet monumenti që i nënshtrohet restaurimit. Praktika shqiptare është qartazi mbështetëse e kësaj së vërtete, e cila ka për pasojë shkallën e lartë të cilësisë së restaurimeve. Kështu, praktika shqiptare formoi krahasimisht shpejt, rreth një dhjetëvjeçari, bërthamën e parë të studiuesve dhe restauratorëve, apo restauratorëve dhe studiuesve të banesës popullore shqiptare. Mendimi ynë, i shprehur në një artikull në revistën "Monumentet" 1/1984, titulluar: "Historia e arkitekturës dhe restaurimi, dy disiplina bashkëplotësuese", i ka qëndruar kohës, sepse pasqyron drejt dukurinë në shqyrtim. Restaurimi i banesave popullore së pari u zbatua në banesat qytetare, më ngushtas në ato të Beratit dhe Gjirokastrës, shpallur qytete-muze. Fillimi sistematik i kësaj veprimtarie, ashtu si vlerësimi i mbarë monumenteve të palëvizshëm në Shqipëri, e ka nismën sistematike bazuar mbi parimet bazë të restaurimit në vitin 1965, vit i cili shënoi krijimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës. Në udhëheqjen metodike të ark. Gani Strazimirit, madje që para vitit 1965 u hartuan një sërë projektesh për ndërhyrje restauruese në banesa qytetare. Përmendim Teqen e Sheh Dyrit në Tiranë, një banesë tipike tiranase me shtëpi zjarri qendrore, banesën e familjes Kalaja në Krujë, (Fig. 2) (sot muzeu etnografik), banesën e Zekatëve në Gjirokastër[1] (Fig. 3) etj. Praktika e miratimit të projekteve në instanca të ndryshme profesionale si, sektori përkatës, këshilli shkencor etj., si dhe ndjekja e zbatimit të ndërhyrjeve restauruese prej autorit të projektit, qenë fillesa tejet pozitive për të arritur në përthithjen e duhur të kritereve të restaurimit dhe zbatimin sa më të përpiktë të tyre. Pas viteve 1970, me shtimin e fondeve të restaurimit dhe rritjen e kërkesave prej banorëve të banesave- monument, ritmi i



Fig. 3. Banesa e Zekateve, Gjirokastër

ndërhyrjeve restauruese, duke përfshirë dhe ato në banesat fshatare, kohësisht të zgjedhura më vonë, përshpejtohet ndjeshëm. Krahas monumenteve të kategorisë së parë në qytet dhe në fshat, përherë dhe më tepër rritet numri i monumenteve të kategorisë së dytë në qytete. Fondet e vëna në dispozicion të restaurimit të banesave zinin rreth 65-70% të fondeve të përgjithshme vjetore të restaurimit. Procesi i rritjes së numrit të ndërhyrjeve restauruese në banesa ecte paralelisht me rritjen e numrit dhe kualifikimit profesional të restauratorëve të rinj, për të cilët shkallë formimi ishte përvoja në rritje me procesin e vlerësimit të monumenteve dhe njohja me literaturën e pakët, për arsye të njohura. Kuptueshëm, pas viteve 1970, edhe për arsye të daljes në qarkullim të revistës "Monumentet" botimi i ndërhyrjeve

[1] Riza, E., "Restaurimi i Teqes së Sheh Dyrit", Tiranë, *Monumentet*, 2002, f. 58-66; Riza, E., "Studim për restaurimin e një banese me çardak në qytetin e Krujës", *Monumentet*, 1975, 9, f. 107-127; Riza, E., "Arkitektura dhe restaurimi i banesës së Zekatëve (Gjirokastër)", *Monumentet*, 1977,13, f. 107-133.

restauruese në banesa filloi të shoqërohet me botime të karakterit studimor për këtë kategori ndërtimore. Së pari, studimet ishin të karakterit tipologjik mbi bazë qendrash qytetare apo krahinash, kur trajtohej banesa fshatare. Krahas, filluan edhe trajtime të elementeve arkitekturore, teknikës së ndërtimit, evolucionit tipologjik, marrëdhënieve banesë fshatare-banesë qytetare, vendit të banesës shqiptare në atë ballkanike dhe më gjerë. Krahas artikujve të botuar, kryesisht në revistën «Monumentet», pas viteve 1970 filloi botimi i monografive mbi bazë qendrash të banuara dhe krahinash. Rreth viteve 1990 filloi botimi i monografive me karakter përgjithësues, madje duke përfshirë dhe banesën qytetare kosovare (Fig. 4).

Njëtemëmevleratërëndësishmeekarakteritpërgjithësues është ajo e lidhjes etni-banesë. Studimet rreth saj kanë treguar se nuk ka lidhje shkak-pasojë etni-banesë, në kuptimin e përcaktimit të karakteristikave të banesës prej tipareve të etnisë, por prej kushteve ekonomiko-shoqërore në të cilat jeton kjo etni. Vendi i banesës tradicionale shqiptare në bashkësinë e banesës popullore ballkanike dhe më gjerë, gjithashtu ka përbërë temë në studimet monografike të viteve të fundit. Është për t'u theksuar se studimet përgjithësuese në vitet e fundit kanë pasur për objekt si banesën qytetare të studiuar krahasimisht më herët, ashtu edhe banesën fshatare. Të dy këto njësi të hershme ndërtimore janë trajtuar me të njëjtën metodologji,



Fig. 4. Banesë me qoshk, Gjakovë

DO NOT COPY

DO NOT COPY

larg pseudopërfundimeve, por me përgjithësime që rrjedhin natyrshëm prej klasifikimit, përqasjes dhe ndjekjes së zhvillimit kohor të dukurive, apo kategorive arkitekturore dhe teknike. Njësia metodike është një arritje madhore, e cila e bën të njësuar trajtimin dhe për pasojë bashkëpërfshirjen e përfundimeve të arritura në fusha paralele të studimeve historike dhe vetë historinë e kombit shqiptar në shekuj. Banesa shqiptare, ashtu si trashëgimia e paluajtshme kulturore në përgjithësi, tashmë është një fushë e re e kërkimeve albanologjike me arritje, madje përgjithësuese, me vlera të rëndësishme. Veçanërisht në fushën e banesës kjo veprimtari, nëse nuk do të kryhej kur u krye dhe siç u krye do të pasohej me humbje të pazëvendësueshme të kësaj pasurie kulturore unikale.

Trajtimet e ngjeshura të mësipërme synojnë të japin një vështrim të përgjithshëm mbi rrugën drejt përfshirjes së banesës popullore shqiptare në hapësirat e fushës kërkimore albanologjike, gjithë duke qenë të trajtuara në artikuj dhe monografi të veçanta. Në këtë artikull, pjesa do të thoshim e trajtuar thuajse së pari është kjo pasuesja, e cila synon të paraqesë rekomandime profesionale për ecurinë e mëtejshme të veprimtarisë shumërrafshëshe të vlerësimit të banesave popullore të cilësuara *monument*. Pa rënë në mëkatin e vetëpohimit do të theksonim se fatkeqësisht, brezi i ri i studiuesve dhe restauratorëve të rinj ende nuk është formuar dhe më tej, rritja e theksuar e kërkesave jetësore me mundësi të prekshme realizimi, tashmë ka shtruar urdhëruesëm rrugë të reja për përfshirjen e banesave-monument me jetën e sotme, kryesisht me funksionin fillestar. Së pari, para fillimit të trajtimit të çështjeve të veçanta, do të thoshim se rekomandimet tona janë në frymën e metodikës, tashmë të konsoliduar ndërkombëtarisht, pa pretenduar të jenë këto rekomandime risi origjinale. Ne do të përpiqemi që këto të vërteta metodike t›i kundrojmë në realitetin shqiptar të fushës së vlerësimit të banesave popullore, të cilën pa pseudomodesti dhe vetëpohim e njohim madje mirë, në sajë të një veprimtarie të pandërprerë 50 vjeçare në fushën e studimit dhe restaurimit. Ngjeshurazi, çështjet që do të trajtohen janë:

Vijimësia në procesin e gjurmimit dhe vënies në mbrojtje të banesave dhe bashkësive ndërtimore në fshat dhe në qytet;

1. Zgjerimi i dokumentimit të banesave-monument;
2. Thellimi i studimeve mbi tiparet e ambienteve të banesave-monument, elementeve arkitekturorë, teknikës së ndërtimit dhe ornamentikës;
3. Trajtimi i çështjes së njësimit të kritereve klasifikues të banesave fshatare dhe qytetare;
4. Thellimi i studimeve lidhur me bashkëmarrëdhëniet ndërmjet banesës shqiptare dhe asaj të popujve të tjerë të hapësirës ballkanike;
5. Kriteret e restaurimit dhe bashkëmarrëdhëniet e tyre me problematikën e bashkëjetesës së kategorisë banesë-monument me kërkesat e sotme funksionalo-estetike;
6. Thellimi i studimeve mbi banesat-monument dhe bashkësitë ndërtimore me synime përgjithësuese dhe botimi i tyre në shqip dhe gjuhë ndërkombëtare;
7. Përfshirja e trashëgimisë ndërtimore shqiptare dhe restaurimit të saj si lëndë universitare dhe e shkollave të mesme;
8. Rritja e vëmendjes për botime popullore në fushën e banesës popullore shqiptare.

Gjurmimi dhe vënia në mbrojtje e banesave me vlera historiko-kulturore, në cilësinë e monumenteve, është një veprimtari sa e rëndësishme, barazisht dhe e vijueshme. Dukuria e dytë lidhet me pamundësinë praktike për gjurmime shteruese dhe shkallën përherë dhe në rritje të njohjes së vlerave të banesave tradicionale në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë dhe teknikë. Vazhdimësia, do të thoshim e pandërprerë e gjurmimit të banesave popullore lidhet me dy rrethana. Së pari, mbështetur me vlerat e saj historiko-kulturore, pra dhe të banesave të veçanta, procesi i gjurmimit dhe vënies në mbrojtje të banesave përfaqësuese është i pandërprerë. Së dyti, vjen në përfillje rrethana e cila lidhet me të vërtetën se procesi i vënies në mbrojtje të vlerave ndërtimore është krahasimisht i vonë dhe për Shqipërinë zë fill në gjysmën e dytë të shek. XX. Kështu, fillesat e këtij procesi mbulojnë një hapësirë të gjerë kohore dhe për pasojë mundësitë për të mos vrojtuar mbarë ndërtimet që ruajnë përfillshëm vlerat autentike, apo një pjesë të tyre, janë të mëdha. Për shkak të kësaj rrethane, qenia e vlerave të paidentifikuara është dukuri e kuptueshme. Për arsyet e mësipërme, veçanërisht identifikimi i vlerave të pagjurmuara, kryesisht në vendbanimet fshatare, shfaqet i pranishëm në realitetin shqiptar. Sa më shpejt të kryhet ky identifikim, aq më tepër shmangen mundësitë për humbjen e pakthyeshme të këtyre vlerave unikale. Është rasti për të theksuar fortazi të vërtetën se termi banesa shqiptare përfshin mbarë këtë kategori në hapësirë dhe kohë, krijuar prej etnosit shqiptar.

DO NOT COPY

Kuptueshëm, në këtë kategori përfshihen edhe banesat tradicionale shqiptare, duke filluar prej Veriut në Jug, në Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni, Greqi dhe më tej në hapësirat, ku që prej shekullit XV janë vendosur shqiptarët apo arbëreshët në Italinë e Jugut. Studimi i banesës shqiptare në trojet e Kosovës, që në muzgun e historisë banuar prej së njëjtës etni iliro-arbëresho-shqiptare ka disa arritje, gjithë duke mos qenë e përfunduar, ndërsa banesa shqiptare në hapësirat tradicionalisht shqiptare në Mal të Zi, Maqedoni dhe veçanërisht Greqi janë të pagjurmuara, për arsyet e njohura, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me synimet e veprimtarisë kërkimore. Është urdhëruese që në këto hapësira sa më parë të kryhet një veprimtari sistematike në këtë fushë të trashëgimisë së paluajtshme, në mos për vënien e tyre në mbrojtje, domosdoshmërisht për dokumentimin e këtyre dëshmive autentike historiko-kulturore. Përvoja e studiuesve shqiptarë të Shqipërisë politike natyrshëm duhet të bashkëpërfshihet në këtë veprimtari, me pjesëmarrjen e specialistëve përkatës në grupet gjurmuese. Është rasti për të theksuar domosdoshmërinë e kryerjes së gjurmimeve lidhur me shpalljen e qendrave historike në fshat, në mbarë hapësirat tradicionalisht shqiptare, si dhe në ato qytetare, jashtë trojeve të Shqipërisë. Për arsye të kuptueshme, qendrat historike në përgjithësi dhe ato fshataret në veçanti ruajnë, krahas vlerave arkitekturore edhe vlera urbanistike, të cilat për vetë tiparet e tyre kanë rëndësi të madhe historiko-shoqërore. Për këto arsye, si dhe zhvillimet e shpejta të mënyrës së jetesës, të cilat pasqyrohen dukshëm në ndryshime, madje thelbësore në banesat qytetare dhe braktisje të vendbanimeve fshatare, vënia në mbrojtje e qendrave qytetare dhe fshatare merr përparësi, do të thoshim pamëdyshje të ngutshme.

Gjatë veprimtarisë për gjurmimin e banesës popullore kryhet njëherazi dhe dokumentimi fillestar i vlerave të kësaj trashëgimie. Ky dokumentim përshkrimor, grafik dhe fotografik, sipas kësaj renditjeje përfshin të dhëna shkrimore mbi tipin e banesës, eventualisht fazat e ndërtimit, shkallën e autenticitetit, dëshmi gojore mbi kohën e ndërtimit, etj.. Dokumentacioni grafik përfshin përgjithësisht rilevimin e kateve dhe pamjen kryesore, të shoqëruar me foto, për të pasqyruar gjendjen e përgjithshme si dhe hollësi me vlera të veçanta. Natyrshëm, prej këtyre banesave të dokumentuara si më sipër, prej instancave përkatëse profesionale përzgjidhen shembujt më me vlerë, të cilët konfirmohen në statusin e monumenteve prej Ministrisë së Kulturës për monumentet e veçantë dhe Këshillit të Ministrave për Qendrat historike. Menjëherë pas cilësimit të banesave apo ansambleve ndërtimorë, përkatësisht me emërtimet *monument* apo *Qendra historike*, kryhet dokumentimi i thellë, trellojesh, duke përfshirë mbarë ndërtimet në hapësirën brenda mureve rrethues të banesave apo brenda konturit kufizues të Qendrave historike. Kuptueshëm, çdo dokumentim pasqyron gjendjen e monumentit në momentin kur ai kryhet. Duke qenë se monumenti, si çdo kategori ndërtimore vijimisht i nënshtrohet ndryshimeve, të themi të natyrshme, krahas atyre prej faktorësh natyrorë apo njerëzorë, në disa raste shkatërruese në shkallë të ndryshme, dokumentimi i gjendjeve vijuese të monumentit është një detyrë parësore. Ky përvijim i dokumentimit në thelb është pasqyrimi i evolucionit të banesës në kohë, pasqyrim i cili ndihmon ndjeshëm vlerësimin e monumentit si dëshmitar autentik historik. Nga sa u parashtrua më sipër rrjedh natyrshëm përfundimi se krahas dokumentimit sa më të thellë dhe të imët të monumenteve të veçantë dhe Qendrave historike, vjen në përfillje dhe dokumentimi i banesave apo ansambleve, të cilët, megjithëse nuk i përmbushin kushtet për t›u mbrojtur si vlera historiko-kulturore, përmbajnë dëshmi të pjesshme të këtyre vlerave. Kuptohet se në rastin e dytë, këto vlera jashtë mbrojtjes janë të destinuara që shpejt a vonë të humbasin pakthyeshëm. Për të theksuar vlerën e pazëvendësueshme të dokumentacionit të monumenteve ripohojmë se ata natyrshëm i nënshtrohen ndryshimeve deri në vetëshkatërrim, megjithëse ndërhyrjet restauruese synojnë ruajtjen e vlerave origjinale, duke potencuar ndjeshëm vlerën e dokumentacionit, pasqyrim vijues i realitetit banesë si njësi ndërtimore në vetëdëmtim të natyrshëm, ashtu si qeniet njerëzore, siç e ka vërejtur me të drejtë Xhon Raskin. Është rasti për të vërejtur se zhvillimi i teknikës, përherë dhe me ritme të shpejta ka ofruar mënyra të reja dokumentimi dhe ruajtje të këtij dokumentimi. Gjithë duke rekomanduar përvetësimin e këtyre të rejave, të cilat përgjithësisht karakterizohen prej shpejtësisë dhe saktësisë së kryerjes, theksojmë domosdoshmërinë e digjitalizimit të dokumentacionit të kryer sipas metodave tradicionale. Digjitalizimi, përveçse shmang rrezikun e humbjes së dokumentacionit tradicional, ofron mundësi të gjera për të qenë i afërt për çdo studies, kurdo dhe kudo qoftë, në të mirë të përmbushjes sa më mirë të funksionit të monumenteve si dëshmi autentike historiko-kulturore.

DO NOT COPY

Siç kemi përmendur, studimet e derisotme në fushën krahasimisht të re të kërkimeve albanologjike, atë të banesës popullore shqiptare, natyrshëm kanë qenë të karakterit tipologjik apo të klasifikimit mbi bazën e dukurisë thelbësore, asaj të kompozimit arkitekturor. Ky klasifikim parakupton njohjen e karakteristikave dhe evolucionit të elementeve arkitekturore, ornamentikës dhe teknikës së ndërtimit. Për arsye të kuptueshme, në rastin shqiptar dhe më gjerë, këto studime nuk kanë qenë të thelluara, sepse faktori kohë ka kërkuar urdhëruesheëm që procesi i mbrojtjes së banesave-monument të kryhej sa më shpejt, për të penguar shkatërrimin e tyre për shkaqet e njohura. Është momenti për të përsëritur se edhe në këtë fushë, kuptueshëm, po gjen zbatim parimi i mirënjohur metodik i kalimit prej së veçantës në të përgjithshmen dhe e kundërta, e sërish i përsëritur, në shkallë më të lartë gjerësie dhe thellësie, duke synuar afrimin drejt së vërtetës. Në këtë kontekst, elementet arkitekturorë, ornamentika dhe teknika e ndërtimit duhet të jenë objekt vrojtimesh sistematike, kryesisht duke u mbështetur në banesat-monument si dhe ato që ruajnë elemente të kategorive të mësipërme. Siç kemi përmendur në kërkimet pararendëse, elementet arkitekturorë shfaqin një zhvillim të qëmtueshëm, i cili është më i shpejtë në banesat e shtresave të pasura, gjithë duke qenë e pranishme dukuria e huazimeve. Ornamentika, kuptueshëm me dendësi dhe arritje më të mëdha dhe vlera të spikatura me banesat e shtresave të pasura është me zhvillim të shpejtë kohor, veçanërisht gjatë shekullit XIX, në banesën shqiptare. Ornamentika është fushë në të cilën huazimet, madje ballore, shfaqen më qartazi, për arsye se këta elementë nuk janë funksionalë dhe si të tillë kanë një pavarësi relative prej dobishmërisë së shfrytëzimit të banesës. Teknika e ndërtimit, kuptueshëm është kategoria më konservatore dhe njëherazi gjerësisht mbarë etnike.

Studimi i tre kategorive të përmendura dhe veçanërisht elementeve arkitekturore dhe ornamentikës, paraqesin fusha thuajse të palëvruara sistematikisht.

Identifikimi i evolucionit të këtyre kategorive në kohë, i cili bashkëpërfshin karakterizimin e tyre kompozicional dhe teknik, eventualisht me vendosjen në kohë të varianteve të ndryshëm dhe domosdoshmërish vendosjen e këtyre varianteve në kronologji relative është synim për t'u arritur. Studimet në fushat e përmendura do



Fig. 5. Kompleksi i Kullave të Dervish Aliut, Dukat, Vlorë

DO NOT COPY

të ndihmonin në vendosjen sa më të përafërt të banesave-monument në kohë, do të qartësonin ndjeshëm ndikimet e ndërsjella në hapësirën shqiptare dhe më tej të këtyre dukurive dhe gjithashtu do të ishin mbështetje për vënien në mbrojtje të banesave, apo pjesëve të tyre.

Mendoj se në arritjet e shëndosha të klasifikimit të banesës popullore shqiptare, ende është e pranishme një çështje, ajo e kritereve të panjësuar të klasifikimit tipologjik të banesave fshatare dhe atyre qytetare. Banesa fshatare shqiptare (Fig. 5) është e klasifikuar sipas kriterit hapësiror, ndërsa ai banesës qytetare shqiptare sipas kriterit tipologjik. Është rasti për të theksuar se këto kritere, megjithëse duken si të ndryshëm, në të vërtetë kanë paralele, sepse kriteri i klasifikimit hapësiror, apo krahinor, e bashkëpërfshin kriterin tipologjik. Sidoqoftë, duke pasur parasysh bashkëmarrëdhëniet banesë fshatare-banesë qytetare, përherë të pranishme, me kahe dhe dendësi të ndryshme në kohë dhe hapësirë, mendojmë se karakteri plotësisht i njëjtë klasifikues, për të dy këto kategori, do të pasohej me më shumë qartësi në karakterin e këtyre ndërtimeve. Pa e cilësuar këtë kërkesë si të domosdoshme, besojmë se edhe nëse nuk arrihet në njësim, sigurisht mbi bazën tipologjike, besojmë se do të bëhen përpjekje për të sqaruar bashkëmarrëdhëniet organike të këtyre dy kategorive ndërtimore, në dobi të qartësimit të së vërtetës historike.

Gjithë duke i qëndruar mendimit se nuk ka lidhje shkak-pasojë ndërmjet etnisë dhe tipologjisë së banesës popullore, mbetemi me tezën se thelbësisht për rrethanat ekonomiko-shoqërore, etni të ndryshme dallojnë edhe prej parapëlqimit për tipologji të caktuara, në periudha të caktuara. Natyrisht, kjo tezë parakupton afritë deri në identitet sipas radhës me teknikën e ndërtimit, dekoracionin, kompozimin dhe elementet arkitekturore. Studimi i dallimeve dhe afrive të banesës popullore shqiptare me atë të popujve të tjerë ballkanikë, përgjithësisht është në fazën fillestare. Megjithatë, në disa raste, nga disa studiues turq apo grekë, shfaqen në mënyrë të paargumentuar pikëpamje të teorisë të importimit, apo të popujve "krijues" dhe atyre "përvetësues". Kuptohet, cilësori i parë i vetëatribuohet kombeve të studiuesve përkatës. Thellimi i studimeve dhe rruga drejt përmirësimeve të karakterit metodik të fushës kërkimore të banesës popullore, në të dy rastet kanë prurë reagime positive, së pari prej studiuesve, bashkëkombës të tezave të përmendura. Ende, rruga për të ecur drejt së vërtetës është e përshkruar do të thoshim, edhe sepse metodikat e studimeve të së njëjtës kategori ndërtimore, banesës, nuk janë të njëjtat, rrjedhimisht ato theksojnë dukuri dytësore apo arrijnë në pseudopërfundime, të cilat thuajse pamundësojnë përqasje apo krahasime të kësaj dukurie arkitekturore në hapësirë dhe kohë. Shembujt krahasimisht të pakët të banesave që ende ruhen, gjithashtu, janë shkak për përgjithësime mbi baza të kufizuara të dhënash autentike. Këto rrethana e bëjnë të domosdoshëm bashkëpunimin mbarëballkanik të studiuesve të fushës dhe do të thoshim kryesisht përpjekjeve për njësimin e metodës studimore.

Një çështje e rëndësishme është ajo e zbatimit të kritereve të restaurimit në kategorinë e banesave-monument. Në dallim prej gjinive të tjera, si ndërtimet mbrojtëse, ato të kultit etj., të cilat nuk paraqesin problematikë lidhur me vendin e tyre në jetën e sotme dhe më tej, për shkak të daljes përfundimisht prej funksionit apo të ruajtjes së pacënuar të funksionit fillestar, kategoria e banesave shfaq dukuri të veçantë. Lidhja e ngushtë shkak-pasojë e banesave me kushtet jetësore e bën atë një kategori qartazi evolutive. Për këto arsye, shfrytëzimi për banim i këtyre monumenteve, pa cënuar vlerat për të cilat ato ruhen është problematik. Në këto rrethana, kriteret e restaurimit, megjithëse tashmë të kristalizuara, shfaqin hapësira për keqinterpretime, në dëm të vlerave të monumenteve. Në këto rrethana, rigororoziteti në interpretimet e drejta të parimeve të restaurimit merr përparësi të domosdoshme. Krahas dhe bashkëpërfshirja e këtyre monumenteve në jetën në vijim kërkon interpretim të drejtë të kritereve të restaurimit.

Monumentet e kulturës në përgjithësi dhe banesat-monument në veçanti funksionin e tyre thelbësor, si dëshmitare autentike të histories, e kryejnë përherë dhe më prekshëm atëherë kur vlerat e tyre janë të njohura prej sa më shumë qytetarësh. Gjithë duke qenë historia e një kombi dhe më gjerë, fushë kërkimore e studiuesve përkatës, këto vlera dokumentare, të shtjelluara si të tilla prej specialistësh, e kryejnë përherë dhe më mirë funksionin e tyre kur bëhen objekt vrojtimi prej sa më shumë shikuesish. Për këtë arsye, popullarizimi sa më i gjerë i këtyre vlerave i bën ato, të themi, më veprimtare në bashkëpërputhje me vlerat si dëshmitare historike-kulturore. Në vijim të përpjekjeve për të bërë të njohura këto vlera vijnë në përfillje botimet e

studimeve për to dhe veçanërisht ata përgjithësues. Besojmë se, megjithëse tashmë mjetet e reja dhe përherë në rritje të informacionit po shumohen dhe përsosen, libri mbetet mjeti efikas për përhapjen e dijeve. Botimet në fushën e banesës popullore shqiptare, të shoqëruara me material dokumentar grafik dhe fotografik, krahas atyre në formë albumesh, janë të realizueshme, madje me shkallë të spikatur vërtetësie, për shkak të kërkimeve sistematike, shoqëruar me grumbullim të gjerë të dhënash dokumentare. Krahas, ka ardhur koha që botimeve në gjuhë të huaja dhe posaçërisht në gjuhën angleze, faktikisht përherë dhe më bindshëm gjuhë ndërkombëtare, t›iu kushtohet rëndësia e duhur. Trashëgimia kulturore shqiptare, ashtu si ajo e mbarë popujve i përket mbarë njerëzimit.

Cilësimi i Qendrave historiko-kulturore, antiko-mesjetare të Butrintit, Beratit dhe Gjirokastrës «pasuri botërore», është dëshmi e prekshme e konsideratave të mësipërme. Më tej, vlerat shumërrafshëshe të dëshmive materiale historiko-kulturore të etnosit iliro-arbëresho-shqiptar, pra edhe të banesës popullore shqiptare, duhet të bëhen pjesë e programeve shkollore dhe atyre universitare të fushës së arkitekturës. Kjo nënkupton edhe përgatitjen e teksteve përkatës, për të bërë më të arritshëm thelbin e dukurive të trajtuara prej nxënësve dhe studentëve.

Duke përfillur të vërtetën se sa më e gjerë të jetë masa e qytetarëve të cilët vlerësojnë dobinë e vënies në mbrojtje të vlerave të kulturës materiale, pra edhe të banesave, bëhet i nevojshëm njoftimi i mbarë bashkësisë qytetare, e cila nuk është drejtpërdrejtë, apo tërthorazi njohëse e kësaj pasurie. Më prektas, duke qenë botimet e kualifikuara të fushës, kuptueshëm larg interpretimeve të shtresave të gjera të shoqërisë, është e nevojshme që botimet me karakter popullarizues të fushës së monumenteve, pra dhe të banesës popullore shqiptare, të jenë synim i popullarizuesve dhe studiuesve të fushës. Botimet popullarizuese, gjithë duke paraqitur të vërtetat, i çlirojnë ato prej profesionalizmit analizues dhe për pasojë vështirë të kuptueshëm për këdo. Këto botime i afrojnë shpejt qytetarët me vlerat me të cilat ata janë në ndërlidhje të shkallëve të ndryshme dhe për pasojë i bëjnë ata njohës të këtyre vlerave, pra mbrojtës dhe jo cënues të tyre, për nevoja pragmatike të zhvillimit të mënyrës së re të jetesës.

Kjo përpjekje për të paraqitur përmbledhtazi arritjet dhe rrugën për të ardhmen në vlerësimin e banesës popullore shqiptare, pa përjashtuar veçantitë e kësaj kategorie ndërtimore, përfshin mbarë trashëgiminë e kulturës sonë materiale sot dhe besojmë edhe në të ardhmen problematike. Themi kështu sepse ruajtja e banesave tradicionale, të ndërtuara në rrethana të caktuara historiko-shoqërore, është vështirë të përfshihet lehtë në të tjera kushte, të cilat janë vijimisht në rrugën e ndryshimeve, madje me ritme përherë dhe më të përshpejtuara.

Siç kemi përmendur, fusha e re e studimeve albanologjike, ajo e banesës popullore shqiptare, i ka fillesat rreth viteve ‹60-të të shek. XX. Sot, pas gjysmë shekulli, duke marrë për bazë dendësinë dhe thellësinë e veprimtarisë shumërrafshëshe vlerësuese, periudhën që prej viteve 1960 dhe deri më sot mund ta ndajmë në dy etapa, atë të viteve 1960-1990 dhe të dytën prej cakut të dytë kohor (ose nga viti 1990) dhe në vazhdim. Siç shihet, ky cak kohor lidhet me ndryshimin e formës së drejtimit të shtetit, prej atij komunist, apo më saktë të bolshevizmit të skajmë enverist dhe pas 1990, vendosjes së sistemit demokratik në formë dhe synues në rritje dhe në përmbajtje. Dy cilësorët e fundit i theksojmë sepse formalisht edhe sistemi enverist kishte struktura dhe metoda të shumta pseudodemokratike të drejtimit si parlamenti, institucioni i zgjedhjeve dhe më gjerë "sundimin e vendit prej popullit". Siç kemi theksuar edhe më herët, kujdesi për vlerësimin e banesës popullore tradicionale dhe në përgjithësi i monumenteve kulturore të paluajtshëm, të luajtshëm dhe jomaterialë lidhej së pari me vetëmbyllen vetërrënuese të vendit, e cila pretendonte se nuk sillte boshllëqe, sepse ne kishim gjithçka tonën edhe në fushën e trashëgimisë kulturore dhe së dyti gjendjen krahasimisht të mirë të kësaj trashëgimie, për shkak të prapambetjes ekonomike. Synimi edhe për autarkizëm kulturor, po aq dëmprurës sa ai ekonomik, pavarësisht se qe tejet rrënues, në fushën e trashëgimisë kulturore pati mjaft dukuri pozitive, siç tregojnë arritjet madhore të tre dhjetëvjeçarëve të fundit të diktaturës. Lidhja e vlerësimit të veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore në formën e regjimit është e kuptueshme, po të kemi parasysh se kjo fushë kërkon investime dhe institucione të fuqishme, të cilat mund t'i krijojë dhe mbajë vetëm shteti, pa përjashtuar bashkëpërfshirjen e ndihmuesve individualë dhe kolektivë, brenda dhe jashtë vendit. Rënia e përkujdesjeve të shkallës së duhur për trashëgiminë kulturore, pas vendosjes së sistemit

BOTIMET

demokratik ashtu si në mbarë vendet e Europës Lindore, ka qenë së pari i pakuptueshëm. Sot, besoj se shpjegimi duhet kërkuar në thelbin e sistemit kapitalist, i cili thuajse çdo veprimtari e gjen të dobishme kur ajo është fitimprurëse. Rigjallërimi i kujdesit për trashëgiminë kulturore, me fillesat e turizmit kulturor fitimprurës mbështet gjykimin e mësipërm. Pavarësisht prej këtij vëzhgimi, po qëndrojmë në veprimet, apo mosveprimet e pas viteve 1990, në lidhje me vlerësimin e monumenteve në Shqipëri. Zvogëlimi i fondeve shtetërore për vlerësimin e monumenteve duhet mbajtur si shkaku kryesor i rënies së ritmit të ndërhyrjeve restauruese dhe më gjerë i përkujdesjeve për këtë trashëgimi të pakthyeshme. Krahas, skema organizative me Institutin e Monumenteve në qendër dhe Degët dhe Atelietë, pjesë organike e tij në rrethe që ishin njësi vepruese për vlerësimin e monumenteve u tjetërsua. Kështu, Degët dhe Atelietë u vunë në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ndërsa njësitë e gjera prej drejtuesish teknikë, mjeshtrash dhe punëtorësh pranë secilës njësi rajonale, të cilat zbatonin projektet e restaurimit të hartuara prej sektorëve përkatës të IMK u shpërbënë, duke u zëvendësuar prej ndërmarrjesh private ndërtimi, të cilët fitonin të drejtën e zbatimit të projekteve përkatës në atë konkurs që emërtohej tender dhe i zbatonin ato. Të dyja këto masa cënuan rëndë centralizmin profesional, garanci për zbatimin sa më të përpiktë të vlerësimit të monumenteve dhe kryerjen e ndërhyrjeve restauruese prej mjeshtrash të specializuar në punë dhe nëpërmjet punës me monumentet. Mosndjekja e gjendjes së monumenteve, anashkalimi i ndërhyrjeve mirëmbajtëse, thelbit të restaurimit, pra ruajtjes së substancës origjinale të veprës dhe përqendrimi i fondeve të pakëta në disa monumente, u shfaqën tejet negative dhe dëmtuese të vlerave origjinale të monumenteve. Ulja e ritmit të botimeve dhe ngadalësimi i procesit të formimit të vijueshëm të specialistëve të kësaj fushe, sa të re aq edhe të veçantë, kanë krijuar një gjendje problematike. Për të përdorur një shprehje disi të moderuar do të pohonim se, përkujdesjet për monumentet janë tepër larg kërkesave urdhëruese për ruajtjen e vlerave origjinale të tyre, si të tilla të pakthyeshme. Në mbarë gjinitë e monumenteve, në atë të banesës popullore, dëmtimet janë më të dendura, madje edhe në Qendrat historike të Gjirokastrës dhe Beratit, të cilat në sajë të vlerësimit sistematik të tyre, që pas shpalljes në mbrojtje shtetërore si qytete muze në vitin 1962, përkatësisht në vitet 2005 dhe 2008, për vlerat e tyre universale u shpallën Pasuri Botërore prej UNESKO-s. Gjendja e banesave fshatare në mbrojtje është sa e panjohur aq edhe me dëmtime deri në tjetërsime thuajse të plota. Kthesa e shfaqur vaktas rreth viteve 2005 duhet thelluar, duke i kushtuar përparësi njohjes së gjendjes *së* monumenteve, për pasojë radhës dhe shkallës së ndërhyrjeve restauruese.

* * *

Tashmë, me arritjen në kufirin kohor prej pesë dhjetëvjeçarësh në fushën e vlerësimit të banesës popullore shqiptare dhe veçanërisht asaj qytetare, gjithë duke e mbajtur atë si një fushë të re të kërkimeve albanologjike, krahas sugjerimeve të mësipërme të karakterit të përgjithshëm dhe njëherazi praktik, ndjej nevojën të parashtroj dhe konsideratat e mëposhtme. Idetë e drejta, kryesisht vlerësuese të pasurisë historiko-kulturore banesë tradicionale dhe më tej metodiko-kërkimore për hulumtimin dhe studimin e saj, kryesisht si dëshmi autentike e së kaluarës, mbeten jashtë dobishmërisë pa qenë përvetësuar dhe zbatuar e njëherazi përmirësuar prej profesionistësh. Është fjala për profesionistët e fushës së vlerësimit të banesës, e cila bashkëpërfshin dy disiplinat bashkëplotësuese, studimin e banesës popullore dhe restaurimin e saj. Për arsye se kjo fushë kërkimore është krahasimisht e re, madje edhe në vende me tradita të hershme kulturore, përgatitja e profesionistëve të fushës, kryesisht arkitektë apo inxhinierë ndërtimi paraqet veçanti, duke qenë vetëformimi rruga më efikase, siç ka provuar bindshëm rasti shqiptar. Në këtë kontekst, prej përvojës personale dhe asaj të kolegëve këshilloj ngultas tre rekomandime.

Së pari, jeta e kufizuar njerëzore, e cila së shumti lejon periudhën rreth gjysmë shekullore për të punuar, nëse synohen arritje të reja dhe të qëndrueshme e **të sakta,** kërkon që kjo hapësirë kohore t›i kushtohet tërësisht fushës në trajtim, ashtu si dhe atyre paralele.

Së dyti, në vijim të kohës, hapësira e fushës kërkimore duhet të jetë përherë e në vazhdim në ngushtim, për të mundësuar thellimin e studimeve. Shembujt e shkencave ekzakte bashkëkohore janë tepër treguese në këtë këndshikim. Arritjet në fusha të ndryshme kërkimore i detyrohen kryesisht hulumtimeve në fusha të ngushta gjatë gjithë jetës,

DO NOT COPY

krahasimisht të shkurtër dhe fatkeqësisht me fund, pikërisht atëherë kur profesionisti ka arritur grumbullim të pasur përvoje dhe ka dhënë vepra me vlerë për fushën.

Së treti, fusha e studimit dhe restaurimit të banesës popullore kërkon urdhërueshëm që studimet të bashkërendohen, madje thellësisht dhe vijueshmërisht me qëndrimin pranë monumenteve, për studimin dhe ndjekjen e ndërhyrjeve restauruese në to. Arritjet e një brezi i përjepen brezit tjetër, i cili i thellon për t'ia kaluar brezit pasardhës dhe kështu vijueshëm, duke iu afruar përherë e më afër së vërtetës, thelb i çdo kërkimi.

Duke vrojtuar veprimtarinë, siç thashë, gjysmë shekullore në fushën e banesës popullore shqiptare, besoj se ajo ka krijuar një mbështetje në këndshikimin metodik, duke përfshirë kryesisht kriteret e klasifikimit tipologjik, ndjekjen e evolucionit të hapësirave të banimit dhe atyre dytësore, karakterin dhe zhvillimin kohor të elementeve arkitekturore dhe teknikës së ndërtimit, si dhe zbatimin e kritereve universale të restaurimit në këtë fushë të kërkimeve albanologjike. Gjurmimi i banesës qytetare kosovare dhe botimet e studimeve mbi të më ka dhënë një kënaqësi të veçantë, krahas gëzimit të çdo botimi, shpërblimeve thuajse të vetme për mbarë përkushtimin e veprimtarisë në fushën e banesës shqiptare, tashmë pjesë e trashëgimisë kulturore të etnosit iliro-arbëresh-shqiptar, pra e historisë së tij shumë shekullore.

BIBLIOGRAFIA

1. Baçe, A., Meksi, A., Riza, E., Karaiskaj, G., Thomo, P., "Gjendja dhe arritjet e studimeve të historisë së arkitekturës shqiptare", *Monumentet*, 1977, 13, f. 5–29.
2. Baçe, A., Meksi, A., Riza, E., Karaiskaj., Thomo., *Historia e arkitekturës shqiptare*, Tiranë, 1979.
3. Baçe, A., Meksi, A., Riza, E., *Berati, historia dhe arkitektura*, Tiranë, 1988.
4. Meksi, A., *Restaurimi i monumenteve të arkitekturës,* Tiranë, 2004.
5. Muka, A., *Banesa fshatare dhe familja e madhe,* Tiranë, 2001.
6. Muka, A., *Ndërtimet tradicionale fshatare,* Tiranë, 2007.
7. Riza, E., *Ndërtimet fshatare në Labëri,* Tiranë 1984.
8. Riza, E., Thomo, P., *Architecture traditionnelle des Balkans-ALBANIE,* Athènes, 1997.
9. Riza, E., *Qyteti-muze i Gjirokastrës*, Tiranë, 1981, Ribotuar, Tiranë, 2004.
10. Riza, E., *Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri*, Tiranë, 1997.
11. Riza, E., *Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës*, Tiranë, 2002.
12. Riza, E., Haliti, Nj., *Banesa qytetare kosovare e shek.XVIII-XIX*, Prishtinë, 2006.
13. Riza, E., *Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare shek.XV-XIX*, Tiranë, 2009.
14. Riza, E., *Banesa popullore shqiptare",* Tiranë, 2010.
15. Riza, E., *Banesa popullore e Prizrenit*, Prizren, 2013.
16. Riza, E., *Arkitektura popullore dhe vlerësimi i saj*, Tiranë, 2013.
17. Drançolli, F., *Kulla shqiptare,* Prishtinë, 2001.
18. *Karta ndërkombëtare e konservimit dhe restaurimit të monumenteve dhe ansambleve monumentale*, Venecia 25-31 maj 1964.
19. Thomo, P., *Banesa fshatare e Shqipërisë veriore*, Tiranë, 1981.
20. Thomo, P., *Korça, urbanistika dhe arkitektura*, Tiranë, 1988, ribotuar, Tiranë, 2012.
21. Thomo, P., Riza, E., «Kritere dhe metoda për gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve popullore në R.P.Sh.», *Monumentet*, 1983 (25), f. 5-17.
22. Vendbanimet dhe banesa popullore shqiptare,vëll. 1, Redaksia: prof. dr. Pirro Thomo, redaktor përgjegjës, prof. dr. Ali Muka, prof. dr. Emin Riza, Tiranë, 2004

DO NOT COPY

Academic Emin RIZA

ALBANIAN VERNACULAR ARCHITECTURE, ACHIEVEMENTS AND ITS FUTURE

The research activity in the albanian dwellings' field, as well as in all other albanological sciences belongs to all generations, with the aim to get much more closer to the truth. This acticity in Albania began around 1960. The preservation in an approximately good condition of the traditional albanian dwellings until half of the last century, makes effective the tracking and protecting activity of its most representative values. Thanks to the archaeologist Gani Strazimiri, during 1961, the historical centres of Berat, Gjirokastër and Kruja's Old Bazaar were taken under protection. Especially after 1970, the activity for tracking, documenting, putting under protection and restoring of traditional dwellings continuously expanded.

The main criteria for the implementation of protection of dwellings, qualified as monuments were: the typological criterion, the authenticity, the architectural values, the chronology and spatial distribution.

An albanian dwelling means a dwelling built by albanians, generally in their own land, in Montenegro, Serbia, Kosovo, Macedonia, Greece and as well as by the arbëresh population in Italy. By work and through it, the evaluation field of traditional albanian dwellings came to important conclusions, which were reflected in a wide publishing activity. We would recommend the following operations for further activity in the field of evaluation of traditional albanian dwellings.

1. Continuation of tracking activity and putting under protection the values of traditional dwellings;
2. Expansion and deepening of the monument-dwellings;
3. Deepening of multilateral studies of the albanian dwellings;
4. Further computation of the classification criteria for the rural and urban dwellings;
5. Deepening the studies over the position of albanian's dwellings in the Balcan area;
6. Deepening of studies on the traditional dwelling and construction communities with generalizing aims and their publishing in albanian language and other known languages;
7. Inclusion of albanian construction inheritance and its restorations as a subject in college and high schools;
8. Incrising of attention for divulgative publications in the field of albanian traditional dwellings.

DO NOT COPY

monumentet
52/2011 - 2014

Nikolla CIVICI*
Edlira ÇAUSHI**
Ilaria CAROCCI***
Stefano RIDOLFI***

DO NOT COPY

EKZAMINIMI DIAGNOSTIKUES ME TEKNIKA JO-SHKATËRRUESE DHE PORTATIVE NË PIKTURAT MURALE TË KISHËS SË SHËN MËRISË VLLAHERNA NË KALA, BERAT

I. Hyrje

Në kuadër të programit ekzekutiv për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik mes Qeverisë së Republikës Italiane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për periudhën 2008-2010, dhe më në veçanti të projektit "Hartimi i procedurave për analizën jo shkatërruese të objekteve arkeologjikë me anë të sistemeve portabël", një ekip i përbashkët i përbërë nga restauratorë dhe kërkues shkencorë kryen ekzaminimin e një pjese të pikturave murale të murit veri-perëndimor të Kishës Shën Mëri Vllaherna (Kala, Berat) lidhur me diagnostikimin dhe monitorimin e gjendjes së konservimit të sipërfaqeve të pikturuara.

Gjatë këtyre ekzaminimeve, të gjitha me natyrë jo-shkatërruese dhe të kryera në vend janë kombinuar metodat tradicionale që përdorin restauratorët për ekzaminimin e gjendjes së konservimit të pikturës murale (rilevimet grafike, fotografim me dritë të dukshme, etj.) me metoda më të avancuara, si fotografimi me dritë normale por ndriçim anësor (dritë rrëshqitëse), fotografimi me dritë ultraviolet (UV) dhe analiza e materialeve të pikturimit me anë të metodës së fluoreshencës së rrezatimit X me dispersion energjetik (EDXRF). Krahas këtyre, për një periudhë të kufizuar kohore, në ambientet e kishës u krye edhe monitorimi i parametrave termikë dhe higrometrikë.

Në përputhje me objektivin e projektit, këtu propozohet një procedurë komplekse për ekzaminimin diagnostikues të gjendjes së ruajtjes së pikturave murale e cila bashkon në një zgjidhje të vetme informacionin e marrë nga ekzaminimi vizual me ato të dala nga analizat jo shkatërruese EDXRF, UV dhe ndriçimit anësor. Informacioni i mbledhur nga përdorimi i një kompleksi të tillë metodash na lejon krijimin e një tabloje më të qartë mbi gjendjen e konservimit të pikturave murale si dhe mbi shkaqet që mund të çojnë në dëmtimin e tyre të mëtejshëm.

Në vijim sillen disa koncepte themelore në lidhje me metodat analitike dhe sistemet portativë të përdorur, rezultatet e fituara nga çdo teknikë lidhur me gjendjen e ruajtjes së pikturave, shënime të shkurtra shpjeguese bashkangjitur tabelave përkatëse dhe sidomos kriteret e përdorura në zgjedhjen e nomenklaturës dhe të simboleve të përdorura në përpilimin e rilevimit diagnostikues (Fig.1).

* Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës.
** Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri".
*** ARS MENSUARAE, Via Comparini, 101, 00188 Roma, Italy.

DO NOT COPY

II. Shënime historiko-artistike

Kisha e Shën Mërisë Vllaherna ndodhet në zemër të Kalasë së lashtë të Beratit, e cila është shpallur Sit i Trashëgimisë Botërore të Njerëzimit (UNESCO) që nga korriku 2008[1] (Fig. 2, 2,1). Themeluar nga ilirët në shekullin IV p.e.s., kështjella u rindërtua pothuajse tërësisht në vitin 1205 nga Mihali I Engjëll Komneni[2] Despoti i Epirit, për të arritur deri në ditët tona, duke i shpëtuar në të njëjtën kohë edhe zjarreve, edhe tërmeteve të shumta. Të njëjtin fat ka pësuar edhe kisha bizantine e Shën Mërisë Vllaherna brenda fortifikimeve të kështjellës[3]. Ajo është një shembull i rrallë i arkitekturës së asaj periudhe dhe një nga kryeveprat artistike të kohës. Gojëdhënat thonë që është kisha më e vjetër në Berat, por nuk kemi akoma të dhëna të mjaftueshme për datimin e saktë të ndërtimit të saj. Përsa i takon pikturës murale kemi faza të ndryshme të pikturimit të brendësisë së kishës. Faza e fundit është ajo e cituar në mbishkrimin e madh të murit perëndimor mbi portë, ku thuhet se tempulli është pikturuar prej Nikollës, të birit të Onufrit në vitin 7086 (1578).

Ajo përfaqëson në Ballkan një nga pikturat më të rëndësishme të periudhës bizantine dhe pas-bizantine. Arti i Mjeshtrit Nikolla shfaqet përtej kompleksit ikonografik, në elegancën dhe solemnitetin e madhërishëm të figurave të pikturuara me kostume luksoze, me ngjyra të pasura dhe pigmente të shtrenjtë[4]. Detajet e përpiktë dhe mënyra e lëvizjes së figurave duken të pazakontë për kohën për të cilën flasim.

Përkundër restaurimeve të mëparshme dhe të vazhdueshme, mirëmbajtjes rutinë dhe ndërhyrjeve, kisha ende ka probleme serioze të natyrës së konservimit, si në strukturën arkitekturore, ashtu edhe në aparatin dekorativ të brendshëm. Mureve të eksterierit, nuk i kanë mbetur veçse disa gjurmë të vogla sipërfaqesh të dekoruara.

[1] Në vitin 2008, Berati u klasifikua në sitet e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si nominim në seri, së bashku me Gjirokastrën që paraprakisht ishte përfshirë në këtë listë në vitin 2005; Cfr *http://whc.unesco.org/en/list/569. For an overview of Albania's main architectural emergencies cfr. UNESCO S.D*

[2] Baçe, Apollon, "Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër)", *Monumentet,* 4/1972; fq 103

[3] Meksi, Aleksander, "Tri kisha bizantine të Beratit", *Monumentet,* 4/1972; fq 59;

[4] Puzanova, V., Popa, Th., "Mbi punimet e piktor Nikollës në kishën Vllaherna (në kështjellën e Beratit)", *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore*, Tiranë,1957, 2, f. 64-75

Rezultatet e hulumtimeve

III. Teknika e realizimit të afreskut (Fig. 3)

Sipërfaqja e pikturës së ekzaminuar i përket murit perëndimor të kishës së Shën Mërisë Vllaherna. Pikërisht në regjistrin e dytë përbri portës perëndimore të hyrjes në kishë gjejmë të pasqyruar dy figura shenjtorësh luftëtarë, atë të Shën Theodhor Stratilatit dhe Shën Theodhor Tironit. Këta dy shenjtorë luftëtarë paraqiten në këmbë, ku i pari mban në njërën dorë heshtën dhe në tjetrën mburojën, ndërsa tjetri përveç mburojës, në dorën tjetër mban shpatën[55].

Ata paraqiten si dy figura shumë ekspresive, mjaft të arrira artistikisht po aq sa teknikisht, me ngjyra të gjalla, me shumë detaje në veshjet e tyre të zbukuruara me elemente dekorative të shumëllojshëm.

Sipërfaqja e pikturës së ekzaminuar, që i përket murit perëndimor të Kishës së Shën Marisë Vllaherna është realizuar në teknikën e afreskut të përfunduar me zbukurime në të thatë, për të lejuar përdorimin e pigmenteve të ndryshme të papajtueshëm me teknikën e pikturës në të njomë.

Aplikimi i suvasë në pjesën e ekzaminuar duket të ketë ndodhur me një seancë të vetme e quajtur edhe "*giornata*", sepse nuk duken gjurmë karakteristike të bashkimit të sipërfaqeve të ndryshme të suvasë që na ndihmojnë të kuptojmë ditët e punës së autorit. Kjo tregon edhe për një teknikë mjaft të mirë dhe cilësore të realizimit të pikturës murale nga autori.

Një karakteristikë e realizimit të pikturës murale të kishës në fjalë është edhe përhapja në afresk e ngjyrës bazë të një sipërfaqe të caktuar dhe më pas punimi me penelata mjaft korpoze të detajeve të konsiderueshme e zbukurimeve dekorative, palave dhe tipareve në portrete apo elementeve karakteristike për çdo figurë.

IV. Gjendja e konservimit të afreskeve (Fig. 4)

Afresket paraqesin probleme serioze të konservimit,

[5] Në fillim të shekullit IV një ushtar romak me emrin Teodor martirizohet dhe varroset në Amasea. Menjëherë fillon kulti i këtij shenjtori duke u përmendur në kronikat e kohës si SHEN TEODORI I AMASEAS. Menjëherë pas vitit 1000 përhapet kulti i një tjetër shenjtori me emrin Teodor GJENERAL, romak i martirizuar në të njëjtën periudhë dhe vend me atë të Shën Teodorit të Amaseas. Në fakt bëhet fjalë për të njëjtin shenjtor që në këtë rast duplikohet.

DO NOT COPY

pavarësisht nga restaurimet e mëparshme të kryera si mbi to apo në pjesën e restaurimit të arkitekturës.

Ato janë të prekura nga shkëputje të suvasë (intonakut) me një shtrirje të konsiderueshme të shpërndarë në gjithë sipërfaqen.

Ka çarje të vogla të suvasë në pjesën qendrore të figurës së Shën Theodhor Tironit dhe hapësira të mëdha mungojnë sidomos në pjesën e poshtme të sipërfaqes së ekzaminuar, të cilat janë kompensuar me stukime që janë bërë gjatë ndërhyrjeve të mëparshme mbi afresk. Asnjë prej stukimeve të realizuara në ndërhyrjet e mëparshme nuk rezulton të jetë e integruar. Zonat e mikro-lakunave të suvasë shfaqen më të dendura në pjesën qendrore të afreskut, dhe pikërisht në zonën midis dy shenjtorëve. Disa gërvishtje mjaft të rregullta të paraqitura si linja të drejta kanë dëmtuar jo vetëm pelikulin e ngjyrës por edhe shtresat përgatitore poshtë tij. Ato janë të pranishme në lartësinë e ijeve të të dy shenjtorëve në pjesën e poshtme të këmbëve dhe poshtë mburojës së Shën Theodhor Tironit.

Pelikuli i ngjyrës është sa i holluar po aq edhe i gërryer plotësisht në vende të tjera, veçanërisht në gjysmën e poshtme të afreskut, duke sjellë për rrjedhojë humbjen e pjesës më të madhe të kampiturave dhe rifiniturave të kryera në të thatë. Fenomenin e mikrolakunave e gjejmë të përhapur në të gjithë sipërfaqen. Në pjesën e sipërme të figurave vihet re një si vello e bardhë që është veçanërisht e dukshme në bustet e të dy shenjtorëve.

Depozitime sipërfaqësore të natyrave të ndryshme, si jashtëqitje shpendësh, rrjedhje dhe pikime vihen re mbi të gjithë sipërfaqen e pikturuar. Ato janë veçanërisht të dukshme në pjesën e poshtme. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së pikturuar, sot paraqitet me shkëlqim, ndoshta për shkak të një shtrese mbrojtëse prej ndonjë rezine akrilike të aplikuar gjatë ndërhyrjeve të mëparshme.

V. Rilevimi diagnostikues, simbolika dhe nomenklatura

Paraqitjet e mëposhtme të rilevimeve diagnostikues të pjesës së ekzaminuar të pikturës murale mbështeten në "Raccomandazioni NORMAL - 1/88 (1990)" përsa i përket leksikut dhe simboleve grafike të përdorura, duke i integruar në ngjyra dhe zëra me paraqitjet e propozuara nga ICR[6] në rilevimet e Kapelës së Scrovegni në Padova[7].

Në rilevimin diagnostikues të Kapelës së mësipërme janë integruar informacionet nga analizat XRF me të dhëna mbi gjendjen e ruajtjes së veprës.

Në këto rekomandime specifikohen leksiku dhe simbolet grafikë të paraqitjes së zërave të ndryshëm që përfshihen në rilevim

Gjendja e konservimit të shtresave përgatitore (Fig. 5, 6, 7)

VI. Dokumentime fotografike me dritë anësore (rrëshqitëse)

Fotografitë me dritë anësore (rrëshqitëse) japin informacion të vlefshëm në lidhje me teknikat e realizimit të pikturës murale si dhe gjendjen e konservimit të afreskut. Ato zakonisht realizohen duke e ndriçuar pikturën me dritë normale (të dukshme) që bie mbi të me një kënd të vogël (rrezet e dritës të jenë afërsisht paralele me sipërfaqen e pikturës).

Fotot e marra në këto kushte evidentojnë praninë në suva të ullukëve të hollë dhe paralelë. Në gjysmën e sipërme të afreskut ulluqet kanë shtrirje të rregullt dhe kryesisht të pjerrët, ndërsa në gjysmën e poshtme ulluqet duken të lakuar dhe vertikalë. Këto fakte japin informacion mbi mënyrën e realizimit të veprës dhe ulluqet mund t'i atribuohen përhapjes së një shtrese suvaje të freskët me duar të zhveshura, ku gishtat e artistit kanë lënë shenjat e tyre mbi suvanë e njomë.

Në fotot me dritë anësore të sipërfaqes së ekzaminuar nuk vihen re shenja të dukshme të ditëve të punës ('*giornata*' *apo* '*pontata*'), që janë karakteristike të punimit të afreskut mbi suvanë e njomë. Përgjithësisht nuk vihen re as gjurmë të dukshme të gërvishtjeve që përdoren për modelimin e figurave, me përjashtim të një relievi të suvasë që ndjek formën e dorës së djathtë të Shën Theodhor Stratilatit që mban heshtën e mbështetur mbi tokë. Imazhet fotografike vënë në dukje, gjithashtu, edhe ekzistencën e gërvishtjeve të drejta e të rregullta si në pozicionin horizontal (në lartësinë e ijeve të dy shenjtorëve dhe këmbëve të figurës së Shën Theodhor Tironit) ashtu edhe atë vertikal (në gjysmën e poshtme të mburojës), të cilat mund të interpretohen si linja udhëzuese të krijuara nga artisti ose si shenja referimi të realizuara për arsye të panjohura në një periudhë të mëvonshme.

Gjithashtu, vërejmë se spesori i rifiniturave dekorative të veshjeve të shenjtorëve luftëtarë rezulton më i madh se sa

kampiturat e ngjyrave mbushëse. Vëzhgimi me dritë anësore lejon edhe shqyrtimin e gjendjes së konservimit të veprës. Kështu, mbi gjithë sipërfaqen e ekzaminuar vërehen në mënyrë shumë të qartë shkëputjet e suvasë nga suporti dhe parregullsitë e murit, që tashmë e ka humbur vertikalitetin. Në këto kushte lexohet mjaft mirë prezenca e gërvishtjeve sipërfaqësore dhe mungesat e vogla të suvasë (Fig. 8, 9, 10, 11, 12, 13).

VII. Teknika e analizës nëpërmjet fluoreshencës UV (ultra violet) - (llamba e Wood-it)

Vëzhgimi i ndriçimit fluoreshent që shkaktohet nga rrezatimi ultraviolet (UV) është një metodë hulumtimi jo shkatërruese që realizohet me anë të një sistemi portativ dhe jep përgjigje të menjëhershme vetëm për shtresat e sipërfaqes së veprës së ekzaminuar.

Kjo teknikë mbështetet në vrojtimin e rrezatimit të fluoreshencës që lëshojnë molekulat e materialeve të sipërfaqes së pikturuar kur ato i nënshtrohen rrezatimit UV. Rrezet UV më energjike se rrezatimi i dukshëm (jo të dallueshme nga syri i njeriut) kanë aftësi për të bashkëvepruar me molekulat e materialeve të sipërfaqes, duke i ngacmuar ato. Kur këto të fundit kthehen në gjendjen bazë, më të qëndrueshme, rilëshojnë fotone që kanë energji më të ulët se rrezatimi UV (gjatësi më të madhe vale) dhe kështu janë të dukshme. Kjo përbën dukurinë e ndriçimit fluoreshent.

Materiale me përbërje të ndryshme kimike, që duken identike në ngjyrë dhe transparencë kur shikohen me dritë natyrale, përgjigjen në mënyrë të ndryshme nëse i nënshtrohen një burimi tjetër rrezatimi, si ai UV. Ky ndryshim konsiston në ngjyrat (gjatësi vale) dhe në intensitetin e ndryshëm të rrezatimit fluoreshent që emetojnë materiale të ndryshme. Veti veçanërisht të mira fluoreshente shfaqin komponimet organike.

Objektet artistike, dhe sidomos sipërfaqet e pikturuara, për shkak të natyrës së materialeve që përdoren për përgatitjen e tyre paraqesin përgjigje dhe nivele ndriçimi fluoreshent të ndryshëm. Kjo përgjigje shpesh ndikohet shumë jo vetëm nga prezenca e komponimeve organike (materialet lidhës të pigmenteve apo verniqet që përdoren në shtresat mbrojtëse) por dhe nga shkalla e vjetrimit të tyre. Në fakt, këto materiale me kalimin e kohës dhe nën veprimin e agjenteve ambientale pësojnë ndryshim të strukturës së tyre molekulare (polimerizim). Si rezultat i kësaj japin rrezatim të ndryshëm fluoreshent. Kështu, materialet më të vjetra (antike), që janë më të polimerizuara japin një përgjigje më intensive ndaj rrezatimit UV se ato të aplikimeve të kohëve të fundit që duken me tonalitet të errët.

Ekzaminimet u kryen duke e ndriçuar veprën me rreze UV nëpërmjet llambave të Wood-it, në kushtet e një mjedisi tërësisht të errësuar (natën). Llambat e Wood-it janë llamba të cilat emetojnë rrezatim UV nëpërmjet shkarkesës elektrike në avujt e mërkurit (Hg) në presion të ulët. Rrezatimi i fluoreshencës regjistrohet me kamera dixhitale të mbrojtur me filtra për të hequr komponentin e dukshëm parazit dhe reflektimin UV. Në këto kushte fotografimi kryhet me kohë të gjatë ekspozimi. Fotografimi lejon regjistrimin dhe bën të dukshme edhe përgjigjet më të dobëta në ndriçim fluoreshent, që nuk janë të perceptueshëm për syrin e njeriut.

Komente në lidhje me hulumtimet e kryera në afresk me fluoreshencë UV

Fotografitë e rrezatimit të fluoreshencës së induktuar nga rrezatimi UV tregojnë një përgjigje shumë të fortë tonalitetesh të verdhë-gjelbër në pjesën e sipërme të afreskut të shqyrtuar (në supet dhe mbi kokat e shenjtorëve, së bashku me sfondin e dy figurave), që i korrespondon sipërfaqes, ku, me dritë natyrale vrojtohen vellot e bardha. Materiale që kanë të njëjtën fluoreshencë janë të pranishme edhe në pjesën e poshtme të afreskut, dhe duken mjaft mirë në pjesën që korrespondon me këmbët e Shën Theodhor Stratilatit. Mbështetur në ndriçimin fluoreshent të verdhë në të gjelbër ky material mund të interpretohet si një lloj verniku i llojit terpenik (rezinë natyrale) që është aplikuar në mënyrë jo uniforme mbi sipërfaqen e pikturuar. Variacionet e intensitetit të ndriçimit fluoreshent mund t'i atribuohen ndryshimit të trashësisë së vernikut të aplikuar mbi sipërfaqen piktorike ose degradimit të ndryshëm që ka pësuar me kalimin e kohës.

Veç kësaj haset edhe prania e zonave të vogla me forma rrethore të vendosura në këmbët e të dy shenjtorëve, që kanë një ndriçim fluoreshent të verdhë shumë intensiv i cili mund t'i atribuohet pranisë së dyllit.

Pigmentet e pranishëm, me përjashtim të së bardhës, nuk duken fluoreshentë, ndoshta për shkak të hollimit të shtresës së ngjyrës që lejon shfaqjen e ndriçimit fluoreshent blu-vjollcë të suvasë nën të.

DO NOT COPY

Nga vëzhgimi me Wood vërejmë gjithashtu të evidentohet prania e jashtëqitjeve të shpendëve, veçanërisht në pjesën sipërme të afreskut, fluoreshenca me nuancë të bardhë-violet, ndërsa fluoreshenca me ngjyrën e purpurtë-violet i përket stukaturave të restaurimeve të mëparshme në gjysmën e poshtme të sipërfaqes së ekzaminuar.

Në figurat e mëposhtme janë sjellë disa detaje të rëndësishme të vrojtuara në imazhet me ndriçim fluoreshent UV (Fig. 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21).

VIII. Teknika e analizave me fluoreshencë të rrezatimit X (EDXRF)

Metoda e fluoreshencës së rrezatimit X me dispersion energjetik (EDXRF) është një metodë e njohur mirë në arkeometri, sepse ajo nuk është destruktive, ka natyrë shumë elementare dhe ekonomikisht është relativisht e lirë. Teknika bazohet në rrezatimin e një kampioni (pikturë) me rrezatim X dhe matjen e energjisë së rrezatimit X sekondar të emetuar nga atomet e materialeve të kampionit. Energjia e rrezeve X sekondare (të quajtura edhe karakteristike) është në fakt e lidhur me elementet kimike të pranishme në mostrën e analizuar dhe intensiteti i tyre është proporcional me sasinë e elementeve në mostër.

Rezultatet e marra nga kjo analizë mund të shërbejnë si për diagnostikimin e gjendjes së konservimit të një objekti kulturor dhe të ndihmojnë një ndërhyrje restauruese, ashtu dhe për qëllimin e thjeshtë të njohjes së materialeve të një vepre, pavarësisht nga lloji i ndërhyrjes. Ndër të tjera, kjo teknikë mund të përdoret si për përcaktimin e pigmenteve të përdorura në të gjitha llojet e pikturave (pikturat mbi kanavacë, dru, afreske, qeramikë, etj.), ashtu dhe për identifikimin e komponimeve që krijohen nga dekompozimi i tyre me kohën.

Identifikimi i pigmenteve të përdorur në veprat e artit është me rëndësi të madhe, si për studime arkeometrike të historisë së artit, ashtu dhe për problemet gjatë restaurimit të objekteve. Njohja e materialeve të përdorura, për shembull, mund të hedhë dritë mbi origjinën e pikturës, duke ndihmuar datimin e saj ose identifikimin e autorit kur njihet paleta e ngjyrave të tij. Nga ana tjetër kjo njohje është e domosdoshme për zgjedhjen e materialeve moderne kompatibël në ekzekutimin e restaurimit.

Ndjeshmëria moderne ndaj trashëgimisë kulturore ka çuar në zhvillimin e disa teknikave krejtësisht jo-shkatërruese, ndër të cilat një vend të rëndësishëm zë edhe teknika e fluoreshencës së rrezatimit X. Kjo teknikë lejon një identifikim të shpejtë dhe të saktë të elementeve që karakterizojnë pigmentet me origjinë inorganike duke kryer kështu analizën cilësore të zonës së analizuar. Teknika lejon zbulimin e elementeve kimike të pranishëm, por jo të komponimeve kimike, të cilëve këta elementë iu përkasin. Megjithatë, shumica e pigmenteve janë të karakterizuar nga prania e një ose më shumë elementeve dhe identifikimi i pigmenteve nëpërmjet tyre në shumicën e rasteve është i drejtpërdrejtë dhe përgjithësisht nuk është e nevojshme të përdoren teknika të tjera shkatërruese, për analiza më të thelluara.

Kapaciteti i penetrimit të rrezeve X është përgjithësisht shumë i ulët, por në rastin e pikturave, ky depërtim është sigurisht më i madh se një film pikturor, pra informacionet e marra nuk kanë të bëjnë vetëm me shtresat më sipërfaqësore të pjesës së ekzaminuar, por shtrihen gjithashtu në shtresat e poshtme duke arritur edhe bazamentin e pikturës vetë. Ky është një fakt që duhet mbajtur parasysh gjatë interpretimit të rezultateve.

Një instrument tipik i analizës me EDXRF përbëhet nga një tub i rrezatimit X, një detektor, një analizator shumë-kanalesh dhe një kompjuter. Zhvillimet e fundit teknologjike kanë bërë të mundur prodhimin e këtyre komponentëve në përmasa të zvogëluara duke ruajtur karakteristika të mira pune. Kështu, tubi X në miniaturë, detektori i vogël i ftohur në mënyrë termoelektrike dhe laptopi bëjnë të mundur që sistemi i matjes të jetë portativ dhe të mund të transportohet dhe të kryejë matje në vendin ku gjendet vepra e artit. Përmes një treguesi me diodë laser bëhet i mundur orientimi i tufës së rrezatimit në sipërfaqe disa mm^2, gjë që na lejon kryerjen e matjeve shumë selektive.

Instrumentet e përdorur

Gjatë ekzaminimeve të kryera në pikturat murale të kishës së Shën Mërisë Vllaherna në kalanë e Beratit, të dy ekipet përdorën instrumentet e tyre, përbërja dhe karakteristikat e të cilëve jepen në tabelën më poshtë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Tabela I. Të dhëna mbi sistemet e Fluoreshencës së rrezatimit X

Komponenti	**Parametrat**	**Ekipi Italian**	**Ekipi Shqiptar**
Tubi X	Tipi	Mini X	Eclipse IV
	Anoda	Ag	Ag
	Tension i lartw max (kV)	40	30
	Rryma max (μA)	100	100
	Filtri	Al, 3 mm	Ag, 0.3 mm
	Ftohja	Ajer	Ajer
	Kolimator (mm)	1.5	2
Detektori	Tipi	SDD (Silicon Drift detector)	Si PIN (Silicon PIN detector)
	Siperfaqja (mm^2)	7	7
	Trashesia (mm)	0.3	0.3
	FWHM (eV)	150	195
	Ftohja	Termoelektrike	Termoelektrike
Analizatori	Tipi	X-1-2-3	PX4
	Kanalet	1024	1024

Gjatë ekzaminimeve u kryen dy lloje matjesh: ato të përcaktuara si arkeometrike dhe ato të klasifikuara si diagnostikuese.

Matjet arkeometrike përfshijnë matjet që synojnë karakterizimin e pigmenteve të përdorura nga artisti gjatë të cilave sistemet matës optimizohen për detektimin e elementeve nga hekuri (Fe) deri tek kallaj (Sn). Gjatë këtyre matjeve instrumenti i ekipit italian punoi me tension të lartë të tubit X prej 38 kV, rrymë 25 μA dhe një filtër alumini 3-mm të vendosur para tubit, ndërsa instrumenti i ekipit shqiptar punoi me tension 30 kV, rrymë 50 μA dhe filtër argjendi 0.3 mm para tubit.

Në matjet që klasifikohen si diagnostikuese synohet të përcaktohen kryesisht elementet kimike me numër atomik të ulet (p.sh. squfuri, klori, etj.), shumica e të cilave bëjnë pjesë në produktet e dekompozimit të materialeve fillestare gjatë vjetrimit të tyre nën veprimin e agjentëve të ambientit. Për përcaktimin e këtyre elementeve, instrumenti i ekipit shqiptar punoi me tension të lartë të tubit X prej 15 kV, rrymë 20 μA dhe pa filtër para tubit, ndërsa ekipi italian përdori të njëjtat vlera të rrymës dhe tensionit por ketë radhë pa filtër (Fig. 22, 23).

Në kushtet e mësipërme, secili ekip me instrumentin përkatës të Fluoreshencë X kreu një numër total prej 23 matjesh, 18 prej të cilave të bërë sipas mënyrës arkeometrike (energji e lartë), ndërsa 5 të tjerat në mënyrën diagnostikuese (energji e ulët). Matjet u kryen mbi pjesë të ngjyrosura të skenës së ekzaminuar që u konsideruan si përfaqësuese lidhur me praninë mbi afresk të pigmenteve të ndryshme.

Në figurën 24 paraqiten pozicionet e sakta të pikave të analizuara mbi veprën (Fig. 24). Pikat e nënvizuara i korrespondojnë matjeve të bëra me të dyja mënyrat, arkeometrike dhe diagnostifikuese. Tabela II tregon listën e pikave të matjes, e pasuar nga ngjyra e zonave përkatëse dhe nga një përshkrim i shkurtër; seria e shënuar me shkronjën R i korrespondon testeve diagnostikuese në energji të ulët.

Tabela II. Pikat e matjes XRF me sqarimet përkatëse.

N° i pikave	Llojet e ngjyrave	KOMENT/ LOKALIZIMI
	1-JESHILE	Sfond i gjelbër në lartësinë e kofshës së djathtë të Shën Th. Stratilatit, pranë bërrylit të tij të djathtë
1-r	**1-JESHILE-r**	E njëjta matje e pikës 1, në energji të ulët
2	**2-E ERRET**	Hapësirë në hije e gjysmës së majtë të pelerinës së shen Th. Stratilatit, pak poshtë mesit të tij.
2-r	**2-E ERRET-r**	E njëjta matje e pikës 2, në energji të ulët
3	**3-E KUQE**	Pika qendrore e mëngës së parakrahut të djathtë të Shën Th. Stratilatit
4	**4-E VERDHE**	Dekoracion i verdhë i bordit të bardhë vertikal të mburojës së shen Th. Stratilatit
5	**5-B**	Hapësira qendrore e brezit të Shën Th. Stratilatit
6	**6-E VERDHE-OKER**	Dekoracioni i fundit të Shën Th. Stratilatit, në të majtë të dorezës së shpatës së tij
7	**7-E BARDHE**	Dekoracioni i armaturës së shen Th. Stratilatit, në qendër të barkut
8	**8-BLU**	Hapësira e sfondit në brendësi të ambientit të përshkruar nga krahu i djathtë i shen Th. Stratilatit
9	**9-VIOLA**	Corope e shen Th. Stratilatit, pranë gjurit të tij të majtë
10	**10-E KUQE-ME SHKELQIM**	Rrudhosje në dritë e gjysmës së djathtë të mantelit të Shën Th. Tironit
11	**11-E KUQE-E ERRET**	Rrudhosje në hije e gjysmës së djathtë të mantelit të shen Th. Tironit, afër pikës së mëparshme
12	**12-OKER**	Hapësirë në dritë mbi kërcirin e majtë të Shën Th. Tironit
12-r	**12-OKER-r**	E njëjta matje e pikës 12, në energji të ulët
13	**13-E VERDHE**	Dekoracioni mbi bordin e poshtëm të mburojës së Shën Th. Tironit
14	**14-E BARDHE**	Dekoracioni mbi bordin e poshtëm-majtas të mburojës së Shën Th. Tironit
14-r	**14-E BARDHE-r**	E njëjta matje e pikës 14, në energji të ulët
15	**15-BLU**	Hapësira e sfondit në lartësinë e shpatullës së majtë të Shën Th. Tironit
16	**16-GRI**	Dekoracioni i errët në qendër të rripit të Shën Th. Tironit
17	**17-E KUQE GJAKU**	Nofulla e majtë e Shën Th. Tironit
18	**18-E VERDHE-OKER**	Hapësira e poshtme e aureolës së Shën Th. Tironit
18-r	**18-E VERDHE-OKER-r**	E njëjta matje e pikës 18, në energji të ulët

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Komente mbi rezultatet e analizave XRF

Nga analizat e kryera sipas procedurës të përshkruar më lart si arkeometrike, u arrit të identifikohen në mënyrë të qartë pothuaj të gjithë pigmentet e përdorur nga autori.

Për përgatitjen e sfondit jeshil si pigment bazë është përdorur 'tokë jeshile' mbi të cilin duhet të jetë aplikuar një shtresë e hollë pigmenti jeshil me bazë bakri (me sa duket malakit, duke marrë në konsideratë papastërtitë e zinkut të gjetur).

Pigmenti i sfondeve të errëta nuk është identifikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nga spektrat merret informacion indirekt për përdorimin e një pigmenti të zi me origjinë minerale, ndoshta karbon.

Në sfondet me ngjyrë blu të erret është identifikuar prezenca e Azurit-it, pigment blu me bazë bakri.

Në zonat me ngjyra të ndryshme që iu nënshtruan ekzaminimit janë identifikuar pigmentet e mëposhtëm:

Ngjyra e bardhë - e bardha e kalciumit dhe e bardha e plumbit

Ngjyra e verdhë - okër e verdhë dhe giallolino (stanat plumbi)

Ngjyra e kuqe - okër e kuqe, e kuqe plumbi (minium) dhe e kuqe zhive (vermilion).

Pigmentet e identifikuara na sugjerojnë të dhëna mbi teknikën e përdorur nga autori, i cili duhet të ketë punuar fillimisht me një sërë pigmentesh mbi murin e njomë (a fresco) dhe më pas e ka përfunduar veprën duke punuar në të thatë (a secco).

Në matjet e kryera sipas procedurës të përkufizuar si diagnostikuese janë identifikuar disa elementë me numër atomik të ulët, ndër të cilët më të rëndësishmit janë squfuri dhe klori.

Prezenca e klorit (Cl) duhet të lidhet tërësisht me kripërat klorure të cilat janë depozituar mbi shtresën e pikturës apo janë formuar si rezultat i transformimeve të materialeve të pikturës nën veprimin e agjentëve të jashtëm gjatë kohës.

Në interpretimin e prezencës së squfurit duhet të jemi më të kujdesshëm, pasi ai mund të vijë si nga kripërat sulfate të krijuara në të njëjtën mënyrë si kloruret por në disa raste mund të vijë edhe nga materialet e pikturës (pigmente që përmbajnë squfur ose prezenca e një shtrese preparatore gipsi).

Në figurat më poshtë janë paraqitur spektrat XRF, të matur me të dy procedurat (arkeometrike dhe diagnostikuese), për pigmentet kryesorë të identifikuar në zonat e ekzaminuara. Në secilën figurë janë paraqitur të mbivendosur spektrat e matur me sistemet matës të të dy ekipeve. Nga krahasimi i tyre rezulton se në përgjithësi të dy sistemet japin rezultate të njëjta persa i përket identifikimit të pigmenteve dhe të materialeve të tjera prezente mbi sipërfaqet e ekzaminuara. Ndryshimet në intensitetet e piqeve apo format e fonit të spektrave lidhen me kushtet e ndryshme të punës dhe me cilësinë e ndryshme të pjesëve përbërëse të tyre. Duhet theksuar se sistemi i ekipit italian paraqet dy avantazhe kryesore që lidhen me tubin X që mund të emetojë rrezatim me energji më të lartë dhe detektorin me karakteristika më të mira.

IX. Analiza mikroklimatike e mjediseve të brendshme të kishës

Për një periudhë të kufizuar kohore (2 ditë) u përfituan të dhëna në lidhje me temperaturën, lagështinë, intensitetin e ndriçimit (LUX) dhe pikën e vesës të mjedisit të kishës në të cilin u kryen analizat.

Siç shihet nga grafiku (Fig. 25), lagështia relative është shumë e lartë. Prania e personave dhe në këtë rast e hulumtuesve ndikon në gjendjen mikroklimatike, kryesisht nga hapja e dyerve që në fakt ul temperaturën dhe lagështinë.

Vlera maksimale e ndriçimit (LUX) paraqet pikërisht kohën kur dielli hyn pasditeve përmes dritareve. Për këtë arsye edhe dataloger-i (matësi i vlerave të mëposhtme) u spostua më tej.

Vlerat mesatare na tregojnë se lagështia relative është 74%, temperatura është 19^0 C, ndërsa ndriçimi është konstant në vlerën 4 LUX, përveç pikut të ndriçimit të drejtpërdrejtë, kur shkon 43. Pika e vesës është rreth 15 gradë celsius.

Përfundime:

Analizat e kryera në kishën e Shën Mërisë Vllaherna në Berat përfaqësojnë një shembull se si mund të kombinohet puna e restauratorëve dhe kërkuesve shkencorë (fizikantëve) në mënyrë që të krijojë dhe të zhvillojë protokolle standarde për ruajtjen dhe monitorimin e afreskeve.

Në sajë të hulumtimeve diagnostike të kryera më

parë nga restauratorët nëpërmjet një analize vizive dhe të prekshme dhe nga fizikanët përmes analizave me instrumentet përkatës, ne mund të përcaktojnë në mënyrë efikase dhe me një kosto modeste gjendjen e konservimit të pikturave murale.

Ky bashkëpunim, na dha jo vetëm mundësi në provimin e protokolleve operative të bashkëpunimit, por edhe shansin për të kuptuar dhe vlerësuar teknikat e realizimit dhe pigmentet e përdorura nga piktori i shquar shqiptar, Nikolla Onufri.

DO NOT COPY

Nikolla CIVICI
Edlira ÇAUSHI
Ilaria CAROCCI
Stefano RIDOLFI

DO NOT COPY

REPORT OF THE DIAGNOSTIC EXAMINATION OF THE MURAL PAINTINGS OF THE SAINT MARY'S CHURCH IN VLLAHERNA, IN THE CITADEL OF BERAT, WITH THE HELP OF NON-DESTRUCTIVE AND PORTABLE TECHNIQUES

Within the framework of the executive program for the implementation of the agreement for scientific and technological cooperation between the Government of the Republic of Italy and the Government of the Republic of Albania for the period 2008-2010, and more specifically as part of the project for the "Drafting of procedures for non-destructive analysis of archaeological objects employing portable systems," a joint team of researchers and conservators, performed the examination of a part of the north-western wall mural paintings of the Church of Saint Mary of Vllaherna (the Citadel of Berat).

During these examinations, which were all performed on the site and were of a non-destructive nature, the team of restorers combined traditional methods used for the examination of the state of conservations of mural paintings (graphic drawings, visible light photographs, etc.) with more advanced methods, such as normal light imaging, using lateral illumination and sliding-light, and ultraviolet light imaging (UV). The materials used in the painting were examined with the method of energy dispersive X-ray fluorescence imaging (EDXRF). Beside this, the thermic-hydrometrical parameters were monitored for a limited period wof time.

In accordance with the project's goal, a complex procedure is being proposed hereby for the diagnostic examination of the state of conservation on mural paintings, which brings together into a unique solution the visual examination information and the analysis results received by the use of non-destructive techniques, such as EDXRF and UV with lateral illumination. The feedback obtained by this complex set of methods allows for a much clearer picture of the state of conservation of mural paintings, and the causes for their further potential deterioration. Following this, the report focuses on some basic concepts in relation with the analytical methods and portable systems employed, the results obtained by each technique on the state of conservation of the paintings, short explanatory notes attached to the relevant tables and especially the criteria employed in selecting the nomenclature and symbols used in developing diagnostic data.

DO NOT COPY



Fig. 1. Matje EDXRF në proces brenda Kishës së Shën Marisë Vllaherna, kryer nga hulumtuesit Niko Civici, Ilaria Carocci, Ridolfi Stefano dhe Edlira Caushi.



Fig. 2. Imazh ajror i lagjes së Kalasë (Berat). (Foto nga Alket Islami).

DO NOT COPY



Fig. 2,1. Pamja verilindore e kishës



Fig. 3. Fragmenti i afreskut i marrë në analizë.



Fig. 4. Analiza e gjendjes së konservimit të afreskut.



Fig. 5. Gjendja e konservimit të shtresave përgatitore.



Vello e bardhë

Defekt i adezionit të pelikulit të ngjyrës

Abrazion i pelikulit të ngjyrës

Zona me mikrolakuna

Depozitim sipërfaqësor koherent (jashtëqitje shpendësh)

Shkëputje e pelikulit të ngjyrës

Depozitim sipërfaqësor inkoherent

Gërvishtje

Fig. 6. Gjendja e konservimit të pelikulit të ngjyrës.



Stukime

Zona të mikro-stukaturave

Shtresë protektive mbi sipërfaqe (rezina)

Zona me rrjedhje rezinash

Brima te konsolidimeve

Fig. 7. Ndërhyrjet e mëparshme restauruese.



Fig. 8. Dritë anësore. Detaj i bustit të Shën Theodhor Stratilatit.



Fig. 9. Dritë rrëshqitëse. Detaj i ijeve të Shën Theodhor Stratilatit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10. Dritë rrëshqitëse. Detaj i këmbëve të Shën Theodhor Stratilatit.



Fig. 11. Dritë rrëshqitëse. Detaj i bustit të Shën Theodhor Tironit.



Fig. 12. Dritë rrëshqitëse. Detaj i ijeve dhe mburojës së Shën Theodhor Tironit.



Fig. 13. Dritë rrëshqitëse. Detaje të këmbëve të Shën Theodhor Tironit.

DO NOT COPY



Fig. 14. Fluoreshencë UV. Detaj i bustit të Shën Theodhor Stratilatit.



Fig. 15. Fluoreshencë UV. Detaj i ijeve të Shën Theodhor Stratilatit.



Fig. 16. Fluoreshencë UV. Detaj i këmbës së djathtë të Shën Theodhor Stratilatit.



Fig. 17. Fluoreshencë UV. Detaj i bustit të Shën Theodhor Tironit.



Fig. 18. Fluoreshencë UV. Detaj i kraharorit të Shën Theodhor Tironit.



Fig. 19. Fluoreshencë UV. Detaj i mesit të Shën Theodhor Tironit.

DO NOT COPY



Fig. 20. Fluoreshencë UV. Detaj i këmbëve të Shën Theodhor Tironit.



Fig. 21. Fluoreshencë UV. Detaj i këmbëve të Shën Theodhor Tironit.



Fig. 22. Matje XRF të kryera nga Edlira Çaushi dhe Ridolfi Stefano.



Fig. 23. Matje në proces XRF, Nikolla Civici dhe Ridolfi Stefano.



Fig. 24. Pikat e matjeve me fluoreshencën e rrezatimit X mbi afresk.

monumentet
52/2011 - 2014

Klodjana GJATA
Marsela DEMAJ (PLYKU)
Ronela ÇUKU

DO NOT COPY

ARKITEKTURA, IDENTITETI DHE FAZAT E NDËRTIMIT TË KISHËS BIZANTINE SHËN MËRI VLLAHERNA, BERAT

1. Vendndodhja dhe konteksti historik

Qyteti i Beratit ndodhet në jug të Shqipërisë qendrore. Është një nga qytetet më të vjetra në vendin tonë, me gjurmë vendbanimi që datojnë qysh në 2600-1800 p.Kr., ndërsa gjurmët më të hershme të qytetit të fortifikuar (kalaja e sotme) datojnë në shek 4^{rt} p.Kr.. Emri antik i qytetit të Beratit është Antipatrea, një qendër e fortifikuar e cila i ka rezistuar legjioneve romake për disa kohë. Qyteti përmendet nga Polibi dhe Livi dhe paraqitet në listën e fortifikimeve të perandorit Justinian. Gjatë periudhës Bizantine, në 533, Berati njihet me emrin Pulcheriopolis, në nder të perandoreshës Bizantine të shek. 5^{të} Pulcheria. Shek. 13^{të} - 14^{të}, periudhë gjatë së cilës Berati ndodhej ende nën perandorinë Bizantine ishte një periudhë e lavdishme sa i përket zhvillimit të qytetit. Në fakt, perandori Mihal Komnen Dukas i Epirit ka jetuar për një periudhë të shkurtër në Berat (1204-1214), ku dhe u vra në 1214. Rindërtimi pjesor i mureve të fortifikimit si dhe ndërtimi i 3 kishave të rëndësishme: Shën Mari Vllaherna, Shën Triadha dhe Shën Mëhilli janë dëshmi e zhvillimit ekonomik që karakterizon këtë periudhë. Për vlerat e pakrahasueshme të trashëgimisë kulturore, Berati u shpall Pasuri Botërore nga UNESCO në vitin 2008.

Kisha e Shën Mëri Vllahernës ndodhet brenda qendrës së banuar të lagjes Kala në Berat, pikërisht në zonën perëndimore të saj, në një terren të ngritur dhe e rrethuar me banesa. Sipas gojëdhënave është kisha më e vjetër në Berat. Emri i kishës Shën Mëri Vllaherna në ikonografi lidhet ngushtësisht me perandorinë Bizantine. Në Shqipëri nuk ka asnjë kishë tjetër mesjetare që i dedikohet Shën Mëri Vllahernës, fakt ky që lë vend për supozimin se ky është emër i huazuar, me shumë mundësi nga Konstandinopoja. Përdorimi më i hershëm i këtij emri daton në shek. 2^{të}. Në shek. 6^{të} ndërtohet kisha e Vllahernës, pranë pallatit të Vllahernës në zonën me të njëjtin emër. Më vonë ky emër ndeshet në monedhat e shek. 11-të të Konstandin IX Monomakut[1] (Fig. 1; Fig. 2).

2. Përshkrimi arkitektonik

Kisha e Shën Mëri Vllahernës në gjendjen e sotme paraqet një mbivendosje të qartë fazash ndërtimi. Ka një planimetri drejtkëndore lehtësisht të rrotulluar në aksin gjatësor. Devijimi i aksit dhe orientimi i absidës drejt jugut kushtëzohet nga plani urban dhe morfologjia e zonës.

Naosi i kishës me planimetri drejtkëndore paraprihet nga një narteks dhe në juglindje përfundon me një absidë

[1] Puzanova, V., Popa, Th., "Mbi punimet e piktor Nikollës në kishën Vllaherna (në kështjellën e Beratit)", *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore*, Tiranë,1957, 2, f. 64-75

DO NOT COPY



Fig. 1. Vendndodhja e Kalasë në qytetin e Beratit (majtas) dhe vendndodhja e Shën Mëri Vllahernës në Kala (djathtas).



Fig. 2. Hartë topografike e zonës shk. 1:1000 (majtas), planimetria e kishës shk. 1:500 (qendër), gen-plan i kishës shk. 1:250 (djathtas).

gjysëmrrethore pak të ngritur nga kuota e dyshemesë së naosit. Absida është e lugët nga brenda dhe poligonale nga jashtë. Në veri kisha kufizohet me një oborr të vogël të rrethuar me mure, me hyrje në krahun lindor (Fig. 3; Fig. 3a).

Dy kolona masive e ndajnë naosin në dy ambiente kryesore: salla qendrore dhe altari. Absida ndodhet në qendër të hapësirës së altarit, e kufizuar nga të dy krahët nga diakonikoni në të djathtë, i cili ndahet nga salla me një mur me faqe drejtkëndore si dhe protezisi në të majtë. Të dyja këto ambiente janë të mbuluara me qemere cilindrikë. Naosi ka dritare në të gjitha faqet e mureve. Dritaret e altarit, fasadës veriore dhe jugore janë bifora të dekoruara me dy gjysmë harqe anësore dhe një dopio hark qendror me tulla. Në fasadat veriore dhe jugore



Fig. 3. Gen-plani i kishës.

DO NOT COPY



Fig. 3a. Pamje e fasadës veriore.



Fig. 4a. Pamje e dritareve në fasadën veriore



Fig. 4. Pamje e dritareve në fasadën jugore.



Fig. 4b. Pamje e dritareve në fasadën lindore.

harku i jashtëm dekorativ me tulla nuk është i paplotë në pjesën e sipërme (Fig.4; Fig. 4a; Fig. 4b).

Në naos mund të hyet nga tre dyer të vendosura në veri, jug dhe perëndim, ku e fundit lidh naosin me narteksin. Në murin verior dallohen gjurmët e një dere të murosur e dukshme nga brenda dhe jashtë naosit. Dyshemeja e sallës qendrore është e mbuluar me pllaka argjilore, të cilat, në qendër formojnë një dekoracion në formë katrore me rreth të brendashkruar. Pjesa tjetër e dyshemesë së kishës mbulohet me materiale të tjera (gur, pllaka tulle, material drusor), fakt që tregon faza të ndryshme ndërhyrje (Fig. 5; Fig. 5a).

Muret e brendshme të kishës janë tërësisht të mbuluara

DO NOT COPY



Fig. 5. Planimetri e kishës ku paraqitet shumëllojshmëria e materialeve të shtrimit të dyshemesë.



Fig. 5a. Pamje pjesore e dyshemesë së dekoruar në naos.

me afresk të pikturuar nga Nikolla Onufri dhe që daton në vitin 1578, informacion ky i bazuar në mbishkrimin e vendosur mbi derën që lidh naosin me narteksin. Në niken e vendosur në të majtë të absidës dallohen qartësisht dy shtresa pikture murale. Shtresa e poshtme daton në një fazë më të hershme dekorimi të naosit (Fig. 6; Fig. 6a; Fig. 6b).

Muratura e jashtme në pjesën më të madhe është e realizuar me teknikën e kluasonazhit, duke krijuar dekoracionin me dy efekte të ndryshme tonesh të tullave dhe gurëve. Kjo teknikë është përcaktuese për pamjen e jashtme të ndërtesës dhe në të njëjtën kohë është elementi bazë që vë në dukje ndryshimet e fazave të mëvonshme. Muri lindor, me përjashtim të xokolaturës është krejtësisht i ndërtuar me teknikën e kluasonazhit. Kjo teknikë është prezente duke filluar nga rreshti i dytë, nën kuotën e dritareve, ndërsa xokolatura karakterizohet nga një muraturë e çrregullt e përbërë nga gurë dhe fragmente tullash. Mbi absidë, në fasadën lindore dallohet një dekoracion me tulla në formë kryqi. Gjithashtu, në qoshen verilindore ruhet një pjesë e kornizës së frontonit me tulla të vendosura në formë dhëmbësharre. Ky tip kornize ndeshet vetëm në këtë pjesë dhe nuk shihet në murin perëndimor.

Hapësira e naosit është e mbuluar nga një strukturë me



Fig. 6. Prerje B-B ku paraqitet faqja e brendshme lindore (drejt altarit), rilevim fotogrametrik i afreskeve

DO NOT COPY



Fig. 6a. Pamje e sipërfaqes së afreskuar në murin verior.



Fig. 6b. Mbivendosje e dy shtresave pikture murale.



Fig. 7. Pamje e strukturës së brendshme të çatisë.



Fig. 7a. Pamje e çatisë nga jashtë.

kapriatë druri, mbuluar me tjegulla, me përjashtim të absidës e cila është e mbuluar me rrasa guri (Fig. 7; Fig. 7a).

Muret e narteksit janë në lartësinë e kuotës së arkitraut të derës në krahun verior. Mbi këtë mur narteksi plotësohet në lartësi me anë të një strukturë druri, (e ndërtuar gjatë punimeve restauruese në 1978) dhe mbuluar me çati njëujëse me pjerrësi në krahun perëndimor. Nën nivelin e dyshemesë të këtij ambienti ndodhet stera e ujit. Nga gjurmët e sotme konstatohet se ajo ka qënë e mbuluar me qemer cilindrik, nga i cili dallohen pjesët e fillimit të harkut përgjatë murit perëndimor të naosit (Fig. 8; Fig. 8a; Fig. 8b).

Dyshemeja e narteksit është e mbuluar pjesërisht me rrasa guri dhe pjesërisht me dysheme druri duke lënë të hapur pjesën qendrore të sterës të kufizuar me parapet druri për soditjen e saj (ref. Fig. 5; Fig. 5a).

DO NOT COPY



Fig. 8. Prerja C-C ku paraqitet vendndodja e depozitës së ujit.





Fig. 8a; Fig. 8b. Pamje të strukturës së mbetur të depozitës së ujit.

3. Studimi gjeometriko proporcional i strukturës

Studimi gjeometriko proporcional është realizuar për identifikimin dhe organizimin e mundshëm të hapësirës së brendshme në mesjetë sipas "proporcionit harmonik". Për të identifikuar këtë proporcion realizohet matja e lartësisë së naosit dhe kupolës qendrore lidhur me gjatësinë e sallës dhe diagonalet e hapësirës së naosit, duke përdorur pikëprerjen

DO NOT COPY



Fig. 9. Studimi i shmangies së mureve nga lineariteti.



Fig. 9a. Gama e trashësisë së mureve.

DO NOT COPY

e saktë të diagonaleve me trekëndëshin barabrinjës me gjatësinë e absidës. Gjithashtu, është studiuar gama e trashësive të mureve si dhe shmangia në planimetri e mureve të strukturës nga lineariteti.

Gama e gjerë e trashësisë së mureve, që varion nga 53 cm në absidë deri në 84 cm në qoshen veriperëndimore, dëshmon për fazat e shumta ndërtimore në këtë monument. Ky fakt përforcohet dhe më shumë nga shmangja e muraturës nga vertikaliteti (Fig. 9; Fig. 9a). Studimi proporcional në planimetri paraqet të dhëna interesante lidhur me kriteret e projektimit, që ndihmojnë për të kuptuar planimetrinë origjinale. Gjatësia e naosit lidhet me thellësinë e absidës

i strukturës origjinale, bazuar në studimin proporcional, duke marrë si shembull kishën e Shën Triadhës në Berat.

4. Studimi krahasimor

Për realizimin e studimit krahasimor, me qëllim identifikimin e planimetrisë të kishës janë marrë në shqyrtim kisha të tjera bizantine, që datojnë në shekujt e 10^{të} – 14^{të}, me vendndodhje brenda territorit të Shqipërisë dhe në përgjithësi në Ballkan.

Kisha e Shën Mëri Vllahernës ka një planimetri drejtkëndore lehtësisht të rrotulluar në aksin gjatësor.



Fig. 10. Studimi gjeometriko-proporcional në plan sipas "proporcionit harmonik".



Fig. 10a. Studimi gjeometriko-proporcional në prerje sipas "proporcionit harmonik".

në raportin 3:1. Raporti midis dimensioneve të narteksit dhe naosit është më pak i qartë. Ndërsa, nga studimi proporcional i fasadës duket qartë se me rrëzimin e mbulimit original të naosit, si pasojë e rënies së murit dhe kolonave në krahun perëndimor, gjendja e strukturës është e pakthyeshme, (struktura e kësaj faze ndërtimi mendohet të ketë qënë me kupolë dhe kryq të brendashkruar, mbështetur në dy pilastra në krahun lindor dhe dy kolona në krahun perëndimor të naosit) (Fig. 10; Fig. 10a; Fig. 10b).

Megjithatë, mund të jetë me interes rindërtimi hipotetik

Pavarësisht faktit që ky është një tipar i ndeshur përgjithësisht në arkitekturën bizantine, ky konfigurim mund të jetë kushtëzuar nga terreni i thyer mbi të cilin është ndërtuar kisha. Krahasimi me kishën e shekullit të 11^{të} të Shën Mërisë në Apolloni paraqet ngjashmëri të lartë sa i përket shmangjes së këndit të planimetrisë në aksin gjatësor. Të dyja kishat përbëhen nga një naos dhe një narteks dhe kisha e Shën Mërisë në Apolloni ka planimetri në formë kryqi me kupolë qendrore. Gjurmët e gjetura në fasadën veriore (në krah të protezisit) të kishës Shën Mëri Vllaherna tregojnë prezencën

DO NOT COPY



Fig. 10b. Studimi gjeometriko-proporcional në pamje sipas "proporcionit harmonik".



Fig. 11. Krahasim në planimetri dhe prerje midis kishave: Shën Mëri Vllaherna dhe Shën Mëria në Apolloni.

e një hapësire ndihmëse në këtë pjesë, gjë të cilën e shohim edhe në kishën e Shën Mërisë në Apolloni. Në prerje, të dyja kishat kanë një sterë nën nivelin e dyshemesë së narteksit (Fig. 11). Përsa i përket zhvillimit planimetrik, kisha e Shën Mëri Vllahernës ngjason me atë të Kishës së Shën Mërisë në Kosinë të Përmetit. Megjithatë, nga një vështrim më i kujdesshëm i planimetrisë mund të kuptohet se zhvillimi i planimetrisë në kishën e Shën Mërisë së Kosinës i përket një periudhe më të hershme se Shën Mëri Vllaherna. Muri perëndimor i naosit në kishën e Shën Mërisë Kosinë ka një thyerje për në brendësi të naosit dhe pastaj i bashkëngjitet murit verior dhe atij jugor, duke krijuar kështu dy ambiente që mbulohen me qemer cilindrik, në të dyja anët e hyrjes perëndimore të naosit. Këtë lëvizje planimetrike nuk e shohim tek Shën Mëri Vllaherna apo tek Shën Triadha, që i përkasin një periudhe të mëvonshme.

Krahasimi me kisha të tjera vë në dukje ngjashmëri të qarta në zonën e altarit. Planimetria kryq i brendashkruar me kupolë qendrore identifikohet fare qartë në kishën e Shën Mëri Vllahernës, bazuar në strukturën e bemës, prezencën e dy pilastrave në zonën lindore dhe gjurmët e gjetura të bazamenteve të dy kolonave në pjesën perëndimore. Bazuar në krahasimin me kishën e Shën Triadhës në Kala/Berat supozohet se kupola mbështetej mbi dy pilastra dhe dy kollona (Fig. 12; Fig. 13).



Fig. 12. Krahasim në planimetri midis kishave: Shën Mëri Vllaherna/Berat, Shën Triadha/Berat, Shën Mëria në Kosinë, Përmet

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 13. Krahasim në prerje midis kishave: Shën Mëri Vllaherna/Berat, Shën Triadha/Berat.

Hapësirat në të dy anët e absidës kanë qënë të mbuluara me qemere cilindrikë siç edhe vërehet sot në hapësirën e protezisit. Në narteks janë gjetur gjurmë harqesh në faqen e murit lindor. Duke e krahasuar me kishën e Shën Triadhës, prezenca e këtyre gjurmëve lë vend për supozimin se mbulimi i narteksit mund të ketë qënë me qemer. Nga krahasimi në prerje me kishën e Shën Triadhës vërehen ngjashmëri në pjesën qendrore të naosit dhe në absidë. Krahasimi në elemente të veçantë të fasadës tregon që dritaret dhe muret e kishave bizantine konturoheshin përgjithësisht me rreshta tullash të vendosura në formë dhëmbësharre, element ky i ndeshur në kishën e Shën Jovanit dhe Kishën e Peribleptos-it, (që daton në gjysmën e dytë të shek. 10[të]) në Maqedoni. Në kishën e Shën Mëri Vllahernës, ky tip kornize ruhet pjesërisht në muret dhe dritaret e fasadës lindore.

5. Identiteti dhe fazat e ndërtimit

5.1. Faza më e hershme (para shek. 13[të])

Në vitet '80 janë realizuar punime restaurimi në kishën e Shën Mëri Vllahernës nga specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës. Gjatë punimeve restauruese të vitit 1980 u realizuan sondazhe gërmimi brenda dhe jashtë ambientit të kishës. Si rezultat i sondazheve, nën nivelin e dyshemesë së naosit u zbulua themeli i murit perëndimor si dhe themeli i një pilastre apo kollone. Lloji i muraturës së murit (qoshja veriperëndimore e naosit) dhe pilastrës së zbuluar nën nivelin e dyshemesë ishte i ndryshëm nga muratura në pjesën e sipërme (Fig. 14a;b;c;d;e). Gjithashtu, u vërejt se dy muret që formojnë qoshen nuk ndërthuren me njëri-tjetrin por ndahen me fugë, ku muri perëndimor i mbështetet murit verior. Duke u bazuar në ndryshimin e tipit



Fig. 14a. Kuota e hyrjes në fasadën veriore; Fig. 14b. Pamje e qoshes veri-perëndimore ku janë kryer sondazhe në hapësirën e brendshme të kishës; Fig. 14c. Muraturë më e hershme ekzistuese e gjetur nën nivelin e dyshemesë; Fig. 14d. Kollona e 3të e gjetur në pjesën perëndimore; Fig. 14e. Lloji i muraturës të fazës më të hershme.

DO NOT COPY

të muraturës mendohet se muri nën nivelin e dyshemesë i përket një faze më të hershme ndërtimi. Kjo fazë identifikohet me gjurmët e murit nën nivelin e dyshemesë në të cilin ka edhe një hapje – me shumë mundësi dritare, çka dëshmon për një fazë më të hershme ndërtimi se kisha e shën Vllahernës poshtë këtij niveli. Nga sondazhet e viteve '80, në murin e fasadës veriore, në të majtë të hyrjes së naosi është gjetur i gdhendur, në anën e poshtme, gur në formë kryqi Paleokristian. Bazuar në këto të dhëna mendohet ekzistenca e një faze më të hershme ndërtimi mbi rrënojat e të cilës është ndërtuar shën Mari Vllaherna. Nga sondazhet e gërmimit të realizuara në oborrin e kishës u zbuluan disa varre, kuota e të cilave është tregues se niveli i tokës ka qenë më poshtë.

Faza 1 (1204-1214)

Nga vëzhgimet e hollësishme në muraturën e kishës u bë i mundur identifikimi i llojeve të muraturave, përcaktimi i fazave të ndryshme si edhe hipoteza mbi periudhat e ndërtimit të tyre. Vëzhgimet u fokusuan në përcaktimin e materialeve dhe teknikave të ndërtimit të muraturës. Në muret veriore, lindore dhe jugore u konstatua përdorimi i teknikës së kluasonazhit (cloisonné) – kombinimi i gurëve dhe tullave. Gjatë studimit krahasimor të llojeve të muraturave u vërejtën ngjashmëri midis muraturës në xokolaturën e fasadës lindore të kishës dhe muraturës në portën veriore të kalasë. Ky tip murature karakterizohet nga ndërtimi me gurë të çrregullt dhe fragmente tullash dhe mendohet të jetë i njëkohshëm me teknikën e kluasonazhit.

Bazuar në teknikën e ndërtimit dhe formën arkitektonike, në bibliografi thuhet se kisha daton në shek. e 13të. Emri Shën Mëri Vllaherna dhe lidhja e mundshme e tij me ndërtimin me të njëjtin emër në Konstandinopojë, si dhe fakti se perandori i Epirit Mihal Komnen Dukas ka jetuar në Berat në periudhën 1204-1214, janë elemente kyç që ndihmojnë në përcaktimin e një datimi edhe më të saktë. Gjatë sundimit të tij perandori ka ndërmarrë punime masive për ringritjen e mureve të kalasë dhe ka realizuar ndërtime të reja si stera e madhe në akropol. Nga krahasimi i muraturave, kjo fazë mund të datohet në fillim të shek të 13të (1204-1214).

Në fasadën veriore vërehen gjurmë të një dere, (sot e murosur), të dukshme nga jashtë dhe brenda. Në krahun e majtë, në pjesën e sipërme të gjurmëve, muri është i sfazuar në një nivel më mbrapa se fasada e përgjithshme dhe ka formë të harkuar (pothuajse gjysmëharku). Këto gjurmë si dhe vëzhgime dhe të dhëna të tjera nga afresku në naos, mbështesin idenë për ekzistencën e një ambienti ndihmës në këtë krah. Në niken e vendosur në të majtë të absidës dallohen qartë mbivendosje të dy shtresave pikture murale (afresk). Sipas historianëve të artit, shtresa e poshtme daton në një fazë më të hershme dekorimi të naosit. Bazuar në teknikën e thjeshtë të përdorur për realizimin e këtij afresku si edhe në mënyrën primitive të paraqitjes së shenjtorëve dhe veshjeve mendohet se kjo shtresë afresku daton në mes ose fund të shek. të 13të. Nga studimi i muraturës vërehet se muri verior i naosit është i vazhduar me të njëjtën tipologji ndërtimi edhe në ambientin e narteksit, gjë që të lë të mendosh se kisha ka pasur narteks në këtë fazë. Gjurmë të tre harqeve janë të vërejtura në fasadën perëndimore të naosit. Duke e krahasuar me kishën e Shën Triadhës theksojmë hipotezën që ky ambjent mund të ketë qenë i mbuluar me qemerë.

Suvatimi me llaç horasan i sterës nën nivelin e dyshemesë së narteksit është teknikë e ndeshur dhe në çisterna të tjera të periudhës bizantine, brenda kalasë Berat. Ky është një element i rëndësishëm për datimin e kësaj faze (Fig. 15a;b;c;d;e).

dhe kupolën. Rrëzimi i kupolës mendohet të jetë shkaktuar nga një tërmet i mundshëm, rrëshkitje dheu në pjesën perëndimore ndihmuar kjo nga lëvizjet dinamike të ujit të sterrës apo pesha e madhe e kupolës, etj.. Korniza e sipërme e pikturës murale si dhe vendet ku mbështeten trarët e drurit



Fig. 15a. Lloji i muraturës së fazës së I; Fig. 15b. Gjurmë të derës së murosur në fasadën veriore; Fig. 15c. Fasada jugore; Fig. 15d. Pamje e suvatimit me horasan të depozitës së ujit; Fig. 15e. Gjurmë të tre harqeve në fasadën perëndimore të naosit.



Fig. 16a. Mbishkrimi në pjesën e sipërme të derës që lidh naosin me narteksin; Fig. 16b. Gjurmë të derës së murosur në fasadën veriore; Fig. 16c. Gjurmë të hyrjes së murosur për në ambientin e diakonikonit; Fig. 16d. Pamje pjesore e dyshemesë; Fig. 16e. Pamje e kornizës së sipërme të afreskeve.

Faza 2 (pas shek 13^{të} – 1578)

Kjo fazë identifikohet nga datimi i pikturës murale të kishës. Bazuar në mbishkrimin e lënë nga piktori Nikolla Onufri, në pjesën e sipërme të derës që lidh naosin me narteksin, i gjithë ambienti i brendshëm i kishës është pikturuar në vitin 1578. Nga vëzhgimet e bëra në këtë ambient kuptohet qartë se kisha ka qenë e mbuluar me çati druri në periudhën e pikturimit. Ky fakt lë të mendosh se mbulimi i kishës me çati (pas rrëzimit të kupolës) është i njëkohshëm ose i një faze më të hershme se pikturimi. Muri perëndimor i narteksit nuk është i njëkohshëm me ndërtimin e sterës, pasi në këtë faqe nuk kemi gjurmë të qemerit të sterës, çka dëshmon se kjo faqe, në këtë fazë është rrëzuar së bashku me një pjesë të muraturës perëndimore të naosit të çatisë në muraturë janë elemente të fortë që mbështesin këtë hipotezë. Nga vëzhgimet në pikturën murale si dhe gjurmët në muraturën e fasadës, kuptohet qartë se murosja e derës në murin verior dhe hapja e derës së sotme në të njëjtin mur daton para vitit 1578. Dyshemeja prej guri dhe pllaka argjilore mendohet të jetë e njëkohëshme me pikturën murale. Kjo hipotezë mbështetet në kornizat e sipërme dhe të poshtme të afreskut (Fig. 16a;b;c;d;e). Gjithashtu, ambienti i diakonikonit ka qënë i mbyllur në këtë kohë, pasi brenda këtij ka afresk të shekullit 13^{të} dhe jo të Nikolla Onufrit.

Faza 3 (pas 1578 – 1978)

Kisha e Shën Mëri Vllahernës u shpall "Monument Kulture i kategorisë së I" në vitin 1948. Në vitet '70

DO NOT COPY

u realizua rilevimi i përgjithshëm dhe u hartua i gjithë dokumentacioni për gjendjen e konservimit të kishës nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Nga materiali fotografik i kësaj periudhe në arkivin IMK shihet qartë se:

Fasadat jugore, veriore dhe perëndimore kanë qenë të suvatuara.

Në ambientin e brendshëm verifikohen të njëjtat çarje që paraqiten dhe sot në afresk në pjesët ku kemi faza të ndryshme murature. Mendohet se këto çarje mund të jenë shkaktuar nga tërmeti i madh i raportuar në vitin 1751, i cili ka shkaktuar dhe dëmtime të tjera masive në banesat e qendrës historike Berat.

Narteksi në këtë periudhë paraqitet i mbuluar me çati të ulët treujëse.

Dera e hyrjes në fasadën jugore si dhe dritaret në fasadën lindore paraqiten të murosura.

Çatia njëujëse që mbulon diakonikonin ka pjerrësi me drejtim nga lindja, ndryshe nga pjerrësia klasike në arkitekturën bizantine me drejtim nga jugu.

Absida dhe protezisi janë të mbuluara me rrasa guri ndërsa pjesa tjetër e çatisë është e mbuluar me tjegulla vendi.

Kjo fazë mendohet se daton pas vitit 1751. Monumenti paraqitet me ndërhyrje minimale, të cilat mendohet të kenë pasur për qëllim përforcimin e strukturës pas tërmetit të sipërcituar (Fig. 17a;b;c;d).



Fig. 17(a,b,c,d). Foto arkivi (vitet '70) ku paraqitet gjendja e kishës para ndërhyrjeve restauruese të viteve '80 (Arkivi i Institutit të Monumenteve të Kulturës); Fig. 17a. Pamje e kishës në anën jugore; Fig. 17b. Pamje e kishës në anën perëndimore; Fig. 17c. Pamje e kishës në anën veriore; Fig. 17d. Pamje e kishës në anën lindore



Fig. 18(a,b,c,d,e). Pamje e gjendjes së sotme të konservimit të kishës (pamje e fasadave kryesore dhe struktura e brendshme e çatisë; Fig. 18a. Pamje e kishës në anën jugore; Fig. 18b. Pamje e kishës në anën perëndimore; Fig. 18c. Pamje e kishës në anën veriore; Fig. 18d. Pamje e kishës në anën lindore; Fif. 18e. Struktura e brendshme e çatisë.

Faza 4 (1980 – sot)

Në vitin 1980, në kishën e Shën Mëri Vllahernës janë realizuar punime restauruese, të cilat përqendroheshin kryesisht në problematikën e mëposhtme:

Konsolidim i konstruksionit nëpërmjet vendosjes së tiranteve që lidhin naosin, përforcim i themeleve në pjesën jug-lindore.

Gjetja e gjurmëve të pilastrit që vërteton formën e kupolës me kryq të brendashkruar.

Gjurmët në murin veri-perëndimor si dhe dritarja e mundshme e një faze që paraprin ndërtimin e shën Vllahernës.

Pastrimi dhe hapja e sterës së ujit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gërmimi dhe nxjerrja në pah e muraturës së xokolaturës të fasadës veriore.

Heqje e shtresës së suvatimit të dukshme në fotot e arkivit të viteve '70 në fasadat jugore, perëndimore dhe veriore. Në disa pjesë, shtresat e poshtme më të vjetra të suvasë janë lënë të dukshme.

Hapja e derës së murosur në fasadën jugore.

Ndryshimi i pjerrësisë së mbulesës së diakonikonit për nga jugu.

Dëmtimet e shumta të çatisë kërkonin restaurimin e saj, i cili u realizua duke ruajtur të paprekur tre trarët prej druri të strukturës së çatisë së vitit 1578 dhe duke ndërtuar një strukturë të lehtë me kapriata druri.

Dera e hyrjes për në hapësirën e diakonikonit ishte e murosur dhe e gjithë hapësira e diakonikonit ishte e mbushur me materiale të ndryshme para vitit 1578, me shumë mundësi për përforcimin e të gjithë strukturës. Gjatë punimeve të restaurimit, kjo hapësirë u çlirua nga mbushjet dhe dera e murosur u hap. Brenda kësaj hapësire u zbuluan gjurmë afresku, datimi i të cilit nuk është i qartë por bazuar në teknikën e realizimit nuk i atribuohet Nikolla Onufrit.

Bazuar në gjurmët e gjetura në fasadën perëndimore narteksi u mbulua me çati druri njëujëse, ndryshe nga çatia ekzistuese treujëse.

Pas këtyre punimeve restauruese, kisha mori pamjen dhe formën arkitektonike që paraqet dhe sot (Fig. 18a;b;c;d;e).



Fig. 19. Identifikimi i fazave të ndërtimit të kishës Shën Mëri Vllaherna dhe rindërtimi i fazave kryesore.

Konkluzion

Hipotezat dhe faktet për fazat ndërtimore të kësaj kishe të paraqitura në këtë artikull janë rezultat i studimit të detajuar të strukturës arkitektonike dhe muraturës, studimit krahasimor me kisha të tjera të së njëjtës periudhë, studimit gjeometriko proporcional të strukturës si dhe studimit kërkimor mbi dokumentacionin historik. Duke u bazuar në të gjithë punën studimore kërkimore, artikulli mundëson identifikimin e mundshëm të fazave ndërtimore dhe rindërtimin e transformimeve në kohë të këtij monumenti (Fig. 19). Punimet restauruese të viteve '80 duket se përveç konsolidimit të strukturës kanë patur qëllim në vetvete nxjerrjen në pah të gjurmëve të reja dhe lexim i strukturës së fazës së shekullit 13të. Ekzsitenca e një ndërtimi më të hershëm, me shumë mundësi paleokristian, mbi rrënojat e të cilit është ngritur kisha bizantine është një hipotezë e re e paraqitur në këtë artikull. Ngjashmëritë e mëdha në planimetri dhe prerje midis Kishës së Shën Mëri Vllahernës dhe kishës së shek. 11të Shën Mëria në Apolloni lenë vend për supozimin se të dyja këto kisha mund të jenë ndërtuar në periudha të afërta nga njëra-tjetra.

DO NOT COPY

BIBLIOGRAFIA

1. Studimi i realizuar në kuadër të kursit të specializimit të UNESCO-s pranë Qendrës Kombëtare të Restaurimit për rilevimin dhe restaurimin arkitektonik "Rilevimi, Arkitektura, Restaurimi i kishës së Shën Mëri Vllahernës, 2007-2009" (grupi i punës: Klodjana Gjata, Ronela Çuku, Marsela Plyku, Luçiano Bojaxhiu).
2. Arapi, Arben., "Mbi disa aspekte të restaurimit në asamblet e qytetit muze të Beratit", *Monumentet*, Tiranë, 1989, 2.
3. Fiorani, Donatella., Compostella, Chiara., *Heritage in Albania* (Centre of Restoration of Monuments in Tirana); Petruzzi Stampa; Citta di Castello; 2011.
4. Kallamata, Kliti., *Ikona (Kuptimi dhe simbolizmi);* Wisdom Palace K.&P. SBILIAS S.A.Athens, 1998.
5. Krautheimer, Richard., *Architettura paleocristiana e bizantina*, Einaudi, Torino 1986 (original title: *Early Christian and Byzantine Architecture*, Penguin Books Ltd, Harmondsworth, Middlesex, England, 1981, (4° ed.).
6. Mango, Cyril., *Architettura bizantina*. Electa, Milano, 1974.
7. Meksi, Aleksandër., "Tre Kisha Bizantine të Beratit", *Monumentet*, Tiranë, 1972, 4.
8. Meksi, Aleksandër., "Dy kisha bizantine në rrethin e Gjirokastrës", *Monumentet*, Tiranë; 1975, 9.
9. Meksi, Aleksandër., "Disa kupola bizantine të vendit tonë", *Monumentet*, Tiranë, 1975, 10.
10. Meksi, Aleksandër., "Probleme dhe aspekte të restaurimit të kishave bizantine", *Monumentet*, Tiranë, 1976, 12.
11. Meksi, Aleksandër., "Disa probleme të kishës së Apollonisë", *Monumentet*, Tiranë, 1982, 1.
12. Meksi, Aleksandër., "Të dhëna për teknikën e ndërtimit të kishave të shekujve VII - XV në Shqipëri", *Monumentet*, Tiranë, 1987, 2.
13. Meksi, Aleksandër., "Kishat Bizantine të Beratit", *Monumentet*, Tiranë, 1990, 2.
14. Meksi, Aleksandër: *Arkitektura e Kishave të Shqipërisë (shekujt VII- XV)*, Uegen, Tiranë, 2004.

15. Ousterhout, Robert., *Master Builders of Byzantium*, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, 1999.
16. Puzanova, V., Popa, Th., „Mbi punimet e piktor Nikollës në kishën Vllaherna (në kështjellën e Beratit)", *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore*, Tiranë,1957, 2, f. 64-75.
17. Thaci, Fatmir – Devolli, Adrian., "Restaurimi dhe vlerat e piktures murore të kishës së Shën Mëri Vllahernës, Berat", *Monumentet*, Tiranë, 1990, 2.
18. Thaçi, Fatmir., "Të dhëna rreth pikturës murale në kishën "Fjetja e Shën Mëri Vllahernës në kishën e Sinjës", *Monumentet*, Tiranë, 1990, 2.
19. Thomo, Pirro., *Kishat Pasbizantine të Shqipërisë së Jugut*, Tiranë, 1998.

DO NOT COPY

Klodjana GJATA
Marsela DEMAJ (PLYKU)
Ronela ÇUKU

DO NOT COPY

ARCHITECTURE, IDENTITY AND PHASES OF CONSTRUCTION OF THE BYZANTINE CHURCH OF ST. MARY VLLAHERNA – BERAT

Berat is one of the oldest cities in Albania, with the earliest traces of settlement dating from 2600-1800 BC, while the castle area had stone fortifications by the 4th century BC. During the Byzantine period, in 533, Berat was called Pulcheriopolis, after the 5th century Byzantine Empress Pulcheria. The 13th – 14th centuries was a time of great development for this city. The partial reconstruction of the fortification walls, as well as the construction of three important churches: St. Mary Vllaherna, Holy Trinity and St. Michael are a testimony of the economic development of this period.

This article is the result of a research study on the Byzantine Church of St. Mary Vllaherna, which lies in the west of the castle, on a steep terrain. Today it presents an unusual architectural plan, an infinity of material traces, testimony of its transformation in time and an outstanding interior painted by Nicholas Onufri in 1578.

Hypotheses and facts about the construction phases of this church are the result of:

- Detailed study of the structure and masonry; the identification of different range of masonry types as well as the differentiation of older parts of walls from the more recent ones was done by visual inspection of the facades. The observations focused on the identification of materials and construction techniques used.
- A comparative study with other byzantine churches in Albania and the Balcans in general of 10th – 13th century was carried out, regarding the identification of the plan of the church.
- The geometrical proportional study aims at the identification of the possible internal organization in medieval times "*harmonic section*".
- Research done on historical documentation reveal the results of the restoration works of the 80s'. The existence of a building of a probably earlier paleochristian church on the ruins of which the Byzantine church is raised as a new hypothesis presented in this article .

As a conclusion, this article presents hypothesis and facts regarding the phases of construction and transformation of this church in time.

monumentet
52/2011 - 2014

Maksim MITROJORGJI
Joli MITROJORGJI

DO NOT COPY

ELBASANI - IDENTITETI I HUMBUR I NJË QYTETI

Hyrje

Paraqitje e problematikës

Qëllimi kryesor i këtij artikulli është të eksperimentojë një lexim të formës së vendbanimit duke e konsideruar qytetin si objekt urban dhe ndoshta më tepër si objekt kulturor, një krijim jo vetëm funksional të shoqërisë njerëzore por dhe estetik, bartës vlerash universale, që trashëgohen, ruhen dhe përcillen nga brezi në brez.

Përse qyteti duhet parë si objekt urban?

Qyteti është shumë më tepër se një objekt krijim i njeriut. Ai është mjedis i marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore, është shtrat i psikologjisë dhe sjelljes shoqërore, është mjedisi ku janë eksperimentuar shpikjet teknikо-shkencore dhe ku kap majat kultura e një kombi.

Sot qyteti është studiuar gjerë dhe thellë në çdo aspekt të tij. Shumë nga këto studime janë orientuar drejt një mori vështrimesh jo-hapësinore marrëdhëniesh infrastrukture, qarkullimi dhe shkëmbimesh ekonomike.

Vihet re se është lënë mënjanë dhe zbehur vështrimi mbi aspektin material të vendbanimeve, në fushën e formës dhe proceseve dinamike që e krijojnë atë, pra është zbehur vështrimi mbi morfologjinë urbane, që studion formën e vendbanimeve dhe proceset e formimit, zhvillimit dhe transformimit të tyre në kohë.

Por gjithashtu është zbehur dhe studimi mbi sintaksën hapësinore të strukturës urbane, janë zbehur studimet mbi përmbajtjen e formës së hapësirës urbane, analiza këto që mundësojnë të kuptojmë se si kultura dhe fenomenet shoqërore janë shkrirë në një të tërë organike me modelet arkitekturore dhe urbane të qyteteve.

Ky proces analitik ndihmon të kuptojmë marrëdhëniet që egzistojnë ndërmjet mjedisit natyror, atij të krijuar nga njeriu dhe strukturës së organizimit të shoqërisë, jetën publike, zakonet, ndodhitë dhe ritet.

Është zbehur vështrimi mbi traditën simbolike që mban brenda forma e vendbanimit. Ky fakt ka nënvlerësuar analizën mbi ndikimin e formës urbane në mënyrën e jetës në bashkësi, e konsideruar kjo si burimi i karakterit dhe identitetit shoqëror e kulturor të qytetit, burim i vlerave estetike dhe urb-arkitektonike të tij. Në të njëjtën kohë anashkalohet kuptimi i *Genius loci-it* apo shpirtit të vendit që çdo vendbanim mbart në vetvete.

Shumë është studiuar dhe analizuar arkitektura e traditës në tipologji ndërtimore nga më të ndryshmet që vijnë nga e kaluara, por shumë pak është folur e shkruar për arkitekturën e objektit urban, tërësinë e formës materiale të qytetit si realitet i proceseve dinamike që e krijojnë një vendbanim dhe i mundësojnë atij jetëgjatësi në shekuj.

Më shumë se çdo objekt i veçuar arkitektonik, kohës i ka qëndruar struktura urbane e vendbanimeve, strukturë që ka pranuar ndryshimin dhe zhvillimin epokë pas epoke.

Kur ndërmarrim studime në fushën e morfologjisë urbane nuk do të thotë që sot të kopjojmë nga tradita dhe format e së shkuarës por do të thotë të gjejmë rrugët që këto studime

DO NOT COPY

të shërbejnë për të dalluar principe dhe përvoja nëpërmjet kuptimit të koncepteve, modeleve dhe teorive që analizojnë mjedisin njerëzor. Kjo arrihet duke e studiuar vendbanimin në dy këndvështrime: nga njëra anë qëndron **qyteti si proces i gjatë krijues** dhe nga ana tjetër studimi i **qytetit si produkt i këtij procesi** shumë të gjatë dhe shumë disiplinor.

Këto këndvështrime, ku konsiderohen njëkohësisht procesi dhe produkti urban, tregojnë lojën e kujdesshme dhe të balancuar ndërmjet unitetit të formës materiale të strukturës urbane dhe divesitetit në konceptimin arkitekturor dhe hapësinor të tij.

Nxjerrja e mësimeve nga e shkuara mund të jetë shumë e dobishme në qëllimin e përmirësimit të cilësisë së mjedisit të ndërtuar bashkohor në disa drejtime: në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kulturor të vendbanimit, në përpunimin e përgjigjeve mbi çfarë, si dhe ku duhet përqendruar procesi planifikues dhe projektues bashkohor, dhe si duhet siguruar zhvillimi dinamik e i pandërprerë i qytetit apo zonave të banimit duke pranuar proceset gjeneruese dhe fenomenet e pashmangshme të ndryshimit dhe të rritjes.

Sistemi tradicional, ndërtimor dhe qytet-formues që ne trashëgojmë është një proces historik në rritje dhe i drejtpeshuar, që sintetizon principe shoqërore e kulturore por dhe norma, kode fetare apo zakonore lokale.

Vështrimi i qytetit si objekt, si bashkim i arkitekturës dhe strukturës hapësinore urbane mundëson një vështrim më gjithëpërfshirës mbi qytetin, mundëson evidentimin e vlerave urb-arkitekturore e artistike si dhe vlerësimin e tij si një krijimtari me cilësi formale-estetike dhe përmbajtje shoqërore-kulturore. Pikërisht këtu merr rendësinë e vet elementi i hapësirës urbane, jo vetëm në aspektin material të saj, si pjesë e pandashme e strukturës urbane të vendbanimit por më tepër e konsideruar dhe studiuar si **kulturë hapësinore,** si faktor i ndikimit të hapësirës publike në jetën shoqërore, mjedis ku manifestohet shkrirja e grupeve shoqërore.

...Pallatet e begata dhe të lumtura në qytetin e hapur janë të stolisuara me vreshta të mrekullueshme, kopshte dhe parqe që duken përrallore me pavionet dhe galeritë e tyre. Ato janë dy ose tre kate të larta, të ndërtuara me gurë dhe çati me tjegulla. Secila prej tyre ka një burim me ujë të pastër dhe të rrjedhshëm, një hauz dhe një shatërvan me ujë që del me forcë. Ato janë banesa luksoze si ato të kopshteve të parajsës.... Pjesa tjetër janë shtëpi për klasën e mesme, të rehatshme dhe me kopshte. Dyert e të gjitha shtëpive janë të hapura ditë e natë... pronarët e shtëpive në këtë qytet e kanë për turp që të mbyllin dyert e shtëpive të tyre, të gjenden pa miq apo të hanë të vetëm nën shikimin e shërbëtorëve të tyre... Lagjet. Qyteti i hapur i cili ngjan me kopështet përrallore të Iremit, ka 18 lagje muslimane dhe 10 lagje të pafesh grekë, shqiptarë dhe latinë... Pazari. Pazari i madh i Elbasanit ka 900 dyqane dhe ato nuk gjenden të gjitha në një rrugë kryesore. Përkundrazi, këto dyqane gjenden përgjatë të gjitha rrugëve kryesore publike. Këto pazare tërheqëse janë të mirë furnizuar dhe mirë pajisur, të pastër, të rregullt dhe të mirëmbajtur, të mbuluar dhe nën hije. Tregjet më të këndshme janë ato të lëkurëpunuesve, të prodhuesve të mëndafshit dhe arpunuesve. Aty gjenden shtatë kafene, të pikturuara si tempujt e idhujve kinezë, vende ku mblidhen dijetarët dhe poetët...

Evlia Çelebiu v. 1670 (për Elbasanin)

Disa fakte historike[1]

Elbasanin e kanë quajtur qyteti i luleve dhe e ka merituar këtë emër. Në ata oborre të ngushtë përreth shtëpive elbasanase, nuset e reja, gratë, të moshuarit, por edhe burrat mbillnin me kujdes lehe të tëra lulesh me ngjyra të ndezura dhe erëmirë. Në portat e moçme e kudo nëpër mure e pezule kacavirren dorëzonjat që kundërmojnë tërë lagjen.

Historia e qytetit e ka zanafillën në shekullin e II-të m. Kr., por përmendet edhe më parë si itinerar kalimi nën emrin Candavia. Më pas është bërë e njohur si qendër antike kur ka nisur jetën e saj si një pikë e itinerarit të "Via Egnatias" dhe në shumë dokumenta historike përmendet me emrin Skampis. Duke patur një pozitë të favorshme gjeografike, shpejt u kthye në stacion kryesor të rrugës Egnatia dhe

[1]Burimi për faktet historike nga të dhënat në Internet

përmendet si qendër urbane, ushtarake e peshkopale.

Kalaja e qytetit datohet e ndërtuar në fund të shekullit të III-të e fillimit të shekullit të IV (vitet 284 – 305) m. Kr., në kohën e sundimit të perandorit Dioklecian.

Në shek. VI qyteti zhvillohet jashtë kështjellës, duke qenë qendër peshkopate, me një numër katedralesh dhe një bazilikë të madhe në kodrën e Tepes, pranë Kalasë.

Gjatë periudhës së dyndjeve barbare të shekullit të VI e të VII dhe të migrimit sllavo-bullgar, rruga Egnatia u bllokua, qyteti nuk përmendet më dhe njeh rënien e tij.

Në shekullin e XIV ndërtohet nga Karl Topija manastiri i Shën Gjon Vladimirit, i cili për afro 700 vjet shërbeu jo vetëm si qendër kishtare por ka pasur dhe një ndikim të madh në jetën kulturore e arsimore të Elbasanit.

Pas disfatës që pësoi në rrethimin e dytë të Krujës Sulltan Mehmeti II-të, në kthim, e rindërtoi kalanë e vjetër dhe në vitin 1466 qyteti mori emrin Elbasan (El– Basan), emër që e mban edhe sot. Në këtë periudhë qyteti u bë një nga qendrat më të rëndësishme administrative të Shqipërisë Qendrore.

Zhvillim të vrullshëm qyteti i Elbasanit mori në shek XVII-XIX me krijimin, organizimin dhe funksionimin e 60 llojeve të zejeve në 45 esnafe.

Në dokumentat e kohës dëshmohet se në mesin e shekullit XVII Elbasani kishte 2000 shtëpi e 900 dyqane. Në këto dyqane artizanale punoheshin lëkura të ndryshme, realizoheshin prodhime leshi, mëndafshi, etj.. Të veçanta kanë qënë dyqanet që realizonin prodhime me metale me ngjyra, sidomos ato të arit dhe të argjendit.

Kalaja e Elbasanit, së bashku me muret rrethuese dhe banesat me arkitekturë karakteristike përfshihen në tipin e veçantë të banesës qytetare.

Në qendër të kalasë ndodhen: Kisha Ortodokse Shën Maria, e ndërtuar në shek. XVI, e djegur në vitin 1819 dhe e rindërtuar në vitin 1833; Xhamia Mbret, e ndërtuar në shek. XVI; godina ku në Shtator 1909 zhvillon punimet i pari Kongres Kombëtar Arsimor, i cili vendosi hapjen e Shkollës Normale; Shtëpia Muze ku lindi Kostandin Kristoforidhi, personalitet i arsimit dhe kulturës kombëtare shqiptare; në anën veriore ndodhet Kisha Unite Katolike, ndërtuar në vitet 30 të shekullit të XX-të; në pjesën jugore ndodhet Kulla e Sahatit e lartë rreth 47 m.

Gjatë periudhës 1924–1939 qyteti i Elbasanit arriti një zhvillim të ndjeshëm në disa drejtime si psh: në infrastrukurë, kryesisht me ndërtimin e rrugëve që lidhnin Elbasanin me Tiranën, Durrësin, Korçën, Gramshin, Dibrën, etj., ndërtimin e ujësjellësit të qytetit dhe ndërtimin e centralit elektrik. Gjatë kësaj periudhe mori zhvillim edhe ekonomia me ngritjen e disa objekteve si: Fabrika e Alkoolit, Duhan Cigareve, Vaj Sapunit, etj., duke vazhduar edhe punën artizanale tradicionale.

Që në kohët antike, 14 Marsi është festa e Ditës së Verës. E quajtur ndryshe si dita e largimit të dimrit, kjo festë ka krijuar tashmë traditën e saj jo vetëm tek banorët e qytetit të Elbasanit por edhe në qytete të tjera të vendit, veçanërisht në Tiranë. Zanafillën "Dita e Verës" e ka në faltoren Zana e Çermenikës, e ndërtuar në rrethinat e qytetit të Elbasanit, e cila ishte perëndesha e gjuetisë, pyjeve dhe e të gjithë natyrës.

E trashëguar brez pas brezi, kjo festë popullore është një ditë e cila sot identifikon edhe vetë qytetin e Elbasanit, i njohur në Shqipëri për tradita të veçanta kulturore.

Sot Elbasani është një nga qytetet më të mëdha të vendit, me një popullsi prej rreth 128.000 mijë banorësh.

Elbasani është një qendër e rëndësishme industriale.

Pozita gjeografike dhe rajoni përreth

Vendndodhja e qytetit dallon për pozicionin strategjik të zgjedhur që në lashtësi në kontrollin e rrugës Egnatia e që më vonë u kthye në një pikë pararojë e ushtrisë osmane dhe pikë kontrolli e territorit në brendësi të vendit.



Fig. 1. Eduard Lir. Elbasani, Shtator 1848

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2. Gjeo-topografia e territorit dhe rruga Egnatia



Fig. 3. Qyteti sot dhe elementët kufizues natyrorë



Fig. 4. Bërthama e qytetit në strukturën urbane të sotme dhe drejtimet e rritjes

Jo pa arsye, udhëtarët e huaj ndër vite kanë tejçmuar peisazhin ku është vendosur qyteti. Peisazh natyror tipik mesdhetar, ku syri i njeriut rrok malet e palosur njëri pas tjetrit, kodrinat e gjelbëruara, luginat e lumejve, fushën e gjerë e deri brigjet e detit në horizont. Peisazh që ndryshon ngjyrë dhe dritë sipas orëve të ditës, motit e stinëve të vitit. Peisazh me kontraste të forta që ngjallte emocione të thella e të paharruara. Peisazh që krijonte të tillë atmosferë që nuk mund të mos vihej re në siluetën e shtrirë të qytetit të therur nga minaret, këmbanoret dhe kulla e lartë e sahatit të Kalasë mesjetare, në bardhësinë e ndërtesave të dekoruara me drurin e kafejtë e çatitë e kuqe, por dhe mbi veshjet shumëngjyrëshe të banorëve në ditët e pazarit në tregun e Bezistenit a në sheshin e rrapit shekullor përballë hyrjes së Kalasë.

Këta elementë gjeo-morfologjikë të zonës përbëjnë barriera kufizuese të shtrirjes së qytetit, të cilat ky nuk i kapërceu asnjëherë gjatë shekujve, duke u mjaftuar me kapërcimin e barrierës së vetme që e pengonte në zhvillim: muret e kalasë mesjetare.

Kjo dalje u realizua fillimisht me lagjen e Pazarit, në jug të Kalasë, për të pasuar më vonë me lagjet e banimit në lindje e veri lindje (Fig.4).

Situata urbane në mesin e shekullit të XX

Për të qendruar brenda idesë së këtij studimi, duhet të vemë në dukje që në fillim faktin se do përqendrohemi në analizën e vlerave të situatës urbane të qytetit të Elbasanit, para viteve 1960, kohë që vendos një kufi të qartë ndërmjet qytetit të ardhur nga e shkuara dhe ndërhyrjeve të para në srukturën urbane të tij nga projektues urbanistë që u përpoqën të përballen me kërkesat e kohës për zhvillim.

Një krahasim shumë të dukshëm për të vënë në dukje se çfarë ka ndodhur me qytetin në këto 50 vitet e fundit na e jep ballafaqimi i dy situatave urbane të shtrirjes dhe dendësimit të ndërtimeve që nga vitet 50-60 të shekullit të kaluar dhe deri më sot në fillim të shekullit të XXI (Fig.5-7).

Që në vështrim të parë dallon se përkundër një shtrirjeje të pa kontrolluar dhe mbidendësimi uniform të territorit të qytetit sot, në të shkuarën plani i qytetit na tregon të tjera veçori.

Së pari, struktura urbane na tregon shtrirjen e ndërtimeve në formën e lagjeve dhe blloqe të banimit si struktura dytësore satelite përreth zemrës së qytetit, të përfaqësuar

nga lagjja Kala dhe lagjja e Pazarit në jug të saj (Fig. 6).

Së dyti, dallojmë faktin se **hapësira e lirë** është pjesa më e vlerësuar e strukturës morfologjike të qytetit (Fig.8). Hapësira e lirë, hapësira e gjelbër urbane ka funksion të dyfishtë në strukturën e qytetit.



Fig. 5. Shpërndarja e ndërtimeve dhe struktura urbane në hartën e qytetit të fillimviteve 1960



Fig. 6. Skemë e organizimit të blloqeve të banimit në strukturën tradicionale urbane të qytetit; Fig. 7. Situata e sotme urbane e qytetit; Fig. 8. Zënia e territorit me ndërtim dhe struktura e hapësirës së jashtme

Ajo është njëkohësisht element ndarës ndërmjet lagjeve dhe blloqeve të banimit por shërben edhe si element bashkues rreth të cilit organizohen lagjet dhe ndërtimet që formojnë bllokun e banimit (Fig. 9).

Hapësira e lirë dallon si pjesë dhe vazhdim i peisazhit rural, që gjen rrugë të shumta për të depërtuar në strukturën urbane të qytetit, duke krijuar oaze gjelbërimi, kopshtijesh e lulishtesh.

Kjo shkrirje e gjelbërimit në strukturën urbane dhe për më tepër zemrat e gjelbra të blloqeve të banimit duhen vlerësuar si principi themelor që krijon identitetin urban, kulturor e më

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9. Funksionimi i hapësirës së jashtme si element ndarës i blloqeve të banimit dhe si element rreth të cilit organizohen ndërtimet që formojnë lagjet dhe blloqet e banimit

DO NOT COPY







Fig. 10. Struktura urbane e qytetit të Elbasanit. Rrjeti rrugor dhe blloqet e banimit; Fig. 11. Struktura e hapësirës së jashtme publike; Fig. 12. Skema aksiale e rrjetit urban sipas intensitetit të përdorimit

tej atë shoqëror të qytetit të Elbasanit të deri viteve 1950. Është pikërisht ky karakter dallues që përmend Evlia Çelebiu që në shekullin e 17-të, duke e krahasuar këtë qytet me kopshtijet e parajsës. Kjo nuk kishte pse të tjetërsohej (shkatërrohej apo mohohej) në vitet e fundit. Gjithçka mund të arrihej edhe nëpërmjet projekteve të sotme duke ruajtur këtë identitet urban të dalluar tek zemra e gjelbër e bllokut të banimit e më tej.

Së treti, struktura e rrjetit rrugor të qytetit lufton ndërmjet dy principeve kompozicionalë.

Nga njëra anë dallon fillesa gjeometrike ortogonale e kushtëzuar nga gjeometria e kështjellës dhe nga ana tjetër kësaj fillese gjeometrike i përgjigjen pak arterie kryesore pranë kështjellës, që ndjekin drejtimin paralel me muret.

Më tej, duke mos e duruar këtë gjeometri, rrugët shpërthejnë në lirinë e tyre organike duke ndjekur ndikimin e pronësisë mbi tokën, drejtimet diagonale më të shkurtra të lëvizjes, tërheqjen e pikave periferike të hyrjes apo daljes nga qyteti dhe çka është më e dallueshme, duke krijuar unaza të mbyllura të lëvizjes përreth blloqeve të banimit.

Kjo përpjekje drejt rrjetave të lira urbane, të ngjashme me organizmat e gjallë të natyrës, na tregon së pari karakterin organik të skemës urbane të këtij qyteti, plotësisht në përputhje me natyrën e gjallë të tij dhe më tej na flet edhe për respektimin e kodeve ndërtimorë popullorë të vendit në procesin e formimit, transformimit apo zhvillimit të qytetit.

I njëjti fenomen ndodh edhe brenda lagjes Kala, ku rrjeta urbane nuk e duron imponimin ortogonal të mureve kufizues dhe respekton vetëm gjurmën e rrugës Egnatia, nga porta lindore në atë perëndimore, sipas skemës gjeometrike edhe kjo e deformuar. Të gjitha rrugët e tjera edhe pse me kushtëzim të fortë nga gjeometria e kalasë devijojnë në drejtime diagonale, duke iu afruar skemave të lira organike (Fig. 14a - 14b).

DO NOT COPY



Fig. 14a. Rrugica karakteristike sot në lagjen Kala



Fig. 14a. Struktura urbane e lagjes Kala. Rrjeti rrugor dhe blloqet e banimit si dhe struktura e hapësirës së jashtme publike në lagjen Kala



Fotot në faqen majtas paraqesin rrugica karakteristike sot në lagjen Kala dhe në fotot sipër pamje të gjurmës së rrugës Egnatia brenda Kalasë.

DO NOT COPY



Fig. 14b. Skema aksiale mbi rrugët e lagjes Kala



Fig. 15a. Planimetri e fillimit të viteve 1960



Fig. 15b. Pamje panoramike e qytetit dhe qendrës se tij

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 15.1. Struktura urbane e Lagjes së Pazarit. Rrjeti rrugor dhe blloqet e ndërtimit;
Fig. 15.2. Skema aksiale e rrjetit rrugor mbi planin e lagjes; Fig. 15.3. Skema aksiale

Së katërti, të tjera veçori morfologjike shfaq lagjja e pazarit në jug të Kalasë dhe jashtë saj, e cila sot nuk ekziston më.

Këtu ndërtimet ekonomike, të shërbimit, tregtisë apo zejeve kanë diktuar ndërtim perimetral, rrjet rrugor gjeometrikisht të përcaktuar nga orientimi i mureve të kështjellës por që gjithsesi nuk përjashton drejtimet diagonale të lëvizjes. Rrugët janë më të ngushta, formulimi i tyre më i saktësuar, nuk ka transparencë hapësinore dhe zënia e sipërfaqes me ndërtim është e lartë si askund tjetër në qytet.

Në këtë lagje dallon si element zotërues kompozicional lidhja e ndërtimeve me mure të përbashkëta ndarëse, fenomen që rrallë haset në lagjet e banimit të qytetit jashtë Kalasë ku zotëron oborri apo kopshtijet.

Perspektivat pamore janë drejtvizore përgjatë drejtimeve të lëvizjes dhe hapësira e lirë shfaqet në formën e oborreve të pasëm thjesht funksionalë.

DO NOT COPY

BLLOKU I BANIMIT

Blloku i banimit jashtë kalasë

Në planin e përgjithshëm të qytetit, blloku i banimit jashtë kalasë na shfaqet në dy modele.

Modeli i parë, që është dhe ai më zotërues, është modeli i mbyllur, i kufizuar nga rrugë. (Fig. 16 - 17).

Ky model i organizimit të njësisë bazë të banimit karakterizohet nga:



Fig. 16. Modele të blloqeve të banimit në zonën e qytetit jashtë kalasë

- Krijimi i rrjetit unazor të rrugëve që realizojnë lëvizjen dhe mundësinë e hyrjes në banesa.
- Rrugë që shpesh herë nisen dhe përfundojnë në hapësira urbane, **nyje** të kryqëzimeve rrugore me sipërfaqe relativisht të vogël dhe me forma të lira jo kënddrejta, ku nisen apo përfundojnë 2,3,4 apo edhe më shumë rrugica.
- Sipërfaqja e bllokut të banimit është shumë e ndryshme si në madhësi ashtu edhe në formë dhe kurdoherë jo e rregullt gjeometrike.
- Organizimi i ndërtimeve është perimetral për të lehtësuar arritjen dhe hyrjen në banesë apo oborrin e saj pranë rrugës. Më shumë zotëron hyrja e drejtpërdrejtë në banesë por gjithsesi, kjo nuk përbën një rregull të detyrueshëm. Edhe banesat rrallë hasen të lidhura me njëra-tjetrën.
- Qendra e bllokut të banimit, pothuaj kurdoherë, e madhe apo e vogël qoftë, është e lirë nga ndërtimet e paracaktuara për oborret e pasëm që janë kopshtije me drurë frutorë, vreshta e lule.
- Perimetri i bllokut që jo gjithmonë është plotësisht i mbyllur nga ndërtesat, gjë që mundëson lidhjen e gjelbërimit nga blloku në bllok.
- Rrugicat qorre janë të pakta, vetëm në rastet e blloqeve të mëdhenj ku ndikon më tepër elementi i pronës në mënyrën e parcelimit të sheshit të përcaktuar për ndërtim.

Në ilustrimin djathtas paraqitet në mënyrë skematike ideograma e strukturës urbane të zonës së banimit jashtë Kalasë, si dhe marrëdhëniet ndërmjet blloqeve të banimit.



Fig. 17. Skema e modelit të blloqeve te banimit në zonën e qyteti jashtë kalasë

DO NOT COPY



Fig. 17/1. Organizimi i ndërtimeve dhe struktura e hapësirës së jashtme në disa modele të bllokut të banimit në lagjet jashtë kalasë. Në sfond të bardhë paraqitet hapësira e brendshme, pozitive. Në sfond të zi paraqitet hapësira e jashtme, negative.

DO NOT COPY



Fig. 17/2. E njëjta zonë e qytetit dje dhe sot.
Dallon dendësimi i ndërtimeve dhe zhdukja e zemrës së gjelbër të bllokut të banimit

Modeli i dytë i organizimit të ndërtimeve është ai linear, përgjatë rrugëve ardhëse në banesë (Fig. 18).

Ky model i organizimit të strukturës urbane shfaqet më tepër i aplikuar në periferinë e qytetit, ku forma e mbyllur e bllokut nuk ka arritur akoma të kristalizohet dhe ndërtimet janë në fazën e pushtimit të territoreve të lira përreth qytetit.

Modeli linear dallohet nga:

- Ndërtimet që shtrihen përgjatë rrugës;
- Dendësia e ndërtimeve është më e vogël dhe rruga jo e formuar plotësisht nga të dy anët apo në gjatësinë e saj;
- Shpesh hyrja nuk është drejt në banesë, cilësi kjo e fazës që i paraprin formimit të bllokut;
- Nyjet e kryqëzimeve janë hapësira më pak të formuara, duke qënë vetëm funksionale dhe në të shumtën e rasteve në formën ku vetëm një rrugë lidhet me atë kryesore;
- Shpesh dallon dhe organizimi i ndërtimeve në dy rradhë dhe prezenca e rrugicave që shkojnë në thellësi, por të pa përfunduara.

Organizimi i ndërtimeve dhe struktura e hapësirës së jashtme në disa modele të organizimit linear të ndërtimeve në periferi të qytetit, ku formimi i bllokut të mbyllur të banimit ka qënë në proces e sipër (Fig.18/1 - 18/2).



Fig. 18/1, 18/2. Organizimi i ndërtimeve dhe struktura e hapësirës së jashtme në disa modele të organizimit linear të ndërtimeve në periferi të qytetit, ku formimi i bllokut të mbyllur të banimit ka qenë në proces e sipër

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Blloku i banimit brenda lagjes Kala



Fig. 19. Plani i ndërtimeve në Lagjen Kala të Elbasanit

Blloku i banimit brenda lagjes Kala shfaq një situatë të larmishme e shumë të vështirë për t'u klasifikuar sepse reflekton veçori që i gjejmë të përsëritura në çdo lagje të qytetit.

Megjithatë:

- Struktura e rrjetit rrugor ruan disa orientime ortogonale por shfaqet tërësisht me prirje drejt skemave organike, duke krijuar unazat qarkulluese rreth blloqeve jo me forma ortogonale;
- Rrugica formulohet herë nga muret rrethues të parcelave e herë nga muret e vetë banesës, e cila në përgjithësi nuk ruan orientime të studiuara në vendosjen e saj të lirë në sipërfaqen e pronës;
- Kompozimi i ndërtimeve kryhet sipas skemave të banesave të bashkëngjitura por dhe të shkëputura. Kjo tregon respektimin e kodeve ndërtimorë shumë të rreptë të vendit, që siç dallon edhe në popullsi të tjera të Mesdheut ka vetëm një ligj parësor "mund të ndërtosh në pronën tënde sa e si të duash por pa prekur dhe dëmtuar të drejtat e fqinjit në pronën e tij";
- Dendësia e banimit është më e lartë se në lagjet jashtë kalasë;
- Megjithë ngushtësinë e diktuar nga muret rrethues të kalasë, banesat shoqërohen pothuaj se kurdoherë me oborre të vegjël të konceptuar si dhoma banimi në natyrë, shpesh në hyrje të banesës edhe kur kjo ka faqe muri përgjatë rrugicës;



20

Fig. 20 Skema në plan të blloqeve të banimit brenda lagjes Kala



Fig. 21. Tregon skemën e rrjetit unazor të rrugicave përreth blloqeve të banimit, intensitetin e zënies së tokës me ndërtim dhe strukturën e hapësirës së jashtme publike e private

• Hapësira e jashtme private shpesh merr cilësitë e një hapësire qendrore të bllokut të banimit, i vogël a i madh qoftë ky. Këtë veçori e hasëm më të realizuar në lagjet jashtë qytetit;

• Tipologjia e banesës në këtë lagje është shumë e larmishme, relativisht e re dhe pak është ruajtur nga ndërtimet tradicionale.



DO NOT COPY

DO NOT COPY

Blloku i ndërtimeve në Lagjen e Pazarit - "Bezistani"

Nga ilustrimet e paraqitura dallon dyllojshmëria e formës urbane të blloqeve të lagjes së Pazarit (sot i humbur).

Së pari, në skemat majtas, ku janë blloqet qendrorë të lagjes dallon kompaktësia ndërtimore, organizimi ndërtimor perimetral që tregon qartë për funksionin ekonomik të tyre (Fig. 22).

Në skemat djathtas janë paraqitur të veçuara blloqet e ndërtimeve. Kompaktësia ndërtimore e bllokut në perimetrin e jashtëm të Pazarit thyhet duke ruajtur këtë kompaktësi dhe linearitet në njërën anë përballë blloqeve qendrorë të Pazarit. Në këtë mënyrë, blloku, në pjesën e jashtme të tij merr disa veti formale të blloqeve të banimit (Fig. 23).



Fig. 22. Dallojmë planimetrinë e lagjes së Pazarit, strukturën morfologjike të organizimit të ndërtimeve dhe strukturën e hapësirës së jashtme brenda blloqeve ndërtimore

Fig. 23. Organizimi i ndërtimeve dhe struktura e hapësirës së jashtme në blloqet e ndërtimeve, në lagjen e Pazarit. Dallon blloku i mbyllur në zemër të lagjes dhe blloku i hapur në periferi të tij. Ndërtimet që përballen me zemrën e pazarit kanë strukturë të ngjashme me to dhe realizojnë së bashku formulimin e plotë dhe kompakt të rrugës





DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 24. Nyjet kryesore në strukturën urbane të qytetit në vitet 1950

DO NOT COPY



Fig. 25. Nyjet të ruajtura në strukturën e sotme urbane të qytetit

Nyjet janë pikat fokus të veprimeve që kryejnë banorët e këtij vendbanimi. Këto janë pika lidhëse të drejtimeve të lëvizjes, vende takimi, sheshe tregu ose hapësira pranë monumenteve të kultit.



Fig. 26. Nyjet në strukturën urbane të lagjes së Pazarit. Në perimetrin e jashtëm dhe brenda saj.

Një vendbanim mund të ketë nyje që i shërbejnë vetëm bashkësisë së disa blloqeve të banimit, nyje të rëndësisë për mbarë qytetin, por mund të kemi dhe të tilla që kanë rëndësi lokale për gjithë zonën përreth. Kjo është shumë e dukshme edhe në planimetrinë e Elbasanit. Shumë nga këto nyje janë akoma edhe sot të dallueshme në strukturën urbane të qytetit dhe ruajnë funksionet që kanë pasur por pa përjashtuar funksione të reja, që mund të kenë fituar me kohën.

Analiza funksionalo-morfologjike e tyre si dhe dallimi i vlerave arkitektonike është një nga mundësitë për të rigjallëruar identitetin kulturor dhe arkitektonik të qytetit, duke mos përjashtuar dhe ndryshimin dhe zhvillimin e tyre në kohë.

Le të dallojmë më poshtë disa lloje të nyjeve kryesore, ndër të shumtat që ka struktura urbane e qytetit.



Nyje periferike të lagjes Kala

Nyje të brendshme të lagjes

Fig. 27. Nyjet në strukturën urbane të lagjes Kala.

1. Është nyje e krijuar në hapësirat e rrugëve hyrëse e dalëse nga qyteti

2. Përfaqëson një nyje lineare me funksione publike në veri të lagjes së tregut të qytetit jashtë mureve jugorë të kalasë.

3. Janë nyjet në ekstremitetet e lagjes së tregut që tregojnë hyrjet dhe daljet në të.

4. Janë nyjet pozicioni i të cilave është përcaktuar nga tre portat e kalasë

5. Janë tre pikat dhe drejtimet kryesore të ardhjes dhe ikjes nga qyteti

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Modele të nyjeve në strukturën urbane të qytetit të Elbasanit



Modele nyjesh në brendësi të lagjes Kala.



Modele nyjesh në perimetrin e jashtëm të lagjes Kala.



Modele nyjesh në pjesë të ndryshme të qytetit.



Modele nyjesh në periferi të lagjes së Pazarit dhe rrugët kryesore të ardhjes në qytet.

DO NOT COPY

Perspektivat pamore në strukturën urbane të qytetit

Perspektivat pamore shumë këndore në disa hapësira publike (nyje) në lagjen Kala dhe perspektivat lineare fluide në rrugicat e kësaj lagjeje.

Një tjetër veçori shumë e ndjeshme e formës së strukturës urbane të Elbasanit është natyra e larmishme me cilësi organike e drejtimeve të shikimit gjatë ecjes në rrugët dhe rrugicat e tij. Kudo zotëron e papritura dhe kureshtja.

Drejtimet e shikimit rrallë janë të gjata dhe shikimi njëdrejtimësh, në të shumtën e rasteve rrëshqet butë përgjatë mureve të oborreve apo godinave që formulojnë rrugën, për t'u përballur më tutje në ndonjë ndërtim, që mbyll pamjen në një shesh të vogël.

Kjo e bën shikuesin kurioz për të arritur në atë shesh ku ai do të shijojë hapësirën e formuluar jo plotësisht në perimetër dhe nga dy plane në thellësi pamore. Formulimi i parë është muri rrethues i godinës, dhe më lart e më tutje, në plan të dytë formulimi realizohet nga gjelbërimi apo kati i sipërm i godinës. Secila zonë urbane e qytetit, lagjja Kala, Pazari apo lagjet e banimit kanë këto veti të përbashkëta dhe njëkohësisht dallohen mes tyre nga:

- Gjatësia e drejtimeve të shikimit,
- Shkalla e formulimit të hapësirave të jashtme në nyjet urbane dhe sheshet,
- Përkulshmëria në plan e aksit të rrugës, e cila është më e thyer dhe e lakuar në lagjet e banimit dhe drejtvizore në lagjen e Pazarit.
- Përkulshmëria e aksit të rrugës në lagjen Kala, e cila është drejtvizore e deformuar. Përkulshmëria e aksit të rrugës ka një shkak shoqëror. Ajo duhet të pengojë shikimin kurioz të portës së fqinjit në lagjet e banimit, ku edhe kodi vendor për ndërtimet në fqinjësi ka përcaktuar që porta e shtëpisë nuk lejohet të hapet përballë portës së fqinjit dhe duhet ta lejojë këtë në lagjen e Pazarit, ku dyqanet duhet të shiheshin.
- Funksioni thjesht qarkullues i hapësirave nyje në lagjet e banimit dhe funksioni i shërbimit dhe grumbullimit përveç atij të qarkullimit që kanë sheshet e lagjes së Pazarit.



Fig. 30. Perspektivat pamore shumë këndore në disa hapësira publike (nyje) në një nga lagjet e banimit jashtë kalasë dhe perspektivat lineare fluide në rrugicat e kësaj lagjeje



Fig. 31. Perspektivat pamore shumë këndore në disa hapësira publike (nyje) në lagjen e Pazarit dhe perspektivat lineare një këndore në rrugicat e kësaj lagjeje

DO NOT COPY



Fig. 29. Perspektivat pamore shumë këndore në disa hapësira publike (nyje) në lagjen Kala dhe perspektivat lineare fluide në rrugicat e kësaj lagjeje

DO NOT COPY

Struktura e ndërtimeve

Nëse do të shkëpusim nga harta e qytetit modele të organizimit të ndërtimeve, këto, megjithëse vështirë të klasifikueshme pasqyrojnë në një farë mënyre ligjësitë e brendshme morfologjike të vetë objektit urban.

Do të dallonim disa raste:

1. Ndërtimet në "bllok" me dendësi ndërtimi relativisht të lartë përreth nyjeve urbane dhe me hapësirë të lirë në brendësi të tyre. Këto organizime janë të lagjeve periferike, jo pranë Kalasë.

2. Ndërtime në "bllok" me dendësi edhe më të madhe pranë Kalasë por që ruajnë deri diku zemrën e tyre të gjelbër.

3. Ndërtime me strukturë lineare të dendura pranë qendrës dhe më të rralla në periferi (Fig. 32/1 - 32/2 - 32/3).

4. Dallon struktura ndërtimore e blloqeve në lagjen e Kalasë ku dendësia është më e lartë dhe një vendosje paksa e orientuar e ndërtimeve, e kushtëzuar nga gjeometria e saj (Fig. 33).

5. Struktura ndërtimore e bllokut në lagjen e Pazarit është më kompakte, ndërtimet janë me mure të përbashkëta, ka gjeometrizim në pamje të parë, por jo gjeometri ortogonale sepse është i dallueshëm edhe diagonaliteti (Fig. 34).

6. Në periferinë e largët të qytetit mund të hasen godina të shpërndara, organizime që nuk kanë arritur ende të krijojnë formë urbane.

• Nëpërmjet këtyre skicave na bëhen shumë të qarta disa cilësi të përbashkëta që shoqërojnë strukturën urbane, që vjen nga e shkuara e Elbasanit.

• Së pari do të dalloja **rrugën që ndjek procesi i formimit të "bllokut"**- si element thelbësor i procesit formëkrijues të vendbanimit.

• Vendosja e ndërtimeve është e çrregullt, "e lirë", duke u shfaqur si tërësisht e "rastësishme" larg modeleve teorikë, që mundohen të klasifikojnë formën. Është pikërisht kjo që **i jep strukturës urbane të qytetit vetëm një emër *"strukturë organike"*.**

• Nga blloqet e banimit në Kala, në periferinë e afërt të saj, në atë më të largët dhe më tej **dallon zotërues elementi i oborrit** dhe shmangia shkallë-shkallë e mureve të përbashkët të ndërtesave.

• **Hapësira e jashtme ka disa cilësi të përbashkëta:**



Fig. 32. Sipër, pamje të modeleve të grumbullimit të ndërtimeve në lagjet e banimit jashtë Kalasë

zotëron vazhdimësi depërtuese që niset nga periferia drejt qendrës, futet në brendësi të perimetrave ndërtimorë drejt zemrës së bllokut, formon unazat rrugore dhe jep mundësi që rruga për në banesë të ketë më shumë se një mundësi. Por, gjerësia e kësaj hapësire rrugore është si vetë ndërtimet, e rastësishme, jo standarte, e konceptuar për lëvizjen me kafshë.

• Hapësira e rrugës, por dhe ajo e nyjeve na **ofron drejtime shikimi apo perspektiva pamore jo të gjata, të thyera dhe fluide,** duke lënë hapur kuriozitetin e asaj që vjen më tutje në rrugë e sipër.

DO NOT COPY





Fig. 33, 34. Djathtas, pamje të modeleve të grumbullimit të ndërtimeve në lagjen Kala dhe lagjen e Pazarit

DO NOT COPY

Në përfundim disa reflektime

Si autorë, kemi bindjen se studime të tilla shërbejnë për të dalluar principet planifikuese edhe sepse vernakulare, që u dhanë formë qyteteve tona të traditës.

Këto studime shërbejnë për të njohur mekanizmat ligjorë, kodet vendorë dhe ekuilibret e marrëdhënieve shoqërore që mundësuan zhvillimin e tyre të balancuar dhe jetëgjatë. Këto analiza, kaq të pakta në fushën e urbanistikës, mund të shërbejnë për të vlerësuar, testuar dhe pse jo në ndonjë rast ripërdorur konceptet formëkrijuese të vendbanimeve të traditës, si dhe principet organizuese të tyre nën këndvështrimin e urbanistikës dhe arkitekturës bashkohore. Trashëgimia dhe kultura popullore nuk është mishëruar vetëm në objektet materiale por para së gjithash ajo duhet kërkuar dhe vlerësuar në idetë krijuese dhe mënyrën e evoluimit të tyre në kohë.

Gjithashtu, këto studime do të mund të realizojnë dokumentimin sistematik të gjetjeve dhe klasifikimin e tyre për t'ju shërbyer të tjerëve studiues dhe projektues urbanë, në mënyrë sa më të shpejtë në logjikën e respektimit dhe ruajtjes së vlerave të trashëgimisë ndërtimore dhe identitetit kulturor.

Cilat mund të ishin disa reflektime pas kësaj ecurie në situatën urbane të Elbasanit të viteve 1950 ?

- Së pari dallojnë principet e qëndrueshme strategjike, gjeo-morfologjike dhe ekonomike që përcaktuan vendndodhjen e qytetit të Elbasanit. Këta faktorë që vijnë që



Fig. 35. Monument kulture natyror

DO NOT COPY





Fig. 36, 37. Objekte të kultit në lagjen Kala brenda oborrit të tyre

nga lashtësia, garantuan jo vetëm fillesën e qytetit por mbi të gjitha jetëgjatësinë e tij në kohë.

• Element tjetër për t'u dalluar është qëndrueshmëria e strukturës urbane të qytetit e dukshme dhe prezente edhe sot në planimetrinë e tij. Kjo strukturë u kristalizua në periudha të gjata kohore duke pranuar si fenomene të papërjashtueshëm:

- zhvillimin në kohë dhe shtrirjen në territorin përreth nëpërmjet një logjike organike, por dhe duke kapërcyer barrierat gjeografike dhe natyrore.

- struktura urbane duke ruajtur identitetin e saj, pranoi ndryshimin, përshtatjen dhe transformimin si elementë konceptualë të domosdoshëm të formës urbane në përpjekjet e saj për t'iu përgjigjur fenomeneve të jetës shoqërore dhe urbane të qytetit.

- gjatë procesit të ekzistencës së saj u përpunuan rregulla dhe ligjësi të detyrueshme për t'u respektuar nga bashkësia qytetare. Këto ligjësi apo kode urbane, u shtrinë në çdo sferë të qënies së objektit urban dhe u shfaqën si ligjësi formale ndërtimore, ligjësi të natyrës së ndikimit të fenomeneve shoqërore mbi formën urbane, por dhe si ligjësi të ndikimit të formës urbane mbi zakonet, doket apo ritet e jetës shoqërore. Studimi i këtyre ligjësive mund të jetë një temë kërkimore më vete, dhe nuk u bë pjesë e këtij artikulli të shkurtër ku u përqëndruam më tepër në vetitë e formës së objektit urban të këtij vendbanimi.

Në formën e përgjithshme të strukturës urbane të Elbasanit dallon:

- Shtrirja e ndërtimeve të vendbanimit në formë shumë racionale nën logjikën e krijimit në kohë, e dendur dhe e kristalizuar plotësisht në lagjen e Kalasë dhe të Pazarit, më pak e dendur dhe akoma me energji të brendshme të procesit formëdhënës në lagjet rreth saj, jashtë mureve dhe shkallë-shkallë e mbetur akoma në fillesat e krijimit në lagjet periferike me dendësi të pakët dhe formë të papërcaktuar urbane;

- Rrugët kryesore janë ato të drejtimeve më të rëndësishme të qasjes në qytet, nga lindja, perëndimi dhe jugu;

- Rrjeta e strukturës urbane duket sikur do t'i përshtatet gjeometrisë së kështjellës, por kjo nuk ndodh as në qytet dhe as vetë brenda kalasë ku rrjeta deformohet. Këtu do të ishte me vend të theksojmë natyrën plotësisht organike jo ortogonale të rrjetës urbane të qytetit, që dallohet për përkulshmërinë e rastësishme, perspektivat pamore jo të gjata dhe fluide, hapësirat urbane me forma spontane jo gjeometrike, të zhvilluara në një terren relativisht të rrafshët e pa pengesa;

- Rrjeta urbane e qytetit ka si veçori dalluese krijimin e unazave rrugore, duke dhënë kështu më shumë se një mundësi për t'iu afruar banesës. Këto unaza të lëvizjes dallohen kudo, si brenda lagjes Kala dhe në lagjet e tjera të qytetit. Në planin e përgjithshëm të qytetit veçohen lagjet periferike, zhvillimi i të cilave fillon me skema ndërtimi lineare, që në të ardhmen tentojnë të krijojnë blloqet e mbyllura brenda unazave të lëvizjes;

- Lagjet e qytetit janë të formuara si bashkësi e disa blloqeve të banimit, satelite përreth kalasë dhe qendrës ekonomiko-zejtare. Kjo ka mundësuar depërtimin e gjelbërimit nga periferia drejt qendrës në formën e brezave të pandërprerë, fenomen që i ka dhënë Elbasanit vetitë e një qyteti me karakter organik e tejet të gjelbëruar;

- Spontaniteti i befasishëm dhe organik në konceptimin e rrjetës së qytetit shoqërohet me konceptim dhe zgjidhje formale shumë të dallueshme të bllokut të banimit, i madh apo i vogël, qoftë ai në shtrirjen e tij. Blloku i banimit karakterizohet nga qarkimi nga rrugët apo rrugicat dhe ndërtimet një apo dy katëshe të rradhitura përgjatë perimetrit, duke lënë mesin apo qendrën e bllokut të lirë për oborret e pasme apo kopshtijet. Ka raste kur perimetri i bllokut nuk mbyllet plotësisht nga ndërtimet, duke realizuar në këtë mënyrë shoqërimin e depërtimit të gjelbërimit nga periferia drej qendrës dhe duke pasuruar në këtë mënyrë strukturën e hapësirës së lirë urbane me elementin natyror më të qënësishëm;

- Pak përdoren rrugicat qorre, kryesisht në lagjen e Kalasë ku edhe ndërtimet janë më të dendura e oborret më të vegjël;

- Vendosja e ndërtimeve në territor apo nëpër parcela është shumë spontane, e rastësishme duke ndjekur siç duket vetëm një parim: të përshtaten me pronën, rrugën dhe të mos krijojnë problem me ndërtimet fqinje;

- Ndërimet e ngjitura, me mur ndarës të përbashkët, hasen pak, kryesisht në lagjen e Pazarit dhe në një farë mase në lagjen e Kalasë.

Të gjitha këto cilësi të formës dhe peisazhit urban të Elbasanit të realizuara ndër vite, në shërbim të marrëdhënieve shoqërore dhe cilësisë së jetës dhe banimit, të bëjnë të mendosh se sa shumë ka humbur ky qytet nga ndërhyrjet e një urbanistike të kultivuar, akademike, aspak e lidhur

DO NOT COPY

me natyrën organike të qytetit gjatë viteve 1960-1990, kur ekzistenca e shtetit të centralizuar mund të respektonte fare lehtë veçoritë morfologjike të objektit urban, karakterin dhe identitetin e papërsëritshëm të këtij vendbanimi.

Por, akoma më shumë qyteti po humbet sot nga arroganca vendimarrëse dhe ndërtimore e pas viteve 1990, kur fitimi shkatërron gjithçka njerëzore që u krijua ndër shekuj.

Elbasani mundohet t'i rezistojë kaosit të ndërtimeve me rrjetën e tij urbane që sot është kthyer në pengesë për jetën brenda tij. Le të shërbejnë studime të tilla për të vënë në rrugë më të mbarë proceset planifikuese e për më tepër ato rigjallëruese të hapësirës së tij publike në shërbim të jetës qytetare por dhe për ruajtjen e vlerave të veçanta që mbart akoma dhe sot peisazhi urban i qytetit.

BIBLIOGRAFIA

Hakim, S. Besim., "Mediteranian urban and building codes: origins, content, impact and lessons", *URBAN DESIGN International*, 2008, f.13, 21–40.

Hiller, Bill., "The architecture of urban object", *Ekistics* 334, January/February 1989, 335, March/April 1989.

Rossi, Aldo., *The architecture of the City,* Paperback, September 13, 1984.

Sitte, Camillo., *City planning according to Artistic Principles*, Random House, 1965.

Të dhëna historike për qytetin e Elbasanit - Nga faqja zyrtare e Bashkisë Elbasan.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Maksim MITROJORGJI
Joli MITROJORGJI

ELBASAN - THE LOST IDENTITY OF A CITY

The main purpose of this article is to experiment a reading of the settlement's form considering the city as an urban object and most of all as a cultural object, not only a creation of the human society but also esthetic, carrier of universal values, that are inherited and transmitted from generation to generation.

More than any other architectonic isolated object, the structure of the urban settlements has resisted time, a structure that has accepted change, transformation and development from time to time.

When we realize studies in the morphologic field, this does not mean that today we should copy from tradition and the forms of the past, but, it means we should find the ways that these studies serve to distinguish principles and experiences through the understanding of the concepts, models and theories that analyze the human environment. This is possible by studying the environment from two perspectives: in one hand there is **the city as a long creative process** and from the other hand the study of **the city as a product of this disciplined process**.

Staying within the idea of this study, we should point out the fact that we are going to concentrate in the analysis of the values of the urban situation of the city of Elbasan before 1960, a time that sets a clear limit between the city from the past and the first interventions in his urban structure from urban planners that tried to respond to the necessities of the time.

What has been distinguished in this short analysis?

First of all, we distinguish the sustainable strategic, geo-morphological and economic principles that have determined the position of the city of Elbasan.

Another distinctive element is the stability of the urban structure of the city, visible and present nowadays in his plan. This structure was consolidated in long periods of time accepting as non-conditional phenomena:

- Evolution in time and the territorial expansion through an organic logic, but also, by overcoming the geographic and natural barriers.
- The urban structure, protecting her identity, accepts change, adaptation and transformation as indispensable conceptual elements of the urban form in her efforts to respond to the phenomena of the social and urban life of the city.

• In Elbasan, in the general form of the urban structure we distinguish:

- The extension of the settlement's buildings in a very rational way under the logic of creation in time, dense and crystallized entirely in the Castle and the Bazaar quarter, less dense and still carrying the inner energy of the forming process in the quarters around her.
- The main roads are those in the most important directions of the city, from east, west and south.
- The grid of the urban structure seems to adapt to the geometry of the castle quarter, but it does not, nor inside the castle where the grid is distorted. It would be necessary to accentuate the organic nature, not orthogonal of the urban grid that stands for casual suppleness, visual short and fluid perspectives, not geometrical and spontaneous urban spaces developed in a flat ground.
-The city urban grid is distinguished for the creation of the street rings giving more than an option to approach the house.

-The city quarters are formed as a union of different satellite residence blocks around the castle and the economic-handicraft centre. This has enabled the insight of greenery from the peripheral area toward the centre by the form of an uninterrupted line.

- The surprising and organic spontaneity of the city grid conception is associated to the conception and very distinctive formal solution of the residential block whether big or small. The residential block is characterized by the perimetral roads and the 1 or 2 store buildings lined up along the perimeter leaving the centre free for the yards. It happens that the perimeter of the block is not entirely closed with buildings realizing the infiltration of greenery from the periphery toward the centre enriching the urban free space structure with the most natural element.

- The position of the buildings in the territory or in the plots very spontaneous, occasional following only one apparent principle: to adapt with the property, the road and not to interfere with the neighbors.

All these qualities of the form and the urban landscape of Elbasan, realized through the years in the service of the social relations and the quality of life and living, makes you think about how much has this city lost from the interventions of a cultivated urban plan, academic, not connected with the organic nature of the city.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet
52/2011 - 2014

DO NOT COPY

Agron ISLAMI
Michele RICCIARDONE
MSc. Klejdi ZGURO

NDËRHYRJET KONSERVUESE NË BAZILIKËN E SHËN JANIT, DELVINË (DYSHEMEJA ME PLLAKA GURI DHE MOZAIK OPUS SECTILE)

Përshkrim i shkurtër historiko – arkitektonik[1]

Bazilika e Shën Janit ndodhet e pozicionuar pothuajse 1 km në perëndim të fshatit modern të Shijanit, Delvinë, në rrjedhën e majtë të lumit të Kalasës. Pikërisht këtu ndodhet një kodër e vogël me përbërje gjeologjike ranore. Në lindje të planit të kësaj kodre gjënden rrënojat e një bazilike të antikitetit të vonë, e njohur nga banorët përreth me emrin e Shën Janit. Gërmimet e para janë ndërmarrë në vitin 1981, duke rifilluar shumë kohë më pas në vitet 2001, 2002, 2003. Pikërisht nga gërmimet e fundit është bërë e mundur evidentimi i disa fazave të ndërtimit të këtij monumenti.

Faza e parë: Kishëz e vogël me një navatë dhe apsidë me planimetri gjysëm rrethore, me pesë hyrje, ndër të cilat ajo e pjesës perëndimore monumentale, e pajisur me kolona graniti.

Faza e dytë: Bazilikë me tre nefe, secili i pajisur me apsidë me planimetri gjysmë rrethore në pjesën lindore, narteks, dhe një hyrje e re në pjesën jugore.

Faza e tretë: Shtohet një ekzonarteks dhe ambienti qendror (naosi) ndahet në tre pjesë.

Faza e katërt: Pas shkatërrimit të bazilikës, në pjesën veriore të narteksit ndërtohet një kapelë e vogël.

[1] Muçaj, S., Lako, K., Hobdari, E., Vitaliotis, Y., "Rezultatet e gërmimeve në Bazilikën e Shën Janit, Delvinë", *Candavia,* 1, 2004, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, 2004.

Analiza stilistike dhe përbërja e *OPUS SECTILES*

Ambienti qëndror i bazilikës (naosi) ka një sipërfaqe prej rreth 71.54 m^2

Në përgjithësi, format e pllakëzave të cilat përbëjnë sectilen janë katër këndore[2], si rombe, katrorë, si dhe në formë gjetheje (elips i zgjatur), të cilat alternohen duke ndjekur skema gjeometrike në përgjithësi jo të sakta, duke paraqitur një lloj mos vazhdimësie në vendosjen e tyre për sa i takon formave por dhe ngjyrave.

Një tjetër element që të bën të mendosh për teknikën dhe cilësinë jo të mirë të realizimit të dyshemesë ka të bëjë edhe me mospërputhjen e mirë të linjave të pllakëzave (crustae) të sectiles, të cilat nga ana e tyre paraqiten të trasha dhe pa vazhdimësi kromatike.

Dyshemeja përbëhet nga katër lloj materialesh[3] kryesore:

- gëlqeror i bardhë
- gëlqeror rozë
- gëlqeror gri (calcarenite), gur sedimentar i përbërë nga një matriks kokrrizash fine
- granit gri

Tre të parat përbëjnë pothuajse 90% të dyshemesë, të cilat janë përdorur për bazament amboni, pllaka opus sectile

[2] Shiko paraqitjen në *Bulletin de l'AIEMA*, 1999, f. 427–430

[3] Analizat petrografike nuk u realizuan, por u arrit në konkluzionin se përbërja e këtyre materialeve është e ngjashme me materialet gëlqerorë të përdorur në akropolin e Foinikes. Shiko *Phoinike* 3.

DO NOT COPY

të vendosura në llaç, me intonacione ngjyrash të ndryshme; e para më një ngjyrë të hapur të qartë, mbi të cilin janë vendosur pllakat dhe i dyti me një ngjyrë rozë, mbi të cilin janë vendosur pllakëzat e sectiles. Mendohet se ky variacion ngjyrash i përket zgjedhjeve stilistike dhe kombinimeve midis kontekstit të bardhë dhe rozë. (Fig.1,2)

Dy kolonat prej graniti, të cilat janë spolie nga ndërtime të tjera të zonës përreth janë ripërdorur, në kontekstin tonë, për të krijuar simetri dhe ndryshim volumetrik, gjatë realizimit të dyshemesë.

Bashkë me kolonat, të tjerë elementë të ripërdorur mendohet të jenë pllaka të tjera, të cilat duke u nisur nga mënyra e realizimit të vrimave për derdhjen e metalit, kanë qënë përdorur më parë në ndërtime të tjera.

Ndërhyrjet Konservuese

Këto ndërhyrje u zhvilluan gjatë muajit shtator 2010, si rezultat i një bashkëpunimi midis Misionit Arkeologjik Italian në Shqipëri, të Universitetit të Bolonjës dhe Institutit të



Fig. 1. Foto ajrore e bazilikës

DO NOT COPY



Fig. 2. Detaje të elementëve të ndryshëm të dyshemesë

Monumenteve të Kulturës. Ndërhyrjet u përqëndruan në pjesën e brendshme të bazilikës, veçanërisht tek dyshemeja e naosit dhe më pak tek ajo e narteksit, duke pasur parasysh se monumenti përbëhet nga elementë me vlerë që paraqisnin paqëndrueshmëri dhe patologji të ndryshme, të cilat me kalimin e kohës kishin agravuar gjëndjen konservuese të monumentit.

Si rezultat i një vëzhgimi të kujdesshëm të bio-kontekstit u zhvilluan kampionatura standarde, me qëllim evidentimin e llojeve të ndryshme të bimëve të cilat mbulonin monumentin (Fig. 3), duke përcaktuar për rrjedhojë llojin e përshtatshëm të herbicideve dhe biocideve për trajtimin e çdonjërës nga këto bio-patologji.

Në vazhdim të këtij procesi evidentimi dhe kampionaturash u ndërmorën ndërhyrje mekanike dhe kimike për eliminimin e bimësisë, me qëllim neutralizimin e këtyre formave biotike, qoftë të larta ashtu dhe të ulta, në mënyrë të tillë që procesi i neutralizimit dhe çrrënjosjes së tyre të mos dëmtonte ndonjë pjesë të dyshemesë (Fig.4). Këto ndërhyrje u realizuan me

DO NOT COPY



Fig. 3. Forma të ndryshme të bimësisë (bio-patologjive)

përdorimin e mjeteve të përshtatshme dhe me përdorimin e bio-herbicideve me spektër të gjërë veprimi, me bazë glisofanti 30.4% (g/l 360) për solucionet kundër gjetheve dhe me bio-herbicidë me bazë piklorami g 21.5 (= 246 g/l), dhe kooformulantë q.b. a g 100, solucion për neutralizimin e rrënjëve, i cili u përdor me spray dhe injeksion.

Operacioni i neutralizimit dhe eliminimit të vegjetacionit u pasua me zbulimin e kujdesshëm të dyshemesë (heqjen e plasmasit-polietilen), i cili ishte vendosur në kontakt direkt me të pas gërmimit të vitit 2006, mbi të cilën ishte hedhur një shtresë rëre. Dëmtimi dhe degradimi i plasmasit kishte bërë të mundur depërtimin e rërës, duke krijuar në shumicën e rasteve procese të pjesshme të bikarbonatizimit dhe ngurtësimit (çimentifikimit) të saj (Fig. 5), duke krijuar një masë uniforme, fenomene të nxitura këto edhe nga prezenca e lagështisë. Një patologji e tillë paraqitet e vështirë për t'u eliminuar me ndërhyrje jo invazive dhe pikërisht për këtë arsye u zgjodh mos eliminimi, por zbutja e kësaj patologjie, siç do të përshkruhet më poshtë.

DO NOT COPY



Fig. 4. Trajtimi i patologjive me natyrë biologjike



Fig. 5. Kalçifikimi mbi pllakëzat e sectiles

DO NOT COPY

Duke ndjekur rekomandimet e UNI-NORMAL 2005, mbas heqjes së polietilenit të vendosur mbi dysheme, eliminimit të formave biotike, bimëve të larta dhe analizës vizive të dyshemesë, u evidentuan dhe përcaktuan patologjitë dhe problematikat e ndryshme, si më poshtë:

- petëzim-zhveshje e materialit
- humbje materiali
- humbje e profileve
- bikarbonatizim
- humbje e intensitetit kromatik
- bio-patologji

Fillimisht u realizua ndërhyrja pastruese në të thatë duke përdorur furça me fije sintetike, duke eliminuar në këtë mënyrë depozitimet sipërfaqësore dhe në vazhdim u realizua ndërhyrja pastruese, duke përdorur detergjentë jo jonik, të përzierë me alkil benzil dimetilamon kloruri, 2% në tretësirë ujore (Fig. 6). Kjo përzierje u përdor për eliminimin e formave biotike të tipit bakterial (alga dhe kërpudha). Mbas këtij operacioni, sipërfaqja e trajtuar u shpëla në mënyrë të kujdesshme me ujë, me qëllim arritjen e një pH neutro (Fig.7).

Ndërhyrjet pastruese u zhvilluan pothuajse në të njëjtën kohë me ndërhyrjet për ngjitjen e copave të pllakave dhe rivendosjen e pllakëzave të sectiles.

Në rastin e parë (Fig. 8) u përdorën për ngjitje rezina epoksidike, me qëllim dhënien e një forme sa më të plotë pllakave të dyshemesë, por edhe për të penguar depërtimin dhe depozitimin e dheut dhe për rrjedhojë rritjen e formave biologjike invazive, duke çuar në këtë mënyrë në humbjen e profileve dhe dimensioneve.

Në rastin e dytë (Fig. 9) u realizuan bordurime mbajtëse me qëllim ruajtjen e opus sectiles dhe linjave të vizatimit, në mënyrë të tillë bërjen të mundur në të ardhmen të studimit stilistik të dyshemesë.



Fig. 6. Pastrimi dhe eliminimi i depozitimeve biologjike mbi dysheme



Fig. 7. Test i pH mbas pastrimit

Plotësimet me llaç: duke marrë parasysh qëndrimin në një kontekst me lagështi të lartë u vendos përdorimi i llaçrave me karakteristika hidraulike, me përbërje gëlqere hidraulike La Farge: rezistenca mekanike 7 gg – 30 bars / 28 gg – 60 bars; masa volumetrike 650 kg / m^3

Raportet e llaçit të përdorur:

3 – inerte të granulometrisë të vogël
1 – gëlqere hidraulike
100 ml – rezinë akrilike në tretësirë ujore

DO NOT COPY



Fig. 8; Fig. 9. Ngjitja e fragmenteve të shkëputura dhe konsolidimi i opus sectiles

Plotësimet më rezinë: duke marrë në konsideratë humbjen e vazhdueshme të materialit, u pa e arsyeshme dhe e domosdoshme aplikimi i një shtresë mbrojtëse të përbërë prej smalti epoksidik, multifunksional, bikomponent, të karakterizuar nga një rezistencë shumë e mirë ndaj agjentëve kimikë agresivë (acide, baza, kripëra), si dhe ndaj shpërbërjes mekanike, në mënyrë të tillë parandalimin e humbjes së materialit, në momentin e zbulimit të dyshemesë në të ardhmen, por dhe rezistencën ndaj agjentëve atmosferikë.

Në vazhdim të ndërhyrjeve të këtij lloji u procedua me trajtimin e frakturave dhe thyerjeve të pllakave, me përdorimin e llaçit hidraulik në raportin 2:1, duke shtuar rezina akrilike në tretësirë ujore dhe në bazë natyrës së tyre petrografike u ndryshua aspekti kromatik i llaçit duke variuar nga e bardha te roza. Një ndërhyrje e tillë u ndërmor për arsye parandalimin e shpërbërjes së materialit si pasojë e rrënjëve të bimëve dhe depozitimit të materialeve të huaja, por edhe për një lexim më të mirë të formave dhe dimensioneve (Fig. 10).

Pas përfundimit të ndërhyrjeve konsoliduese, me qëllim stabilizimin e gjëndjes fizike të veprës, puna u përqëndrua në vënien në kontroll dhe neutralizimin e makroflorës, duke trajtuar më herbicid të tipit qelizor kundër drurëve dhe rrënjëve, në tretësirë ujore 15%, ato bimë dhe rrënjë të cilat rezultonin akoma aktive pas trajtimeve të para. Operacioni konsistoi në hapjen e vrimave të thella në trupin e drunjtë të bimës, duke injektuar më pas herbicidin. Në përfundim ato u mbuluan me copa plasmasi (polietilen) të spërkatur po me herbicid, duke penguar në mënyrë të tillë riaktivizimin e tyre (Fig. 11).

Dyshemeja paraqiste gjithashtu lakuna dhe boshllëqe të konsiderueshme, kryesisht në zonat e sectiles dhe për këtë arsye, për të parandaluar depozitimin e dheut por dhe zhvillimin e bimëve të ndryshme dhe për rrjedhojë shmangien e paqëndrueshmërive statike, këto lakuna u trajtuan duke u mbushur me granil të granulometrisë së mesme, me qëllim



Fig. 10. Gjatë dhe pas ndërhyrjeve konsoliduese

bërjen sa më të lexueshme të dyshemesë dhe dekoracionit bazë të saj (Fig.12). Midis dyshemesë dhe granilit u vendosën shtresa gjeotekstili, duke penguar në një farë mënyre rritjen e formave biotike dhe në rradhë të dytë bërjen më të lehtë të **dallimit** të shtresës origjinale nga ajo e granilit.

Në përfundim të ndërhyrjeve, me qëllim mbrojtjen e dyshemesë në tërësi (pllakave të gurit/dekoracionit në opus sectile), pjesët me sectile u mbuluan fillimisht me një shtresë rrjete plastike (poliestër) me thurje të vogla dhe më pas e gjithë dyshemeja u mbulua me gjeotekstil, duke krijuar në këtë mënyrë një dopio shtresë mbrojtëse me spesor 0.5-1 cm.

Mbi shtresën e gjeotekstilit u hodh një shtresë granili, i cili u ngjesh mirë me qëllim krijimin e një shtrese kompakte unike, duke e mbrojtur dyshemenë në një farë mënyrë nga infiltrimi i ujrave të shiut dhe agjentët e tjerë atmosferikë. Përpara se të shtrohej i gjithë granili, pjesët e hapura në strukturat murale u mbyllën me mur të thatë, me qëllim mos derdhjen e granilit jashtë sipërfaqes së dyshemesë (Fig.13).

DO NOT COPY



Fig. 11. Trajtimi i bimëve me trup të drunjtë



Fig. 12. Integrimi i lakunave të mundshme



Fig. 13. Detaje para, gjatë dhe pas rimbulimit të dyshemesë

DO NOT COPY

Agron ISLAMI
Michele RICCIARDONE
MSc. Klejdi ZGURO

DO NOT COPY

CONSERVATIVE INTERVENTIONS ON THE BASILICA OF ST. JEAN, DELVINA

(Floor in Stone Tiles and Opus Sectile)

Conservative interventions were held in September 2010 as a result of a collaboration between the Italian Archaeological Mission in Albania, the University of Bologna and the Institute of Cultural Monuments, focused on the interior of the basilica, especially to the floor of the central nave and a little on narthex. As a result of careful observation of the bio-context, was conducted standard sampling to identify the different types of plants that covered the monument, thus determining the appropriate type of herbicides and biocides for the treatment each bio-pathologies. In continuation of this process and samples with evidences, were taken chemical- mechanical intervention and elimination of vegetation, in order to neutralize these biotic forms, whether high and low also, so that the process of neutralization and their eradication do not damage any part of the floor.

These interventions were performed with the use of appropriate tools, and the use of bio-herbicides with wide range of action, based on glisofant 30.4% (g / l 360) for solutions against leaves, and bio-based herbicide picloram 21.5 g (= 246 g / l), and q.b cooformulants ag 100, solution to neutralize the roots of which was used to spray and injection.

The concerning pathologies consisted in: exposure-material lamination, material loss, loss of profiles, bicarbonatism, loss of chromatic intensity, bio-pathology. Initially the intervention was conducted in the dry cleaning using brushes with synthetic fibers, thus eliminating surface deposits, than using non-ionic detergents, mixed with dimetilamonyum alkyl benzyl chloride, 2% aqueous solution. This mixture was used to eliminate bacterial type biotic forms (algae and fungi).

Supplements with mortar: considering the context with high humidity, was decided to use a hydraulic mortar, using hydraulic lime La Farge: mechanical resistance gg 7 - 30 bars / gg 28 - 60 bars; volumetric measures 650 kg / m3.

Supplementation with resins: taking into consideration the continuous loss of material, it was reasonable and necessary to apply a protective layer made of epoxy resin, characterized by a very good resistance to aggressive chemical agents (acids, bases, salts), as well as to mechanical disintegration.

The floor also presented significant lacunae, mainly in the areas with sectile. To prevent the deposition of the earth but also the development of different plants and therefore avoiding static inconsistencies, these lacunae was filled with granulated stone.

Generally the shape of the sectile, rectangular, as lozenges, squares, as well as leaf shape (elongated ellipse), which alternated following geometric schemes generally not accurate and not presenting a kind of continuity in placing them in terms of shapes and colors.

The floor consists of four main kinds of materials: white limestone, pink limestone, gray, gray granite.

monumentet
52/2011 - 2014

Andi REMBECI*

DO NOT COPY

KODIKU I MITROPOLISË SË KORÇËS DHE SELASFORIT (SHEK. XVII-XIX): TË DHËNA PËR KULTURËN NË ZONËN E KORÇËS

I. Veprimtaria ndërtimore dhe kulturore

Gjatë Perandorisë Osmane, komunitetet vendore të krishtera të hapësirës shqiptare dhe jo vetëm u detyruan të organizohen për të përballuar detyrimet taksore[1], për të zgjidhur problemet vendore dhe për të realizuar veprat e nevojshme fetare dhe veprat me karakter social[2]. Falë këtij organizimi, komunitetet fituan me kohë një jetë të brendshme politike pak a shumë të ndërlikuar, me zgjedhje të parësisë vendore dhe krijimin e grupeve të tyre të interesit, të cilat, në disa raste, evoluonin në forma politike vendore të mirëkonsoliduara ose jo. Nga zonat rurale, me komunitete më të vogla dhe me forma të thjeshta organizimi, deri tek qytetet, me numër të madh banorësh, mozaik fetar, me specialitete dhe larushi profesionale, me funksionim të esnafeve dhe të sistemeve tregtare, është e qartë se roli i faktorit dhe udhëheqjes fetare është mjaft i fortë, si në formësimin e mëpasshëm, ashtu edhe në administrimin e komuniteteve të krishtera ortodokse brenda Perandorisë Osmane[3].

Jeta sociale, ekonomike, kulturore dhe shpirtërore e elementit të krishterë në Korçë manifestohej në institucionet e krishtera të qytetit, domethënë kishat, manastiret dhe shkollat. Objektet e kultit të krishterë gjatë periudhës së pushtimit osman nuk përbënin vetëm vatrën e shprehjes fetare, por edhe qendrën e jetës komunitare, si vend mbledhjeje për bashkësinë, gjithashtu ishin vend i manifestimeve artistike të kohës[4]. Kësisoj, prania aktive e

---

* Pedagog në Departamentin e Historisë të Universitetit të Tiranës.

[1] Për praktikat fiskale të Kishës Ortodokse shih Kabrda J., *Le système fiscal de l'Eglise Orthodoxe dans l'Empire Ottoman*: (d'après les documents turcs), Brno : Universita J. E. Purkyne, 1969.

[2] Mbi funksionet sociale shih S. Petmezas, *Recherches sur les structures économiques et sociales de Pélion (1700-1830)*, thèse de doctorat, E.H.E.S.S., Paris 1989, pjesa 3. G. B. Dertilis, «Réseaux de crédit et stratégies du capital», në G. Dertilis (ed.), *Banquiers, Usuriers et Paysans. Réseaux de crédit et stratégies du capital en Grèce (1780-1930)*, Paris 1988, f. 33–80; Κωστης, K., «Κοινότητες, Εκκλησιά και Μιλλέτ στις «Ελληνικές» περιοχές της Οθωμανικής Αυτοκρατορίας κατά την Περίοδο των Μεταρρυθμίσεων», *Μνήμων* 13 (1991), f. 57–76. Për kundërvëniet ndërmjet elementëve kozmikë dhe kishtarë shih N. Pantazopoulos, *Church and law in the Balkan Peninsula during the Ottoman Rule*, Θεσσαλονίκη 1967, f. 107–112.

[3] Κονόρτα Π., «Η οθωμανική κρίση του τέλους του ΙΣΤ' αιώνα και το Οικουμενικό Πατριαρχείο», *Τα Ιστορικά*, vëll. 2, fash. 3, 1985, f. 45–76.

[4] Për sistemin komunitar dhe institucionet islame që përcaktonin jetën e të krishterëve gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, shih Amantos, C., "La reconnaissance par les Mahométans des droits politiques et religieux des Chrétiens et le décret de Sinan pacha" (in Greek), *Chroniques Épirotes* 5 (1930), f. 197–210. Amantos C., "The charters of Islam in favor of the Christians", *Hellenica* 9 (1936), f. 156–157. Ιω. Γ. Γιαννόπουλου, "Κοινότητες", *Ιστορία του Ελληνικού Έθνους*, vëll. XII, bot. Αθηνών, 1975, f. 134–143. Papastathis C., "Terms of Submission – The "Privileges", *Epirus. 4000 Years of Greek History and Civilization*, Athens: Ekdotike Athenon 1997, f. 242–244. Papastathis C., "Community Life – Justice and Customary Law", *Epirus. 4000 Years of Greek History and Civilization*, Athens: Ekdotike Athenon 1997, f. 252–257. Skendi S. "The Millet System and its Contribution to the Blurring of Orthodox National Identity in Albania", në: *Christians and Jews in the Ottoman Empire. The Functioning of a Plural Society*, ed. Braude B. - Lewis B.,

DO NOT COPY

faktorit kishtar në jetën e bashkësisë së Korçës, por edhe në atë të zonave që ndodheshin nën administrimin kishtar të Mitropolisë së Korçës, ndër të tjera bëhet e dukshme edhe nga zhvillimi i ndjeshëm i ndërtimit dhe nga veprimtaria artistike në sektorin kishtar, siç janë ndërtimi dhe stolisja e kishave të reja, rindërtimi i kishave të vjetra, themelimi i manastireve, ndërtimi i komplekseve kishtare, etj..

Me fillimin e pushtimin osman, zhvillimi kulturor u ngadalësua: largimi i intelektualëve, mbyllja e shkollave, rrënimi ekonomik, kaosi i krijuar prej nënshtrimit, ishin faktorë që ndërprenë çdo lloj krijimi shpirtëror. Megjithatë, shek. XVI dhe XVII, ndonëse sillnin jehonat e pushtimit osman, karakterizoheshin nga një lëvizje elementare shpirtërore dhe veprimtari ndërtimore kishtare në zonën e Korçës. Që prej fillimit të shek. XVII, me stabilizimin e kushteve të jetesës në hapësirën e Perandorisë Osmane, u krijuan kushte të favorshme për veprimtaritë ekonomike[5]. Shembull i njohur i kësaj periudhe është kisha pasbizantine e Metamorfozës së Shpëtimtarit në Tremisht të Përmetit, që u ndërtua më 1560[6], kisha e Kryeengjëllit Mëhill në fshatin Shalës në Kolonjë, ndërtuar në shek. XVII[7]. Po ashtu, kisha e Shën Joan Pararendësit në Voskopojë, që u ndërtua më 1632, është e tipit në formë kryqi, me kupolë dhe konke anësore[8], dhe karakterizohet nga pikturat murale mbresëlënëse në interiorin saj[9]. Po ashtu, gjatë



Fig. 1. AQSh. f. 488. Kodiku i Korçës nr. 99 (Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit). Pamje e veshjes së kodikut.

më pak se një njëqindvjetëshi, mes viteve 1650-1740, në Voskopojë u ndërtuan 24 kisha[10].

Fusha të shumta të hulumtimit shkencor shpalosen nga prezantimi dhe studimi i të dhënave që burojnë nga arkivat kishtarë. Një prej tyre është edhe Kodiku i Mitropolisë së

vol. 1, London-New York 1982, f. 243–257. Në lidhje me kanonizmat administrative të komuniteteve të krishtera shih Papastathis C., "Οἱ κανονισμοὶ τῶν Ὀρθόδοξων ἑλληνικῶν κοινοτήτων τοῦ Ὀθωμανικοῦ κράτους καὶ τῆς διασπορᾶς, vëll. I, bot. Ἀδελφῶν Κυριακίδη, Θεσσαλονίκη 1984. Për organizimin e komunitetit të krishterë të qytetit të Korçës shih Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça and Selasphorus: Edition and Historical Documentation (17th – 19th centuries)* (in Greek), Ionian University 2009, f. 97-113.

[5] Χασιώτης Ἰ., «Ο Ελληνισμός κατά τους δύο πρώτους αιώνες μετά την άλωση», *Ιστορία του Ελληνικού Έθνους*, vëll. 10 (1974), f. 16. Patrinelis C. G., "Hellenism during the Early Period of the Tourkokratia (1453-1600). A Historical Survey with Particular References to the development of Post-Byzantine Art", *Deltion of the Christian Archaeological Society* 16 (1991-1992), Series 4. In memory of André Grabar (1896-1990), f. 33–38.

[6] Thomo, P., *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut,* bot. KOASh, Tiranë 1998, f. 38, 88–89.

[7] Shkupi, F., *Dëshmi të zbukurimores*, f. 97. Thomo, P., *Kishat pasbizantine,* f. 38.

[8] Thomo, P., Stratobërdha G., *Restaurimi i monumenteve të Kishës Orthodhokse në Shqipëri*, bot. KOASh, Tiranë 2005, f. 250.

[9] Adhami S., "Një monument me vlerë i shek. XVII në Voskopojë", *Monumentet 10* (1975), f. 63–70.

[10] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/10. Shi, po ashtu, Τρίτος Μ., «Ἡ Μοσχοπόλη τοῦ χθὲς καὶ τοῦ σήμερα», *Ηπειρωτικό Ημερολόγιο 10* (Ιωάννινα 1998), f. 219 e në vijim. Thomo, P., *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut*, bot. KOASh, Tiranë 1998, f. 57–79. Adhami S., *Një monument me vlerë në Voskopojë,* f. 63–64. Κουρίλας Ε., «Μοσχόπολις και η Νέα Ακαδήμεια αυτής. Η καταγωγή των Κουτσοβλάχων και η εγγραμμάτισις της γλώσσης αυτών», *Θεολογία* 12 (1934), f. 153.

DO NOT COPY

Korçës dhe Selasforit[11] (Fig. 1), i pasur me informacione të rëndësishme lidhur me veprimtarinë ndërtimore kishtare, si dhe me zhvillimin e artit kishtar në shek. XVIII-XIX. Fillimet i ka në periudhën kur në fron ishte Kryepeshkopi i Ohrit dhe Primati i Korçës, Partheni (1670-1676). Ka qenë ruajtur në arkivin e Mitropolisë së Hirshme të Korçës dhe sot ruhet në Arkivin Qendror Shtetëror në Tiranë, bashkë me arkiva të tjera që kanë përmbajtje të natyrës kishtare. Në AQSh, dorëshkrimi është renditur mes 100 dorëshkrimeve më të rëndësishëm të Shqipërisë, në Fondin "Kodikët e Shqipërisë", Dosja 99.

Njoftimet në Kodikun e Korçës nr. 99 janë shkruar në kohëra të ndryshme, brenda periudhës kohore nga viti 1676 deri në fillim të shek. XX. Ato janë përdorur, në një pjesë të madhe apo të kufizuar, si burime historike nga studiues të ndryshëm, vendas dhe të huaj, gjatë fundit të shek. XIX dhe shek. XX[12]. Për sa i takon përmbajtjes, në fletët e shpëtuara të kodikut gjendet një numër i madh regjistrimesh apo shënimesh kronikale (170 akte/regjistrime), që lidhen me aspekte të ndryshme të jetës së banorëve jo vetëm të qytetit të Korçës, por edhe të zonave përreth. Një peshë të veçantë zënë shënimet kronikale dhe regjistrimet që lidhen me veprimtarinë ndërtimore të Mitropolisë së Korçës, e cila, siç rezulton edhe nga dokumentet, ishte intensive dhe ecte paralelisht me zhvillimin shoqëror dhe kulturor të vendit[13]. Duke u mbështetur në informacionet që mbledhim kryesisht nga kodiku i Korçës nr. 99[14], por edhe nga kodikë të tjerë administrativë të kishave apo manastireve të Mitropolisë së Korçës dhe duke i krahasuar ato me burime të tjera të botuara sot, do të paraqesim një pamje të veprimtarisë kulturore dhe artistike si dhe do të japim një informacion mbi pasurinë monumentale të kultit të krishterë në qytetin dhe zonën e Korçës.

Gjatë periudhës nën shqyrtim, në qytetin e Korçës funksiononte kisha e Shën Marisë ose e varrezave, kisha e Mitropolisë e Burimit Jetëdhënës, kisha e Shën Gjergjit dhe dy kapelat, e Shën Thanasit dhe e Profetit Ilia, që kishin të ndërtuara në dy kodra ndanë qytetit[15].

a) Kisha e Shën Marisë kishte në anën e djathtë të saj kishëzën (paraklisin) e Shën e Premtes (ose Shën Parashqevisë) dhe ndodhej në Varosh të Poshtëm, në një "*vend të mënjanuar, jo fort larg Varoshit*"[16]. Kisha ishte ndërtuar atje ku më herët ka qenë ndodhur manastiri i Fjetjes së Hyjlindëses, manastir, i cili, në kohë të ndryshme, është djegur tri herë[17]. Kisha e Shën Marisë pati të njëjtin fat, duke iu nënshtruar dy a tri herë, edhe ajo, pasojave të zjarrit, por

[11] Për një analizë shteruese kodikologjike dhe paleografike të Kodikut të Korçës nr. 99 shih A. Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis of Korca,* ku paraqitet edhe e gjithë bibliografia studimore e deriatëhershme mbi këtë kodik. Po ashtu, shih edhe Sinani Sh., "Një nga kodikët e Korçës", në *Kodikët kronografikë të Shqipërisë,* bot. Naimi, Tiranë, 2014, f. 383–410.

[12] Në pamundësi për të paraqitur bibliografinë shteruese mbi kodikun e Korçës nr. 99, për shkak të hapësirës së kufizuar dhe të karakterit të këtij artikulli, po përmendim vetëm emrat e studiuesve kryesorë: Thimi Mitko, Nuçi Naçi, Joakim Martinianos-i mitropolit i Ksanthit, Anthim Aleksudhi mitropolit i Beratit, Harallamb Karmici, Heinrich Gelzer, Ilo Mitko Qafëzezi, Petraq Pepo, Pirro Thomo, Kosta Naçi, Shaban Sinani, Andi Rembeci, Sokol Çunga etj. Për referenca të plota bibliografike deri më 2009, shih Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*: bibliografi. Për studime të kryera pas vitit 2009, shih paraqitjen bibliografike te Sinani Sh., *Një nga kodikët e Korçës*, f. 383–410.

[13] Për zhvillimin ekonomiko-shoqëror dhe demografik të Korçës gjatë shek. XVIII-XIX shih: Petraq P., "Kontribut mbi historinë e tregut të Korçës e të Voskopojës gjatë zhvillimit osman", *Korça e re* 5 (1964), f. 162–182; Petraq P., "Materiale dokumentare mbi veprimtarinë e zanatçinjve të Korçës e të Voskopojës në shek. XVIII-XIX", *Studime Historike* 1 (1967), f. 165–181; Rembeci, A., «Οικιστική και Πολεοδομική Ανάπτυξη στην Κορυτσά (15ος -19ος αιώνας)», në: *Η Κοινή Αρχιτεκτονική Κληρονομιά των Αρχοντικών Σπιτιών της Ηπείρου και της Νοτίου Αλβανίας*, Παν. Ιωαννίνων, Ιωάννινα 2008, f. 117–136; Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, 75-96; Thomo, P., *Korça: urbanistika dhe arkitektura*, bot. Akademia e Shkencave, Tiranë ²2012, f.32–41.

[14] Edhe pse njoftimi për ekzistencën e kodikut të Korçës nr. 99 dhe realizimi i studimeve të mbështetura në regjistrimet e tij nisin që në shek. XIX, i pari që ndërmori botimin në shqip të regjistrimeve të tij në formë shaptilografike, për nevoja të brendshme burimologjike të Institutit të Historisë, është Petraq Pepo (*Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shekullit XVIII-fillimi i shekullit XX (Kodiku i Korçës dhe i Selasforit),* vëll. I-II, bot. Akademia e Shkencave – Instituti i Historisë, Tiranë 1981). Për shkak se në botimin shqip të regjistrimeve të kodikut u konstatuan probleme, sikundër edhe vetë autori përmend "*Në përkthime tekstesh të këtij lloji, të metat nuk janë të rralla, por lexuesi ka mundësi t'i kontrollojë, pasi ne kemi dhënë dhe materialet origjinale të kodikut*" dhe, duke qenë se materialet në origjinal të kodikut nuk janë dhënë, sikundër deklarohet prej autorit, për shmangien e gabimeve të mundshme, kemi dhënë transkriptimin paleografik të origjinalit (marrë nga Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça,* pj. II, f. 200–366) dhe përkthimin gjegjës në shqip, kryer prej nesh.

[15] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/4.

[16] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 161/1: «*θέσιν μεμονωμένην είς μικράν τινα ἀπόστασιν τοῦ Βαροσίου*». Ranskriptimi paleografik dhe përkthimi yni. Shih, po aty, edhe regjistrimin nr. 160/4.

[17] Për Manastirin e Fjetjes së Hyjlindëses, shih më poshtë, tek f. 11.

arriti të mbijetonte në sajë të meremetimeve dhe ndërhyrjes së menjëhershme të komunitetit. Në nefin e djathtë të kishës, në anën jugore, ka ekzistuar ky mbishkrim[18]:

«Ὁ θεῖος καὶ ἱερὸς οὗτος ναὸς τῆς ὑπεραγίας Θεοτόκου πυρποληθεὶς τὸ δεύτερον, ἀνεγέρθη τὸ τρίτον κατὰ τὸ 1844 ἔτος, ἐπιστατεύοντος καὶ ἐπιτροπεύοντος τοῦ κ. Χρ. Γώδη καὶ ἀρχιερατεύοντος τοῦ πανιερωτάτου κ. Κιρίλλου ἐκ Βερροίας. Ἐν ἔτει δὲ 1846, ἀρχιερατεύοντος τοῦ πανιερωτάτου μητροπολίτου Κορυτσᾶς κ. Νεοφύτου ἐξ Ἀργυρόκαστρου καὶ ἐπιτροπεύοντος τοῦ ῥηθέντος κ. Χρ. Γώδη, ἐζωγραφήθησαν τὰ ἐξῆς ἐν τῷ ναιῷ τούτῳ: Ὅλαι αἱ δεσποτικαὶ εἰκόνες, οἱ 4 θόλοι, ἡ πλατυτέρα, ἡ πρόθεσις καὶ ἡ κοίμησις διὰ χειρὸς παπᾶ Ζήκου καὶ τοῦ υἱοῦ αὐτοῦ Δημητρίου 1847 Ἰουλίου 20 ἐκ Σελίτσης»

Kjo kishë e shenjtë dhe e hirshme e së Përmbishenjtës Hyjlindëse, si u dogj për herë të dytë, u rindërtua për të tretën herë në vitin 1844, në kohën kur ishte kujdestar dhe epitrop zoti Kristo Godi dhe në kohën e kryepriftërisë së të tërëhirshmit z. Kiril nga Veria. Në vitin 1846, në kohën e kryepriftërisë së të tërëhirshmit Mitropolit të Korçës, z. Neofit nga Gjirokastra, dhe të kujdestarisë së të sipërpërmendurit, z. K. Godi, u pikturuan në kishë sa vijojnë: të gjitha ikonat dhespotike, 4 kupolat, platitera, proskomidhia dhe Fjetja, [të cilat u punuan] nga papa Zikoja nga Selca dhe i biri, Dhimitri, më 20 korrik 1847.

Gjithashtu, me dhuratat e Dhimitër Joan Kirkës dhe me lejen e prefektit të Selanikut Aqif Pasha, që inspektonte ato zona, u ndërtua më 1868 kambanorja e kishës së Shën Marisë[19]. Nuk mungonin, ndërkaq, dhe dhuratat e herëpashershme të të krishterëve dhe të kontribuuesve të kishës, të cilat shënohen jo me ndonjë rend të caktuar dhe jo me rend kronologjik në kodikun e Korçës. Si shembull sjellim përpjekjen e Kryepeshkopit të Ohrit, Zosimait dhe komunitetit së Korçës për blerjen e një çifligu, i cili iu dhurua kishës së Shën Marisë. Çifligu kushtoi 49.000 aspra dhe të ardhurat e tij shërbenin për mirëmbajtjen e kishës së Shën Marisë dhe më pas, për kishën e Burimit Jetëdhënës, ndërsa tepricat shkonin në arkën e Llasos për mbështetjen e arsimit në qytet[20].

b) Kisha Mitropolitane e Burimit Jetëdhënës (Fig. 2-4) ishte kishë kushtuar tri shenjtorëve[21]. Nderonte Burimin Jetëdhënës (që qendër), Shën Harallambin (në anën veriore) dhe Shën Visarionin (në anën jugore)[22]. Kisha ndodhej brenda zonës së shkollave dhe mbante emrin e "Hyjlindëses"[23]. Siç dihet, gjatë pushtimit osman ndalohej ngritja e kishave të reja, ndërsa për rindërtimin e kishave ekzistuese duhej të lëshohej leje ndërtimi nga autoritetet osmane[24] (si, p.sh., rasti i lejes së

[18] Mbishkrimi është botuar për herë të parë te Καρμίτσης Χ., *Γεωγραφία τῆς Κορυτσᾶς καὶ τῆς περιοικίδος*, ἐν Θεσσαλονίκῃ 1888, f. 18–19. Në vijim, është botuar vetëm përkthimi i tij në shqip te N.D.N., *Korça бe Πσatrat per qark*, Sofje 1901, f.15 dhe N.D.N. *Korça dhe katundet e qarkut*, Korçë 1923, f. 32–33, duke mos i qëndruar besnik origjinalit. Së fundmi është botuar, më 1998, nga Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 202, nr. 440. Këtu, përkthimi në shqip yni.

[19] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 131.

[20] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/4.

[21] Për tipologjinë e kishave kushtuar tre shenjtorëve shih: Βελένης Γ., «Τὸ πολύκογχο Ἱερὸ Βῆμα τῶν τρισυπόστατων ἐκκλησιῶν τῆς Τουρκοκρατίας (1453-1850)», në: *Ἐκκλησίες στὴν Ἑλλάδα μετὰ τὴν Ἅλωση* (Përg. Χ. Μπούρα), vëll. 2, bot. Ἐκδόσεις Ἐθνικοῦ Μετσόβιου Πολυτεχνείου, Athinë 1982, f. 13–20.

[22] N.D.N, *Korça бe Πσatrat,* f. 13-14. Shih dhe Κουρίλας Ε.,«Μοσχόπολις και η Νέα Ακαδήμεια αυτής. Η καταγωγή των Κουτσοβλάχων και η εγγραμμάτισις της γλώσσης αυτών», *Θεολογία* 12 (1934), f. 153.

[23] Καρμίτσης Χ., *Γεωγραφία τῆς Κορυτσᾶς*, f. 16 , shën. 1.

[24] Për këtë çështje shih: Βακαλόπουλος Α., *Ἱστορία τοῦ Νέου Ἑλληνισμοῦ*, vëll. 2, f. 198-199, ku referohet se për rindërtimin apo ndërtimin e një kishe lypej leje e veçantë, për të cilën ktitorët paguanin shuma të mëdha të hollash. Shih, po ashtu: Puzanova, V., *Shënime mbi artin shqiptar,* f. 49; Runciman St., *The Great Church in Captivity: A Study of the Patriarchate of Constantinople from the Eve of the Turkish Conquest to the Greek War of Independence,* vol. II (in Greek), Athens 2000, f. 375. Faroqhi, S., *Subjects of the Sultan: Culture and Daily Life in the Ottoman Empire*, (in Greek), Athens 2000, f. 85–86. Për kuadrin ligjor dhe lejet e ndërtimit të kishave në Perandorinë Osmane gjatë shek. XVIII dhe në shek. XIX shih, gjithashtu: Tsitimaki, M. K., *Traditional church building in Lesbos (18th - 19th c.)*, National Technical University of Athens (NTUA), Athens 2006, f. 100–127. Për këtë çështje në tërësi shih:. Kiel M., *Art and society*

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2. Kisha e vjetër katedrale "Burimi Jetëdhënës" në Korçë.

lëshuar nga prefekti i Selanikut për ndërtimin e kambanores së kishës së të Tëreshenjtës). Me një vështrim të parë kjo procedurë juridike paraqitet si faktor frenues, por në realitet kishte funksion diametralisht të kundërt, duke krijuar realisht një shpërthim në ndërtimin e kishave. Kështu, kishat "rikonstruktohen", duke i dhënë këtij termi një kuptim të veçantë me shtrirje të gjerë: që nga punimet e thjeshta të mirëmbajtjes e deri ndërtim nga fillimi të kishave në vendet ku ekzistonin rrënoja apo kishë ekzistuese. Rast krejt karakteristik përbën mënyra me të cilën bashkësia e Korçës siguroi lejen për ndërtimin e kishës së Mitropolisë së Korçës:

of Bulgaria in the Turkish period: a sketch of economic, juridical and artistic preconditions of Bulgarian post-Byzantine Art and its place in the development of the art of the Christian Balkans,1360/70–1700: a new interpretation. xxii, 400 f. Assen-Maastricht: Van Gorcum, 1985.

DO NOT COPY

«Φοβούμενοι δέ ἕνεκα τῶν τότε περιστάσεων, καθ' ἃς δεν ἐπιτρέπετο ἐλευθέρως ἡ ἀνέγερσις τοιούτων ἱερῶν σκηνωμάτων, τρεῖς ὄντα πρῶτα τότε φέροντες Μάκος Βασιλείου, Σιάμος καί Χατζῆ Κώτσης κατώρθωσαν κρύφια νά ρίψωσι θεμέλια τινα καί, σκεπάσαντες αὐτά, νά διαδώσωσιν ὅτι ἐν τῷ μέρει ἐκεῖνο ὑπήρχεν ἄλλοτε παρεκκλήσιόν τι, ὅπερ καί βέβαιον ὡς ἐκ τῆς θέσεως τῆς Μητροπόλεως καί ζητήσωσι τήν ἀνέγερσιν τῆς ἐκκλησίας, μετά πολλῶν δέ κόπων καί μόχθων, οὓς ὑπέστησαν... κατώρθωσαν ἐπί τέλους ἐν τάχει νά οἰκοδομήσωσιν αὐτήν, ἐργασθέντες μικροί τε καί μεγάλοι πρός ἀνέγερσιν τοῦ κτιρίου»[25]	*Të frikësuar nga rrethanat e atëhershme, pasi ndërtimi i këtyre ndërtesave të shenjta nuk lejohej, tre vetë nga paria, Marko Vasiliu, Siamo dhe Haxhi Koçi arritën që fshehurazi të hidhnin një palë themele dhe, si i mbuluan, hapën fjalën se në atë vend pat ekzistuar dikur një paraklis, fjalë të cilën e vërtetoi edhe Mitropolia, duke kërkuar leje për ndërtimin e kishës, që u mor me shumë mund e lodhje.... Në fund u arrit që shpejt të ndërtohej kisha, duke punuar të mëdhenj e të vegjël për të.*

Për nder të kësaj vepre të guximshme, ikonat e tre ndërtuesve veshur me veshje tradicionale ishin pikturuar brenda në kishë, në anën jugore.

Brenda kishës, në nefin e majtë (verior), mbi hyrje, ndodhej ky mbishkrim ktitorik[26]

Lidhur me ndërtimin dhe pikturimin e kishës qarkullojnë informacione që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Për sa i përket ndërtimit, referenca e parë kohore jepet në mbishkrimin e mësipërm ktitorik, pra se punimet e ndërtimit filluan më 1707 dhe puna përfundoi, me gjithë pikturimin, më 1720. Të njëjtën periudhë kohore na jep edhe një dokument "*i njëjtë me origjinalin*" nga kodiku i Korçës, që thotë: "*Në vitin një mijë e shtatëqind e njëzet e pesë u ndërtua kjo kishë e Burimit Jetëdhënës të Korçës [...] E pikturuan vëllezërit Zografi, Konstandini dhe Athanasi, nga Korça*"[27]. Përkundër këtyre informacioneve vjen data e ndërtimit të kishës, që referohet në një paraqitje të shkurtër të hartuar nga mitropoliti i Korçës, Dhorothe Kristidhi, e shkruar në kodikun e Korçës. Sipas këtij shënimi, ndërtimi i kishës daton rreth vitit 1749[28] Dhorotheu ngutet ta argumentojë këtë fakt, duke shtuar se "*kisha në fjalë është ndërtuar para rreth 130 vitesh, çka vërtetohet edhe nga testamenti i ktitorit të parë të saj, Maku Vasiliu, që daton më 1756*"[29]. Informacionet e tij mund të krahasohen dhe me ato të Aravantinos-it, i cili e cakton kohën e ndërtimit të kishës më 1750 dhe referon, për më tepër, se ktitori i sipërpërmendur, Maku Vasiliu, ndërroi

«Ὁ ναὸς οὗτος τῆς Ζωοδόχου Πηγῆς ἱδρύθη ἐν ἔτει σωτηρίου 1707, ἀρχιερατεύοντος μὲν τοῦ Πανιεροτάτου Μητροπολίτου Κοριτσᾶς καὶ Σελασφόρου Ἰωασάφ, ἐπιτροπεύοντος δὲ τῶν κτιτόρων αὐτῆς Μάκου, Χατζῆ Κώτση καὶ Σιάμου. Κωνσταντῖνος δὲ καὶ Ἀθανάσιος Ζωγράφος ἱστόρησαν αὐτὸν τῷ 1720»	*"Kjo kishë e Burimit Jetëdhënës u themelua në vitin shpëtimtar 1707, në kohën e kryepriftërisë të të nderëhirshmit Mitropolit të Korçës dhe të Selasforit, Joasafit, kur kujdestarë ishin ktitorët e saj, Maku, Haxhi Koçi dhe Shamo. E pikturuan Konstandin dhe Athanas Zografi më 1720".*

[25] Rembeci A., The Codex of the Holy Metropolis of Korça, regjistrimi nr. 160/4. Transkriptimi paleografik dhe përthimi yni.

[26] Mbishkrimi është botuar në greqisht nga Καρμίτση Χ., *Γεωγραφία τῆς Κορυτσᾶς*, f. 16–17; në shqip nga N.D.N, *Korça be Πατrat*, f. 14 dhe N.D.N. *Korça dhe katundet*, f. 30; Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, f. 165–166, nr. 329. Këtu, përkthimi yni.

[27] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. A´ tek Shtojca: *«Ἐν ἔτει χιλιοστῷ ἑπτακοσιοστῷ εἰκοστῷ πέμπτῳ ἠγέρθη ὁ ναός οὗτος τῆς Ζωοδόχου Πηγῆς Κορυτσᾶς [...] Ἱστόρησαν δέ αὐτόν οἱ κύριοι αὐτάδελφοι Ζωγράφου, Κωνσταντίνος καί Ἀθανάσιος ἐκ Κορυτσᾶς»*. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[28] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/4: *"ἡ ῥηθεῖσα ἐκκλησία ἀνῳκοδομήθη πρός 130 ἐτῶν ἀποδεικνύεται καί ἐκ τῆς διαθήκης τοῦ πρώτου κτίτορος αὐτῆς Μάκου Βασιλείου χρονολογουμένης ἀπό τοῦ 1756"*. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[29] Rembeci, *A., The Codex of the Holy Metropolis of Korça, regjistrimi nr. 160/4: «Ἡ δέ ἐκκλησία τῆς μητρόπολης ἡ ἐν ὀνόματι τῆς Ζωοδόχου Πηγῆς τιμωμένη... Πρό ἑκατόν τριάκοντα ἐτῶν, ἀριθμός 130, οἱ τῆς Κορυτσᾶς ὀρθόδοξοι κάτοικοι ζήλῳ εὐσεβείας κινούμενοι συνέλαβον τήν εὐσεβῆ πρόθεσιν τοῦ νά ἀνηγείρωσι τοιαύτην ἐκκλησίαν πρός ἀποκεντρόντι μέρος πλησίον τῆς μητρόπολης»* ("Kisha e Mitropolisë e nderuar me emrin e Burimit Jetëdhënës... Para njëqind e tridhjetë viteve, nr. 130, banorët ortodoksë të Korçës, të shtyrë nga zelli i shpresëtarisë, patën dëshirën shpresëtare që të ndërtojnë këtë kishë në një vend jashtë qendrës, pranë mitropolisë"). Duke marrë parasysh se kjo shkresë u hartua më 1879, arrijmë në përfundimin se data e ndërtimit të kishës është 1749. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

Do not COPY



Fig. 3. Pamje e brendshme e kishës së vjetër katedrale "Burimi Jetëdhënës", Korçë.

jetë "*me një vdekje të papritur*" tri ditë pasi u betuan që të tre ktitorët se çështjen e themeleve të kishës do ta mbajnë krejtësisht të fshehtë[30].

Për sa i përket datës së pikturimit të kishës, referenca e parë kohore mbështetet në mbishkrimin e mësipërm ktitorik, i cili e saktëson pikturimin më 1720. Datë të përafërt (1725) jep edhe dokumenti "*i njëjtë me origjinalin*". Por, studiuesit e veprimtarisë artistike të Athanas dhe Konstandin Zografit nuk janë dakord me datën e mbishkrimit. Theofan Popa, duke kufizuar fillimin e veprimtarisë së tyre artistike jo më herët se viti 1741, i konsideron të gabuara informacionet e mbishkrimit[31].

Gjithashtu, edhe vetë Karmici, që ka botuar mbishkrimin, tërthorazi kishte shprehur dyshime për mbishkrimin, duke pranuar se duhet të jetë shkruar pas pikturimit të kishës dhe jo nga duart e Zografëve[32]. Për më tepër, këtë këndvështrim e përforcon edhe fakti se vëllezërit Zografi pothuaj gjithmonë i nënshkruanin punët e tyre me formën: «*Διά χειρός αὐταδέλφου*

[30] Ἀραβαντινὸς Π., Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου εἰς τρία μέρη, (me hyrjen e K. Θ. Δημαρᾶ, dhe red. e E. I. Νικολαΐδου), bot. E.H.M., Ἰωάννινα 1984, vëll. 1, f. 115 dhe shën. 1.

[31] Th. Popa i qëndron idesë se, e para, veprimtaria 63 vjeçare e vëllezërve Zografi, pra, që nga viti 1720, që referohet në mbishkrim, deri më 1783, që shënohet në fund të veprimtarisë së tyre, është një hapësirë kohore mjaft e gjatë. E dyta, që t'u jepej Zografëve detyra e pikturimit të një monumenti kaq të rëndësishëm, do të thotë se në atë kohë ata ishin piktorë të mirënjohur dhe, si rrjedhojë, në një moshë të pjekur. Në mbështjetje të këtij këndvështrimi, Popa sjell dhe dëshminë gojore të banorëve të Korçës në vitet '60, sipas së cilës kryesia e qytetit shpalli një konkurs për pikturimin e kishës, të cilin e fitoi Konstandini, si piktori më i talentuar. E treta, nga viti 1720, deri më 1744, kur daton vepra e parë e firmosur prej tyre, nuk kemi asnjë punë tjetër. Popa, Th., "Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi dhe freskat e tyre në skenat e Apokalipsit", *Buletin i Universitetit Shtetëtor të Tiranës, ser. Shkencat Shoqërore* 1959, 1, f. 25–26; shih gjithashtu: Popa, Th., «Shkolla e Korçës dhe tradita e saj në pikturën murale», *Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë 1969, f. 5. Krahaso edhe me Πελεκανίδης Σ., *Βυζαντινὰ καὶ μεταβυζαντινὰ μνημεῖα τῆς Πρέσπας*, Θεσσαλονίκη 1960.

[32] Καρμίτσης Χ., *Γεωγραφία τῆς Κορυτσᾶς*, f. 17.

DO NOT COPY



Fig. 4. Kisha e re katedrale "Burimi Jetëdhënës" në Korçë.

Κωνσταντίνου καί Ἀθανασίου ἐκ πόλεως Κοριτσᾶς» (*Me dorën e vëllezërve Konstandin dhe Athanas nga qyteti i Korçës*)[33]. Dhe, në fund, ekziston një mbishkrim i piktorit Athanas Zografi në ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e Burimit Jetëdhënës, që thotë: *«+ Δέησις Ἀθανασίου ζωγράφου καὶ ἠπὸ χειρὸς αὐτοῦ ηστορίθεῖ εἰς 1752»* (*Lutje e Athanas Zografit, pikturuar me dorën e tij më 1752*)[34]. Si përfundim, pra, mbështetur në të dhënat e mësipërme, priremi të mendojmë se kisha filloi të ndërtohej nga viti 1707 dhe pikturimi i saj duhet të jetë përfunduar pak vite pas përfundimit të ikonave të ikonostasit[35] (rreth viteve 1752-55).

Në oborrin e kishës së Burimit Jetëdhënës u ndërtuan më pas selia e Mitropolisë dhe shkollat e para të komunitetit[36]. Vijoi, në periudha të ndryshme, dekorimi i interierit të kishës

[33] Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 98, 173–174, 176–177, 181.
[34] *Po aty*, f. 178.

[35] Është e ditur se në atë kohë, zakonisht, pikturimi i kishës bëhej pasi përfundonin së punuari ikonat e ikonostasit. Shih: Tourta A.,„ *The churches of Agios Nikolaos at Vitsa and Agios Minas at Monodendri. A study of the Linotopi Painters,* Athens 1991 (in Greek with summary in English), f. 37–38 dhe Τσιγαράς Χρ. Γ., «Ἐργασίες ἠπειρωτῶν ἁγιογράφων καὶ κτιστῶν στὴ Σκήτη τῆς Ἱερᾶς Μονῆς Ξενοφῶντος», *Ἠπειρωτικὸ Ἡμερολόγιο* 15–16 (1993-1994), f. 311.
[36] Për shkollat që funksiononin në Korçës shih: Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, f. 151–162, ku gjendet edhe bibliografia përkatëse.

dhe ndërtimi i ikonostasit nga drugdhendësi Dhimitër[37], me kontributet jo vetëm të qytetit të Korçës, por edhe të komuniteteve fqinje, të cilat shënohen në kodik pa saktësi kohore[38]. Ikonostasi i mrekullueshëm përfaqësonte një mjeshtëri të lartë artistike dhe ishte punuar në dru arre me motive zoomorfe dhe floreale. Ikonat e ikonostasit i kanë pikturuar vëllezërit Konstandin dhe Athanas Zografi[39]. Pas pothuaj një shekulli, komuniteti arriti me miratimin e Aqif Pashës, që përmendëm më sipër, të ndërtojë kambanoren e kishës më 1876[40].

c) Kisha madhështore e Shën Gjergjit (Fig. 5-6) ndodhet në Lagjen e Re (Jenimahalla), në të djathtë të hyrjes së pazarit, ndanë udhës me kalldrëm, që mbante të njëjtin emër, ndërtuar nga esnafi i lëkurëregjësve[41]. Kisha u ndërtua mbi rrënojat e një kishëze më të vjetër, së cilës nuk ia dimë datimin. Nga të dhënat e kodikut të Korçës mësojmë se të krishterët e Korçës mendonin të ndërtonin një kishë më të madhe, për të përmbushur nevojat e komunitetit dhe, më 1874, filluan punimet për ndërtimin e saj[42]. Në vitin 1881, banorët e Korçës, me lejen e autoriteteve osmane, shembën kishën e vjetër dhe filluan punimet, të cilat u ndërprenë dy herë. Herën e parë u ndërprenë për shkak të pafuqisë ekonomike të komunitetit, të cilit i erdhi në ndihmë me kontributin e tij të bollshëm bamirësi i Korçës, Anastas Laçke[43]. Herën e dytë, dëshmitë e rreme të dhëna tek autoritetet osmane se komuniteti ka qëllime të dyshimta, duke ndërtuar një ndërtesë që ngjan më shumë me kështjellë, se me kishë, sollën ndërprerjen e punimeve deri në një urdhër të dytë. Pas kontrollit që bënë autoritetet osmane, u dha leje për vijimin e punimeve, të cilat përfunduan më 1885[44]. Për ndërtimin e kishës së Shën Gjergjit u shpenzuan rreth 50.000 lira[45], çka dëshmon se korçarët e pasur dhe bujarë bënë përpjekje serioze për zhvillimin e vendit amë. Pas vdekjes së Anastas Laçkes në Bukuresht, komuniteti i Korçës e solli trupin e tij në Korçë, ku u varros me shumë nderime në kishën për të cilën ndihmoi të ndërtohej[46].

d) Për dy kishat e tjera, të **Profetit Ilia** (Fig. 7) dhe **Shën Athanasit** (Fig. 8) nuk ekzistojnë të dhëna historike mbi mënyrën si u ndërtuan. Në kodikun e Korçës, në regjistrimin me dt. 12 mars 1878 përmendet: *Përveç këtyre dy kishave, ekzistojnë edhe tre paraklise, dy prej të cilave ndodhen mbi dy kodrat pranë qytetit, ajo e Shën Athanasit dhe e Profetit Ilia...*"[47]. Kishat janë të ndërtuara në kodrat që mbajnë të njëjtët emra dhe më parë shërbenin edhe si kisha varrezash.

[37] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 7[137]: «*Ο εντιμότατος κύριος Δημήτριος σκαληζῆς του αὐτοῦ τέμπλον αφιέρωσεν ὑπέρ ηγεῖας ασλλ(άνια) 0.5. Αι(ωνία ἡ μνήμη) γ'*» ("*Fort i ndershmi zoti Dhimitër, gdhendës i këtij ikonostasi, kushtoi për shëndet 0,5 asllanë. I përjetshëm kujtimi*"). Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[38] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimet nr. 9, 29, 30, 67, 68, 69, 70, 102, 129, 130, 134, 135, 159.

[39] Popa, Th., *Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi*, f. 25.

[40] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/4.

[41] Lidhur me mënyrën e funksionimit të esnafeve në Korçë dhe kontributin e tyre në zhvillimin ekonomiko-shoreror të qytetit shih: Petraq Pepo, "Materiale dokumentare mbi veprimtarinë e zanatçinjve të Korçës e të Voskopojës në shek. XVIII dhe XIX", *Studime Historike* 1 (1967), f. 165–181. Rembeci, A., "A Greek Post-Byzantine Manuscript: The Codex of the Diocese of Korça. Information about the Guilds of Korça during the 18th-19th Centuries", *Albanohellenica* 5 (2013), f. 259–268. Gjithashtu për enafet në pëgjithësi në Shqipëri shih Shkodra, Z. *Esnafet shqiptare*, Tiranë 1973.

[42] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/4: "*τό δέ ἕτερον ἐντός τῆς πόλεως τό τοῦ ἁγίου Γεωργίου, περί τοῦ ὁποίου οἱ χριστιανοί σκπτονται τήν ἀνέγερσιν ἐκκλησίας ἀναγκαιοτάτης διά τήν πόλιν, περιτοιχίσαντες πρό πέντε ἐτῶν τόν περίβολον αὐτῆς*" ("*Paraklisi tjetër, ai i Shën Gjergjit [gjendet] brenda në qytet, të cilin të krishterët mendojnë ta rindërtojnë në kishë më të madhe, mjaft të nevojshme për qytetin dhe, për këtë qëllim rrethuan përpara pesë vitesh (1874) oborrin e tij*"). Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[43] N.D.N, *Korça бe Πσatrat*, f. 14–15; shih gjithashtu: Καρμίτσης Χ., *Γεωγραφία τῆς Κορυτσᾶς*, f. 17–18. Karmici, gabimisht, referon si bamirës dhe kontribues në ndërtimin e kishës së Shën Gjergjit, Gjergj Dukën, themeluesin e Shkollës së Vashave. Kjo për shkakun se të dy ishin investitorë të arsimit dhe se që të dy përmenden në të njëjtin vend në veprën e Karmicit. Besojmë se bëhet fjalë për ndonjë lajthitje të autorit. Për biografinë e Anastas Laçkes, shih: Μπέττης Σ., *Ἠπειρωτικὴ Εὐποιΐα, ἢ βιογραφικὴ συλλογὴ Ἠπειρωτῶν εὐεργετῶν τῆς Τουρκοκρατίας*, vëll. A, bot. Ἀγαθοεργῶν Καταστημάτων Ἱερᾶς Μητροπόλεως Ἰωαννίνων, Ἰωάννινα 1982, f. 265, ku jepet dhe bibliografia përkatëse.

[44] N.D.N. *Korça dhe katundet*, f. 30–31.

[45] Ισμυρλιάδου Α., *Κοριτσά, Εκπαίδευση, ευεργέτες, οικονομία 1850-1905*, Ίδρυμα Μελετών Χερσονήσου του Αίμου-Institute for Balkan Studies, Θεσσαλονίκη 1997, f. 23. Shih, gjithashtu, Ευλόγιος Κουρίλλας, «Κορυτσά», *Μακεδονικόν Ημερολογίον*, viti 1909, Εν Αθήναις, f. 284.

[46] N.D.N. *Korça dhe katundet*, f. 31.

[47] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/4: "*Ἐκτός τῶν δύο τούτων ἐκκλησιῶν ὑπάρχουσι καί τρία παρεκκλήσια, τά μέν δύο ἐπί δύο λοφίσκων πλησίον τῆς πόλεως ὀνομαζόμενα τοῦ ἁγίου Ἀθανασίου καί Προφήτου Ἡλίου...*". Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

DO NOT COPY



Fig. 5. Pamje nga kisha e Shën Gjergjit, Korçë.



Fig. 6. Pamje e brendshme e kishës së Shën Gjergjit, Korçë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7. Kisha e Profetit Ilia, Korçë.



Fig. 8. Kisha e Shën Thanasit, Korçë (v. 1906).

DO NOT COPY

II. Manastiret e zonës së Mitropolisë së Korçës

Manastiret ortodokse në Shqipërisë janë të shquara si mjedise institucionale të kultit të krishterë, të kulturës bizantine gjatë dhe pas Bizantit, duke luajtur, veçanërisht gjatë periudhës osmane, një rol të rëndësishëm ndërkulturor dhe arsimor. Në zonën e Korçës, ekzistenca e shumë manastireve dhe për më tepër, në një periudhë islamizimesh, agresioni, shfrytëzimi dhe abuzimesh që zgjatën më shumë se gjysmë shekulli, është tregues i çmuar për të kuptuar më thellë jo vetëm aspektin e drejtpërdrejtë fetar të çështjes, por më tepër dimensionin e shumanshëm që shpaloset nga ndërthurja e kultit, me monumentin e kultit, me historinë e krijuar apo të regjistruar prej tij dhe me kontributin e larmishëm të ofruar në komunitetet përreth apo më gjerë. Sigurisht, shumë manastire, kohë pas kohe, u shkatërruan apo u shkretuan, dhe në vendin e disa prej tyre, më vonë, u ndërtuan kisha, nën kujdesin e zonave rreth tyre. Kjo listë e parë e 19 manastireve, që u themeluan ose u rindërtuan në zonën e administrimit kishtar të Mitropolisë së Korçës dhe për të cilat do të japim më poshtë informacione të përmbledhura, është bazuar kryesisht nga të dhënat që burojnë prej kodikut të Korçës dhe kodikëve e burimeve të tjera të botuara[48].

1. Manastiri i Fjetjes së Hyjlindëses në Korçës, i cili, sipas Aravantinos-it, u ndërtua më 1225[49], në vendin e të cilit, siç u tha më sipër, u ndërtua më 1844 kisha e së të Tërëshenjtës në varreza. Manastiri ka qenë djegur tre herë në kohëra të ndryshme. Nga gërmimet që ishin bërë në atë kohë në zonë, siç na informon kodiku i Korçës: *"u gjetën shenjat e një kishe trihipostazike, pjesë ndërtese në formë qelish, trarë, çka dëftejnë lashtësinë e saj"*[50]. Po ashtu, për ekzistencën e këtij manastiri dëshmon dhe një akt i shkruar vonë në kodikun e Korçës, lidhur me një dhuratë që bën Kryepeshkopi i Ohrit dhe primati i Mitropolisë së Korçës, Joasafi[51]:

"Ὁ μακαριώτατος, λογιώτατος καί θεοπρόβλητου πατριάρχης τῆς Πρώτης Ἰουστιανῆς Ἀχριδῶν καί πάσης Βουλγαρίας καί πρόεδρος Κορυτσᾶς καί Σελασφόρου κύριος κύριος Ἰωάσαφ ἀφιέρωσε τῇ ἁγίᾳ καί σεβασμίᾳ Μονῇ τῆς Ὑπεραγίας Θεοτόκου τήν οἰκοδομήν τῆς οἰκίας μετά πάσης τῆς περιοχῆς αὐτῆς...."	*"Fortlumturia e Tij, fort i dituri dhe i perëndizgjedhuri patriark i Justinianës së Parë të Ohrit dhe gjithë Bullgarisë, primati i Korçës dhe Selasforit, zoti Joasaf, i kushtoi manastirit të shenjtë dhe të nderuar të së Tërëshenjtës Hyjlindëse ndërtimin e banesave dhe gjithë hapësirës përreth..."*

2. Manastiri i Ungjillëzimit në Korçë, për rrënojat e të cilit Aravantinos thotë: *"[manastir] i Ungjillëzimit, në një vend të veçuar, pamja e të cilit ruhet e pikturuar në ballë të kishës ekzistuese*[52]*"*.

3. Manastiri i Shën Joan Teologut ndodhet në Voskopojë, mes Akademisë së Re dhe shtypshkronjës së qytetit. Ishte cenobi[53] më i madh i grave në Voskopojë

[48] Shih Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrime nr. 160/4, 160/10, 161/1, 163/3, 163/7. Shih, po ashtu, Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως. Ἡ Ἱερὰ Μονὴ τοῦ Τιμίου Προδρόμου κατὰ τὸν ἐν αὐτῷ κώδικα (1630-1875)*, bot. Δημητρίου Δημητράκου, Ἀθήνα 1939 f. 27–28, 33–39; Γεωργιάδης Θ., *Μοσχόπολις*, bot. Συλλόγου πρὸς Διδασκαλίαν Ἑλληνικῶν Γραμμάτων, Ἀθήνα 1975, f. 13, 17, 30–32, 61; Thomo, P., *Kishat pasbizantine*, f. 50–51, 70–73, 77–79; Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, vëll. 1, f. 118; Εὐαγγελίδης Δ., *Ἡ Βόρειος Ἤπειρος*, Ἀθήναι 1919, f. 109 dhe Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, vëll. 3, f. 170; Τίτος Γιοχάλας, Λίζα Ἔβερτ, *Στὴ γῆ τοῦ Πυρροῦ*, bot. Εκδόσεις Αστερισμός, Αθήνα 1993, f. 235; Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, f. 147–217; Καμαρουλίας Δ., «Τὰ μοναστήρια τῆς Ἠπείρου», *Ἠπειρωτικὴ Ἑταιρεία* 184 (1992), f. 3–12; G. Tsigaras, *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 10–29.

[49] Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, vëll. 1, f. 111, 115.

[50] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/4: *"ἀνευρέθησαν σημεῖα τρισυποστάτου ἐκκλησίας, μέρη ἐν εἴδει κελλίων, δοκοί, ταῦτα πάντα ἀποδεικνύουσι τήν ἀρχαιότητα αὐτῆς"*. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[51] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/4; shih, po aty, edhe regjistrimin nr. 161/1. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[52] Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, vëll. 1, f. 118.

[53] ***Cenobi*** (gr. κοινόβιον) është formë e organizimit të jetës murgjërore, sipas së cilës murgjit jetojnë së bashku, në komunitet, hanë në të njëjtën

DO NOT COPY

dhe, sipas Mitropolitit të Ksanthit, Joakim Martinianos-it: "*Në kishën e Mitropolisë duket se, që herët e deri në vitet e fundit (1820) shërbejnë disa murgesha, të cilave 'çdo ditë që festohet e Diela e Orthodhoksisë, Pashka, Krishtlindjet, Shën Vasili, u jepen dhurata nga kisha', veshje ose dhe ushqime [...]. Të njëjtën gjë bëjnë edhe kishat e tjera [...] të Shën Joan Teologut, ku ndodhen dhe qelitë e tyre, pranë ndërtesës me kupolë të shtypshkronjës, dhe në katin e sipërm më 1725 bananin jo pak murgesha, bashkësia e të cilave emërtohej si* cenob *i Shën Joanit*"[54]. Më shumë informacione për funksionimin dhe veprimtarinë e manastirit të Shën Joan Teologut na jep mësuesi voskopojar, Theofrast Gjeorgjiadhi: "*Pranë kambanores ndodhen shumë qeli dhe salla, ku banojnë familje të varfëra që i shërbejnë kishës. Në këto qeli banonte edhe hieromonaku i ditur Grigor Konstandinidhi dhe nën çatinë e tyre punonte për të shkruar veprat e tij. Po ashtu, shërbejnë edhe si vend mbledhjeje për burrat e urtë dhe të ditur, si për profesorët e Akademisë dhe për drejtorin e shtypshkronjës, Grigor Konstandinidhin.... Kisha, ndonëse e vogël, ka qenë e pasur me relike. Ikonostasi ka qenë i pasur; ... dallonte ikona mrekullibërëse e Shenjtit, dy flamuj fetarë, dhjetë kryqe të stolisur me gurë të çmuar dhe libra të shtypshkronjës së Voskopojës stolisin këtë kishë*"[55].

4. Manastiri i Varrit të Shenjtë ishte, sipas Martininos-it, metoq[56] i Vendeve të Shenjta në Voskopojë para vitit 1650, deri të paktën në vitin 1798, pra edhe pas shkatërrimit të Voskopojës, që ndodhi më 1769[57]. Në këtë metoq, që ndodhej pikërisht përpara portës së kishës së Mitropolisë, banonte një "*përfaqësues i Varrit të Tërëshenjtë, protosingjeli Sofron*" i cili nënshkruante si "*Protosingjel i Varrit të Shenjtë*"[58]. Para se të vdiste, Sofroni i dhuroi vendi të Voskopojës një kryq me Drurin e Nderuar nga kryqi i Krishtit, që ruhej në një kuti të çmuar të prodhuar në Vjenë, me kontributet e të krishterëve. Kjo gjë dëshmohej edhe nga kodiku i Taksiarkëve, në të cilin ishte regjistruar kjo e dhënë: "*1720: [emri] i të ndjerit Sofron, protosingjel i Varrit të Shenjtë u shënua në proskomidhi, për hir të drurit të nderuar dhe jetëdhënës, të cilin ia dhuroi vendit tonë për mbrojtje dhe ndihmë*"[59].

5. Manastiri i Shën Joan Pararendësit (Prodhromit) (Fig. 9-12) në Voskopojë ndodhet në shpinën e një kodre të pyllëzuar në veri të Voskopojës, 30 minuta larg qytetit. Sipas mbishkrimit ktitorik të kishës qendrore[60], manastiri është ndërtuar më 1632. Si ktitorë përmenden arkondët Gjergj Guco dhe Mihal Meligjeri, dhe hieromonaku, më pas igumeni i manastirit, Andoni nga Shipska. Dy të fundit ndërtuan narteksin e kishës qendrore

tryezë, nuk disponojnë pasuri vetjake dhe janë nën udhëheqjen shirtërore të një igumeni (kryemurgu).

[54] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 27. Përkthimi yni. Për të dhënat pragmatologjike dhe referencat bibliografike të kodikut të manastirit të Shën Prodhromit të Voskopojës shih monografinë Xhufi P., *Shekulli i Voskopojës (1669-1769)*, bot. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2010, ku për herë të parë botohet e plotë përmbajtja e tij në shqip, e zhveshur "përgjithësisht" nga shtesat shpjeguese të Joakim Martinianos-it. Për këtë arsye, kur na është dashur t'u referohemi këtyre të fundit ose kur kemi konstatuar pasaktësi në përkthim, kemi përdorur përkthimin tonë.

[55] Γεωργιάδης Θ., *Μοσχόπολις*, f. 26.

[56] ***Metoqi*** (gr. μετόχιον) është pronë manastiri që gjendet jashtë zonës së tij. Administrohet nga një përfaqësues i manastirit, ka murgjër si ndihmës apo kultivues, ka kishë, qeli dhe mjedise mikpritjeje.

[57] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 66–67. Xhufi P., *Shekulli i Voskopojës*, f. 411–412 dhe, posaçërisht për vitin 1769, f. 196–224.

[58] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 66. Xhufi P., *Shekulli i Voskopojës*, f. 412.

[59] Kodiku i Taksiarkëve sikundër edhe ai i kishës së Fjetjes së Hyjlindëses humbën me shkatërrimin e Voskopojës më 1916. Disa pjesë të tyre kanë shpëtuar përmes kopjimeve apo botimeve. Shih Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 67, shën. 19.

[60] Sipër hyrjes së kishës, nga brenda, ndodhet mbishkrimi ktitorik, ku shkruhet: "*U ndërtua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar me kontributin dhe shpenzimet e të shumënderuarit dhe shumë fisnikut arkondit, zotit, zotit Gjergji Guço, në vitin 7140 (=1632). U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i shenjtit të lavdëruar profet, pararendësit dhe pagëzor Joanit, me igumen zotin Andon jeromonak, dhe me shpenzimet e të shumënderuarit dhe të shumëfisnikut arkond, zotit Mihal, biri i të ndjerit Kostë, për shpirtin e tij dhe të bashkëshortes, dhe të fëmijëve të tij, në kohën e peshkopatit të shumëlumturit kryepeshkop të shumëshenjtës Justinianës së parë, të Ohrit, zotit, zotit Egnati, në vitin 1659.*" Mbishkrimi është botuar nga Theofan Popa, bazuar në një faksimile të një fotografie nga mbishkrimi, në botimin *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, f. 158–159. Mbishkrimi është botuar, gjithashtu, nga Martinianos tek *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 38 shën. 7, duke ndrequr gabimet drejtshkrimore, por jep të gabuar datën e pikturimit të kishës (1649). Po ashtu, mbishkrimin e ka botuar edhe nga Evllogj Kurilla tek: «Ἡ Μοσχοπόλις καὶ ἡ νέα Ἀκαδημία αὐτῆς, ἡ καταγωγὴ τῶν Κουτσοβλάχων καὶ ἡ ἐγγραμάτισις τῆς γλώσσης αὐτῶν», Θεολογία 12 (1934), f. 157, i cili nuk ndërhyn në përmbajtje dhe elementët e mbishkrimit. Ndërkaq, sipas katalogut të kryepeshkopëve të Justinianës së Parë, që ka paraqitur E. Konstantinou (Tegou-Stergiadou), *Η Αρχιεπισκοπή Πρώτης Ιουστινιανής. Συμβολή στη διερεύνηση του προβλήματος*, Thessaloniki 2001 (unpublished doctoral disertation in greek), f. 130–138, periudha e kryepriftërisë së Ignait (1659) përputhet me atë që referon mbishkrimi.

DO NOT COPY



Fig. 9-10. Manastiri i Shën Joan Prodhromit, Voskopojë.

DO NOT COPY



Fig. 11. Manastiri i Shën Joan Prodhromit, Voskopojë. Gravurë e Teodor Gruntović (1767).



Fig. 12. Voskopoja dhe manastiri i Shën Joan Prodhromit. Gravurë e Hristofor Žefarović (1742)



Fig. 13. Manastiri i Shën Naumit dhe zona e Korçës. Gravurë e janarit të vitit 1849.
1. Mali i Galicicës 2. Korça ose Peshkëpia 3. Livanisht 4. Rruga nga Bitolia drejt manastirit të Shën Naumit 5. Ohri 6. Manastiri i Shën Naumit 7. Starova 8. Pogradeci 9. Voskopoja 10. Manastiri i Shën Joan Prodhromit, Voskopojë.

dhe kontribuuan për pikturimin e gjithë kishës më 1659. Sipas kodikut të manastirit, të cilin e botoi më 1939 Mitropoliti i Ksanthit, Joakim Martinianos-i, themelimi i kishës qendrore të Manastirit të Pararendësit u bë më 18 korrik 1634[61]. Manastiri ishte stavropigjiak[62] dhe e fitoi këtë status gradualisht, pjesë pas pjese, që më herët, para periudhës së tre Kryepeshkopëve Rafael, Filothe dhe Josif, siç referohet në Letrët Sinodike që ndodhet mes dokumenteve të Kryepeshkopatës së Ohrit[63]:

"... εὕρηται πλησίων τῆς πολιτείας Μοσχοπόλεως μοναστήριον, καὶ ὄνομα τοῦ Προφήτου Προδρόμου καὶ βαπτιστοῦ Ἰωάννου τιμώμενον, σταυροπηγίου μὲν ὄνομα περιφέρον, ἐκ τῶν πρὸ αὐτῆς Πατριαρχῶν ἔκπαλαι δοθέν, Κωδικέλλου δὲ τοῦ μὴ ὑπ' ἐξουσία τινὸς τῶν Μητροπολιτῶν διατελεῖν ἀλλὰ παντελεύθερον εἶναι, ὡς καὶ ἄλλοις Σταυρωπήγιοις ἔνεστιν εὑρεῖν, ὑστερούμενον".

"... ndanë qytetit të Voskopojës ndodhet një manastir, nderuar me emrin e Profetit, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan, që edhe pse mban emrin stavropigjiak, që iu dha qëmoti para kohës së tre Patriarkëve, i mungonte kodicili që vërtetonte se nuk është nën pushtetin e asnjërit prej Mitropolitëve, por është krejt i lirë, ashtu si edhe manastiret e tjerë Stavropigjiakë..."

Letra Sinodike është nënshkruar më *"αχψθ', ἐν μηνὶ Αὐγούστω Ἰνδικτ. Ζ"* (*"më 1679, në muajin gusht, indiktioni VII"*) nga Kryepeshkopi i Ohrit, Ignati, [Mitropoliti] i Kastoriasë, Dionisi, [Mitropoliti] i Korçës, Danieli, [Mitropoliti] i Beratit, Nektari, [Mitropoliti] i Gorës dhe Mokrës, Arseni.

Kisha është e tipit bizantin, në formë kryqi me kupolë dhe konke anësore[64]. Igumenin e parë të manastirit të Pararendësit, hieromonakun Andon Shipska (1649-1660), e pasoi Haxhi Gabrieli (1660-1662), i cili, sipas një dokumenti "të njëjtë me origjinalin" që është kopjuar nga kodiku i Manastirit të Pararendësit në kodikun e Korçës, shkoi si igumen në Manastirin e Oshënar Naumit të Ohrit (Fig. 13), duke lënë në vend të tij Theodhosin[65]. Haxhi Gabrieli, siç na informon kodiku i Korçës, pasi shkoi në manastirin e Oshënarit Naum, "... *e zbukuroi manastirin, ndërtoi narteksin, skevofilakun, dhe gjithë qelitë rreth e qark manastirit, lart dhe poshtë, policën, zapananë si dhe odat nga krahu i liqenit, kuzhinën, hambarët, odat nga ana e vreshtit, bashkë me ahurin me qemere, ndërkohë që kishte gjetur atje vetëm furrën e vjetër dhe kuzhinën, dhe asgjë tjetër ...*"[66]. Manastiri i Pararendësit ishte mjaft i pasur, zotëronte pasuri të madhe në prona të patundshme, si dhe kishte shumë kushtime apo dhurata nga të krishterë të ndryshëm. Gjithashtu, duhet shënuar dhe kontributi dhe ndihma që ofronte manastiri në dobi të komuniteteve të tjera. Në kodikun e Korçës përmenden, në një akt më vete, dhuratat bujare dhe shumë të rëndësishme të manastirit të Pararendësit dhe gjithë qytetit të Voskopojës për ndërtimin e kishës së Burimit Jetëdhënës në Korçë, si dhe për realizimin e ikonostasit të saj[67].

[61] Shih: Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 123: «*Ἐπὶ ἔτους ,αχλδ΄ (=1634) ἐθεμελιώθη ὁ ναὸς τοῦ Τιμίου ἐνδόξου προφήτου προδρόμου καὶ Βαπτιστοῦ Ἰωάννου ἐν μηνὶ Ἰουλίῳ ΙΗ΄ ἐν ἡμέρᾳ Παρασκευῇ, Καὶ πρῶτος κτήτορας καθηγούμενος τοῦ κὺρ ἀντωνίου ἱερομονάχου. Καὶ εἰσὶν βοηθοῦντες αὐτοῦ, Κτήτορες: Τὸν μὲν πρότον Γκοῦτζος τοῦ μυλινΓέρι*» ("Në vitin 1634 u themelua kisha e të ndershmit, të lavdëruarit, profetit, pararendësit dhe Pagëzorit Joan, më 19 të muajit korrik, ditën e premte, dhe ktitor dhe kathigumen i parë i tij ishte zoti Andon hieromonaku. E ndihmuan si ktitorë: i pari Gucoja dhe Meligjeri").

[62] Stavropigjiak (gr. σταυροπηγιακός) karakterizohet një manastir, i cili varet jo nga juridiksioni kishtar i peshkopit lokal, por nga kreu i Kishës, kryesisht Patriarku.

[63] Καλλινίκου Δελικάνη, Πατριαρχικῶν Ἐγγράφων, *Ἤτοι ἐν τοῖς κώδιξι τοῦ Πατριαρχικοῦ Ἀρχειοφυλλακίου σωζόμενα ἐπίσημα ἐκκλησιαστικὰ ἔγγραφα, τὰ ἀφορῶντα εἰς τὰς σχέσεις τοῦ Οἰκουμενικοῦ Πατριαρχείου πρὸς τὰς Ἐκκλησίας Ῥωσσίας, Βλαχίας καὶ Μολδαβίας, Σερβίας, Ἀχριδῶν καὶ Πεκίου 1564 – 1863, οἷς προστίθεται Ἱστορικὴ Μελέτη περὶ τῆς Ἀρχιεπισκοπῆς Ἀχριδῶν*, vëll. 3, ἐν Κωνσταντινουπόλει 1905, f. 809–810. Dokumenti gjendet, gjithashtu, i botuar në shqip te: Xhufi P., *Shekulli i Voskopojës*, f. 403–404.

[64] Thomo, P., *Kishat pasbizantine*, f. 38, 57–60.

[65] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 115.

[66] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 115: *"...ἐκαλλώπισε τό μοναστήριον, ἔκτισε τόν νάρθηκα, τό σκευοφυλακίον, καί ἅπαντα τά ὁλόγυρα τοῦ μοναστηρίου κελλεία, ἀπάνω καί κάτω, τήν πολουίτζαν τόν ζαμπανάν, καί τάς πρός τήν λίμνην ὀντάδες, τά μαγειρεῖα, τά ἀμπάρια, καί τάς πρός τό ἀμπέλι ὀντάδες, μέ τό κιεμερλίτικο ἀχοῦρη, ὅτι μόνον τόν φοῦρνον εὐρῆκε παλαιόν καί τό μαγειρείον ἄλλο δέ ὄχι..."*. Transkriptimi paleografik yni. Shih, po ashtu, Pepo P., *Materiale dokumentare*, II, f. 16.

[67] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 68.

DO NOT COPY

6. Manastiri i Shën Konstandinit dhe Helenës u themelua, sipas Martinianos-it, gjatë sundimit të shtëpisë së Muzakajve (shek. XIV-XV), në një pyll të dendur në veri-perëndim të Voskopojës, në një distancë 3 orë me këmbë nga qyteti[68]. Manastiri bizantin kishte dhe një metoq "[ndërtesë] *me kupola*" në qendër të Voskopojës, në qelitë e të cilit u strehua, më vonë, dhe funksionoi deri më 1840, Shkolla[69]. Pas vitit 1750 u ndërtua në kopshtin e metoqit kisha kushtuar të barabartëve me apostujt, Konstandinit dhe Helenës, kishë që më vonë funksionoi si famulli. Manastiri filloi të humbiste shkëlqimin e tij që prej shek. XVII, po më shumë gjatë shek. XVIII (1760), kohë kur ndodhi islamizimi masiv i fshatrave të zonës, me përjashtim Voskopojën[70].

7. Manastiri i Taksiarkëve gjendet në pjesën jugperëndimore të Voskopojës. Kisha e manastirit, që mban të njëjtin emër, ishte një ndër më të mëdhatë dhe më madhështoret e qytetit. Sipas kodikut të manastirit të Shën Joan Prodhromit "*zoti Vreto Bezuka vuri themelin e kishës së Kryeengjëjve Mëhill më 1720, në muajin gusht, me shpenzimet e tij*"[71]. Sipas mbishkrimit ktitorik, kisha është pikturuar në vitin 1722[72]. Në kodikun e manastirit të Shën Joan Theologut ekzistonte dikur një katalog, në të cilin ishin shënuar emrat e të gjithë kontribuuesve dhe dhuruesve të kësaj kishe. Ndërmjet tyre ishte regjistruar edhe aktdhurimi i një punishteje, që gjendej në Çaushin e madh të Korçës, nga Mihal Papathanasi, për kishën e Shën Mëhillit[73]. Pranë kishës së Taksiarkëve ishin ndërtuar edhe dy kishëza (paraklise): ajo e Shën Spiridhonit dhe ajo e Shën Naumit, të cilat u shkatërruan së bashku me qelitë ekzistuese të manastirit[74].

8. Manastiri i Profetit Ilia në Voskopojë paraqitet në një gravurë të vitit 1742 (Fig. 14). Mësuesi voskopojar Theofrast Gjeorgjiadhi, kur përshkruan gravurën, thotë: "*Mbi to* [kishave të Shën e Premtes dhe të Shën Donatit] *dallohet manastiri i Pararendësit me kishën dhe germën kapitale Π, domethënë «Πρόδρομος» (Pararendësi). Poshtë kësaj lagjeje dallohet rruga, e cila kalon pas lagjeve të Shën Thanasit, Apostujve të Shenjtë dhe Profetit Ilia dhe ndan zonën e parë, ku gjenden edhe shtëpitë e këtyre lagjeve. Kjo rrugë shërbente si arterie tregtare që lidhte me lagjet e sipërme. Germa kapitale A tregon kishën e Shën (A)Thanasit, numri 11 kishën e Apostujve të Shenjtë (shënohet edhe me kryq), germa kapitale Π kishën e Profetit Ilia, e cila është shumë madhështore dhe shquhet mbi të tjerat. Pranë saj dallojmë një portë të madhe, të ngjashme me atë të Pararendësit* [Prodhromit]. *Brenda oborrit të* [kishës së] *Profetit Ilia dikur ekzistonte një manastir i ndritshëm dhe famëmadh*[75]". Mbi ekzistencën e manastirit të Profetit Ilia dëshmon edhe një raport i përmbledhur «Περί Βοσκοπόλεως ἤ Μοσχοπόλεως ἐν γένει» ("*Në përgjithësi mbi Voskopojën ose Moskopo*jën)", që është

[68] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 25, shën. 2: «*Ἔχομεν τοιαῦτα ἀρχαιότερον (μοναστῆρι), τὸ τῶν Ἰσαποστόλων, Κωνσταντίνου καὶ Ἑλένης, ἀπὸ πολλοῦ ἱδρυμένον ἐν τῷ τρίωρον περίπου ΒΔ τῆς πόλεως ἀπέχοντι φερωνύμῳ πυκνῷ δάσει, καὶ ἀνάγον πάντως τὴν ἵδρυσιν πολλῷ πρὸ τῆς τουρκικῆς κατακτήσεως, καὶ ἴσως κατ' αὐτὴν τὴν φεουδαρχικὴν δεσποτείαν τοῦ οἴκου Μουζάκη...*» ("Ndodhet atje dhe një (manastir) më i vjetër, i të barabartëve me apostujt, Konstandinit dhe Helenës, themeluar para shumë kohësh, tre orë larg qytetit në drejtim veri-perëndimor, në mes të një pylli të dendur me të njëjtin emër, themelimi i të cilit daton para pushtimit turk, ndoshta në kohën e sundimit feudal të shtëpisë së Muzakajve..."). Përkthimi yni.

[69] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 25–26, shën. 2.

[70] Sipas Mihalopulit: "*Po atë vit (1760) valë e re islamizimesh shpërtheu nga zonat përreth. Tridhjet e gjashtë fshatra të Pogonit, të shtypur nga taksat dhe përndjekjet, vendosën të ndryshojnë besim... Po atë kohë (1760) një zonë e madhe e Maqedonisë Veriore, ndërroi fenë, bashkë me dhespotin, ditën e Ngjalljes!! Islamizimi përparonte me një shpejtësi të pabesueshme dhe tragjike. Fshatrat rreth lumit Devoll pothuaj të gjitha kanë ndërruar besim, dhe fari i vetëm i krishterimit kishte mbetur Voskopoja e bukur dhe martire*". Μιχαλόπουλος Φ., *Μοσχόπολις. Αἱ Ἀθῆναι τῆς Τουρκοκρατίας*, f. 40. Në lidhje me humbjen e shkëlqimit të manatirit të Taksiarkëve si shkak i islamizimit të fshatrave përreth shih, Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 25–27 shën. 2. Gjatë shek. XVIII vërehen islamizime edhe në zona të tjera të krishtera, si në zonën e Delvinës, të Paramithisë, të Margaritit etj. Paralelisht dallohen zona që i bëjnë rezistencë islamizimit gjatë shek. XVIII, siç janë zonat e Zagorisë (nën të cilën varet Koncka dhe Sheperi), e Rizës (nën të cilën varej Hormova dhe Përmeti) dhe ajo e Lunxhërisë. Shih Galvinas A.A., "The Church in Epirus under the Turkish domination", *Epirus. 4000 Years of Greek History and Civilization*, Athens: Ekdotike Athenon 1997, f. 314–317. Λαμπρίδης Δ., *Ηπειρωτικά Μελετήματα*, vëll. II, Ιωάννινα 1993, f. 62; Αραβαντινός Π., *Χρονογραφία της Ηπείρου*, vëll. I, 1856, f. 251–252, shën. 2, 369–370.

[71] Γεωργιάδης Θ., *Μοσχόπολις*, f. 30-32: «*ὁ κὺρ Βρέττας Μπετζούκας ἔβαλε θεμέλιον εἰς τὴν ἐκκλησίαν Ἀρχαγγέλων Μιχαὴλ τὸ 1720 μηνὶ Αὐγούστου μὲ τὰ ἔξοδά του*». Përkthimi yni.

[72] Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, f. 167–168.

[73] Teksti i plotë i aktdhurimit u shpëtua i botuar nga Γεωργιάδης Θ., *Μοσχόπολις*, f. 31.

[74] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 27–28, shën. 2.

[75] Γεωργιάδης Θ., *Μοσχόπολις*, f. 17. Përkthimi yni.

DOKTORATURË



Fig. 14. Voskopoja 1742. Gravurë e Hristofor Žefarović.



Fig. 15. Shipska. Gravurë e shek. XVIII.

shkruar në fletët e kodikut të Korçës[76]. Sipas Mitropolitit të Ksanthit, Joakim Martinianos-it, manastiri i Pararendësit ishte manastir grash: "*ku banojnë 2-3 murgesha, të cilat shërbenin dhe murgjëronin deri më 1840*" [77].

9. Manastiri i Profetit Ilia në Shipskë (Fig. 15) referohet se ka ekzistuar më 1649-1670, kur i vetmi igumen i njohur deri më sot i atij manastiri ishte Andon Shipska, bashkëthemelues dhe igumeni i parë i manastirit të Pararendësit në Voskopojë[78]. Për manastirin e Profetit Ilia në Shipskë na flet kodiku i Shën Prodhromit, në të cilin lexojmë: "*Gjatë vitit 1649, u shfaq një hieromonak* [me emrin] *Andon nga Shipska, i cili ishte murg në kishën e Profetit Ilia, në mëhallën me diell*" [79]. Informacione shtesë na jep mitropoliti i Ksanthit, Joakim Martinianos-it, sipas të cilit: "*Në të majtë, duke ardhur nga poshtë drejt qytezës, gjendet një barakë, një kishëz e skamur, e ngritur mbi rrënojat e Manastirit të dikurshëm të Profetit Ilia, ku fillimisht jetonte si murg dhe më pas u rikthye dhe jetoi deri sa vdiq në mërzitje hieromonaku në fjalë Andoni*"[80]. Sipas kësaj të dhëne rezulton se manastiri në vitin 1939, kohë kur Martinianos-i botoi librin e tij mbi manastirin e Shën Prodhromit të Voskopojës, ishte shkatërruar dhe në vendin e tij ishte ngritur një kishëzë e thjeshtë.

10. Manastiri i Profetit Ilia në Mborje ndodhej, sipas Aravantinos-it, "*në malin e Korçës, përkarshi majës së malit*

[76] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/10.

[77] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 27, shën. 2. Përkthimi yni.

[78] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 33–38. Xhufi P., *Shekulli i Voskopojës*, f. 396–398.

[79] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως*, f. 33–38: «*Κατά δέ τό αχμθ΄ (1649) ἔτος, ἀνεφάνη ἱερομόναχος τίς Ἀντώνιος Σιπισχιώτης, ἠσυχάζον εἰς τήν ἐκκλησίαν τοῦ πρόφ. Ἠλιοῦ, τοῦ προσηλίου μαχαλά*». Përkthimi yni. Shih, po ashtu, Xhufi P., *Shekulli i Voskopojës*, f. 396-397.

[80] Μαρτινιανὸς Ἰ., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως, f. 34, shën. 6: «Ἀριστερόθεν τῷ κατόθεν εἰρεχομένῳ, εἰς τὴν κομώπολιν, σώζεται παράπηγμά τι, παρεκκλήσιον πενιχρόν, ἐστημένον, ἐπὶ τῶν ἐρειπίων τῆς ἄλλοτε ἐνταύθα ἐπ' ὀνόματι τοῦ Προφήτου Ἠλιοῦ, Ἱερᾶς μονῆς, ἐν ᾗ πρότερον ἐμόναζε, καὶ εἶτα ἀποσυρθείς ἐκ τῆς ἡγουμενείας, ἐγκατεβίωσε καὶ ἀπέθανεν ἐν ἀνίᾳ, ὁ ἐν λόγῳ ἱερομόναχος Ἀντώνιος*». Përkthimi yni.

DO NOT COPY

Qytet"[81]. Për themelimin e manastirit Aravantinos-i përmend si vijon: "*Ky manastir i takon komunitetit të Mborjes dhe u ndërtua, sipas traditës, nga një hegjemon i Qytetit për përdorim vetjak dhe për këtë qëllim ndërtoi një urë druri që bashkonte majat e dy kodrave të përmendura*"[82]. Për sa i takon toponimit "Qytet", gjeografi i shek. XIX, Kosma Thesprotos-i, na jep këtë shpjegim: "*Në lindje të Korçës, në një distancë prej rreth një ore, ekzistojnë një radhë malesh të vegjël... të quajtur Morava nga vendasit. Në majën e njërit prej këtyre maleve, gjendet një kështjellë e vjetër e shkatërruar, e cila dallohet nga Korça me sy të lirë; këtë e quajnë Qytet*"[83]. Sipas studimeve, përmasat e vogla të kështjellës së Mborjes dëshmojnë se ajo ka qenë seli e fortifikuar e një feudali vendas[84]. Gjithashtu, edhe kisha e vogël bizantine e Metamorfozës së Shpëtimtarit apo e Ristozit në Mborje, e ndërtuar më 1389 në rrëzë të kodrës, shfaq karakteristikat e një kishe familjare të ndërtuar nga sundimtarë lokalë[85]. Bazuar nga sa më sipër dhe nga të dhënat e dy mbishkrimeve ktitorike[86] të kishës së Ristozit në Mborje, ka shumë gjasa që hegjemoni i përmendur nga Aravantinos-i të përputhet me personin e Amiralit, që përmendet në mbishkrimin e pikturuar mbi hyrjen perëndimore, brenda kishës së Ristozit, në Mborje. Sipas një tjetër mbishkrimi[87], që gjendet në kishën e Shën Marisë në Maligrad të Prespës, hegjemoni Amiral duket se është djali i Qesar Novakut, i cili administronte zonën e Prespës dhe Korçës deri më 1390, vit kur trashëgohet nga i biri i tij, Amirali[88]. Duke u mbështetur në të dhënat e mësipërme mund të themi, sigurisht me rezerva[89], se Manastiri i Profetit Ilia duhet të jetë ndërtuar përpara pushtimit osman të zonës (1395), me shumë gjasa në të njëjtën periudhë me kishën e Ristozit në Mborje dhe ndoshta nga i njëjti hegjemon, Qesar Novaku ose i biri i tij, Amirali.

Sipas informacioneve që na jep Aravantinos-i, manastiri i Profetit Ilia kishte në zotërim edhe një kodik mjaft të vjetër dhe me shumë vlera, me përmbajtje ungjillore, të cilin, së bashku edhe me një copë dru nga druri i Kryqit të Shenjtë, ia kishte dhuruar manastirit një tregtar i madh voskopojar[90].

11. Manastiri i Kamenicës ndodhej në fshatin me të njëjtin emër, në një largësi prej 2 orësh nga qyteti i Korçës[91]. Sipas Evangjelidhit, manastiri i është kushtuar Shën Nikollës[92]. Sipas Th. Mitkos, manastirin "*edhe myslimanët vendas e nderojnë, dhe për ndërtimin e tij, kur u shkatërrua në kohës e fundit nga një zjarr i rastit, ata ndihmuan më shumë sesa të krishterët*"[93].

12. Manastiri i Profetit Ilia në Hoçisht u ndërtua, sipas Evangjelidhit, më 1817: "*Në Hoçisht, manastiri i Profetit Ilia, u ndërtua më 1817*"[94], në një vend mjaft të

[81] Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, v. 1, f. 118, shën. 2.
[82] Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, v. 1, f. 118, shën. 2.
[83] Βλ. Ψαλίδας Ἀ. - Θεσπρωτὸς Κ., *Γεωγραφία Ἀλβανίας καὶ Ἠπείρου. Ἐξ ἀνεκδότου χειρογράφου τοῦ Κοσμᾶ Θεσπρωτοῦ μὲ τοπογραφικὰ σχεδιογραφήματα καὶ γεωγραφικοὺς χάρτας τοῦ ἰδίου*, bot. E.H.M., Ἰωάννινα 1964, f. 14. Krhs. Anonim, «Περὶ ἐν Μακεδονίᾳ Κοριτσᾶς», *Πανδώρα*, fashik. 235 (1859), vëll. 10, f. 447–448 (botuar në shqip tek Mitko, Th., pa titull, *Vepra*, Akademia e Shkencave-Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë 1981, f. 552, ku sqarohet edhe anonimati i abonentit, që shkruan tek revista Pandora, që, sipas studiuesve, është Thimi Mitko).
[84] Karaiskaj, Gj., *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, f. 170–172.
[85] Karaiskaj, Gj., 5000 vjet fortifikime në Shqipëri, f. 170–172, 193–194. Veçanërisht për kishën e Ristozit në Mborje shih Thomo, P., "L'Architecture de l'église du Saint-Sauveur a Mborje de Korçe», Studime historike, 1967, 2, f. 151–159. Meksi. A., "Të dhëna mbi ndërtimin e kupolës së kishës së Ristozit në Mborje", Monumentet ,1972, 4, f. 199–204; Meksi, A., Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV), bot.. Eugen, Tiranë, 2004, f. 211–213.
[86] Lidhur me mbishkrimet e kishës së Ristozit në Mborje shih Miljukov P.N., "Hristianskie drevnosti Zapadnoj Makedonii", *Izvestija Russkogo arheologičeskogo instituta v Konstantinopole* IV-1 (1899), f. 74–76, 21–151; Popa, Th., "Disa mbishkrime të kishave të Shën Mërisë në Maligrad dhe të Ristozit në Mborje", *Buletin i Universitetit Shtetëtor të Tiranës, ser. Shkencat Shoqërore*, (1959, 2, 257–258; Idem, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, f. 151–153, nr. 290–292.
[87] Bëhet fjalë për mbishkrimin e kishës së Shën Marisë në ishullin e Maligradit të Prespës, që shoqëron portretet e personave të pikturuar në fasadën e kishës. Shih Βλ. Miljukov P.N., *Hristianskie drevnosti Zapadnoj Makedonii*, f. 64–73; Popa, Th., *Disa mbishkrime të kishave*, f. 259–261; Idem, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, f. 151, nr. 289.
[88] Popa, Th., *Disa mbishkrime të kishave*, f. 260.
[89] Si një ndërtim i mëvonshëm përmendet pa argumente në: Κ.Χρ.Χ., «Η Μπόρια», *Μακεδονικὸν Ἡμερολόγιον*, viti 4 (1911), f. 46–48.
[90] Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, vëll. 3, f. 174.
[91] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/1.
[92] Εὐαγγελίδης Δ., *Ἡ Βόρειος Ἤπειρος*, f. 109. Shih, po ashtu, Οἰκονόμου Φ., *Ὀρθοδοξία καὶ ἑλληνισμός στὴν βόρειο Ἤπειρο. Ἡ ἐκκλησία ἐν βορείῳ Ἠπείρῳ*, bot. Ἐ λεύθερη Σκέψις, Ἀθήνα ²1990, f. 157.
[93] Anonim, «Περὶ ἐν Μακεδονίᾳ Κοριτσᾶς», *Πανδώρα*, vëll. 18: fashik. 424 (1867), f. 318 (botuar në shqip tek Mitko Th., pa titull, *Vepra*, f. 552).
[94] Εὐαγγελίδης Δ., *Ἡ Βόρειος Ἤπειρος*, f. 109.

DO NOT COPY

PO NOT COPY

mrekullueshëm dhe që dominonte në të gjithë zonën[95]. Nga kodiku i Korçës informohemi se më 1868 igumen i manastirit ishte Meleti, i cili njëkohësisht kryente dhe detyrën e epitropit të Mitropolitit të Korçës: "*... në ditët e epitropit të të shenjtit të Korçës, Meletit, igumen i Profetit Ilia të Hoçishtit*"[96].

13. Manastiri i Devollit sipas Aravantinos-it ndodhet në fshatin me të njëjtin emër dhe i kushtohet Ngjitjes në Qiell të Krishtit: "*[manastiri] i Ngjitjes në Qiell [ndodhet] përkarshi, pothuaj 1 orë larg qytezës së Devollit*"[97].

14. Manastiri i Shën Gjergjit gjendej në Magulën e afërme (Μαγκούλα), në fshatin Dvoran, poshtë Boboshticës. Sipas Aravantinos-it në këtë fshat ka pasur rrënoja të manastirit të Shën Gjergjit, i cili u dogj më 1637, duke shpëtuar vetëm ikona e tij, e cila ndodhej në manastirin e Shën Nikollës në Boboshticë: "*Po ashtu, dallohen në vende të ndryshme rrënoja të tjera, të cilat i përkasin Shën Gjergjit të fshatit Magula, ikona e të cilit ruhet në manastirin e sipërpërmendur të Shën Nikollës*"[98], në kohën kur igumen i tij ishte Makar Nikolicioti[99].

15. Manastiri i Shën Nikollës, sipas informacioneve që na jep Aravantinos-i, ndodhej mes fshatrave Dishnicë dhe Kuç të Korçës: "*(manastiri) i Shën Nikollës, mes fshatrave Dishnicë dhe Kuç, mban një orë e gjysmë larg nga Korça*"[100].

16. Manastiri i Shën Gjergjit të Zvezdës. Në fshatin e Zvezdës, që "*gjendet 2 orë e gjysmë larg Korçës, drejt veriut, poshtë Malit të Thatë, në rrugën drejt Bitolisë*"[101] ekzistojnë, sipas Aravantinos-it, rrënoja "*të (manastirit të) Shën Gjergjit, pranë mullirit të Zvezdës*"[102].

17. Manastiri i Shën Nikollës ndodhet në fshatin Boboshticë (Fig. 16) dhe u themelua, sipas Arvantinos-



Fig. 16. Manastiri i vjetër i Shën Nikollës, Boboshticë-Korçë.

it, më 1450: "*(manastiri) i Shën Nikollës atje – në Boboshticë – u ndërtua më 1450*"[103]. Por në pjesën e tretë të punimit të tij "Përshkrim i Epirit", Aravantinos-i thotë se manastiri i Shën Nikollës në Boboshticë është ndërtuar në shek. XIV: "*manastiri i Shën Nikollës u ndërtua në shek. XIV*"[104]. Ndërkaq, mësuesi voskopojar Theofrast

[95] Ευλόγιος Κουρίλλας, *Κορυτσά*, f. 288. Shih edhe Anonim, «Περὶ ἐν Μακεδονίᾳ Κοριτσᾶς», *Πανδώρα*, vëll. 18: fashik. 424 (1867), f. 319 (botuar në shqip tek Mitko, Th., pa titull, *Vepra,* f. 552), ku përmendet se manastiri është ndërtuar prej të ndjerit Moisi nga Prizreni i Shqipërisë së Epërme, me kontributin e Ismail pahë Plasës.

[96] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 131: «...ἐπί ἡμερῶν ἐπιτρόπου τοῦ ἁγίου Κορυτζᾶς κυρίου Μελετίου, ἡγουμένου τοῦ Προφήτου Ἠλίου Χοτζήστης». Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[97] Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, vëll. 1, f. 118.

[98] *Po aty*, f. 118, shën. 3.

[99] Shih edhe Anonim, «Περὶ ἐν Μακεδονίᾳ Κοριτσᾶς», *Πανδώρα*, vëll. 18: fashik. 424 (1867), f. 319 (botuar në shqip tek Mitko Th., pa titull, *Vepra,* f. 553).

[100] *Po aty*, f. 118, shën. 3.

[101] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 160/1.

[102] Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, vëll. 1, f. 118, shën. 3.

[103] *Po aty*, f. 118. Të njëjtin informacion jep edhe Th. Mitko tek: Anonim, «Περὶ ἐν Μακεδονίᾳ Κοριτσᾶς», *Πανδώρα*, vëll. 18: fashik. 424 (1867), f. 318 (botuar në shqip tek Mitko Th., pa titull, *Vepra,* f. 552).

[104] *Po aty*, f. 170.

DO NOT COPY

Gjeorgjiadhi referon se në manastir ekzistonte një kodik, ku ishte shënuar[105]:

> *"ἐν ΣΙΑ ἔτος ἀπὸ κτίσεως κόσμου ἐκτίσθη ἡ Μονὴ αὕτη καὶ ἡ ἐκκλησία της παρὰ τινος Κυρίου Πέτρου Χαρτοφύλακος καὶ Υἱοῦ του Κυρίου Τοῦσα καὶ γυνὴ του Κυρία Κόμνα εἰς μνημόσυνον αὐτῶν ἐπὶ Χαρίτωνος ἀρχιερέως".*
>
> *Μετὰ παρέλευσιν δὲ 160 χρόνων Ἰωάννης ὁ Καπουμάρε ἐκ Μοσχοπόλεως ἔκτισε τὴν κούλαν καὶ τούς πέρα τρεῖς ὀντάδες, ἐπὶ Ῥαφαὴλ ἡγουμένου καὶ ἀρχιερέως Κωνσταντίνου*
>
> *"në vitin ΣΙΑ nga krijimi i botës u ndërtua ky manastir dhe kisha e tij nga zoti Petro Hartofilaku, nga i biri, zoti Tusha, dhe e shoqja, zonja Komna, për kujtim të tyre, në kohën e kryepriftit Hariton".*
>
> *Si kaluan 160 vite, Joan Kapumare nga Voskopoja ndërtoi kullën dhe tre odat tutje, në kohën e igumenit Rafael dhe kryepriftit Konstandin.*

Siç janë gjasat, data "ΣΙΑ", e barabartë me 211, nuk është lexuar mirë. Kështu, duhet të hamendësojmë se bëhet fjalë për ΣΤΙΑ=6011, ose ZIA=7011 nga ndërtimi i botës, që janë vitet 503 ose, siç ka më shumë të ngjarë, 1513 nga lindja e Krishtit. Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin se kryeprifti Konstandin, që përmend kodiku, ishte Mitropolit i Korçës në vitet 1790-1798, arrijmë në përfundimin se, sipas kodikut, data e themelimit të manastirit duhet të jetë ose 1630-1638 (160 vite para 1790-1798), ose viti 1513.

18. Manastiri i Fjetjes së Hyjlindëses në Boboshticë, ekzistencën e të cilit thjesht e përmend vetëm Aravantinos-i[106].

19. Manastiri i Apostujve të Shenjtë[107] (Fig. 17-18) ndodhet në një kodër në anën veri-lindore të fshatit të sotëm Vithkuq. Manastiri u ndërtua gradualisht dhe ndodhej nën administrimin kishtar të Mitropolisë së Kosturit[108]. Sipas kodikut të manastirit të Apostujve të Shenjtë[109], manastiri filloi të ndërtohej më 1709, pas lëshimit të fermanit sulltanor[110], dhe më 1710 u bë inaugurimi i tij nga Mitropoliti i Kastoriasë me prejardhje nga Voskopoja, Dionisi, dhe peshkopi i Prespës, Joasafi[111]. Bashkëngjisim, në vijim, një pjesë nga ky kodik i botuar, përkthyer në shqip[112]:

I përuluri Mitropoliti i Kastoriasë, Krisanthi, vërteton.

I. – Kodik i Manastirit të hirshëm të Shën Apostujve në Vithkuq, i kushtuar nga i përuluri Mitropolit i Kastoriasë, zoti Krisanth, në motin një mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë nga ekonomia e mishërimit të Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht.

II. – Fort i ndershmi prijës Haxhi Athanas Bimaraj, nga mëhalla Borishe, teksa kthehej nga qyteti i shenjtë Jerusalem, pati mendimin, për lavdi të Perëndisë, të

---

[105] Γεωργιάδης Θ., *Μοσχόπολις*, f. 13.

[106] Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, vëll. 3, f. 170.

[107] Lidhur me Manastirin e Apostujve të Shenjtë shih: Thomo, P., Kishat pasbizantine, f. 50-51; shih, gjithashtu: Popa, Th., Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi, f. 25–26 Papakozma, A., «Manastiri i shën Pjetrit dhe Pavlit në Vithkuq, datimi, urbanistika, arkitektura, mjeshtrit e ndërtimit», Monumentet 1 (1983), f. 77–85, ku jepet dhe bibliografia përkatëse. Shih, për më tepër: Εὐλ. Κουρίλας Λαυριώτης, Γρηγόριος ὁ Ἀργυροκαστρίτης ὁ μεταφραστὴς τῆς Καινῆς Διθήκης εἰς τὸ Ἀλβανικόν, ἤτοι αἱ βάσεις τῆς Ἀλβανικῆς φιλολογίας καὶ γλώσσης καὶ ἡ Ἀκαδήμεια τῆς Μοσχοπόλεως, Τύποις Φοίνικος, ἐν Ἀθήναις 1935, f. 252–253; Βαφείδης Φ., Κῶδιξ τῆς Ἱερᾶς Μητροπόλεως Καστοριᾶς, «Κῶδιξ τῆς Ἱερᾶς Μητροπόλεως Καστοριᾶς καὶ τινὰ ἐκκλησιαστικὰ βιβλία ἀποκείμενα ἐν τισι τῶν ἐκκλησιῶν αὐτῆς», Ἐκκλησιαστικὴ Ἀλήθεια 24 (1900), f. 318–319; Tsigaras G., The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa, f. 15.

[108] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 163/7.

[109] Kodiku i Manastirit të Apostujve të Shenjtë u botua nga Mitropoliti i Kastoriasë Fillaret Vafidhi: Φιλάρετος Βαφείδης, «Περὶ τῶν ἐν τῇ ἐπαρχίᾳ Καστορίας ἱερῶν μονῶν», Ἐκκλησιαστικὴ Ἀλήθεια, vëll. 20 (1900), sf. 316–320. Fragmente të kodikut që u referohen fazave të ndërtimit i ka botuar edhe Tsigaras G., The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa, f. 15–17.

[110] Për këtë çështje referoju shënimit 26.

[111] Ky hierark i shquar, me prejardhje nga Voskopoja, u zgjodh më 1706 peshkop i Prespës, më 4 qershor 1709 mitropolit i Korçës dhe më 5 korrik 1718 kryepeshkop i Ohrit. Nga viti 1718, deri sa vdiq, më 22 tetor 1745, kryesonte njëkohësisht edhe Mitropolinë e Korçës. Lidhur me këtë shih: Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 10, ku jepet dhe bibliografia përkatëseὉ ἐπιφανὴς αὐτὸς ἱεράρχης, ποὺ καταγόταν ἀπὸ τὴ Μοσχοπόλη, ἐκλέχτηκε τὸ 1706 ἐπίσκοπος Πρεσπῶν, στὶς 4 Ἰουνίου 1709 μητροπολίτης Κοριτσᾶς καὶ στὶς 5 Ἰουλίου 1718 ἀρχιεπίσκοπος Ἀχρίδας. Προεδρικὰ διατηροῦσε καὶ τὴν ἐπαρχία τῆς Κοριτσᾶς ἀπὸ τὸ 1718 μέχρι τὸ θάνατό του στὶς 22 Ὀκτωβρίου 1745. Lidhur me këtë shih: Τσιγάρας Γ., *Οἱ ζωγράφοι Κωνσταντίνος καὶ Ἀθανάσιος*, f. 10, ku jepet dhe bibliografia përkatëse.

[112] Shih shënimin 111.

DO NOT COPY



Fig. 17. Manastiri i Apostujve të Shenjtë, Vithkuq: kisha qendrore.

ndërtojë manastir në fshatin e quajtur Vithkuq, ndaj dërgoi kërkesë në Konstandinopojë dhe i sollën fermanin e manastirit, në vitin një mijë e shtatëqind e nëntë nga lindja e Krishtit, hodhën themelet, për lavdi të Perëndisë, në këtë manastir të Apostujve të shenjtë, të nderuar dhe të lavdëruar, dhe të korifenjve Pjetër dhe Pavël, në po këtë vit mbaruan vetëm muret dhe ndenjëset, dhe në vitin një mijë e shtatëqind e dhjetë nga lindja e Krishtit e inauguruan në kohën e kryepriftërisë sonë, të tërëshenjtit dhe gjithëditurit Mitropolit të Mitropolisë fort të shenjtë të Kastoriasë, të ndershmit dhe ekzarkut dhe të parit në fron të së shenjtës Mitropoli të Justinianës së Ohrit, zotit Dionis, dhe të shenjtit të Prespës, shpresëtarit dhe të gjithëditurit, zotit Joasaf. Këta të dy e inauguruan manastirin në këtë vit, pikturuan dhe muret, deri në vitin që është shkruar në kishë brenda. Në po atë vit mbaroi dhe ikonostasi. Kryemjeshtri që ndërtoi manastirin ishte mjeshtri Thana Lenas nga mëhalla Borishe. Ata që kishin nën kujdes ndërtimin e manastirit dhe që sollën fermanin për ndërtimin e tij, ata që hodhën themelet dhe e inauguruan, ata që e pikturuan, ata që bënë ikonostasin, bashkë me fort të ndershmin zotin Haxhi Athanasi, i cili u mundua për të, bashkë me gjithë të krishterët që deshën dhe ndihmuan qoftë me fjalën e mirë, qoftë me dhurata, apo me çdo mënyrë tjetër. Çdo i krishterë i bekuar, kudo që ndodhet, të këndojë tri herë "i përjetshëm kujtimi" për ta.

Më 1736 vazhdoi ndërtimi i kishës së Shën Anargjendëve Kozma dhe Damian (Fig. 19-20). Sipas mbishkrimit ktitorik[113], kisha u ndërtua në kohën e kryepriftësisë së mitropolitit të Kastoriasë, Krisanthit (1719-1761)[114], kur igumen i manastirit ishte Metodi. Për ndërtimin ndihmoi murgu i po atij manastiri, Anthimi, ndërsa kontribuues

[113] Mbishkrimi është botuar nga Popa, Th., tek *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, f. 176–177.

[114] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 85. Péchayre P. A., L'archevêché d'Ochrida de 1394 a 1767, A propos d'une ouvrage récent, *Échos d'Orient* 35 (1936), f. 183-323. Gelzer H., «Der Patriarchat von Achrida. Geschichte und Urkunden», në: *Abhandlungen der Philologisch-Historischen Klasse der Königlich-Sächsischen Gesellschaft der Wissenschaften*, vëll. 20, nr. 5. Leipzig Teubner 1902, f. 94, 97–98, 102–103, 106, 108–111, 143.

DO NOT COPY



Fig. 19. Manastiri i Apostujve të Shenjtë, Vithkuq: kisha e Anargjendëve.

ishte prifti-ikonom Joani nga "Ajdhonohori pranë Seresit". Sipas mbishkrimit, kisha u pikturua më 1750 nga piktorët korçarë Konstandin dhe Athanas Zografi, kurse shpenzimet e pikturimit i morën përsipër arkondi Siropulos nga Ajdhonohori dhe Panajot Desina nga Vithkuqi.

Kisha e Apostujve Pjetër dhe Pavël u ndërtua më 1759 nga igumeni i manastirit, Niko Tarasio[115]. Kisha u pikturua më 1763-1764 nga vëllezërit Athanas dhe Konstandin Zografi dhe kushtoi 700 grosh[116]. Kurse më 1761 u punua ikonostasi i kishës. Për ndërtimin e kishës u shpenzuan 500.000 aspra, të cilat i siguroi igumeni i sipërpërmendur në një udhëtim në Magjar (Hungari), kurse për pikturimin e ikonostasit u shpenzuan 600 grosh, që u mbuluan nga paratë e mbledhura prej voskopojarëve të Lehisë (Polonisë). Sjellim në shqip fragmentin gjegjës nga kodiku i Manastirit[117]:

V. – Në vitin 1759 nga lindja e Krishtit, i shtyrë nga zelli hyjnor dhe nga dashuria për Krijuesin, i nxitur nga shpresëtaria e denjë, i ndershmi gjithoshënar dhe kathigumen i shenjtë i këtij Manastiri të hirshëm dhe të respektuar, papa Tarasi, i biri i Gjika Bukës nga mëhalla Qirso e vendit të Vithkuqit, rikonstruktoi nga themelet dhe ndërtoi këtë kishë të respektuar dhe të shquar që mban emrin e dymbëdhjetë Apostujve të shenjtë, të lavdëruar dhe të nderuar, si dhe të shtatëdhjetë dhe gjithë Apostujve të tjerë. Ndërtoi narteksin me gjithë hijeshinë që i takon, ashtu siç duket sot, duke shpenzuar pesëqind mijë aspra, të cilat i solli të gjitha nga udhëtimi në Magjari i sipërpërmenduri, i shenjti gjithoshënar kathigumen papa Tarasi. Tri herë i përjetshëm kujtimi.

VI. – Në vitin 1761 u ndërtua dhe u skalit ikonastasi me shpenzimet e voskopojarëve që bëjnë tregti me Lehinë, shuma e të cilëve është gjashtëqind grosh. Tri herë i përjetshëm kujtimi i tyre.

VII. – Në vitin shpëtimtar 1763 u pikturua e gjithë kisha me duart e vëllezërve Zografi, zotit Konstandin dhe zotit Athanas nga Korça, shpërblyer me shumën e shtatëqind groshëve, të cilat i solli nga Hungaria i gjithoshënari kathigumen papa Tarasi, tri herë i përjetshëm kujtimi i tij.

Sipas kodikut të Korçës, në atë kohë Vithkuqi kishte "*pothuaj tetë mijë banorë. Kjo provohet edhe nga dhjetë kishat dhe dy manastiret e vjetra që ekzistojnë*"[118]. Gjithashtu, në kodikun e Korçës referohet se Manastiri i Apostujve, bashkë me Manastirin e Shën Minait zotëronin: "*në Korçë [...] nga pasuritë e dhuruara, punishte, të cilat sillnin fitime deri dhjetë mijë, të cilat përdoreshin për qëllime të shenjta*"[119]. Për më tepër, manastiri i Apostujve zotëronte një metoq në qytetin e Korçës, ndërtimi i të cilit ishte kryer në vitin 1746 dhe kishte kushtuar 1200 asllanë dhe një metoq tjetër në

[115] Igumeni Taras referohet në kodikun e Korçës si dhurues i ikonës së Apostujve të Shenjtë për kishën e Burimit Jetëdhënës në Korçë: «Ὁ Πνευματικός Ταράσιος ἀφιέρωσεν τήν εἰκόνα τῶν Ἁγίων Ἀποστόλων» ("Shpirtërori Taras kushtoi ikonën e Apostujve të Shenjtë"). Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 3^{10}, 9^{77}, $A'.^{127}$.

[116] Κουρίλας Ἐ., Ἡ *Μοσχόπολις*, f. 155. Pikturimi i kishës filloi, sipas kodikut të Manastirit, më 1763, dhe përfundoi, sipas mbishkrimit, më 1764. Lidhur me mbishkrimin ktitorik, shih: Thomo, P., *Kishat pasbizantine*, f. 181. Rousseva, R., «Iconographie Characteristics of the Churches in Moschopolis and Vithkuqi (Albania)», *Μακεδονικά* 35 (2006), 163–191.

[117] Shih shënimin 111.

[118] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. $163/7^{5-7}$: «ὀκτώ χιλιάδας περίπου κατοίκους. Τοῦτο δέ ἀποδεικνύεται ἐκ τῶν σωζόμενων δέκα ἐκκλησιῶν καί δύω ἀρχαίων Μοναστηρίων». Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[119] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. $163/7^{16-19}$: «ἐν Κορυτσᾷ [...] ἐξ ἀφιερωμάτων κτηματικήν περιουσίαν εἰς ἐργαστήρια, τά ὁποῖα φέρουσι πρόσοδον περί τάς δέκα χιλιάδας ἅτινα ἠδύναντο νά χρησιμοποιηθῶσι δι' ἱερόν τινα σκοπόν». Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

DO NOT COPY

Voskopojë, të ndërtuar në vitin 1754[120]. Gjithashtu, lidhur me Manastirin e Apostujve, Aravantinos-i thotë: "*Në emër dhe në të drejtën e këtij manastiri, një klerik mëshirëbërës që banonte në Venecia, bleu përjetësisht taksën mbi peshat (τοῦ ζυγίου), në mënyrë që të ardhurat e përvitshme të kësaj takse t'i kalonin igumenit, në dobi të manastirit, gjë që vijonte deri sa dha shpirt shteti Venedikas më 1797*"[121].

III. Fryma artistike në zonë – punishtja e piktorëve të Korçës

Gjatë shek. XVIII dhe gjysmës së parë të shek. XIX, Korça, e ndodhur në kryqëzimin e rrjeteve të rëndësishme rrugore që e lidhin me zonat e tjera në lindje, veri dhe jug, u kthye në një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike, kulturore dhe politike të Shqipërisë juglindore. Me zhvillimin ekonomik të saj shënoi një rritje mbresëlënëse edhe ndërtimi i kishave të reja. Shënojmë, si shembull, se vetëm në Voskopojë, në vitet 1712-1759, ishin ndërtuar të paktën 7 kisha (të cilat ruhen deri sot), veç manastireve dhe riparimeve të kishave të tjera ekzistuese. Brenda kësaj klime zhvillimi, një punishte aktive artistike shtrin me dinamizëm veprimtarinë në zonën e Korçës. Bëhet fjalë për punishten e piktorëve të Korçës, që përfaqësohet nga piktorë vendas, kryesisht korçarë.

Piktori më i shquar i shek. XVIII në zonën e Korçës ishte artisti David Selenica, sipas disa studiuesve, nga fshati Selenicë i Kolonjës [122], ndërsa për studiues të tjerë nga Selenica e Vlorës[123]. Ishte ndër përfaqësuesit kryesor të rrymës lokale artistike agjiorite, që lëvizte drejt kthimit tek modelet e shek. XIV, ashtu sikundër ato ishin shprehur nga piktori i Protatos-it, në Karies të Malit Athos, Manuel Panselinos[124]. Nga bashkëpunëtorët e afërt të tij njohim vetëm Konstandinin dhe Kriston. Më pas vijuan veprimtarinë e tyre piktorë të tjerë të shquar, si Konstandin Shpataraku, Kostandin Hieromonaku, vëllezërit Konstandin dhe Athanas Zografi, si dhe djemtë e këtyre dy të fundit, Terpo dhe Efthim Zografi[125]. Shumica e piktorëve nuk ishin vetëm nxënës të kryemjeshtërve, por dhe pasardhës të tyre, duke ushtruar veprimtarinë e tyre krah mësuesve, fillimisht si nxënës në punë teknike të rëndësisë dytësore dhe, në vijim, si bashkëpunëtorë në sektorë të ndryshëm, në varësi të prirjeve vetjake. Tek punishtja e Korçës, pra, hasim një grup artistësh që nuk veprojnë të shpërndarë dhe pa lidhje mes tyre. Përkundrazi, konstatojmë ekzistencën e një procesi të zhvillimit të artit që, siç paraqitet dhe nga kodiku i Korçës, transmetohet nga kryemjeshtri te nxënësi, nga babai tek i biri: "*Këtë derë hijeroreje e kushtoi papa Efthimi, i biri i Athanas Zografit, i cili e pikturoi*"[126], dhe nga burri, te bashkëshortja: "*E shoqja e Athanas Zografit pikturoi kryqin e ikonostasit*"[127], duke ruajtur veçoritë teknike dhe karakteristikat themelore dhe duke imituar krijimtarinë e tyre më përfaqësuese[128].

---

[120] Κουρίλας Εὐλ., *Γρηγόριος ὁ Ἀργυροκαστρίτης*, f. 252–253. Papakozma A., *Manastiri i shën Pjetrit dhe Pavlit në Vithkuq*, f. 80. Për marrëdhëniet ekonomike midis Vithkuqit dhe Voskopojës shih Adhami S., "Marrëdhënie ekonomike, shoqërore dhe kulturore midis Vithkuqit dhe Voskopojës në shekullin e lulëzimit të tyre", *Monumente* 17 (1979), f. 71–81.

[121] Ἀραβαντινὸς Π., *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου*, vëll. 1, f. 118, shën. 1. Shih, po ashtu, Anonim, «Περὶ ἐν Μακεδονίᾳ Κοριτσᾶς», *Πανδώρα*, vëll. 18: fashik. 424 (1867), f. 318–319 (botuar në shqip tek Mitko Th., pa titull, *Vepra*, f. 552).

[122] Puzanova, V., "Prapë mbi artin shqiptar të shek XVIII", *Buletin i Universitetit Shtetëtor të Tiranës, ser. Shkencat Shoqërore*, 1958, 2, f. 182; shih edhe Popa, Th., *Shkolla e Korçës*, f. 94–95.

[123] Shih shën. 129.

[124] Chatzidakis, M., "Postbyzantine Art, 1430–1830" (in Greek), në: Sakellariou, M.B. (ed). *Macedonia: 4000 Years of Greek History and Civilization (Greek Lands in History)*, Published by Ekdotike Athenon S.A., Athens 1982, f. 423. Τσιγαρίδας Ε. Ν., «Οι τοιχογραφίες του ναού της Νέας Παναγίας Θεσσαλονίκης και το κίνημα επιστροφής του 18ου αιώνα στην παράδοση της τέχνης της «Μακεδόνικης Σχολής», *Χριστιανική Θεσσαλονίκη, Οθωμανική περίοδος 1430-1912*, vëll. B', Θεσσαλονίκη 1994, f. 321. Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 309-310. Thomo, P., "Veprimtaria e Piktorëve Pasbizantinë në viset e Ballkanit: Shqipëri-Greqi", kumtesë e pabotuar, mbajtur në International Symposium *Culture and Space in the Balkans (17th-20th centuries)*, (21, 22 November 2014).

[125] Popa, Th., *Shkolla e Korçës*, f. 92. Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. $3^{31,45}$. Shih, po ashtu, Popa, Th., "Piktor Kostandini prej Shpati", *Buletin i Universitetit Shtetëtor të Tiranës, ser. Shkencat Shoqërore* 4 (1955); Popa, Th., *Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi*, Tiranë 1959· Popa, Th., *Piktorët Grabovarë Cetiri nga familja Katro, Buletin i Universitetit Shtetëtor të Tiranës, ser. Shkencat Shoqërore* 3 (1960).

[126] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 23^{1-2}: *«Ἀφιέρωσεν ὁ πα(πάς) Εὐθύμιος ὑός Ἀθανασίου Ζωγράφ(ου) ἱστόρησε τά βημῶθυρα»*. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[127] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. $3^{31,45}$: *«Ἡ γυνή τοῦ Ἀθανασίου Ζωγράφου ἱστόρησεν τόν σταυρόν τοῦ τέμπλου»*. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[128] Popa, Th., *Shkolla e Korçës*, f. 93.

DO NOT COPY



Fig. 21-22. Kisha e Shën Nikollës, Voskopojë.

Prodhimtaria artistike e David Selenicës fillon në Malin Athos në vitin 1715. Një mbishkrim i zhdukur që ndodhej pranë pikturave murale të mrekullueshme në kishëzën (paraklisin) e Shën Marisë Kukuzelisa në Manastirin e Lavrës shënonte se piktori quhej David, se e kishte prejardhjen nga Vlora, dhe jepte datën 1715. Sipas mendimit të Haxidhakis-it, bëhet fjalë për David Selenicasin[129]. Në vijim, Davidi punon në Voskopojë, ku realizon pikturën murale të bazilikës së madhe të Shën Nikollës në Voskopojë (1722-1726) (Fig. 21, 23-24): "*tani për tani u pikturua [në mënyrë] madhështore përshtatshmërisht rreth e përqark naosit, përgjithësisht me dorën e të shumëditurit dhe me furçën e hollë të gjithoshënarit z. David Selenicasi dhe me shoqërimin e Kostandinit e të Kristos...* "[130]. Një vit më vonë ai pikturon kishën e Joan Prodhromit në Apozari të Kosturit dhe kishën Nea Panagia të Selanikut. Ndërkaq, të njëjtit autor i atribuohet edhe piktura murale e Eksonarteksit të Manastirit të Dohiariut në Malin Athos[131]. Kostantini, i cili përmendet së bashku me Kriston në mbishkrimin e kishës së Shën Nikollës në Voskopojë si bashkëpunëtor i piktorit të njohur David Selenicës, është identifikuar si Kostantin Hieromonaku[132]. Kostandin hieromonaku, që zakonisht nënshkruan «*χεὶρ Κωνσταντίνου ἱερομονάχου*» (*dora e Konstandin hieromonakut*], duket se është marrë kryesisht me pikturimin e ikonave, më shumë se 50 prej të cilave janë gjetur në Shqipëri (Elbasan, Pogradec, Voskopojë, Vithkuq), Greqi (Kostur, Veria, Malin Athos) dhe Kryepeshkopatën e Ohrit, dhe i përkasin periudhës mes viteve 1693 dhe 1726[133].

[129] Chatzidakis, M., "Spiritual Life and Culture" (in Greek), *Istoria tou Ellinikou Ethnous*, vol. XI, f. 245–246 e në vijim. Shih edhe Chryssochoidis K., «Aspekte të marrëdhënieve mes Malit Athos dhe trevave shqiptare në periudhën pasbizantine», në: *2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri*, Tiranë 2003, f. 63; Κωνσταντίου Δ., *Προσέγγιση στὸ ἔργο τῶν ζωγράφων ἀπὸ τὸ Καπέσοβο τῆς Ἠπείρου*, vëll. 1, Αθήνα 1997, f. 234. Shuteriqi Dh, "Mbi piktorin David Selenica dhe mbi Voskopojën", *Gazeta Drita,* 29 janar, 1984.

[130] Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 166–167, nr. 331.

[131] Thomo, P., *Veprimtaria e Piktorëve Pasbizantinë në viset e Ballkanit: Shqipëri-Greqi*, November 2014. Chatzidakis M., Drakopoulou E., *Έλληνες ζωγράφοι μετά την Άλωση* [Greek painters after the Fall of Constantinople], Vol. II, Athens 1997, f. 229–236, 458. Κυριακούδης Ε. Ν., «Η μνημειακή ζωγραφική στη Θεσσαλονίκη και το Άγιον Όρος, το 18ο αιώνα: αισθητικές αναζητήσεις και τεχνοτροπικά ρεύματα», *Θεσσαλονικέων Πόλις* 4 (2001), f. 143–190 (147–151).

[132] Shih Kallamata, K, "Constantin Ieromonachou, an Icon Painter in Moschopolis (1693-1726)", në: *Μοσχόπολη* [International Colloquim Moschopolis], Thessaloniki 1999, f. 69; Krhs. Drakopoulou E., "The study of the Icons from the Collection of the National Museum of Medieval Art, Korçë", në: *Icons from the Orthodox Communisties of Albania,* katalog ekspozite, Thessaloniki 2006, ikona, no. 40, f. 120–122. Drakopoulou, E., "The Itineraries of the Orthodox Painters in the Eighteenth Century: The Common Aesthetics in South-East Europe", *The Historical Review/ La Revue Historique* 5(2008), f. 21–39.

[133] Popa, Th., "Mbishkrimi dhe piktura në katedralen Fjetja e Shën Marisë në Voskopojë", *Buletin I Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore,* 1962, 3, f. 76–106; Kallamata K, *Constantin Ieromonachou*, f. 65–70; Popovska-Korobar V.., "A Contribution Towards the Artistic Relations Between the Fresco-paintings of the Monastery Dracha and the

DOKTORSKO

Veprimtaria artistike e Konstandin Shpatarakut shtrihet nga viti 1726 deri më 1767. Veç prodhimtarisë të pasur ikonografike, sot nga ky piktor ruhen vetëm ikonat e kishës qendrore të Manastirit të Shën Marinës, si dhe disa fragmente pikture murale në kishat e fshatit Llëngë[134].

Veprimtaria artistike e vëllezërve Konstandin dhe Athanas Zografi zë vend kryesor mes gjithë piktorëve të punishtes së Korçës dhe zhvillohet mes viteve 1741 deri 1783[135]. Vëllezërit Zografi e kishin prejardhjen nga fshati Potkozhan i zonës së Mokrës dhe mbiemrin e kishin Vako[136]. Duket se familja e tyre zbriti në Korçë, e cila në shek. XVIII ishte një qendër urbane mjaft aktive, me tregti të zhvilluar dhe gjallëri ekonomike. Sipas informacioneve që marrim prej kodikut të Korçës[137], piktorët Konstandin dhe Athanas merrnin pjesë aktivisht në jetën e bashkësisë së qytetit. Shpesh emrat e tyre i hasim në dokumente apo llogari të kodikut, kur herë dhurojnë 11.000 aspra[138] për kishën katedrale të Korçës, herë 50 asllanë[139] dhe herë 100 grosh[140]. Veç shumave në të holla, në kodikun e Korçës janë regjistruar edhe dhuratat në ikona që u kanë bërë vëllezërit Zografi kishave të qytetit. Kështu, Konstandini ka dhuruar "*ikonën e madhe të së Tërëshenjtës*"[141] (të cilën, sipas të gjitha gjasave, e ka pikturuar vetë ai) për fronin dhespotik të katedrales së Burimit Jetëdhënës në Korçë, bashkë me të shoqen, e cila ka dhuruar 100 grosh për kishën[142]. Po ashtu, edhe Athanasi është regjistruar në kodik si dhuruesi i "*ikonës së madhe të Krishtit*"[143], kurse e shoqja e tij, Maria, ka bërë dhuratë "*kryqin e ikonostasit*"[144].

Sipas mbishkrimeve bërë me dorën e tyre, rrezja e veprimtarisë së vëllezërve Zografi shtrihej, përveçse në zonat ortodokse të Shqipërisë jugore, edhe në Malin Athos, edhe në Thesali. Dimë se vëllezërit Zografi kanë pikturuar kishën qendrore të Lindjes së Hyjlindëses në Manastirin e Ardenicës (1744)[145], kishën e Shën Athanasit në Voskopojë (28 tetor 1744)[146] dhe, më vonë, edhe hajatin e saj (28 qershor 1745)[147] (Fig. 25), kishën e Anargjendëve të Shenjtë Kozma dhe Damian në Manastirin e Apostujve Pjetër dhe Pavël në Vithkuq (18 maj 1750)[148] (Fig. 19-20), hajatin e kishës së Shën Nikollës në Voskopojë (23

Painting in Macedonia in the First Half of the 18th Century", *Zbornik, Muzej na Makedonija* 1 (1993), f. 149-156. Drakopoulou E., "The Itineraries of the Orthodox Painters in the Eighteenth Century: The Common Aesthetics in South-East Europe", *The Historical Review/La Revue Historique* 5(2008), f. 25–26.

[134] Popa, Th., *Shkolla e Korçës*, f. 93 dhe Popa, Th., *Piktor Kostandini prej Shpati,* nr. 4, Tiranë 1955. Shih, po ashtu, Nalibani H., "Rreth krijimtarisë së piktorit David Selenicasit", *Monumentet* 1971, 1, f. 119–126.

[135] Popa, Th., *Shkolla e Korçës*, f. 94. Krhs. Tsigaras G. C., "The Painters Constantine and Athanasios from Korçë and their Work on Mount Athos", në: *2000 Years Church Art and Culture in Albania, Papers of the International Symposium, Tirana, 16-18 November 2000*, Tirana, 2005, f. 307–322; Zheku, K., *Konsandin dhe Athanas Zografi. Piktorët mesjetarë korçarë në Malin e Shenjtë, Athos, 1750-1783*, Tiranë, 2004.

[136] Popa, Th., *Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi,* f. 23–24 dh N.D.N, *Korça бе Πσatrat*, f. 14.

[137] Përmendja e parë e kontributit të tyre social me referencë në kodikun e Korçës u bë prej Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 297-298.

[138] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 9^{87}, A'^{130}.

[139] Rembeci, A., The Codex of the Holy Metropolis of Korça, regjistrimi nr. 26^{6}.

[140] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. $3^{15, 17, 33}$.

[141] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 9^{94}: *«τὴ μεγάλην οἰκόνα τῆς Παναγίας»*. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[142] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 3^{33}.

[143] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 9^{96}: *«οἰκόνα τοῦ Χριστοῦ τὴ μεγάλην»*. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni. Shih, po aty, edhe regjistrimin nr. A'^{58}, tek Shtojca.

[144] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 3^{31}: *«τόν σταυρόν τοῦ τέμπλου»*. Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[145] Mbishkrimi në pjesën e sipërme të portës perëndimore të kishësh shkruan: *«Διὰ χειρὸς τόν αὐταδέλφον Κωνσταντίνου καὶ Αθανασίου ἐκ πολιτείας Κορητζᾶς»* ("*Me dorën e vëllezërve Konstandin dhe Athanas nga qyteti i Korçës*"). Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 98; Popa, Th., *Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi,* f. 24; Mihalcka S., "Të dhëna mbi disa vepra të artit kishtar në vendin tonë", në: *2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri*, Tiranë 2003 f. 247; Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 8-9; Πιομπίνος Φ., Ἕλληνες Ἁγιογράφοι μέχρι τὸ *1821*, Ἀθήνα 1982, f. 122–125.

[146] Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 173–174; shih edhe Popa, Th., *Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi,* f. 24.

[147] *«Ἀνιστορήθη αὕτη ἡ στέγη ἠς 17(45) ἐπιτροπεύοντος τοῦ κὺρ Βρούσιου Σοφρωνί(ου) διὰ χειρὸς τῶν αὐταδέλφων Κωνσταντίνου καὶ Ἀθανασίου ἐν μηνί Ἰουνίῳ 28»* ("*U pikturua kjo strehë më 17(45), në kohën e kujdestarisë së zotit Vrusho Sofroni, me dorën e vëllezërve Konstandin dhe Athanas, në muajin qershor, 28*"); Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 174; Σκενδέρης Κ., Ἱστορία τῆς ἀρχαίας καὶ συγχρόνου Μοσχοπόλεως, Ἐν Ἀθήναις 1928, f. 126.

[148] Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 11–12; Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, f. 176-177; shi edhe Popa, Th., *Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi,* f. 24–25.

DO NOT COPY



Fig. 25. Kisha e Shën Thanasit, Voskopojë.

gusht 1750)[149] (Fig. 22) si edhe kishën e Mitropolisë, Burimi Jetëdhënës,në Korçë (1752-55) dhe ikonostasin e saj (1752)[150], siç e thamë edhe më sipër. Gjithashtu, kanë pikturuar kishën qendrore të Manastirit të Filotheit në Malin Athos (7 tetor 1752)[151] dhe Skitin e Shën Anës të Lavrës në Malin Athos (1757)[152], kishën qendrore të Manastirit të Apostujve të Shenjtë Pjetër dhe Pavël në Vithkuq (1764)[153] (Fig. 17-18), narteksin e kishës qendrore të Manastirit të Filotheit në Malin Athos (15 shtator 1765)[154], kishën e Skitit së Ksenofondit në Malin Athos (20 shtator 1766)[155], ndërsa Athanasi me të birin e tij, Naumin, kanë pikturuar kishën e Shën Marisë, sot të shembur, në Klinovo të Thesalisë (1780)[156]. Konstandini, pa të vëllain, Athanasin, ka pikturuar, bashkë me të birin, Terpon[157], ikonostasin e kishës së Shën Nikollës në fshatin Vanaj në Myzeqe (19 gusht 1781)[158], kishën e Shën Gjergjit në Libofshë, Myzeqe (6 mars 1782)[159], dhe, po ashtu, në Malin Athos, kanë pikturuar (Kostandini, Athanasi dhe Naumi) kishën qendrore të Manastirit të Ksiropotamit (1783)[160]. Gjithashtu vëllezërve Zografi u është atribuuar edhe pikturimi i kishës së Shën Marisë së Purpurt në Prespë (1741), i kishës së Shën Gjermanoit në Prespën e Vogël (1743), i kishës së Apostujve të Shenjtë, sot e shembur, në Voskopojë (1752), e kishës së Skitës "Fjetja e Hyjlindëses" (që quhet edhe Bogorodica) në Malin Athos (1757)[161], si dhe kishën e Anargjendëve në Voskopojë, kishë e cila është shembur[162].

[149] Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 176; Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 11.

[150] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. A´ në shtojcë. Për mbishkrimin, shih më lart; shih, gjithashtu Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 24–25; Popa, Th., *Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi,* f. 24.

[151] Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 12–13 ku jepet edhe bibliografia përkatëse.

[152] Chryssochoidis K., *Aspekte të marrëdhënieve mes Malit Athos*, f. 63; për veprimtarinë e vëllezërve Zografi në Malin e Shenjtë shih: Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa,* f. 13-15.

[153] Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 181; Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa,* f. 15–17.

[154] Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 17, ku jepet edhe bibliografia përkatëse.

[155] *Po aty*, f. 17, ku jepet edhe bibliografia përkatëse.

[156] *Po aty*, f. 18, ku jepet edhe bibliografia përkatëse. Krhs. Thomo, P., "Veprimtaria e Piktorëve Pasbizantinë në viset e Ballkanit: Shqipëri-Greqi", kumtesë e pabotuar, mbajtur në International Symposium *Culture and Space in the Balkans (17th-20th centuries),* (21, 22 November 2014).

[157] Piktorët korçarë ndoqën një traditë mjaft të përhapur në kohën e pushtimit osman, sipas së cilës, kur ndihmësit kishin përparuar në mjeshtërinë dhe kontributi i tyre gjatë pikturimit të monumenteve ishte më i madh, shënoheshin emrat e tyre në mbishkrimet ktitorike. Për këtë shih: Tourta A., *The churches,* f. 227–229; Eugenidou D. «Les peintres Kolakiotes au 19eme siècle», *Μακεδονικά* 22 (1982), f. 180–204

[158] Ikona e Kryeengjëjve, që ndodhet e vendosur në ikonostasin e kishës, ka mbishkrimin: *«Διὰ χειρὸς τόν αὐταδέλφον Κωνσταντίνου ἀπὸ Κορητζᾶς ἐπὶ ἔτους 1781 Αὐγούστου 19»* (*"Me dorën e vëllezërve Konstandin dhe Athanas nga Korça, në vitin 1781, 19 gusht"*.) Gjithashtu, të gjitha ikonat e tjera të ikonostasit identifikohen si të të njëjtit piktor. Për këtë shih Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 107–108.

[159] Kisha u ndërtua më 1776 dhe është bazilikë trinefëshe me nartekst në nivel të ngritur. Mbishkrimi ktitorik, ku përmenden si piktorë Konstandini dhe Terpoja, thotë: «Ἀνιστορίθη ἡ παρούσα ἐκ(κ)λησία διὰ χειρὸς Κωνσταντίνου καὶ ὁ υἱὸς αὐτοῦ Τέρπος ἐκ πόλεως Κοριτζᾶς. *1782 Μαρτίου 6*». ("*+U pikturua kjo kishë me dorën e Konstandinit dhe të birit të tij, Terpos, nga qyteti i Korçës, 1782, 6 mars*"). Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* f. 109–110. Shih gjithshtu Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 19; Thomo, P., *Kishat pasbizantine*, f. 209–214.

[160] Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 19–20; Σμυρνάκης Γ., *Τὸ Ἅγιο Ὄρος*, Καρυὲς Ἁγίου Ὄρους 1988, f. 546.

[161] Κουρίλας Ἐ., *Ἡ Μοσχόπολις*, f. 29. Kurilla, bazuar në informacionet që merr nga Porfir Uspenski, është i mendimit se piktorët Konstandin dhe Athanas kanë pikturuar sketën e Fjetjes së Hyjlindëses më 1757, mendim që e pranon edhe Th. Popa. Për problemet që ngre ky qëndrim, shih: Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa,* f. 28.

[162] Popa, Th., *Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi,* f. 24–25. Popa, i mbështetur në dëshminë gojore të Antigonës, së bijës së Pandeli

Veprimtaria artistike e të birit të Konstandinit, Terpos, dhe të birit të Athanasit, Efthimit, zhvillohet në periudhën 1792-1819. I pari u mor paralelisht edhe me pikturat murale në kisha, edhe me ikonografinë. Më 1782 pikturoi, bashkë me të atin, siç thamë më sipër, kishën e Shën Gjergjit në libofshë të Myzeqesë dhe ka lënë identitetin e tij në mbishkrimin e kishës. Në vijim punoi i vetëm, duke shtrirë veprimtarinë e tij në Berat[163], në Përmet[164], në Drenovë dhe në Manastirin e Oshënarit Naum[165]. Për veprimtarinë artistike të Efthimit ekzistojnë fare pak informacione. Nga kodiku i Korçës mësojmë se është ikonograf dhe dhurues i ikonave të dyerve të ikonostasit në kishën katedrale të Korçës: "*...papa Efthimi, i biri i Athanas Zografit, pikturoi dyert e ikonostasit*"[166]. Dimë, po ashtu, se u mor më shumë me pikturimin e ikonave dhe se ka pikturuar ikonostasin e kishës së fshatit Rëmbec, pranë Korçës[167]. Manolis Haxidhakis-i na informon se Efthimi ka punuar në Voskopojë dhe në zonën e Oparit në Korçë[168].

Piktorët Konstandin dhe Athanas zhvillonin në Korçë, për pothuaj 40 vjet, një punishte të organizuar në bazë familjare. Gjatë këtyre viteve, vëllezërit Zografi morën famë të madhe, gjë që provohet nga fakti se brenda kësaj periudhe kohore arritën të përfundojnë trembëdhjetë porosi për pikturimin e monumenteve të rëndësishme të kohës së tyre[169].

K. Zografit, pasardhës i piktorëve korçarë, ua atribuon Konstandinit dhe Terpos, të birit, pikturat murale të kishës. Sidoqoftë, mëtimi se kjo kishë ka qenë pikturuar nga këta piktorë është i pamundur të verifikohet, pasi ky monument sot është i shembur.

[163] Më 1805 ka pikturuar një kishë në Vodicë, pranë Beratit. Për këtë shih Puzanova V., *Prapë mbi artin shqiptar,* f. 156.

[164] Nga kodiku i Korçës informohemi se ka pikturuar kishën e Shën Parashqevisë: «*Κατά δέ τό 1808 ἐπί τοῦ τότε ἀρχιερατεύοντος Ἰωάσαφ ἐφημερεύοντος δὲ τοῦ Σακελλαρίου παππά Πάνου καί ἐπιτροπεύοντος τοῦ Δημητρίου Στεφάνου ἐζωγραφίσθη [ὁ ναός τῆς ἁγίας Παρασκευῆς] ὑπό τοῦ Κορυτσαίου Τέρπου Κωνσταντίνου Ζωγράφου*» ("*Në vitin 1808, në kohën e kryepriftërisë së Joasafit, kur ishte famullitar saqellari papa Pano dhe kujdestar Dhimitër Stefani, u pikturua [kisha e Shën Parashqevisë] nga korçare Terpo Konstandin Zografi*"). Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 163/3[12-16]. Traskriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[165] Puzanova V., *Prapë mbi artin shqiptar të shek. XVIII,* f. 156; Μαρτινιανὸς Ι., *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως,* f. 42, shën 9.

[166] Rembeci, A., *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, regjistrimi nr. 23[1]: «*...ὁ πα(πᾶς) Εὐθύμιος ὑός Ἀθανασίου Ζωγράφ(ου) ἱστόρησε τά βημῶθυρα*». Transkriptimi paleografik dhe përkthimi yni.

[167] Puzanova V., *Prapë mbi artin shqiptar të shek. XVIII,* f. 156.

[168] Chatzidakis M., *Spiritual Life and Culture,* f. 286.

[169] Tsigaras G., *The painters Konstantinos and Athanasios from Korytsa*, f. 304-305.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Andi REMBECI

THE CODEX OF THE METROPOLIS OF KORÇA AND SELASPHORUS (17th - 19th CENTURIES): INFORMATION ABOUT THE CULTURE IN KORÇA AREA

The social, economical, cultural and spiritual life of the Christian community in Korça was manifested through the Christian institutions of the city, which were the churches, the monasteries and the schools. The institutions of the Christian Orthodox religion during the Ottoman conquest constituted the center of the community and were, at the same time, the venue of the artistic manifestations of the time. The development of the masonry and of the artistic activity in the city of Korça, as well as in the areas that were under the jurisdiction of the Metropolis of Korça, is evident also from the data offered by the church archives. One of these sources is the Codex of the Metropolis of Korça and Selasphorous, rich with important information concerning the masonry and the development of religious art during the 18th-19th centuries.

Based on the data that come mainly from this source, but also from other regesta of churches or monasteries of the Metropolis of Korça, this paper aims to make a presentation of the cultural and artistic activity, through the critic presentation of the historic data regarding the monumental heritage of the Orthodox Christians in the city of Korça. The paper is separated in three units. In the first unit are presented the five church monuments that are built in the city of Korça. In succession we have presented a list of 19 monasteries, based on information from the Codex of Korça and other codices, giving also short information about the sources. On the last unit we have made a presentation of the artistic trends about the area in question, which are represented by the workshop of the Korça painters, starting with David Selenica, later mentioning other prominent painters, Konstandin Shpataraku, Konstandin the hieromonach, the brothers Konstandin and Athanasios Zografi, and also their sons, Terpo and Efthimios Zografi. The up to now research data are linked with new data that derive from the aforementioned sources, thus completing or reconsidering nowadays hypotheses about the artistic activity of these painters.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 18. Manastiri i Apostujve të Shenjtë, Vithkuq: fragment nga piktura murale e kishës qendrore. Piktorët Kostandin dhe Athanas Zografi.



Fig. 20. Manastiri i Apostujve të Shenjtë, Vithkuq: fragment nga piktura murale e kishës së Anargjendëve. Piktorët Kostandin dhe Athanas Zografi.

DO NOT COPY





Fig. 23-24. Kisha e Shën Nikollës, Voskopojë. Fragmente nga piktura murale. Piktori David Selenica.

monumentet
52/2011 - 2014

DO NOT COPY

Kreshnik MERXHANI
Elena MAMANI

MATERIALET NDËRTIMORE NË MONUMENTET HISTORIKE - GJIROKASTËR*

Hyrje

Gjirokastra është një nga vendndodhjet e trashëgimisë kulturore më të rëndësishme në Shqipëri. Në vitin 1961 Gjirokastra shpallet qytet muze[1], për arsye se ruan një numër të konsiderueshëm monumentesh brenda qendrës së saj historike. Ndërtesat historike ndahen në dy kategori, prej të cilave 56 monumente klasifikohen si kategori e parë dhe mbi 500 monumente si kategori e dytë, por qyteti ruan dhe objekte të tjera prej guri të paklasifikuara si monumente.

Në vitin 2005 qyteti i Gjirokastrës shpallet si pjesë e trashëgimisë botërore dhe mbrohet nga UNESCO[2].

Publikimi i parë rreth banesës gjirokastrite, tipologjisë dhe karakteristikave të saj ndërtimore është bërë 10 vjet pas shpalljes së Gjirokastrës "qytet muze" në vitin 1971 në revistën *Monumentet,* 1971/1, me autor Prof. Emin Riza. Në 1981 publikohet nga i njëjti autor monografia "Qyteti - muze i Gjirokastrës" (ribotim në 2004). Që në vitin 1971 e në vazhdim nuk janë botuar shumë artikuj që prekin problemin e materialeve të ndërtimit. Një nga këta artikuj është ai i Thanas Kamberit me titull "Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës gjirokastrite" publikuar në revistën *Monumentet,* 1971/2.

Ky artikull risjell në vëmendje peshën dhe rëndësinë që materialet tradicionale kanë në praktikën restauruese.

Materialet

Në ndërtesat historike të Gjirokastrës janë përdorur lloje të ndryshme materialesh. Një pjesë e mirë e tyre janë materiale lokale ndërsa një pjesë tjetër sigurohej nga importi. Importi hedh dritë dhe për marrëdhëniet që ka patur qyteti me botën, nivelin e shkëmbimeve dhe të tregtisë si dhe nivelin ekonomik dhe kulturor të porositësve të këtyre banesave.

Në materialet e përdorura mund të përmendim:

Materiale natyrore:
- Guri
- Druri
- Dheu (argjilë apo baltë e zakonshme)

Materiale të përpunuar:
- Hekur
- Gëlqere
- Allçi
- Xham

Materiale të përbërë:
- Llaçi lidhës
- Suvatë

*Ky artikull është mbajtur në: *International Students' Conference of Civil Engineering*, ISCCE 2012, 10-11 May 2012, Epoka University, Tirana, Albania.

[1] Vendim i Këshillit të Ministrave nr.172, dt. 02.06.1961

[2] Criterion (iii), Criterion (iv)

DO NOT COPY

Materiale dytësore:

- Vajra dhe recina natyrore
- Lesh dhie, kashtë, e bardha e vezës
- Tullë e thërmuar
- Pigmente të ndryshme për lyerje, etj..

Nga këto materiale që përmendëm, sigurisht pjesën kryesore e zë guri dhe druri.

Pikërisht në këto dy materiale, në sigurimin, trajtimin dhe përdorimin e tyre do donim të ndaleshim më shumë.

Guri

Materiali më i përdorur pa dyshim është guri. Guri është përdorur në themelet e ndërtesave, në mure e deri në çatitë e mbuluara me rrasa. Nga përdorimi i gjerë i këtij materiali Gjirokastra është e njohur gjithashtu si "Qyteti i Gurtë". Nga një vëzhgim i hollësishëm është e qartë që guri është vendor.



Fig.1. Harta gjeologjike[3]

Gur i Zi
Gur i bardhë

Ky material na paraqitet në tri cilësi kryesore fiziko-mekanike dhe kimike:

- Guri i bardhë gëlqeror;
- Guri i bardhë gëlqeror gjysëm i kristalizuar[4];
- Guri i zi silikat.

Guri i bardhë gëlqeror që përdorej për ndërtim merrej ose nga vetë sheshi i ndërtimit të objektit ose sillej nga zonat përreth (Fig.1). Në të dyja rastet guri ka cilësi shumë të mira fiziko-mekanike.

Kavat (*mademet* – Gjr.) e vjetra gjendeshin brenda qytetit dhe në zonat rreth tij. Këto formacione shkëmbore kanë trashësi të ndryshme e pikërisht prej kësaj mjeshtrit e vjetër siguronin dhe materialin për pjesët e ndryshme të ndërtesës. Në kohët e vjetra mjeshtrat i merrnin gurët në faqet anësore të përrenjve, sepse atje mund të depërtonin në shtresat më të thella, pa u dashur të gërmojnë shtresat sipërfaqësore që ishin të papërdorshme (Fig. 2).



Fig. 2. Formacionet shkëmbore në zonën e Gjirokastrës

Shtresat më të përshtatshme për t'u përdorur janë një horizont i caktuar gëlqeror që fillon nga zona e Viroit e deri në Zervat, diku del më në sipërfaqe e diku zhytet në thellësi të mëdha. Ky horizont ndahet në tre pako. Pako e parë duke filluar nga sipërfaqja, me një trashësi totale prej 1.6 m,

[3] Ky gur njihet me emrin e një prej përronjve të qytetit nga ku edhe sigurohej, gur nga përroi i Çullos.

[4] Progetto "transismic" (cod. 170), riduzione del rischio sismico nella pianificazione ecosostenibile dei centri storici transfrontalieri.

përbëhet nga 13 shtresa me trashësi të ndryshme duke filluar nga 1cm e deri në 16cm.

Në Fig. 1 dhe Fig. 2 shihen shtresat e ndryshme që ka formacioni shkëmbor me përmasa të ndryshme dhe harta e shtrirjes së tyre në qytet. Midis pakos së parë dhe të dytë gjendet një shtresë gëlqerore kristaline me trashësi 0.35 - 0.40 m që nuk përdorej për ndërtim (përdorej për gurët e mullirit).

Pakoja e dytë me një trashësi totale prej 1.6 m përbëhet nga 11 shtresa me trashësi shtresë maksimale 10 cm. Poshtë kësaj pakoje ndodhet një shtresë gëlqerore 0.60 m e trashë, e cila nuk përdorej pasi ishte shumë e thyeshme.

Pakoja e tretë ka një trashësi të përgjithshme 1.2 m dhe përbëhet nga 16 shtresa të holla, me shtresë më të madhe 12 cm trashësi. Poshtë saj ndodhen 4 shtresa strallore dhe lidhëza që përsëri nuk përdoreshin në ndërtim.

Ky lloj guri gjendet në tre ngjyra të ndryshme:

- Gushëpëllumbi (ngjyrën e jep oksidi i bakrit i ndodhur në këtë shtresë)
- I bardhë mat (ngjyrën e jep oksidi i magneziumit)
- I kuq (ngjyrën e japin oksidet e hekurit, Fe_2O_3)

Në çdo karierë gjenden shtresa me të tre këto ngjyra.

Për mbulimin e çative përdorej ekskluzivisht guri i bardhë gëlqeror, shtresat më të holla të tij prej 1.5 - 3 cm, e cila gjendet gjithmonë në pakon e parë dhe vetëm në dy nga shtresat e saj. Përzgjedhja zgjaste në kohë për vetë faktin se shtresa të tilla shfaqen më rrallë (Fig. 3).



Fig. 3. Guri i përdorur për mbulimin e çatisë



Fig. 4. Guri i bardhë i përdorur në muraturë



Fig. 5. Gur i bardhë Çullos dhe gur i bardhë gëlqeror.



Fig. 6. Gur i Çullos i përdorur për elementë dekorativë

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Përzgjedhja ishte rigoroze. Pllakat duhet të ishin të kësaj trashësie dhe me përmasa të ndryshme sepse trashësia ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në peshën e çatisë, e cila në kushte normale (trashësi 1.5 cm dhe përmasa sipas mënyrës tradicionale të mbulimit) – arrin një peshë prej 280 kg/m², përfshirë edhe konstruksionin).

Mbulimi i çatisë gjithashtu ruante një logjikë, pjesa afër kulmit të çatisë mbulohej me pllaka të përmasave të vogla, ndërsa përmasa rritej sa më afër i afroheshin strehës. Kjo bëhej për dy arsye që plotësojnë njëra tjetrën: arsyeja e parë është se uji i reshjeve në afërsi të strehës është më i madh se në kulme dhe madhësia e pllakave ndihmon për të mos lejuar depërtimin e ujit në brendësi. Arsyeja e dytë ka të bëjë me faktin që pesha e pllakave të vogla në kulme nuk



Fig. 7. Përdorimi i gurit të zi në muraturë

shtyjnë pllakat e mëdha pranë strehës, pasi këto të fundit kanë sipërfaqe më të madhe fërkimi, dhe kjo siguron një qëndrim më të mirë të tyre.

Shtresat e tjera të gurëve me përmasa normale që variojnë të kenë një trashësi prej 7-16 cm përdoreshin në muraturë. Në kënde përzgjidheshin kryesisht gurë më të mëdhenj në përmasë. Kjo për arsyen e vetme që këndet të ishin më të qëndrueshëm (Fig. 3).

Guri që përdorej për elemente dekorative dhe elemente arkitektonike është guri i bardhë gëlqeror kokrrizor (gjysëm i kristalizuar) (Fig. 5-6). Shtresat e këtij guri ndodhen mbi shtresat e gurit të bardhë që përdorej në muraturë dhe gjendet në përgjithësi në majat e maleve. Këto shtresa janë më masive dhe variojnë nga 0.4-2 m trashësi. Në Gjirokastër ky gur seleksionohej edhe nga gurët e sjellë nga përroi i Çullos (përrua lokal).

Guri i zi, olikocen i poshtëm Pg31, përdorej si në muraturë ashtu edhe në dysheme apo kalldrëm. Guri i zi ka shtresëzim natyral dhe formohet nga blloqe të mëdha me trashësi 0.8-1.2 m Për nxjerrjen e tij shfrytëzoheshin hapësira të vogla midis shtresave në të cilat futeshin pykat për të shkëputur pjesë nga masivi. Guri i zi merrej ose nga terreni ku ndërtohej objekti ose nga zonat përreth. Është gur i formuar mekanikisht në ndryshim me gurin e bardhë që është formuar kimikisht. Ka përbërje hidrokside, mangani, kuarce dhe felspati, kjo e fundit i jep atij ngjyrën karakteristike[5].



Fig. 8. Guri i zi në formacionet natyrore

Druri

Ky material është ndër më të rëndësishmit dhe më të përdorurit në ndërtesat gjirokastrite. Me përjashtim të Pazarit, ku për arsye të rrezikut nga zjarri, materiali i drurit ka tendenca për t'u reduktuar në një masë të konsiderueshme[6], ky material,

[5] Informacioni për formacionet shkëmbore të zonës është marrë nga ing. gjeolog Thanas Llahana

[6] Për Pazarin, nëse i referohemi Prof. Emin Rizës, ka të dhëna që është djegur masivisht në fund të shek. XIX, dhe kjo na bën të kuptojmë që një ndër shkaqet ka qënë prania masive e materialit të drurit. Pas këtyre zjarreve, ndërhyrjet kanë synuar të reduktojnë përdorimin e drurit, përmendim këtu ndërhyrjet e fillimit të shek. XX-të me ndërkatet me

DO NOT COPY

në banesa ruan një raport të njëjtë si në ato të kategorisë së parë dhe në ato të kategorisë së dytë. Sigurisht që përjashtim bën Kalaja e qytetit, e cila është një ndërtesë specifike.

Llojet e drurit të përdorur, (sipas shkallës së përdorimit):

1. Pishë - *(Pinus pinea)*
2. Bredh - *(Abies)*; Bredh i bardhë *(Abies alba)*; Bredh i kuq *(Picea excelsa)*
3. Lis - *(Quercus pubescens Willd)*
4. Ah - *(Fagus sylvatica)*
5. Rrap - *(Platanus orientalis)*
6. Gështenjë - *(Castanea sativa Mill)*
7. Arrë - *(Juglans regia)*
8. Panjë - *(Acer)*

Mënyra e sigurimit: Mënyra se si pritej druri, periudha kur pritej, mënyra e tharjes dhe stazhionimit të tij përbënin një ritual të mirëmenduar dhe rigoroz.

Periudha e prerjes lidhet me stinën e ftohtë të vitit, në atë kohë kur druri bie në "gjumë letargjik". Druri pritej duke filluar nga mesi i dhjetorit e deri në shkurt. Kjo për arsye se në këtë periudhë sasia e lëngjeve është më e vogël dhe druri është më pak i ekspozuar ndaj insekteve.

Druri sigurohej nga pyjet përreth por dhe nga importi (Fig. 9). Nëse i referohemi Prof. Emin Rizës (sipas një bisede me ustallarët e vjetër), ai thotë se ata e merrnin drurin nga disa fshatra pranë Janinës (Vavusa), pasi në Gjirokastër pyjet u rralluan shumë.

Por pyje ka në disa zona përreth deri në ditët e sotme e për nga diametri i trungjeve duhet të jenë të paktën 100–150 vjeçare. Këtu mund të përmendim pyjet e Zagorisë, pyjet në Bushec-Delvinë (gështenjë), Dhrovjan (lis), pyjet e Sotirës (pishë) etj..

Tharja dhe stazhionimi: Tharja ishte natyrore. Fillimisht trungjet e prerë liheshin vertikalisht në mënyrë që të largoheshin lëngjet e shumta. Më pas druri pritej dhe stivosej në mënyrë të kryqëzuar duke lënë hapësira ajri midis tyre për tharje më të mirë. Stazhionimi natyror zgjaste jo më pak se një vit, ndërsa për drurët e fortë që përdoreshin në karpentieri stazhionimi zgjaste deri në 2 vjet, ndërsa druri i lisit 4 vjet (Fig. 10).

Përdorimi: Për elemente të ndryshëm arkitektonike e dekorative përdorej druri i përshtatshëm. Sipas të gjitha të dhënave të deritanishme, pisha mbizotëron në lëndën kryesore për konstruksionin e çatisë. Me të realizoheshin mahitë, baballëkët (edhe pse ka të dhëna që është përdoruar dhe material tjetër), pajantat, trarët etj.. Gjithashtu edhe petavrat realizoheshin prej druri pishe ose bredhi.

Lënda e përdorur në çati ka seksion të vogël, ajo varion nga 8 cm deri në 12-15 cm. Mjeshtri i vjetër e ka përdorur



Fig. 9. Dru lisi në qytet



Fig. 10. Mënyra e tharjes natyrale të drurit

me mjaft pjekuri këtë lëndë dhe kjo vërtetohet dhe nga rezistenca e tyre në kohë (Fig. 11; Fig. 12; Fig. 13; Fig. 14).

konstruksion metalik dhe tullë si dhe ndërhyrjet e viteve '70 - '80 me struktura B/A. Të gjitha këto e bëjnë të vështirë gjetjen e fakteve të sakta për përdorimin fillestar të materialit të drurit në Pazar.

DO NOT COPY



Fig. 11. Konstruksion karakteristik çatie



Fig. 12. Druri i përdorur si testek për mbështetjen e strehëve



Fig. 13. Derë e realizuar me dru lisi



Fig. 14. Dysheme me dru rrapi

Trarët e ndërkatit gjithashtu kishin këto dimensione 10 cm-12 cm. Ato në përgjithësi janë pishë, ndërkohë që dërrasat dhe dyshemetë janë prej pishe, bredhi (i kuq ose i bardhë), apo edhe rrap.

Për testeket (elemente mbajtës të strehës së çatisë), është përdorur kryesisht dru që i reziston agjentëve atmosferikë, dru lisi apo gështenjë Gjithashtu, po ky dru përdorej dhe për elementet e çardakut (divanit).

Për elementet arkitektonike (dyer, dritare, shkallë, tataposh) druri përzgjidhej me kujdes, në varësi të pozicionit dhe ekspozimit me agjentët atmosferikë apo me aktivitetin funksional. Elementët që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me agjentët atmosferikë, si p.sh. kapakët e dritareve, tarabatë, apo dyert e jashtme, realizoheshin me dru lisi apo gështenjë, ndërkohë që elementet e tjerë të brendshëm realizoheshin me dru pishe apo bredhi. Ndeshim shpesh edhe raste të përdorimit të drurëve të tjerë më të shtrenjtë dhe kjo gjithmonë për arsyet e përmendura më sipër.

DO NOT COPY

Për elementet e mobilimit të murëzuar, dollape, musandra etj., apo elemente dekorative, përgjithësisht përdoreshin dru të butë me cilësi të mira në gdhendje, panjë (për elemente të imët dekorative), pemë frutore (qershi, arrë, man, etj.).

Por druri përdoret dhe i kombinuar me gurin në muraturë në formën e brezave. Përgjithësisht, për breza janë përdorur dru me cilësi të mira konstruktive – lis apo gështenjë. Drurët në përgjithësi nuk liheshin nën ndikimin e agjentëve atmosferikë, ata ose suvatoheshin kur muri ishte tepër i hollë deri në 60 cm, ose kur e kalonte këtë trashësi një gur 10-12 cm qëndronte gjithnjë para brezit në faqen e jashtme të murit (Fig. 15; Fig. 16).

mbronte drurin nga insektet. Mobiljet trajtoheshin me dyll apo vajra.

Mbrojtja e brezave të drurit: Brezat e drurëve të vendosur në fasadat e ekzpozuara me shumë ndaj rreshjeve në përgjithësi vendoseshin më në brendësi të tij dhe mbuloheshin nga jashtë me një rresht guri. Këto breza nuk nisnin asnjë herë në nivel të dyshemesë së katit përdhes, ato nisnin gjithmonë 120-130 cm mbi nivelin e dyshemesë duke qëndruar larg dhe nga lagështia kapilare.

Për të mbrojtur trarët e çatisë, aty ku këta mbështeten në





Fig. 15; Fig. 16. Brezat e drurit në muraturë dhe detaje të lidhjes së tyre

Në çatma përgjithësisht përdorej dru pishe - për kolonat, dhe dru i thjeshtë sharre (i ngelur nga punimet e ndryshme) për listelat në të cilat ngecej suvaja.

Trajtimi dhe mbrojtja e drurit: Druri është një material ndërtimi i jashtëzakonshëm por dhe ai ka nevojat dhe veçantitë e tij. Nëse druri është në kontakt me lagështinë - si material organik - ai dekompozohet. Gjithashtu, përzgjedhja sikundër e përmendëm më lart, është një vendim shumë i rëndësishëm.

Lënda e drurit që përdorej në çati është e pastruar plotësisht nga lëkura dhe në shumicën e rasteve elementet janë të latuar. Druri pastrohej nga lëkura për ta mbrojtur nga insektet, pasi ajo ishte pjesa e drurit ku insektet depozitonin vezët. Mendohet gjithashtu se një dhomë e katit të sipërm lihej pa tavan në mënyrë që tymi i oxhakut të përhapej në çati. Kjo krijonte një shtresë (cipë) e cila muraturë, vendoset një brez me dy listela në të dy faqet e murit. Mbi këtë brez mbështeten trarët e çatisë. Në këtë mënyrë, trarët nuk janë në kontakt me murin dhe ata janë të mbrojtur nga kondensimet që mund të ndodhin dhe lindja e kërpudhave në këtë pjesë, ndërkohë që brezi i drurit, si pjesë e muraturës ka të njëjtën temperaturë me të dhe nuk kondenson. Ndërsa trarët kondensojnë sepse ata takohen me murin vetëm në një pikë dhe vijnë nga një hapësirë me temperaturë të ndryshme. Brezat e drurit mbi muraturë kishin edhe si qëllim shpërndarjen e njëtrajtshme të peshës së çatisë në muraturën vertikale.

Llaçi dhe suvatë

Në ndërtesat e Gjirokastrës hasim dy lloj muraturash guri: muratura e thatë (midis shtresave të gurit nuk përdorej llaç) dhe muratura e lidhur, muratura ku përdorej llaçi si material

lidhës. Tek rasti i dytë dallohen dy lloje llaçi: llaçi i argjilit, i cili nxirrej nga kavat e gurit (shtresat argjilore midis rreshtave të gurit) dhe llaçi i gëlqeres. Llaçi i gëlqeres vjen nga përzierja e rërës me gëlqere të stazhionuar. Llaçi përdorej vetëm në dy faqet e muraturës, faqen e jashtme dhe të brendshme, ndërsa mesi i murit, siç e kemi përmendur dhe më lart mbushet me copa guri të vogla.

Muret e ndërtesave gjirokastrite suvatoheshin me dy shtresa suvaje. Kemi dhe muratura, sidomos kati përdhes i objekteve, të cilat lihen pa suvatuar kryesisht për të mos lejuar lagështirën e terrenit të ngjitej lart.

Suvatimi më i vjetër dhe më i përhapur, sipas Thanas Kamberit, është ai me argjil. Balta e argjilit përzihej mirë me fije kashte dhe lihej dy deri në tre ditë për të fituar lagështi uniforme, pastaj aplikohej në mur. Këtë lloj suvatimi e hasim si shtresë të parë, si në muret e katit përdhes ashtu edhe në ambientet e kateve të sipërme (p.sh. banesa Babaramo). Kur kjo lloj suvaje përzihej edhe me gëlqere përfitohej një suva më e mirë, e cila aplikohej me një trashësi prej 2 cm dhe lihej të thahej deri sa të tkurrej argjili, duke krijuar plasaritje.

Një lloj tjetër suvaje e përdorur si shtresë e parë është



Fig. 17. Suva e realizuar me dy shtresa

suvaja me përzierje rëre dhe gëlqere përgjithësisht në raportin 2.5:1. Në këtë lloj suvaje mund të shtoheshin dhe elementë të tjerë si kashtë, hi apo dhe tullë e thërmuar, siç shikojmë në shtresat e suvasë së banesës Babameto kategoria I-rë[7]. Të gjithë këta elementë, para se të përziheshin, kalonin në sitë për të shmangur copat e mëdha dhe për të pasur një shtresë sa më homogjene.

Shtresa e dytë e suvasë, me trashësi rreth 5 mm, përgatitej me përzierjen e gëlqeres me lesh dhie. Leshi i dhisë rrihej me një shufër deri sa të hapej plotësisht dhe pastaj përzihej me gëlqere të kaluar në sitë shumë të imët, deri sa të krijohej një lëndë viskoze. Në stinën e verës, për të ulur tkurrjen e gëlqeres hidhej dhe pak rërë e larë dhe e imët. Një karakteristikë teknike e kësaj suvaje të mbushur me fibra shtazore është që ajo shërben si një shajak i fortë dhe rezistent pasi fibrat shtazore i shtojnë elasticitetin kësaj shtresë. Kjo lloj suvaje përdorej si shtresë e dytë në muraturat e gurit por edhe për suvatimin e çatmave. Në disa raste, në elementët e kësaj shtrese shtohen dhe proteina shtazore.

Në pjesët e dekoruara të muraturës, si p.sh. në oxhakë, përdoret një lloj tjetër suvaje e cila përfitohej nga përzierja e pluhurit të gurit të bardhë dhe të gëlqeres.

Muslluket (sterat e ujit) si dhe pjesë të tjera të godinave, ku kërkohej hidroizolim, suvatoheshin me



Fig. 18. Suva tip horasan

një suva të veçantë që quhet horasan. Për përbërësit e horasanit ka të dhëna të ndryshme, megjithatë, në linjë të përgjithshme mund të themi se kjo suva përbëhet nga dy shtresa me një trashësi totale rreth 3 cm. Shtresa e parë përbëhet nga gëlqere dhe pluhur tulle dhe mbi të aplikohet një shtresë tjetër më e fortë që mund të jetë një përzierje

[7] Raport i Nihad Çengiç, projekt restaurimi, Babameto-monument kulture kategoria e I-rë

DO NOT COPY

DO NOT COPY

me të bardhë vezë dhe vaj ulliri[8].

Metalet

Sigurimi dhe furnizimi:

Materialet metalike, në të shumtën e rasteve siguroheshin nga importi.

Hekuri: Përdorimi më i hershëm i tij është kryesisht pa dyshim për gozhdë, ganxha apo elemente fiksues të dyerve dhe dritareve, etj..

Gozhdët e kovaçit sipas përmasave i kemi si perona apo kollonisho. Të parat janë të vogla, kurse të dytat janë më të mëdha për gozhdimin e kollonave, trarëve të çatisë, etj..

Gjithashtu, zgarat e dritareve, ato metalike përpunoheshin nga kovaçi. Më të vjetrat janë prej druri.

Ullukët kanë qënë të pranishëm që në fazën e parë të



Fig.19. Elementet metalike në fasadat e Pazarit

[8] *Elemente Projektimi, Lagështia; Dritaret*, grup autorësh, botuar në ISP Nr.1 – pa datë botimi

DO NOT COPY

ndërtimit të banesave, pasi ato përdoreshin për grumbullimin dhe përcjelljen e ujit të shiut nëpër stera. Nuk kemi asnjë të dhënë me çfarë materiali kanë qënë ato fillimisht. Sot ato i gjejmë me material llamarinë.

Kangjellat gjithashtu janë elementë të rinj, po ashtu dhe profilet metalike "I" (arkitrarët).

Metali është përdorur për arkitrarët e vitrinave edhe për tarabatë metalike në dyqanet e Pazarit. Gjithashtu, trarët metalikë me profil "I", të ngjashëm me ata të arkitrarëve të cilët kanë lartësi 11-15 cm dhe gjerësi 4.5-6 cm dhe spesor 0.5-0.7 cm janë përdorur dhe për ndërkate apo dysheme të ballkoneve.

Tullat

Tullat janë një material i vonë në Gjirokastër, por ka shumë mundësi të jetë material i importuar nga Evropa perëndimore. Tullat janë përdorur për ndërkate ose për dyshemenë e ballkoneve.

Ato janë me vrima për të qenë të lehta. Skema e kapjes kryesisht është kjo: dy tulla të vendosura me kënd 13-15 gradë dhe në mes një e tretë në formën e çelësit shtrëngues. Kjo njësi qëndron në profile metalikë, të cilët e kufizojnë në të dyja anët e kështu vazhdon me radhë, derisa krijohet dyshemeja (Fig. 20; Fig. 21).

Materiali i gipsit

Është përdorur relativisht pak dhe përgjithësisht në krijimin e oxhakëve dekorative apo dekoracioneve të ndryshme në reliev. Edhe për këtë material nuk ka shumë të dhëna.

Materiali i xhamit

Nuk dihet me saktësi se kur ky material është përdorur në ndërtim (kryesisht dritare). Sipas Prof. Emin Rizës, dritaret fillimisht nuk kanë pasur xham meqënëse ky material ka qenë i kushtueshëm. Me xham me ngjyrë kanë qenë disa dritare të pa hapshme që krijonin një nivel të dytë, të cilat fusnin dritë në brendinë e kthinave (odave) në ditët me mot të keq, kur dritaret mbylleshin me taraba. Si material i kushtueshëm e i shtrenjtë normalisht ka qenë në formate të vogla, kjo dhe për arsye mirëmbajtje, pasi e zëvendësoje kollaj e pa kosto. Nga fotografitë e viteve '20-30 vihet re prania e tij në vetratat e pazarit. Sot nuk trashëgojmë ndonjë vetratë të asaj kohe.

Material - dhé (argjilë apo baltë e zakonshme)

Dheu natyror kryesisht sigurohej ose në kantier ose në kava (si shtresa argjilore midis shtresave të gurit).





Fig. 20; Fig. 21. Hollësi e dyshemesë me konstruksion metalik dhe mbushje me tulla.

Dheu si material përdorej si mbushës, nivelues, në rastin e dyshemeve të shtruara me pllaka guri, i trazuar me gëlqere kokërr të pashuar, si mbushës në rastet e dyshemeve mbi qemerë guri apo edhe në rastin e vatrës (*gjirmes* –Gjr.) së oxhakut, apo si përbërës i llaçeve apo suvave të ndryshme.

Gëlqerja

Gëlqerja është materiali lidhës kryesor. Ajo sigurohej nga procesi i djegie-shkrirjes së gurit natyror gëlqeror në "kamine". Djegia kryhej me dru dhe për një kohë të caktuar. Pas djegies së gurit gëlqeror i shtohet ujë dhe lihet të stazhionohet për një kohë të caktuar. Stazhionimi preferohej mbi tre vjet dhe si ideal shihej një stazhionim 5 vjeçar. Gëlqerja ruhej në gropa të hapura në tokë. Ka qenë traditë që çdo banesë në Gjirokastër, ruante në qypa të mëdhenj të groposur – kryesisht në kopështin pas shtëpisë – sasi gëlqereje e cila përdorej për merremetime apo lyerje të banesës. E kombinuar me pigmente apo dhe e pastër ajo përdorej për lyerje. Ndërkohë që gëlqeren e gjejmë të përdoret në suva, llaç, apo si mbushës nivelues dheu.

Konkluzione

- Njohja e mirë e materialeve dhe teknikave tradicionale ndikon drejtpërdrejt në praktikën restauruese.
- Studimet në këtë fushë kërkojnë një ndërthurje të mirë të praktikës restauruese në terrren me provat laboratorike, si dhe përgatitjen e materialeve të bazuar edhe në praktikën tradicionale.
- Aktivizimi i kavave në pikat tradicionale, për arsye të cilësisë së lëndës së ndërtimit (gurit), planifikimi për lëndën e drurit, gëlqeres etj., ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e restaurimeve.
- Studimet në fushën e materialeve kërkojnë përfshirjen e një spektri më të gjerë specialistësh: inxhinierë ndërtimi, gjeologë, kimistë, biologë – dendrologë, inxhinierë të pyjeve, inxhinierë teknologë e profile të tjerë sipas rastit, veçanërisht në rastin e Gjirokastrës, e cila sot është nën mbrojtjen e UNESCO-s.

Bibliografia

1. Çingic, N., "Analiza e shtresave të bojës dhe punimeve të drurit për banesën e familjes Babameto, Monument i Kategorisë së I-rë, në Gjirokastër, Shqipëri", *Projekti "Gjirokastra 2009-2011"*, porositës: organizata suedeze CHwB.
2. *Elemente Projektimi, Lagështia; Dritaret*, grup autorësh, botuar në ISP Nr.1 – pa datë botimi
3. Ferracuti, P., Ospitali, F., "Studimi i materialeve të përdorura në banesat historike të Gjirokastrës. Alla Scoperta della Citta di Pietra, Il Piano di Ricupero del Centro Storico di Gjirokastra", *Quaderni di Piano,* Nr. 2, a cura di Fabrizio Torrezi, 2006.
4. Kamberi, Th., "Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës gjirokastrite", *Monumentet*, 1971, 2, f. 157-161.
5. Riza, E., *Qyteti - Muze i Gjirokastrës* (monografi), Tiranë, 1981.
6. Riza, E., "Banesa e fortifikuar gjirokastrite", *Monumentet*, 1971, 1, f. 127-149.

DO NOT COPY

Kreshnik MERXHANI
Elena MAMANI

DO NOT COPY

CONSTRUCTION MATERIALS USED IN THE HISTORIC MONUMENTS – GJIROKASTËR

In 2005, Gjirokastra was declared a UNESCO protected site. This fact gives priority to the protection of the town from a general urban point of view. But, upon closer inspection, one can see that the architecture of this city holds other values, as well. One of these values is the use of materials, which reflects the mature, rational and careful decisions made by the master-builders of Gjirokastra.

The city has inherited a considerable number of buildings. A part of them requires immediate conservation, restoration and revitalization. Knowledge of the construction techniques and the materials used in the original construction will make these interventions more accurate and sustainable.

Our work over the past 3 years has consisted in collecting data, documentation and evaluation of several first and second category monuments in Gjirokastra. During these experiences, we encountered various architectural, technical and historical aspects which could be problematic for restoration. The solution to these always required deep knowledge of original building materials and construction techniques. All of this data and experience serve as the basis for our presentation.

Gjirokastra is known as the ''City of Stone,'' but despite one's first impressions, the buildings also make skilful use of wood and iron. Particularly in the case of wood, it is extremely important to understand the types of wood used and the reason why they are used. A mismatched reconstruction could jeopardize not only the character of a historic house but its structural integrity, as well. In this way, we can understand not only how to restore, but also how to conserve and how to maintain these monuments, based on sustainable and scientific data. In the end, this leads to a better appreciation of these monuments and will allow future generations to enjoy them.

monumentet
52/2011 - 2014

Ahilino PALUSHI

DO NOT COPY

AFRESKU NË NARTEKSIN E KISHËS E TËRËSHENJTA E KUKUZELIT NË MANASTIRIN E LAURËS SË MADHE NË MALIN ATHOS (1715)

Të dhëna të përgjithshme mbi monumentin

Kisha e Tërëshenjta e Kukuzelit (Kukuzelica) është e ndërtuar në brendësi të manastirit të Laurës së Madhe në Malin Athos. Sapo hyn në derën e këtij Manastiri, ndërtesa e parë që të shfaqet është kisha në fjalë. Ajo renditet e dyta për nga rëndësia, duke pasuar kështu tempullin qëndror të këtij manastiri (katholikon)*, që i është kushtuar Ungjillëzimit të Virgjëreshës Mari si edhe Shën Athanas Athonitit. Sipas mbishkrimit ktitorik, e Tërëshenjta e Kukuzelit është ndërtuar më 1713[1]. Kisha mban të njëjtin emër me ikonën çudibërëse që sot ndodhet në brëndësi të saj. Sipas traditës gojore, ikona çudibërëse e Shën Mërisë Hyjëlindëse, mori emrin e Tërëshenjta e Kukuzelit[2], për nder të kompozitorit dhe këngëtarit të madh Jan Kukuzeli dhe festohet çdo 1 Tetor, ditë që përkon me fjetjen e kompozitorit.

Nga ana tipologjike, kisha i përket tipit Athonit të ndërtimit, ose në formë kryqi të brendashkruar me kupolë, me apsida anësore dhe me narteks. Kupola qëndron mbi një tambur të lartë e të ngushtë në formë oktagonale nga jashtë (Fig. 1). Katër kolonat që formojnë bërthamën qëndrore janë të ndërtuara me mermer ngjyrë gri. Brendësia ndriçohet nga tetë dritaret e kupolës, nga dritaret e hapura në dy apsidat anësore, si dhe në apsidën qëndrore.

Narteksi ka planimetri drejtkëndore i mbuluar me një kalotë sferike. Ai ndriçohet nga katër dritare të mëdha të zbukuruara me vitrazh, dy në murin verior dhe dy në murin jugor. Dera qendrore është e futur brenda një sipërfaqeje mermeri. Mesa duket, si dera ashtu edhe dritaret janë shtuar me vonë, me qëllim ruajtjen e pikturës së narteksit, e cila sot është në gjëndje të shkëlqyer.

Sipas një mbishkrimi që nuk ka arritur deri në ditët tona, afresket e narteksit të Shën Mërisë së Kukuzelit përcaktohen si të vitit 1715 dhe i atribuohen Davidit të Selenicës[3]. Ndonëse me sipërfaqe të vogël, narteksi i Kukuzelicës zë një vend shumë të rëndësishëm në krijimtarinë e këtij autori, si përsa i përket programit të realizuar, ashtu edhe nivelit të lartë të ekzekutimit artistik. Sapo hyn në narteks, befasohesh nga larmia dhe pasuria e skenave dhe elementëve të përdorura. Hapësira e kufizuar merr një frymëmarrje dhe një vëllim më të madh, falë dekorimit që ka bërë autori, duke shfrytëzuar me mjeshtëri elementin arkitektonik, që i është dhënë. Planimetria rrethore e kapelës, trompat, timpanet, harqet mbajtëse, harqet e dritareve si dhe qemeret e tyre janë zbukuruar me shenjtorë, medalione martirësh, skena të

* Ndodhet në lindje të Kukuzelicës.

[1] Millet, G., "*Recueil des inscriptions chretiennes de l'Athos*", (Paris, 1904), f. 124. Naosi i kësaj kishe është zbukuruar më afresk nga piktori Damaskinos nga Janina më 1719.

[2] Kukuzelica, njihet ndryshe edhe si Portaitisa ose Ikonomisa.

[3] Χατζηδάκης, M., *Έλληνες ζωγράφοι μετά την Άλωση, 1450 - 1830*, με εισαγωγή, Κέντρο Νεοελληνικών Ερευνών, Αθήνα, 1987, 235-236. Piktura murale që zbukuron këtë hapësirë zë vendin e parë ndër afresket që i atribuohen Davidit të Selenicës.

DO NOT COPY

ndryshme statike dhe në lëvizje, që krijojnë midis tyre një ansambël të mrekullueshëm që të bën përshtypje.

Përshkrim i programit ikonografik

Është e qartë që indentifikimi funksional dhe historik në programin ikonografik të narteksit lehtëson leximin e tij nga ana e besimtarit. Për këtë arsye, si kriter bazë i vendosjes së skenave në narteks është interpretimi i Historisë së Shenjtë (Cikli kohor Biblik), duke patur gjithmonë në epiqendër paraqitjen e Krishtit. Kështu, Krishti Fjalë, që në dhjatën e Vjetër është *"Engjëll i Vullnetit të Madh"*, *"Engjëll në Lavdi"* ose *"Më i Moçmi i Ditëve"*, në Dhjatën e Re bëhet Krisht nëpërmjet Mishërimit (Shën Mëria me Krishtin Fëmijë në prehër). Prandaj, dhe *Krishti në Lavdi* (Fig. 2) vendoset qëllimisht në pikën më dominuese, duke zënë një vend të rëndësishëm në programin ikonografik të këtij narteksi. Duke e përdorur këtë paraqitje si një nyje lidhëse, piktori përforcon qëllimin kryesor teologjik të këtij programi që është bashkimi i Dhjatës së Vjetër me Dhjatën e Re[4]. Ky tip i Pantokratorit është i vendosur në mes të dy rrathëve bashkëqendrorë. Anash, në katër kulmet i qëndrojnë Tetramorfët. Në dorë mban një mbishkrim *"Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të eci në errësirë por do të ketë dritën e jetës"* (Joani 8,12). Në kokë mban brerorën e artë me kryqin e pikturuar me ngjyrë të ndritshme fosforeshente, brënda të cilit dallohen qartë të pikturuara me të bardhë germat OωN. Rreth Tij janë paraqitur dy katërkëndësha, të cilët, me zhvendosjen e tyre kanë krijuar një konfiguracion që i ngjan një ylli me tetë cepa. Është e rëndësishme të vihet re që numri 8 ka një kuptim simbolik në traditën shpirtërore Judeo-Kristiane. Shtata është numri i kohës tokësore, është dita e bekuar e pushimit në këtë botë, kurse teta është dita e *"kalimit"* përtej kufijve të kësaj bote.[5]

Përreth Pantokratorit qëndrojnë nëntë Urdhërat Engjëllorë[6]. Urdhrat janë të kufizuara nga një perimetër ku paraqiten shënjat zodiake, ndërsa përreth tyre vijnë të ilustruara Lavdërimet (Psalmet 148,149,150)[7]. Formëzimi në mënyrë të rrjedhshme i figurave është në sinkron me gërmëzimin e çdo vargu. Priftërinj, princa e mbretër, me duar drejtuar drejt *"ujërave përmbi qiej"* lëvdojnë emrin e Zotit (Fig. 3). Centaurë, kinoqefalë, stithoqefalë, sirena, zogj, male me borë dhe shtrëngatë, zjarr dhe breshër, paraqiten me një realizëm të thellë.[8]

Skena më e spikatur në këtë kompozim është padyshim *Vallja e Virgjëreshave* (Fig. 4). Mjeshtri na jep një kompozim me pesëmbëdhjetë figura, të lidhura në mes tyre në një ritëm. Mbreti dhe profeti David qëndron në qendër me harpë në dorë, rrethuar nga djem të rinj që luajnë „me kordhëza e me instrumente", shoqëruar nga goditje të lodrës dhe dajres, ku vajzat ja kanë marrë valles dorë për dore[9]. Udhëheqësi i valles është djalë, kjo është dhe arsyeja që piktori e mban figurën e tij me tone më të errëta. Paraqitja e një djali në krye të "Valles" nga Davidi i Selenicës, pikërisht në paraklisin e Kukuzelicës, në Laurën e Madhe, përbën një rast të veçantë në traditën e pikturimit të kësaj skene në pikturën pasbizantine[10].

Lavdërimet plotësojnë edhe dy trekëndëshat sferikë, përkatësisht atë jugperëndimore dhe veriperëndimore. Sipas profecisë, këtu paraqiten figurat e ushtarëve që duket se personifikojnë ushtrinë e shenjtorëve që ka ardhur për të marrë shpagim dhe për të dhënë ndëshkimin e duhur. Ata vringëllijnë shpatat sipër kokave të mbretërve dhe fisnikëve, të cilët paraqiten të lidhur, kokë, trup e duar, me litarë të trashë[11].

Dy trekëndëshat sferike të tjera janë rezervuar për poetët: Shën Joan Damaskinin dhe Shën Kozmain. Të dy Shenjtorët janë pak a shumë me të njëjtën veshje dhe me

---

[4] Σίσιου. Ι. *"Το πρόγραμμα στον εξωνάρθηκα του Αγίου Γεωργίου Ομορφόκκλησιας-Καστοριάς"*

[5] Hopko, Th., *Besimi Orthodhoks, vëllimi i II, Adhurimi*, Tiranë: Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, 2011, f. 151

[6] Dionisio Da Furna, *Ermeneutica della pittura*, Napoli: Fiorentino Editore, 1971, f. 61

[7] Bibla *"Dhjata e vjetër dhe Dhjata e Re"*, (Tiranë: Shoqata Shqiptare e Biblës, botim 1995), f. 1136

[8] Τούρτα, Α., *Οι ναοί* του *Αγίου Νικολάου* στη *Βίτσα και του Αγίου Μηνά* στο *Μονοδένδρι*, Athens, 1991, f. 131-134; κενταυροι, κινοκεφαλοι, στηθοκεφλοι, γοργονα..etj, centaur, njerëz me kokëqeni, njerëz me kokë në gjoks, sirena etj,…janë kafshët mitologjike që Aleksandri i Madh takon në përçartjet e tij.

[9] Palushi, A., *"Takim me David Selenicën"*, *Kërkim*, nr, 10. Kisha Orthodokse Autoqefale e Shqipërisë, 2013, f.112-117

[10] Παρχαρίδου-Αναγνώστου, Μαγδαληνή: "Ο χορός στη μεταβυζαντινή μνημειακή εκκλησιαστική ζωγραφική", *Αρχαιολογία* 91, 2004, f. 50-58.

[11] Bibla, *Dhjata e vjetër dhe Dhjata e Re, vepër e cit. Psalmi 149-6,7,8,9. ;"për t'i lidhur mbretërit e tyre me zinxhirë dhe fisnikët e tyre me pranga hekuri" "për të zbatuar mbi ta gjykimin e shkruar" "ky është nderi që u rezervohet mbarë shenjtorëve të tij"*

DO NOT COPY

çallmë në kokë, ashtu siç është paraqitja e zakonshme e Shën Joanit nga Damasku. Me mjekra të bardha, të ndarë në dy pjesë, ata janë të ulur në stola para tryezave të tyre të punës. Poshtë tyre, në timpanin e faqes lindore, i cili pozicionohet në brezin e tretë të pikturimit, mbi derën që të çon në naos, zhvillohet tema "*Nga lart profetët*"[12]. Në këtë kompozim, Profetët janë të paraqitur sipas një programi të caktuar në gjysëmfigurë, në medalione që krijohen nga një motiv floreal, me zambakë që shumohen duke dalë nga qendra e njëri-tjetrit. Në qendër paraqitet Mbreti Profet David me kurorë Mbretërore në kokë dhe me tunike të hedhur krahëve në ngjyrë violet të hapur dhe të zbukuruar me motive floreale ngjyrë të bardhë, me mjekër të rrumbullakët dhe me harpë në dorë. Sipër tij ndodhet Mbreti profet Solomon, i ri dhe me kurorë mbretërore në kokë. Bustet e tyre (Mbretërve) shoqërohen nga medalionet e tetë profetëve të tjerë që shpërndahen në mënyrë simetrike, nga katër në çdo krah. Këto figura qendrore shoqërohen edhe nga medalionet e dhjetë profetëve, të cilët janë pikturuar në të gjithë perimetrin e harkut mbajtës, që qarkon timpanin, që sapo përshkruam. Ata janë konceptuar si pjesë përbërëse e të njëjtit kompozim në mënyrë unike në marrëdhënie të ndërsjellë me njëri-tjetrin (Fig. 5). Profetët paralajmërojnë ardhjen e të Përmbishenjtës në *Forma* të ndryshme[13] dhe profetizojnë ardhjen e Krishtit në mish njerëzor nëpërmjet Hyjëlindëses, ndaj dhe paraqitjen e Hyjëlindëses në Fron me Krishtin Fëmijë në prehër e gjejmë të vendosur pranë medalioneve të Tyre.[14] Ky kompozim, siç e përmendëm edhe më sipër, ilustron temën ikonografike "Nga Lart Profetët (*Ανωθεν οι Προφηται*)", e cila e ka marrë këtë emër nga vargjet e para të himnit (tropare) kushtuar Shën Marisë. Ky himn është kënduar që në shek. XII dhe vazhdon të këndohet akoma edhe sot në Malin e Shenjtë ."Nga lart profetët të parashikuan[15]."

Pozicionimi i Shën Marisë me Krishtin Fëmijë zë një sipërfaqe të madhe, e cila merr trajtën e një "apside të verbër", duke e evidentuar në këtë mënyrë paraqitjen e Saj në qendër të gjithë skenave që mbulojnë faqen ballore (lindore), mbi derën që të çon në tempull. Anash i qëndrojnë dy kryeengjëj, të cilët përulen me krahë të kryqëzuar mbi gjoks. Ata mbajnë veshje të oborrit mbretëror dhe përulja e tyre kërkon të theksojë idenë e paraqitjes së Hyjëlindëses si Sunduese e Qiejve.

Po në faqen lindore, në qendër të një harku të dekoruar me medalione martirësh që mbyll nga lart temën (timpanin) "Nga lart Profetët", mes të dy trompave ku paraqiten dy Poetët kompozitorë (Shën Joan Damaskini dhe Shën Kozmai) është pikturuar *Mandili i Shenjtë*. Ky imazh, "që nuk është bërë nga duart e njeriut", ose ndryshe "imazhi i Zotit në pëlhurë (shami) që vendin qendror ndër imazhet e Krishtit. Ai na jepet me mjekër të plotë, gjithësesi të ndarë në mes, e me flokë të gjatë me onde që i derdhen në të dy krahët. Në brerorën që rrethon kokën e Tij, si gjithmonë, paraqitet shenja e kryqit. Në krahët e tij ndodhen gërmat O ωN. Në të dy anët e brerores jepen gërmat IC dhe XC –Jesu Krisht. Shamia mbi të cilën është stampuar portreti i Krishtit është e bardhë dhe e dekoruar me motive floreale.

Mandili është një interpretim autentik dhe i padiskutueshëm i Mishërimit Hyjnor[16]. Për këtë arsye në Kukuzelica, pozicionimi në narteks nga ana e Davidit është i vendosur lart, i lidhur me kupolën (kalota sferike e

[12] "Το εικονογραφημένο θέμα «*Άνωθεν οι προφήται*» σε τοιχογραφία της Μεγίστης Λαύρας του Αγίου Όρους. Νικόλαος Δρανδ΄΄ακης, *Δελτίον XAE* 20 (1998), Περίοδος Δ'. Στη μνήμη του Δημητρίου Ι. Πάλλα (1907-1995), Αθηνα ,1999, f. 195-200

[13] Herë në formën e Arkës së Shenjtë (David, psalmi 131:8), herë si shtëpi me shtatë shtylla (Solomoni. Fjalët e Urta, 9:1), herë si mashë që merr thëngjillin (Isaia 6:6), si shkalla e Jakobit, si Deti i Kuq apo si Mal i Pagërmuar (Daniel 2:34), etj.

[14] Dionisio Da Furna, *vepër e cit.*, f. 128 ."Intorno al nartece.-…fai la Madona con il Bambino ed angeli che la sorreggono e, piu in basso, tutt'intorno i profeti..." (Në narteks ….pikturo Shën Marinë me Foshnjën dhe engjëjt që i qëndrojnë përkrah dhe pak më poshtë, rreth e qark profetët).

[15] Ξυγγόπουλος, Ά., *Μονσεῖον Μπενάκη,* Κατάλογος τών εικόνων, έν Αθήναις 1936, f. 50. Τό τροπάριον έχει ώς έξης (ο.π., σ.49-50): «*Ανωθεν οι Προφήται σε προκατήγγειλαν, στάμνον, ράβδον, πλάκα, κιβωτόν, λυχνίαν, τράπεζαν, ορός άλατόμητον, χρυσοϋν θυμιατήριον καί σκηνήν, πύλην άοιόόεντον, παλάτιον καί κλίμακα καί θρόνον τον βασιλέως*» (Nga lart Profetët të parashikuan, shtambë, pjatë, arkë, pishtar, barrakë, mal i pagërmuar, tabernakull, portë, pallat dhe shkallë e fron mbretëror)

[16] Παπαδακη-Oekland Στ., "Το Αγιο Μανδηλιο ως το νεο συμβολοσε ενα αρχαιο εικονογραφικο σχημα" *Δελτιον XAE* 14 (1987-1988), Περιοδος Δ', Αθηνα 1989, f. 283-296; Kjo simbolikë dikton paraqitjen e tij në vënde të tilla specifike në tempujt me kube në mes të dy pjesëve, të cilat përfaqësojnë mbretëritë tokësore dhe qiellore. Kjo është më e qartë në rastin e kishave pa kube (monumentet Kretezë) ku dimensionet dhe format arkitektonike të këtyre tempujve imponuan transferimin e këtij imazhi në timpanin e murit lindor. Këtu Mandili përfshihet në një cikël temash, të cilat, në tërësi, i referohen idesë së Mishërimit Hyjnor e nëpërmjet tij shpëtimit të njerëzimit.

DO NOT COPY

narteksit) pikërisht në faqen lindore, jo rastësisht i shoqëruar me disa tema të tjera përreth (Shën Maria me Krishtin Fëmijë, Ungjillëzimi) dhe i alternuar me elemente të tjera ikonografike (edhe këta të zhvendosur nga programi i zakonshëm nga naosi në narteks), të cilët janë pozicionuar këtu në shërbim të simbolikës së përgjithshme.

Mbi hyrjen për në narteks, e cila është njëkohësisht dhe hyrja e vetme kryesore për në kishë, në murin (timpanin) perëndimor është e pikturuar skena e *Sinodit të parë Ekumenik*. Në qëndër të kompozimit paraqitet Perandori Kostandin. Ai qëndron i ulur në Fron, i veshur me rrobën mbreterore ngjyrë të kuqe si simbol i sundimit, zbukuruar me kordona ngjyrë ari, me Mitrën mbretërore në kokë dhe me flokë të gjatë, shenjë kjo e sundimtarëve civilë në kohët e para. Në dorë shtrëngon *"Bastunin Baritor"*që tregon pushtetin e tij sekular. Në të dy krahët e tij qëndrojnë të ulur disa prelatë shenjtorë. Ata paraqiten me veshje priftërore, me sako me mitra dhe me omoforet e zbukuruara me kryqe të mëdhenj. Në krah të majtë të Perandorit, i ngritur në këmbë është Shën Spiridhoni i veshur me sako të zbukuruar me motiv të mbingarkuar kryqesh të thjeshtë dhe kryqe brenda rrathësh të pikturuar në siena, me mbimëngë dhe me omoforin ngjyrë të bardhë me kryqe të mëdhenj po në kafe siena. Në kokë mban *"kidarisin"*e famshëm, kapelen e tij karakteristike, e cila është e thurur me gjethe palme. Ai na jepet pikërisht në momentin kur kryen mrekullinë, kur shpërbën një tjegull në tre komponentët përbërës të saj, baltë, ujë, zjarr, për t'u paraqitur "Arianëve" heretikë në mënyrë të dukshme dogmën e Shën Trinisë (Një Substancë por tre Hypostaza - Persona).

Në pjesën e poshtme të këtij kompozimi, pikërisht poshtë këmbëve të etërve të kishës, kemi një sipërfaqe horizontale të suvatuar rishtazi, ku kohë më parë ndoshta ekzistonte mbishkrimi i *"Davidit ngaVlora"*, tashmë i zhdukur plotësisht. Ky duhet të ishte vëndi ku sipas skemës së zakonshme duhej të ishte i vendosur Ariosi, i vetëm ose bashkë me heretikë të tjerë dishepuj të tij, por këtë situatë autori na e zgjidh me mjeshtëri duke na e zhvendosur ngjarjen në pjesën e sipërme të kompozimit. Për të thelluar më tepër idenë e kësaj kontradikte të fillim shekullit të IV, mbi figurën e perandorit Kostandin, brenda të njëjtit kompozim, me një lidhje të natyrshme, Davidi ilustron *"Vizionin e Pjetrit të Aleksandrisë"*[17] dhe *"Më i Moçmi i Ditëve"*. Vendosja e Tij në pikën më të lartë të kompozimit i mëshon parimit themelor që u mbrojt në Sinodin e Parë; Krishti Fjalë (Logos Shekullor), që ka ekzistuar përmes kohëve, vjen për t'u Mishëruar në trup njerëzor.

Në faqen veriore të narteksit, në qendër të një kordoni me medalione martirësh, që zbukuron anën ballore te harkut mbajtës, mbi skenën e "Hardhisë", qëndron medalioni me paraqitjen e *Krishtit Emanuel*. Ai paraqitet gjysëm figurë, me ballë të gjërë. me flokë të shkurtër me onde, duke bekuar me dorën e djathtë dhe duke mbajtur një pergamenë në të majtën. Veshja e tij është e tëra në një ngjyrë (të artë). Mbrapa Tij, për të dhënë idenë e një *" lavdije rrezatuese"* është pikturuar një diell me rreze që shpërndahen ngado, në pjesën e sipërme të të cilit është shkruar në mënyrë simetrike ndarë në dy pjesë ΕΜΜΑ-ΝΟΥΗΛ.

Timpani verior është rezervuar për subjektin e *Hardhisë*. Nga baza qëndrore "Trungu", shpërndahen në mënyrë spirale degët e hardhisë që rrethojnë bustet e Apostujve, duke krijuar kështu 12 medaljone, ndërsa në mes tyre Krishti bekon me të dy duart. Në brenda të cilëve janë gërmat ΟωΝ, ndërsa në prehër mban ungjillin të hapur duke predikuar. Kjo mënyrë paraqitjeje është interpretim simbolik që ilustron pasazhin e Ungjillor Joanit *"Unë jam Hardhia, dhe ju jeni degët"* (Joani 15:1) dhe aludon në mënyrë të veçantë mbi misterin e *"Eukaristisë"*, simboli i bashkëpërjetimit me Perëndinë[18].

Figura e Krishtit në këtë paraqitje është pikturuar me tone të ngrohta. Me veshje në një ngjyrë, e tëra në kafe të çelët dhe me linjat e palave të thelluara me kafe më të errët. Kjo e ka evidentuar mjaft mirë figurën qendrore në raport me figurat e tjera, që e rrethojnë dhe sfondin, të cilat në përgjithësi janë trajtuar nga piktori në tone të ftohta. Gërmat e zeza të shkrimit të shenjtë (që mban Krishti në prehër) lexohen mjaft mirë mbi ngjyrën e bardhë të faqeve të librit, i cili ndahet me të kafenjtën e çelur të rrobes nga shirita ngjyrë violetë të çelur.

---

[17] Sipas këtij jetëndërrimi, Aleksandri, Kryepeshkopi i Aleksandrisë, pa në ëndërr Krishtin me hiton të grisur dhe e pyeti *«Zot kush ta ka grisur rrobën?"*. Dhe Ai ju përgjigj: *«Arius i mallkuar"*.

[18] "Απο τι Σαρκωση του Λογου στη Θεωση του Ανθρωπου", *Βυζαντινες και Μεταβυζαντινες Εικονες απο την Ελλαδα*, Αθήνα; 2008, f. 98, kap 44: *«Ο Χριστός Η Αμπέλος»* . Krijimi i këtij prototipi i atribuohet piktorit ikonograf të njohur nga Kreta, Angjelos Akotanto.

DO NOT COPY

Krishti *si Engjëll i Vullnetit të Madh* është i vendosur në mënyrë simetrike me medalionin e Krishtit Emanuel, në qendër të një kordoni me medalione martirësh, që zbukurojnë ballin e harkut tjetër mbajtës, që ndodhet mbi skenën "Martirizimi i Shën Stefanit, në faqen jugore të narteksit. Skenat me paraqitjen dhe martirizimin e *Martirit të parë të Krishtit, kryedhjakon Stefanit,* zënë gati gjithë faqen jugore. *"Rrëfimi"* mbi jetën, veprën dhe martirizimin e Shenjtit të ri është konceptuar nga piktori i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e poshtme, midis dy dritareve, Shën Stefani na paraqitet gati në trajtë engjëllore. I lehtë, në një lëvizje që të kujton kryeengjëjt në mision, i mbushur me një *"rrezëllim të brendshëm",* duket sikur fluturon. Me majat e gishtave ai vetëm sa prek fare pak tokën gjatë rendjes së tij për të përmbushur misionin e shenjtë. Mbi trup i qëndron hijshëm stihari karakteristik i dhjakonit, i pikturuar në ngjyrë të bardhë dhe i zbukuruar me elemente dekorative e floreale. Në dorën e djathtë mban temjanicën, që simbolizon ngjitjen lart të lutjes tonë shpirtërore (tymi) dhe i aromës së mirë të Mbretërisë së Perëndisë (era e temjanit) ndërsa në të majtën mban simbolin e Kishës së parë të Krishterë, vendi i banimit të Perëndisë bashkë me njeriun.

Në pjesën e sipërme (timpani jugor) kemi të realizuar një kompozim me dy skena dhe me shumë figura. Në krahun e djathtë është martirizimi i Shën Stefanit. Të bie në sy ekspresiviteti me të cilin piktori ka trajtuar turmën, e cila, në ekstazë, godet martirin e ri me gurë, sy të zgurdulluar djemsh të rinj që mbushin e rimbushin duart me gurë për të goditur pa mëshirë dhjakonin e ri, i cili ka rënë në gjunjë duke iu lutur Zotit t'i falë për papërgjegjshmërinë e tyre (Fig. 6). Majtas, mbrapa figurave që qëllojnë me gurë, ilustrohet një skenë tjetër martirizimi[19]. I ulur në gjunjë, në pozicion lutjeje në momentin e ekzekutimit të tij, na paraqitet një shenjt i paidentifikuar.

Vend të rëndësishëm në paraqitjen e programit ikonografik të përdorur për zbukurimin e këtij narteksi kanë edhe skenat me "*mrekullitë e Shën Athanas Athonitit.*" Ato zënë komplet brezin e dytë të pikturimit në murin lindor të litit (narteksit), pikërisht mbi derën që të çon në naos, duke përfshirë në vetvete dhe Paraqitjen e Shën Marisë me Krishtin Fëmijë në prehër. Kjo vendosje nuk është e rastësishme, përkundrazi, mendojmë që piktori i ka ndërthurur këto paraqitje me qëllim, duke marrë për bazë shkrimet e shenjta, ku rrëfehet që e Tërëshenjta i është shfaqur disa herë Shenjtit në momentet më të vështira. Këto aspekte nga jeta e Shën Athanas Athonitit janë ilustruar nga piktori, duke u ndarë në katër skena. Mendojmë se ato janë ilustruar në mënyrë kronologjike ashtu siç edhe janë pasqyruar në shkrimet e shenjta mbi jetën e shenjtorit[20].

Lajmërimi, si skenë udhëheqëse në përfaqësimin e ciklit Kristologjik dhe të Shën Marisë, zë thuajse gjithë brezin e parë të pikturimit në faqen lindore të narteksit[21]. Kjo shfaqje është e ndarë në dy pjesë, me dy protagonistët e saj: Kryeengjëllin Gabriel dhe Shën Marinë, të vendosur në të majtë dhe në të djathtë të hyrjes për në tempull. Kryeengjëlli Gabriel përcjell i gëzuar Lajmin, duke ardhur nga e majta, me një hap të gjatë, energjik e me veshje që valviten nga era, duke krijuar ndjesinë e një lëvizjeje të fuqishme. Në dorën e majtë mban shkopin e Lajmëtarit (të Dërguarit), ndërsa të djathtën e shtrin përpara me një xhest bekimi, që i drejtohet Virgjëreshës. Në dy skajet fundore të dy paneleve, në pjesën e sipërme, mbrapa Kryeengjëllit dhe Virgjëreshës, dallojmë bustet e Profetit David (në të majtë) dhe Profetit Isaia (në të djathtë). Shkrimi në greqisht me gërma të bardha mbi sfond të errët është ndarë në dy krahët Ο ΕΥΑΓΓΕ---ΛΙCΜΟC.

Në narteksin e kishës së Shën Marisë së Kukuzelit gjendet edhe një cikël nga Apokalipsi (Zbulesa). Ai është relativisht i kufizuar, i përbërë nga një grup (seri) prej shtatë skenash, të cilat zënë sipërfaqet e harqeve mbajtëse jugore dhe veriore, mbi të cilat mbështetet kalota sferike e narteksit të kësaj kishe. Forma tregimtare e tyre është e thjeshtë, duke drejtuar paralelisht vështrimin e besimtarit nga e majta në të djathtë, sipas një rradhe të caktuar nga perëndimi drejt lindjes. Ky Cikël renditet i katërti në vargun kohor të cikleve Athonitë dhe i pari ndër pesë ciklet e realizuara në shek. XVIII[22].

[19] Skenat e martirizimit nuk janë pjesë e të njëjtit kompozim. Ato paraqesin dy momente të veçanta.

[20] *Thesari i Shenjtorëve "Athanas Athoniti"*, Tiranë, 2004, Botim i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, f. 5.

[21] Βαραλής, Ιωάννης, «Παρατηρήησεις για τη θέση του Ευαγγελισμού στη μνημειακή ζωγραφική κατά τη μεσοβυζαντινή περίοδο», *Δελτίον ΧΑΕ* 19, 1996-1997, Περίοδος Δ, Αθήνα, 1997, f. 201-220.

[22] Shih: Τσιμπουκης, Δ.Γ., "Η Αποκάλυψη του Ιωάννη στη Μνημειακή ζωγραφική του Αγίου Όρους." *Μονή Μέγιστης Λάυρας-Παρεκκλήσιο Παναγίας Πορταιτισσας (Κουκουζέλισσας), Νάρθηκας 1715*", Αθηνα, 2013, f. 40-61

Piktura murale në paraklisin e Shën Marisë së Kukuzelit plotësohet me paraqitjen e busteve të shenjtorëve në medalione, të shenjtorëve stilitë (ndodhen në dy niket në faqen lindore) dhe të shenjtorëve asketë, që zbukurojnë qemeret e katër dritareve të narteksit (Shën Pjetër Athoniti, Shën Efthimi, Shën Theofan Himnografi, Shën Pavlo Thivioti, Shën Pavlo i Qeropotamit). Bustet e martirëve në medalione janë të rrethuara nga një motiv i dendur bimor dhe formojnë një kordon dekorativ, që përshkon gjithë perimetrin e paraklisit. Siç vërejmë, edhe në monumente të tjerë, vendosja e një kordoni me medalione me buste shenjtorësh të rrethuara me elemente floreale të rënduara, që shoqëron gjithë perimetrin e dekorimit, përbën një karakteristikë në punën e Davidit, por, në narteksin e Kukuzelicës, mënyra se si ato përdoren për të qarkuar harqet e mëdha në të katër faqet e murit, i japin më shumë ritëm dhe shprehje skenave, duke krijuar në këtë mënyrë një atmosferë më të gjallë dhe njëkohësisht iluzionin e një hapësire më të gjerë.

Davidi reflekton në Lavra sigurinë, kulturën teologjike dhe kualitetin teknik të një piktori të shkathët e të aftë. Besimi që i është dhënë atij për të dekoruar kapelën e Kukuzelicës nga murgjit e manastirit të Lavrës së madhe, domosdoshmërisht është bazuar mbi kriterin e të qënit një piktor agjiograf me përvojë. Tek Davidi, ndikimi i pashmangshëm i realitetit Athonit, i pikturës monumentale të Protatonit, i Manuel Panselinos, i fundit të shek. XIII, por edhe i pikturës së Katholikonit të manastirit të Lavrës së Madhe, ku kanë lënë afresket me mbishkrimet e tyre Theofani dhe Frango Katelano, gjetën me siguri një bazament të formuar artistik nga njëra anë dhe nga ana tjetër ndikuan në alternimin e teknikave të ndryshme artistike në punën e tij në të ardhmen.

DO NOT COPY

Ahilino PALUSHI

DO NOT COPY

THE FRESCO IN THE NARTHEX OF THE HOLY CHURCH OF KUKUZELI, IN THE MONASTERY OF GREAT LAWRA, MOUNT ATHOS (1715)

The Holy Church of Kukuzeli is built within the Monastery of Great Lawra. It ranks the second from the importance, following in this way the central temple of this monastery. From the tipological point of view, the church belongs to the Athonit type of construction. It is an instilled cross temple, with a dome and a narthex. Narthex is of a rectangular shape and covered by a dome. It is enlighted from four big windows decorated with vitreous, two on the northern wall and two on the southern one. According to the inscription which did not reach our days, narthex frescos are defined as of year 1715 and are attributed to the painter David from Selenica. The mural picture of the Holy Church of Kukuzeli takes the first place among the frescoes attributed to David from Selenica. The trust given to him to decorate the Kukuzelica chapel by the monks of Great Lawra Monastery necessarily is based on the criteria of being an experienced ageograph painter. In Lawra, David reflects the confidence, theological culture and the technical quality of a capable and an agile painter. In David, the indespansible impact of Athonit reality, of monumental painting of Protaton but also of Catholicon painting of Great Laura monastery where have left their frescoes with inscriptions Theophan and Frango Katelano, certainly found a formed artistic basement, from one side and on the other side influenced the alternation of different artistic technics in his work.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1. Faqe Jugore



Fig. 2. Krishti në Lavdi



Fig. 3. Lavdërimet (Kinoqefal etj.).

DO NOT COPY



Fig. 4. Vallja e Virgjëreshave



Fig. 5. Shën Mëria me Krishtin Fëmijë



Fig. 6. Martirizimi i Sh. Stefanit

monumentet
52/2011 - 2014

DO NOT COPY

Blerina TOÇI

MENDIME MBI PËRDORIMIN E ORDRIT DORIK TETËKËNDËSH NË APOLONI

Një nga aspektet më interesante të dekorit arkitektonik në Apoloni është ordri dorik tetëkëndësh[1].

Ordri dorik tetëkëndësh në Apoloni është i dokumentuar në stoanë me 17 nishe, ku ruhen shtatë fragmente nga tamburet e kolonave (Fig. 2-9) dhe një kapitel i fragmentuar (Fig. 1).

Dy tambure të tjera tetëkëndëshe gjenden në tempullin e Dianës (Fig. 10), nga ku edhe kanë dalë gjatë gërmimeve dhe një tjetër fragment gjendet në oborrin e manastirit të Shën Mërisë, në të majtë të hyrjes perëndimore të kishës (Fig. 11).

Tambure të tjera kolonash tetëkëndëshe, që me shumë mundësi e kanë prejardhjen nga Apolonia gjenden në oborrin e manastirit të Shën Kozmait në rrethinat e Fierit[2] (Fig. 12-13).

Duke qenë se stoa me 17 nishe është i vetmi monument ku kolonat tetëkëndëshe ndodhen në kontekstin e tyre urbanistik, do të prezantohet këtu një përshkrim i shkurtër i kësaj ndërtese.

Stoa me 17 nishe

Stoa me 17 nishe është një portik i gjatë drejtkëndor me dy anijata, ku muri fundor përbëhet nga 17 nishe në formë absidash. Ndërtesa ndodhet në shpatin veri perëndimor të kodrës 104 dhe ka shtrirje veri-perëndim jug-lindje. Stoa ka dalë në dritë nga gërmimet e bëra nga Leon Rey gjatë viteve 1925-1927[3]. Gërmime me qëllim nxjerrjen në dritë plotësisht të murit që shtrihet përballë stoasë, për gjithë gjatësinë e tij, janë bërë nga arkeologë shqiptarë gjatë vitit 1951[4]. Monumenti është ndërtuar me blloqe guri gëlqeror të bardhë dhe të fosilizuar.

Fasada e ndërtesës është 78,20 m e gjatë ndërsa muri fundor është 76,10 m i gjatë. Kjo pasi muri fundor në anët hapet me kënd më të gjerë se 90°. Gjerësia e stoasë është 10,5 m deri në ballin e murit të pasëm dhe 12 m deri në fundin e nikeve. Stoaja është e mbyllur në dy anët dhe ka pasur dy kate[5]. Largësia bosht në bosht, ndërmjet rrjeshtave të kolonave dhe rrjeshtit të brendshëm e ballit të murit të pasëm, është përkatësisht 5,35 m dhe 4,75 m. Çdo mesi nikeje dhe pilastri të murit të pasëm i përgjigjeshin një kolonadë e brendshme dhe një e jashtme. Interkolumni, si në rrjeshtin e brendshëm ashtu dhe të jashtmin është 2,10-2,20 m, më shpesh 2,15 m, ndërsa hapësira e dritës 1,60 m. Kollonat e rrjeshtit të jashtëm ngrihen drejt e mbi stilobat, ndërsa ato të rrjeshtit të brendshëm mbi bazamente katrore

1 Do flitet për ordër dorik pasi struktura e elementeve përbërës (kolonë, kapitel) është e ngjashme me ordrin dorik normal. Do të përdoret, gjithashtu, emri kolona dhe jo pilastra pasi fragmentet paraqesin një ngushtim drejt ngjitjes.

2 Në ambientet e këtij manastiri gjenden fragmente të ndryshme skulpturore dhe arkitekturore që mendohet se vijnë nga Apolonia.

3 Rey, L., "Fouilles de la Mission Française a Apollonie d'Illyrie", *Albania. Reveu d'archeologie, d'histoire, d'art et des sciences appliquées en Albanie et dans les Balkans*, Paris, 1928, f. 13-31.

4 Gërmimet nuk janë botuar por informacione mbi to gjenden në Arkivin e Institutit Arkeologjik në Tiranë, në raportin e vitit 1951 për Apoloninë.

5 Baçe, A., Ceka, N., "Shëtitoret e periudhës qytetare në Iliri", *Monumentet*, 1981, 22, f. 15.

DO NOT COPY

prej blloqesh guri (84 x 84 x 16 cm), të cilët kanë për themel blloqe të tjerë guri ranor, paksa më të mëdhenj, me faqet anësore të çrregullta[6]. Ballina e katit të sipërm ka qenë e dekoruar me gjysmë kolona jonike të aplikuara në pilastër.

Kolonat tetëkëndëshe të stoasë me 17 nishe kanë prerjen e një tetëkëndëshi të rregullt, i cili i brendashkruhet një rrethi. Guri i përdorur është gëlqeror i fosilizuar, me ngjyrë të bardhë dhe grimca të vogla shumë kompakte. Faqet e kolonave ruajnë gjurmët e gradinave dhe nuk kanë marrë lëmimin përfundimtar. Vetëm katër nga tamburet që gjenden në stoa ruajnë lartësinë e tyre të plotë, ndërsa tre të tjerët na ruhen të fragmentuar. Në njërin prej tambureve ruhen dy shkronja greke të mëdha (Fig. 7), të cilat kanë shërbyer për të treguar vendosjen e saj brenda ndërtesës. Duke pasur prerjen e një tetëkëndëshi të rregullt, kolonat e Apolonisë mund të krahasohen me shembujt që na vijnë nga Peloponezi dhe Atika[7] të cilët i përkasin periudhave më të vjetra. Por, përmasat e kolonave lidhen ngushtë me ato të Bylisit dhe Nikaias, ku edhe përdorimi i tyre në arkitekturë është i njëjtë. Kapiteli i Apolonisë veçohet nga kapitelet e dëshmuara në qytetet e tjera për praninë e një torusi që ndan ehinin nga qaforja.

Ordri dorik tetëkëndësh është një veçanti e arkitekturës antike greke. Prandaj për të kuptuar më mirë përdorimin e ordrit dorik tetëkëndësh të dokumentuar Apoloni do jepet një përmbledhje e përdorimit të tij, brenda kësaj arkitekture.

Kolonat dhe pilastrat tetëkëndëshe janë dëshmuar gjerë në arkitekturën greke[8]. Përdorimi i tyre dëshmohet që në periudhën arkaike por përqëndrimin më të madh e gjejmë gjatë helenizmit.

Periudha arkaike dhe klasike

Është vërejtur se gjatë periudhës arkaike kolonat dhe pilastrat tetëkëndësh kanë gjetur përdorim arkitektonik në ndërtesa laike, siç janë propyletë në sanktuarin e Afaias në Eginë e në sanktuarit e Poseidonit në Kalaureia[9] dhe në çisterna, ku i shohim të përdorura në fontanën e Glauces në Korint të datuar në gjysmën e dytë të shek. VI p. Kr.[10] dhe në fontanën e Megarës të datuar në fillim të shek. V p. Kr. [11], ku kolonat tetëkëndëshe me kapitele përkatëse do të përdoren në brendi të rezervuarit.

Tjetër përdorim duket se ka pasur një kolonë me përmasa të konsiderueshme (L. 3,5 cm; DP 71,5 cm; DS 65 cm) me një mbishkrim funerar arkaik, e cila është gjetur e ripërdorur në një çisternë në Troizen[12]. Një tjetër dëshmi që i është atribuar periudhës arkaike vjen nga Hymetos në Atikë. Këtu janë gjetur një sërë kolonash tetëkëndëshe të cilat nga zbuluesi i tyre janë menduar se i përkisnin njërit nga tempujt e sanktuarit të Zeus Ombrios dhe Apolo Proopsion dhe janë datuar në fundin e shek. VI-V p. Kr.. Ky interpretim dhe datimi i tyre është vënë në dyshim nga Hellner pasi nuk ka të dhëna të sigurta dhe të mjaftueshme.

Shembujt të tjerë të periudhës arkaike i përkisnin përdorimit të tyre si mbajtës ofertash. Nga akropoli i Athinës janë dokumentuar katër pilastra tetëkëndëshe që kanë shërbyer si mbajtës ofertash dhe janë datuar para vitit 500 p. Kr.[13]. Me të njëjtin funksion prezantohen edhe katër fragmente të tjera nga sanktuari i Afaias në Eginë[14] dhe një fragment nga Argos[15] i gjetur në perëndim të tempullit klasik të Heras[16].

Nga periudha klasike kemi vetëm një shembull nga Stoa

6 Baçe, A., Ceka, N., *Vep. cit.,* f. 15.

7 Do sillen më poshtë shembujt e përdorimit të kolonave tetëkëndëshe në arkitekturën greke.

8 Hellner, N., "**Überlegungen zu achteckigen Stützen in der antiken griechischen Architektur**», *Revue Archéologique*, Nr. 52, 2011, f. 227-262. Në këtë artikull është bërë një përmbledhje e të gjithë dëshmive mbi kolonat dhe kapitelet tetëkëndëshe. Artikulli merr nismë nga gjetja e një baze të plotë dhe disa gjysmëbazash tetëkëndëshe prej guri në Kalapodi. Autori mendon se pilastrat mbi baza duhet të ishin prej druri dhe trajton në këtë artikull prejardhjen e kolonave dhe pilastrave tetëkëndëshe. Artikulli ofron një përmbledhje të të gjithë dëshmive në fragmentet tetëkëndëshe dhe një përshkrim të përqendruar në dhënien e përmasave.

9 Hellner e radhit këtë shembull mes atyre klasike dhe helenistike, por tempulli i Poseidonit në Kalaureia, bashkë me temenosin e tij ku propyletë bënin pjesë, është datuar nga zbuluesit e tij, por edhe autorë të tjerë (Carpenter J. R., *The propylon in greek and Hellenistic Architecture*, Ph.D. Diss. University of Pennsylvania, 1970, f. 64; Wegner 1965, EAA), në fund të shek. VI p. Kr..

10 Hellner e ka radhitur atë në shembujt helenistike në artikullin e tij por autori nuk sjell të dhëna kronologjike, Hellner, N., *Vep. cit.,* f. 250. Ndërkohë që Elderkin që ka botuar në mënyrë të detajuar fontanën, e ka datuar atë në të njëjtën kohë me tempullin e Apolos, d.m.th. në gjysmën e dytë të shek. VI p. Kr. dhe mendon se janë pjesë e të njëjtit program ndërtimor, Elderkin G. W. "The Fountain of Glauce at Corinth", *AJA*, 14, 1910, f. 24.

11 Hellner, N., *Vep. cit.,* f. 235.

12 Welter, G., *Troizen und Kalaureia*, Berlin, 1941, f. 39-40, fig. 22 b-d; Hellner, N., *Vep. cit.,*f. 242, Fig. 13.

13 Hellner, N., *Vep. cit.,* f. 236.

14 Furtwängler, A., Et al., *Aegina, Das Heilingtum der Aphaia.* München 1906, f. 85, Tab. 68; Hellner, N., *Vep. cit.,* f. 240, Fig. 10.

15 Hellner, N., *Vep. cit.,* f. 241-242, Fig. 12a-c.

16 Waldstein, Ch., The Argive Heraeum, 1902, f. 42, Fig. 15, f. 139, Fig. 70.

e Brauron, e cila daton 425-416 p. Kr.[17]. Një fragment kolone tetëkëndëshe është gjetur në portikun e ofertave, të cilin Bouras e ka rindërtuar në mënyrë hipotetike me kolona tetëkëndëshe[18].

Siç shihet, dëshmitë e përdorimit të kolonave dhe pilastrave tetëkëndësh nga periudha arkaike dhe ajo klasike na vijnë nga Atika dhe Peloponezi.

Periudha helenistike

Në periudhën helenistike përdorimi i kolonave dhe pilastrave tetëkëndëshe në arkitekturë gjen përhapje të gjerë. Nga fundi i shek. IV p. Kr. kemi vetëm dy dëshmi nga Peleponezi. Kavvadias ka gjetur pranë stoasë në perëndim të Abatonit, në sanktuarin e Asklepit, një kapitel me qafore tetëkëndëshe, në bazë të të cilit ka rindërtuar me kolona tetëkëndëshe kolonadën e mesit, të katit të poshtëm të stoasë. Stoa në perëndim të abatonit është datuar në fund të shek. IV p. Kr.. Një shembull tjetër na vjen nga Nemea, ku pranë ambienteve të ksenonit (ambiente hotelerie) janë gjetur tre fragmente kolonash dhe një kapitel tetëkëndësh. Ksenoni është ndërtuar me fragmente të ripërdorura dhe është datuar në 30 vjeçarin e fundit të shek. IV p. Kr.[19].

Një tjetër dëshmi mbi përdorimin e kolonave tetëkëndëshe nga Peleponezi vjen nga Kromna (Korinthia), por një informacion mbi vendgjetjen e saktë, përdorimin në arkitekturë dhe dokumentimin e tyre mungon, prandaj vlen këtu vetëm si shembull numerik.

Edhe pse shembujt e sapo përmendur nuk janë shumë të qartë në strukturën e tyre, vihet re se përdorimi i tyre në arkitekturë ka ndryshuar. Tani ordrin dorik tetëkëndësh e gjejmë në stoa dhe në ambientet private të një ksenoni. Doja ta vija në dukje këtë fakt pasi do të shikohet më poshtë se në periudhën kur ky ordër do të gjejë përhapjen e tij më të madhe në arkitekturë, duket se arkitektët e kanë tashmë të qartë se ku duhet të përdoreshin këto lloj kolonash apo pilastrash.

Shekulli i III p. Kr. është periudha kur ordri dorik tetëkëndësh gjen përhapjen më të madhe në arkitekturë dhe përdorimi i tij gjatë këtij shekulli është dëshmuar më së shumti në Epir dhe Ilirinë e Jugut. Duke qenë se shembujt janë të shumtë do t'i paraqes këtu me radhë duke filluar nga Epiri dhe më pas do të ndalem mbi disa vërejtje mbi përdorimin e tyre.

Dodona

Në Dodona, pranë *naiskos* L, të quajtur edhe tempulli i Afërditës, janë gjetur dy kolona tetëkëndëshe me prerje të përzgjatur, të vendosura in antis. Zbuluesi i tyre e ka datuar *naiskos* L në fund të shek. IV-fillimi i shek. III p. Kr.[20], ndërkohë që autorët e tjerë e kërkojnë datimin e saj në fund të shek. III p. Kr.[21]. Kolona dorike tetëkëndëshe janë gjetur në Dodona edhe në stoanë prapa skenës së teatrit. Gjetje të tjera vijnë nga stoa prapa skenës së teatrit, e datuar nga Dakaris në fazën e parë të ndërtimit të teatrit, d.m.th. 297-272 p. Kr.[22], ndërsa nga Heller në fazën e dytë të ndërtimit të teatrit, pra në fund të shek. III p. Kr.[23].

Kassope

Peristili i të ashtuquajturit katagogion[24] në Kasope ka qenë rrethuar me kolona tetëkëndëshe me prerje të përzgjatur[25]. Dakaris, i cili e ka gërmuar ndërtesën preferon një datim në shek. IV p. Kr.[26] për të, ndërsa Hoepfner dhe Schwander, në bazë të materialit qeramik dhe një monedhe të gjetur në sondazhe të bëra në pjesën lindore, e datojnë ndërtesën në çerekun e fundit të shek. III p. Kr., periudhë kjo

[17] Bouras, Ch., *I anastilosis tis stoas tis Brayronos. Ta arhitektonika kai ta problemata*, Athinë, 1967, f. 183.

[18] Bouras, Ch., *Vep. cit.*, f. 137, 182, Fig. 97, 99, Tab. 12b.

[19] Birge et al., *Excavations at Nemea. Topographical and Architectural Studies: The sacred square, the Xenon and the Bath*, Berkeley, 1992, f. 175.

[20] Dakaris, S., "Ἀνασκαφὴ του ἱεροῦ τῆς Δωδώνης», *Praktika*, 1967, Athinë, 1969, f. 35.

[21] Hammond, N. G. L., *Epirus: the Geography, the Ancient Remains, the History and Topography of Epirus and Adjacent Areas*, Oxford 1967, f. 666; Emmerling T. E., *Studien zu Datierung, Gestalt und Funktion der Kultbauten im Zeus-Heilingtum von Dodona*, Hamburg, 2012, f. 197-198.

[22] Dakaris, S. I., *Dodona. Archaeological guide to Dodona*, Ioanina, 1971, f. 69

[23] Hellner, N., *Vep. cit.*, f. 251, fig. 18.

[24] Zbuluesi i saj, Dakaris, e interpreton ndërtesën si katagogion – Dakaris, S., „Ανασκαφή εις Κασσώπην-Πρεβέζης", *Praktika*, 1952, Athinë, 1955, f. 326-362, Dakaris S., "Von einer kleinen ländlichen Ansiedlung des 8.-4. Jhs. V. Chr. Zu einer spätklassischen Stadt in Nordwest-Griechenland", *Palast und Hütte. Bauen und Wohnen im Altertum, 25-30 Nov. 1979 Berlin.* Mainz am Rhein 1982, f. 365, por Hoepfner W., Schwander E. L. Haus und Stadt im klassischen Grieschenland, Berlin 1994, f. 114-160, hedhin mendimin se mund të ketë qenë një treg pranë agorasë. Shiko edhe Hoepfner, W., „Stützentypen in Nord-Westgriechenland", *Phigos. Timetikos tomos gia ton kathegete Sotire Dakari*, Ioanina, 1994, f. 435.

[25] Dakaris, S., *Vep. cit.*, f. 326-362.

[26] Dakaris, S., *Vep. cit.*, f. 367.

DO NOT COPY

DOKTORE

në të cilën Kasope ka pasur edhe lulëzimin me të madh[27].

Hoepfner jep njoftimin se pilastra me të njëjtën prerje si ato në qoshet e peristilit të katagogeonit (pilastrat nisin nga një prerje në formë katrore të cilave ju janë prerë cepat duke u është dhënë atyre formë tetëkëndëshe) janë gjetur në stoanë prapa buleterionit[28]. Autori thotë se këto pilastra janë akoma më të vegjël dhe bëjnë të mendohet për një stoa të ulët por nuk jep përmasa. Buleterioni është datuar në fund të shek. III p. Kr.[29]. Stoa me pilastra tetëkëndëshe prapa buleterionit në Kasope sjell menjëherë në mendje stoanë me kolona tetëkëndëshe prapa teatrit të Dodonës. Gjithashtu, një kapitel tetëkëndësh, i cili nuk është lidhur akoma me asnjë ndërtesë është gjetur menjëherë në lindje të banesës 5[30].

Pasaron (Rodotopi)

Në Pasaron janë gjetur fragmente kolonash me prerje tetëkëndëshe të përzgjatur dhe kapitel i të njëjtës formë në rrethinat e varrit, në veri të tempullit. Duke qenë se nuk është e qartë se cilës ndërtesë i përkasin fragmentet edhe datimi i tyre mbetet i hapur[31].

Finiq

Në Finiq, fragmente kolonash tetëkëndëshe prej guri me diametër 34 cm janë gjetur në oborrin e vogël të shtëpisë me dy peristile[32], njëra nga të cilat (tambur) është e plotë dhe arrin në 130 cm lartësi[33]. Në një botim të fundit mbi shtëpinë me dy peristile theksohet se portiku i vogël kishte tetë kolona, nga të cilat katër të vendosura në kënde me bazë rrethore (ruhet një fragment me diamentër 0,348 m) dhe katër të vendosura në qendër të dy anëve të gjata, nga dy për anë, me bazë tetëkëndore. Autorët njoftojnë se nga këto të fundit mbeten 5 fragmente me gjerësi maksimale 0,310 m[34].

Fragmente të tjera kolonash dhe një kapitel tetëkëndësh janë gjetur në Finiq brenda rrënojave të bazilikës paleokristiane. Tre fragmente kolonash[35] me përmasa të ndryshme (kolona e parë e ka diametrin 40 cm, kolona e dytë 33 cm dhe të tretës i jepet vetëm lartësia 56 cm) dhe një kapitel[36] i cili mbart nën vete pjesën e sipërme të kolonës (objekti është gjithsej 37 cm i lartë ku kolona e ka diametrin 44 cm ndërsa kapiteli 56 cm), janë gjetur nga Ugolini gjatë gërmimeve të tij në qytetin antik. Skeda e një tjetër fragmenti kolone tetëkëndëshe të rregullt (L. M. 46 cm, Diam. 36 cm, gjerësia në anë 13 cm)[37] i gjetur brenda bazilikës paleokristiane na jepet nga Podini. Autori e daton fragmentin në shek. III p. Kr. dhe shprehet se të gjithë fragmentet e gjetura brenda bazilikës kanë qenë të ripërdorura aty[38].

Butrint

Në të majtë të sanktuarit të Asklepit, Ugolini ka gjetur një fragment kolone tetëkëndëshe me përmasa: lartësi 44 cm, diam. të poshtëm, i matur cep më cep 49 cm, gjerësia e faqeve poshtë 19 cm, ndërsa gjerësia e faqeve lart 18,5 cm. Kolona ngushtohej rreth 1 cm për çdo metër lartësi[39]. Nuk dimë nëse është ky fragment apo ndoshta fragmente të tjera që i kanë dhënë shkak Prof. Apollon Baçes për të rindërtuar tempullin e Asklepit në Butrint me dy kolona tetëkëndëshe në ante duke e krahasuar më pas me tempullin L të Dodonës[40]. Për një kolonë të rrallë që gjendet në Durrës por që vjen nga Butrinti na flet Hoepfner, i cili njoftimin për të dhe një skicë të prerjes e ka siguruar nga Prof. Neritan Ceka në mënyrë private[41]. Tamburi është 1 m i lartë dhe ka një diametër prej rreth

[27] Hoepfner, W., Schwander, E. L., *Vep. cit.*, f. 114-160.
[28] Hoepfner, W., "Stützentypen in Nord-Westgriechenland", *Phigos. Timetikos tomos gia ton kathegete Sotire Dakari*, Ioanina, 1994, f. 436.
[29] Hoepfner, W., Schwander, E. L., *Vep. cit.*, f. 114-160.
[30] Hoepfner, W., *Vep. cit.*, f. 436, fig. 4
[31] Hellner, N., *Vep. cit.*, f. 254-255.
[32] Çondi, Dh., et al. "La "Casa dei due Peristili" e la ripresa delle ricerche nel quartiere a terraze di età ellenistica", *Phoinike I*, nën kujdesin e S. De Maria, Sh. Gjongecaj, Firenze, 2002, f. 65, Fig. 62; Giorgi et al., "Conclusione degli scavi nella Casa dei due peristili", *Phoinike II. Rapporto preliminare sulla campagna di scavi e ricerche 2001*, Bologna, 2003, f. 24-25, Fig. 15-16.
[33] Çondi, Dh., et al. *Vep. cit., Vep. cit.*, f. 65.
[34] De Maria, S., Gorica, S., "Vitruvio e la Casa dei due peristili a Phoinike", *Ocnus. Quaderni della Scuola di Specializzazione in Beni Archeologici*, Bologna, 2012, f. 69, Fig. 9.
[35] Ugolini, L. M., *Albania antica. L'acropoli di Fenice*. Volume II, Roma 1932, f. 168, Fig. 101
[36] Ugolini, L. M., *Vep. cit.*, f. 172, Fig. 101.
[37] Podini M., "La basilica paleocristiana. I materiali architettonici", *Phoinike IV. Rapporto preliminare sule campagne di scavi e ricerche 2004-2006*, nën kujdesin e S. De Maria dhe Sh. Gjongecaj, Bologna, 2007, f. 47.
[38] Podini, M., *Vep. cit.*, f. 48.
[39] Ugolini, L. M., *Albania antica. L'Acropoli di Butrinto*. Volume III, Roma, 1942, f. 183.
[40] Baçe, A., "Vështrim mbi besimin dhe arkitekturën e kultit tek ilirët", *Monumentet*, 1984, 28, f. 21.
[41] Hoepfner, W., *Vep. cit.*, f. 437, Fig. 5.

60 cm dhe veçantia e tij qëndron në faktin se prej tetëkëndëshit mund të shihen vetëm 6 faqe, ndërkohë që pjesa tjetër është e gdhendur me kanelyra dorike. Një kolonë tetëkëndëshe me të njëjtat përmasa dhe vendndodhje në muzeun e Durrësit është përmendur dhe më parë nga Baçe-Ceka, por autorët nuk thonë asgjë më tepër se aq[42].

Sot, në brendi të parkut arkeologjik të Butrintit gjenden disa fragmente kolonash tetëkëndëshe, të cilat nuk janë botuar dhe nuk ka informacione mbi prejardhjen dhe përmasat e tyre.

Në Ilirinë e Jugut, përveç se në Apoloni, kolonat dhe kapitelet tetëkëndëshe janë dëshmuar në Bylis dhe në Nikaia.

Bylisi

Në Bylis kolonat dorike tetëkëndëshe janë gjetur në stoa dhe në një ambient të ngushtë me kat të nëndheshëm i interpretuar si arsenal. Njoftimin e parë për stoanë e Bylisit e kemi nga Praschniker[43] i cili ka kryer gërmime aty. Ai njofton për zbulimin e një salle me dy anijata e cila ndahej nga një radhë kolonash tetëkëndëshe me interkolumnium 5 m. Tamburet e kolonave kishin lartësi të ndryshme dhe njëra prej tyre u arrit të rindërtohej pjesërisht deri në 1,80 m lartësi. Autori thotë që pranë tyre gjendeshin edhe fragmente kolonash të lëmuara që ndoshta i përkisnin katit të dytë[44].

Fragmente të tjera tamburesh të kolonave tetëkëndëshe nga stoa e Bylisit janë gjetur gjatë gërmimeve të vitit 1981. Prerja e tyre është e përzgjatur, me diametër 54 dhe 50 cm[45]. Sipas materialeve arkeologjike të gjetura në gërmime, stoa e Bylisit është datuar në gjysmën e dytë të shek. III p. Kr.[46].

Tambure kolonash tetëkëndëshe me prerje të përzgjatur ruhen gjithashtu në Bylis, në një ambient të mbyllur me përmasa 18,20 x 6,20 m, ndërtuar prapa murit të agorasë, por me disnivel prej 3 m nga kjo e fundit. Një radhë kolonash tetëkëndëshe shërbenin për të mbajtur dyshemenë e katit të parë të ndërtesës që ngrihej mbi të. Rindërtimet e mëvonshme nuk lejojnë të përcaktohet funksioni i saktë i këtij ambienti, por integrimi në agora ka bërë të mendohet se kishte një karakter publik, ndoshta një arsenal për armët[47].

Nikaia

Për gjetjen e dy trungjeve kolonash dhe dy kapiteleve tetëkëndëshe në Nikaia na njoftojnë Prof. Baçe dhe Prof. Ceka[48]. Trungjet kanë prerje të përzgjatur si ato të Bylisit, lartësi 0,82 cm, diametër 53 dhe 45 cm. Ndërsa kapitelet kanë një lartësi prej 34 cm dhe gjerësi 55 cm. Ato mendohet se bënin pjesë në një shëtitore (autorët shfaqin pasiguri për ta quajtur ndërtesën shëtitore dhe e lenë të hapur interpretimin e saj), e cila është gërmuar më parë nga Lazër Papajani, por që në artikullin e tij ai nuk përshkruan fragmente nga dekori arkitektonik. Papajani e ka datuar ndërtesën në shek. III p. Kr.[49]

Përfundime

Siç mund të vihet re nga pasqyra e mësipërme, shembujt më të shumtë të kolonave tetëkëndëshe na vijnë nga Epiri dhe përdorimi i tyre përqëndrohet në shek. III p. Kr., kryesisht në gjysmën e dytë të tij. Përdorimi i tyre në arkitekturë gjen vend në portikë apo salla me radhë kolonash dhe përveç Finiqit, ku janë dokumentuar në arkitekturën private (banesa me dy peristile), shembujt e tjerë na vijnë nga ndërtesa publike laike (portiku prapa skenës së teatrit në Dodona, portiku pas buleterionit në Kasope, katagogion në Kasope) por edhe tempuj të vegjël (naiskos L në Dodona, tempulli i Asklepit në Butrint[50]). Vihet re gjithashtu se kolonat tetëkëndëshe në Epir kanë më së shumti prerjen e një tetëkëndëshi të përzgjatur.

Është kurioz fakti se, ndërkohë që në Epir kolonat tetëkëndëshe janë përdorur në ndërtesa të ndryshme, duket se në Ilirinë e jugut kolonat tetëkëndëshe kanë gjetur vend në katin e poshtëm të stoave. Në këtë ka ndikuar me siguri rasti i Apolonisë. Bylisi e ka marë shembullin për ndërtimin e stoasë së tij nga Apolonia, duke ndikur më pas në qytetin e afërt të Nikaias. Edhe pse Apolonia dallon nga këto qytete për prerjen e rregullt tetëkëndëshe të kolonave

[42] Baçe, A., Ceka, N., *Vep. cit.*, f. 39.
[43] Praschniker, C., *Muzakhia und Malakastra. Archäologische Untersuchungen in Mittelalbanien*, Wien, 1920, kol. 80-81.
[44] Praschniker, C., *Vep. cit.*, kol. 81.
[45] Baçe, A., Ceka, N., *Vep. cit.*, f. 30-31
[46] Baçe, A., Ceka, N., *Vep. cit.*, f. 31; Ceka N., "Gërmime arkeologjike të vitit 1983. Bylisi", *Iliria*,1986, 2, f. 264.
[47] Ceka, N., Muçaj, S., *Bylisi*, Tiranë, 2004, f. 37-38.
[48] Baçe A., Ceka N., *Vep. cit.*, f. 32.
[49] Papajani, L., "Disa monumente të arkitekturës në qytetin antik në Klos", *Monumentet*, 1976, 11, f. 23-34.
[50] Rasti i Butrintit nuk është shumë i qartë.

Do not copy

DO NOT COPY

të saj, ndërkohë që Bylisi dhe Nikaia i kanë kolonat me prerje të përzgjatur[51], të bien në sy përmasat e njëjta të diametrit të poshtëm të kolonave nga këto qytete (Apoloni 54,5 cm; Bylis 54 cm; Nikaia 53 cm).

Por gjithësesi, koncepti i përdorimit të këtyre kolonave në Ilirinë e Jugut nuk largohet shumë nga koncepti i përdorimit të tyre në Epir. Siç u tha dhe më lart, përdorimi i tyre gjen vend në salla të gjata me rradhë kolonash (siç janë stoatë dhe portikët) apo nëpër peristile që gjithashtu janë salla të gjata me rradhë kolonash që bashkohen në kënde dhe arkitektura e tyre është e lidhur ngushtë me portikët[52].

Autorët kanë shprehur shkurt mendimin e tyre mbi përdorimin e kolonave dhe pilastrave tetëkëndëshe në arkitekturën greke. Hoepfner dhe Hellner kanë shtruar edhe pyetje mbi prejardhjen e tyre dhe autorët mendojnë se kjo lloj forme kolonash merr nismë nga një arkitekturë e mëparshme prej druri[53], e cila, sipas Hoepfner, privilegjohej për natyrën më të thjeshtë të formave[54]. Mertens e shikon përdorimin e tyre si një tendencë për të ekonomizuar dekorin urbanistik[55].

Duke qenë se ato gjetën një përhapje të madhe në një zonë të caktuar dhe në një periudhë të caktuar, përdorimi i tyre është parë edhe brenda një konteksti historik të caktuar. Mendohet se në përhapjen e tyre në të gjithë Epirin gjatë shek. III p. Kr., ka ndikuar lidhja Epirote që në atë periudhë ishte shumë e zgjeruar. Hoepfner mendon se ngjan sikur është përpjekur me kujdes për të krijuar një stil lokal[56], ndërsa Podini shton se është zgjedhur ky ordër duke e përdorur atë në ndërtesa të ndryshme për ta ngritur atë pothuajse në një simbol "kombëtar"[57].

Është shumë e qartë se Epiri në radhë të parë, por edhe Iliria e Jugut e zgjedhin këtë ordër duke e përdorur në ndërtesat e tyre. Gjithësesi, është për tu thënë se, edhe pse ordri dorik tetëkëndësh gjeti një përdorim aq të gjerë në këto zona, ai nuk e kalon përdorimin e ordrit dorik dhe në krahasim me të mbetet i kufizuar. Vihet re gjithashtu se nuk ka rregulla as në module, as në ngushtimin e kolonave e as në formën e kapiteleve[58]. Çdo qytet i ka punuar ato në mënyrën e vet. Futja e tij në arkitekturë ngjan më shumë si një «modë» që përhapet gjatë shek. të III p. Kr. Në fakt nuk kemi deri më sot nga këto krahina dëshmi që t'i përkasin shek. II p. Kr.. Nga shekulli i II p. Kr. kemi vetëm një shembull nga Greqia e veriut në Kalydon ku kolonat tetëkëndëshe i shikojmë përsëri të përdorura në një propilon dhe forma e tyre ngjan me ato të Kasopes[59].

Shembujt e tjerë që i përkasin shek. II p. Kr. na vijnë nga Jonia. Është kurioz fakti që edhe në Joni dëshmitë mbi përdorimin e pilastrave apo kolonave tetëkëndëshe i shohim përsëri në stoa dhe në portikë. Një kapitel jo i zakontë, i cili ruan një qafore tetëkëndëshe që bën të mendosh se kapiteli mbështetej në një pilastër tetëkëndësh na vjen nga agora e poshtme e Pergamit[60]. Kapiteli shihet si një përzierje mes një kapiteli me voluta, një kapitel me konsola dhe një kapitel pilastri. Mendohet se ky kapitel bënte pjesë në katin e poshtëm të agorasë së poshtme të Pergamit, e cila është datuar në çerekun e parë të shek. II p. Kr.[61]. Një tjetër dëshmi na vjen nga stoa 3 katëshe e Asos, ku janë gjetur 5 tambure pilastrash katërkëndëshe, të cilëve për një pjesë së lartësisë së tyre u janë prerë cepat dhe u është dhënë formë tetëkëndëshe[62]. Pilastrat mendohet se janë përdorur në katin e poshtëm apo në katin e mesëm mbi çisternën nën stoa[63]. Stoa e Asos i përket shek. II p. Kr. dhe bashkë me Notion, shembulli i të cilit do sillet menjëherë, i përket atyre stoave të cilat u ndikuan nga Pergami në mënyrën e strukturimit të tyre[64]. Mbi prezencën e pilastrave tetëkëndëshe së Notion na flet Martin. Këto

[51] Baçe, A., Ceka, N., *Vep. cit.,* f. 31, Fig. 56, f. 33, Fig. 58.
[52] Lauter, H., *L'architettura dell'ellenismo*, Milano, 1999, f. 124-128.
[53] Hoepfner, W., *Vep. cit.,* f. 437; Hellner N., *Vep. cit.,* f. 258.
[54] Hoepfner W., *Vep. cit.,* f. 437.
[55] Mertens D., "Magna Grecia, Epiro e Macedonia. Nota introdutiva per l'architettura", *Magna Grecia, Epiro e Macedonia. Atti del XXIV convegno di studi sulla Magna Grecia,* Taranto 1984, f. 440.
[56] Hoepfner W., *Vep. cit.,* f. 437.
[57] Podini, M., "Alcuni aspetti della decorazione architettonica di eta ellenistica in Illiria meridionale e nell'Epiro del nord", *L'Illyrie meridionale et l'Epire dans l'antiquite, Vol. II 10-12 Oct. 2008,* Paris, 2008, f. 595.
[58] Për një paraqitje të raporteve të kolonave shih: Hellner, N., *Vep. cit.,* f. 227-262.
[59] Dyggve, E., et al., *Das Heron von Kalydon*, Copenhagen, 1934, f. 328, Tab. IV, f. 382, f. 380, Fig. 102.
[60] Radt, W., "Ungewöhnliche Kapitelle von der unteren Agora in Pergamon", *Ist. Mitt.*, 39, 1989, f. 455, Fig. 1.
[61] Radt, W., *Vep. cit.,* f. 460-461.
[62] Clarke, J. T., et al., *Investigations at Assos. Drowings and photographs of the building and objects discovered during the excavations of 1881 - 1882 - 1883*, London, 1902, f. 91, Fig. 2.
[63] Clarke, J. T., et al., *Vep. Cit.,* f. 83, Fig. 1, f. 85, Fig. 1.
[64] Martin, R., *Recherches sur l'agora greque*, Paris 1951, f. 429-431.

pilastra mbështeteshin mbi baza katrore dhe mbanin katin përdhes të portikut jugor të agorasë së Notion[65].

Veçohet nga shembujt e mësipërm rasti i Lindos, ku pilastrat tetëkëndëshe janë përdorur në dy çisterna nga akropoli i qytetit, në çisternën B[66], në cepin veri perëndimor poshtë propyleve dhe në çisternën veri perëndimore që ndodhet në të djathtë të shkallares hyrëse në akropol[67].

KATALOG

Fragmente arkitektonike nga Stoa me 17 nishe:

1 - Fragment Kapiteli tetëkëndësh (Fig. 1):



Fig. 1. Fragment kapiteli tetëkëndësh në stoanë me 17 nishe.

Gur gëlqeror i fosilizuar, me ngjyrë të bardhë dhe grimca të vogla shumë kompakte.

L. M.: 29,3 cm; Gj. M.: 48,6 cm; Th. M.: 30 cm.

Diametri i qafores 44,6

L abaku 9,6 cm; L ehini (ehini) 9 cm; L torusi 2,7 cm; L qafore 8 cm.

Kapiteli është i thyer majtas dhe prapa. Thyerja ka shkëputur gjysmën e kapitelit. Ciflosje të vogla dëmtojnë torusin dhe bordet e fragmentit.

Abaku me formë katrore mbështetet mbi ehinin me formë tetëkëndëshe nga i cili ruhen vetëm dy faqe të plota dhe dy të tjera pjesërisht. Ehinin e ndan nga qaforja një torus, i cili del në reliev për 2,3 cm. Si torusi, ashtu edhe qaforja kanë prerje tetëkëndëshe. Në pjesën ku bashkohen me abakun, faqet e ehinit kanë gjerësi 26,3 cm njëra dhe tjetra 25 cm, ndërsa në pjesën ku bashkohet me torusin, vetëm një faqe mund të matet dhe është 19,8 cm. Nga qaforja mund të matet gjerësia e vetëm njërës brinjë dhe kjo është 18,5 cm.

Plani mbështetës dhe plani pritës janë të lëmuar. Në planin pritës shihet një rreth i vijëzuar në të cilin brendashkruhet një skamilus me formë tetëkëndore i ngritur pak milimetra në reliev. Për një pjesë të rrethit shihen dy vija që shkojnë paralel njëra tjetrës. Si duket, në një përpjekje të parë skulptori është gabuar në përmasa. Nga scamilus-i ruhen dy brinjë, të cilat nuk kanë gjatësi të barabartë. Njëra prej tyre është 25 cm, ndërsa tjetra 17,6 cm.

Tambure kolonash tetëkëndëshe

2 - L. M.: 126,8 cm; Gj. M.: 50 cm; Th. M.: 48 cm (Fig. 2):



Fig. 2. Tambur kolone tetëkëndëshe - stoa me 17 nishe.

[65] Martin, R., *Vep. cit.*, f. 431, Tab. XII-1.

[66] Dyggve, E., Poulsen, V., *Lindos. Fouilles de l'acropole 1902-1914-1952 III,I. Le sanctuaire d'Athena Lindia et l'architecture lindienne*, Berlin-Copenhagen, 1960, f. 156, f. 193, Tab. V B, f. 195, Tab. V 6.

[67] Dyggve, E., Poulsen, V., *Vep. cit.*, f. 239.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DP 50 cm; DS 44,6 cm
BP 19,5-21 cm; BS 18,4 cm
Gur gëlqeror i fosilizuar, me ngjyrë të bardhë dhe grimca të vogla shumë kompakte.

Tambur kolone tetëkëndëshe. Tamburi ka një ciflosje të madhe në fund në pjesën prapa dhe ciflosje më të vogla pranë cepave. Sipërfaqet janë të lëmuara ashpër. Gjerësia e faqeve sipër ndryshon nga 17,7 cm në 18,4 cm ku kjo e fundit mbizotëron.

Në planin pritës shihen katër vrima për kunja metalike me kanale përkatëse për derdhje. Kemi një vrimë qëndrore me prerje të çrregullt pothuajse katrore dhe përmasa 5,6 x 5,4 x 6,4 cm. Kanali i saj ka prerje ovale dhe përmasa 19 x 3,3 x 1,5 cm. Në të njëjtin aks me vrimën qendrore kemi dy vrima drejtkëndore, njëra me përmasa 5 x 3,7 x 3,6 cm e kanal me prerje ovale me përmasa 8,5 x 2,5 x 1 cm dhe tjetra me përmasa 4,2 x 2,6 x 3,7 cm e kanal me prerje ovale 7,6 x 1,4 x 0,8 cm. Përballë me këtë të fundit kemi një vrimë me të njëjtën formë dhe përmasa 5 x 4,5 x 3,3 cm dhe kanal me prerje ovale 9,5 x 1,6 x 0,7 cm.

3 - L. M.: 92 cm; Gj. M.: 53,2 cm; Th. M.: 52 cm (Fig. 3):



Fig. 3. Tambur kolone tetëkëndëshe - stoa me 17 nishe.

DP 53,2 cm; DS 50,7-49 cm
BP 22 cm; BS 20-20,5 cm
Gur gëlqeror i fosilizuar, me ngjyrë të bardhë dhe grimca të vogla shumë kompakte.

Tambur kolone tetëkëndëshe. Është i thyer lart dhe prapa ka një ciflosje të madhe e cila e përshkon pothuajse në të gjithë lartësinë, duke dëmtuar disa nga faqet e tetëkëndëshit. Sipërfaqet janë të lëmuara ashpër.

4 - L. M.: 77,3 cm; Gj. M.: 52,2 cm; Th. M.: 52,2 cm (Fig. 4):



Fig. 4. Tambur kolone tetëkëndëshe - stoa me 17 nishe.

DP 52,2 cm; DS 50,7 cm
BP 22 cm; BS 20-20,5 cm
Gur gëlqeror i fosilizuar, me ngjyrë të bardhë dhe grimca të vogla shumë kompakte.

Tambur kolone tetëkëndëshe. Tamburi ka ciflosje të vogla në trup afër planit pritës dhe atij mbështetës. Në fundin e tamburit është bërë lëmimi i sipërfaqes për rreth 6 cm lartësi.

Plani pritës është i lëmuar dhe mbi të ruhen dy vrima për kunja bashkë me kanalet kulluese përkatëse me prerje trekëndore.

DO NOT COPY

Përmasat e vrimave:
1. - 5 x 2,2 x 4,7 cm; kanali 10 x 2 x 0,8 cm
2. - 4,5 x 2,5 x 4,3 cm; kanali 15 x 1,9 x 0,8 cm.

5 - L. M.: 40 cm; Gj. M.: 54 cm; Th. M.: 27,3 cm (Fig. 5):



Fig. 5. Tambur kolone tetëkëndëshe - stoa me 17 nishe.

DP 54,6 cm
Brinja 22,5-23,5 cm
Gur gëlqeror i fosilizuar, me ngjyrë të bardhë dhe grimca të vogla shumë kompakte.

Fragment tamburi kolone tetëkëndëshe i thyer prapa dhe lart, ku ruhen vetëm tre faqe dhe fillimet e dy faqeve të tjerave.

6 - L. M.: 127,7 cm; Gj. M.: 52,6 cm; Th. M.: 43 cm (Fig. 6-7):



Fig. 6. Tambur kolone tetëkëndëshe - stoa me 17 nishe.



Fig. 7. Tambur kolone tetëkëndëshe - stoa me 17 nishe. Në planin pritës lexohet ΓΗ.

DP: 52,6 cm; DS: 47,5 cm
BP 21,5 cm; BS 20 cm
Gur gëlqeror i fosilizuar, me ngjyrë të bardhë dhe grimca të vogla shumë kompakte.

Tambur kolone tetëkëndëshe me një thyerje të madhe vertikale prapa, e cila i ka hequr tre nga faqet. Ciflosje të tjera më të vogla dëmtojnë lehtë sipërfaqen. Sipërfaqet janë lëmuar ashpër.

Plani mbështetës është i lëmuar dhe në të shihen një vrimë qendrore katrore për kunj dhe dy vrima drejtkëndore për kapëse të vendosura në një aks diagonal me të parën. Dy vrimat për kapëse ruajnë brenda fragmente të kapëseve (kllapa) prej hekuri dhe plumbi të derdhur për ta fiksuar. Duke qenë se vrimat janë të mbuluara është matur gjerësia e plumbit të derdhur. Gjurma e plumbit te vrima e djathtë është 3,7 x 1,9 cm ndërsa tek e majta 3,4 x 1,5 cm. Kapësja prej hekuri brenda vrimës së djathtë është 2,6 x 0,7 cm, ndërsa brenda së majtës 2,2 x 1,5 cm.

Edhe plani pritës është i lëmuar. Në të mund të shihen dy vrima për kunja bashkë me kanalet përkatëse dhe dy shkronja greke, ΓΗ me lartësi rreth 3,5 cm, të cilat kanë shërbyer për të treguar vendin se ku duhet të vendosej kolona. Vrima e djathtë është 5,7 x 5 cm dhe kanali i saj është 7 x 1,8 x 0,7 cm. Vrima e majtë është 5,3 x 3,3 x 5,4 cm ndërsa kanali i saj 8 x 1,5 x 0,7 cm. Brenda vrimës shihen gjurma hekuri.

DO NOT COPY

7 - L. M.: 67,3 cm; Gj. M.: 53,5 cm; Th. M.: 53,5 cm (Fig. 8):



Fig. 8. Tambur kolone tetëkëndëshe - stoa me 17 nishe.

DP 53,1 cm
Brinja 22 cm
Gur gëlqeror i fosilizuar, me ngjyrë të bardhë dhe grimca të vogla shumë kompakte.

Fragment tamburi kolone tetëkëndëshe. Fragmenti është thyer lart dhe ka ciflosje kudo përreth. Faqet janë lëmuar ashpër.

8 - L. M.: 127,3 cm; Gj. M.: 48,2 cm; Th. M.: 49 cm (Fig. 9):



Fig. 9. Tambur kolone tetëkëndëshe - stoa me 17 nishe.

DP 48.2 cm; DS 46.6 cm
BP 20 cm; BS 18,5 cm
Gur gëlqeror i fosilizuar, me ngjyrë të bardhë dhe grimca të vogla shumë kompakte.

Tambur kolone tetëkëndëshe. Ka ciflosje të vogla afër planit pritës dhe në planin mbështetës. Sipërfaqet janë lëmuar ashpër. Plani pritës është i lëmuar dhe në të shihen tre vrima drejtkëndore për kapëse të hapura në të njejtin aks. Vrima qendrore është 6 x 2 cm. Thellësia e saj nuk mund të matet pasi ka në brendi mbetje llaçi modern. Dy vrimat anësore kanë kanal për derdhjen e metalit. Vrima në të majtë është 5,3 x 2,5 x 2,3 cm dhe kanali i saj 4,1 x 1,2 x 0,6 cm. Vrima e djathtë është 7 x 4 cm x 3,1 cm dhe kanali i saj 4,3 x 1,5 x 0,7 cm.

Edhe plani mbështetës është i lëmuar. Në të shihen gjurmët e gradinës dhe tre vrima, një për kunj në qendër dhe dy për kapëse të hapura në një aks diagonal me vrimën qendrore. Vrima qendrore ka në mes prerje katrore me përmasa 4 x 4 x 3,8 cm, ndërsa bordet i ka të zgjeruara në formë rrethore të çrregullt me diametër rreth 10 cm. Vrimat anësore ruajnë brenda kapëset prej hekuri dhe plumbin e derdhur për t'i fiksuar. Në në majtë, kapësja prej hekuri është 1,8 x 0,8 cm dhe me plumbin përreth zgjerohet 3 x 2,1 cm. Te vrima e djathtë çdo gjë është e mbuluar nga plumbi me përmasa 4,2 x 1,8 cm.

Dy tambure kolonash tetëkëndëshe prej guri gëlqeror të bardhë, me grimca të vogla kompakte gjenden në brendësi të Tempullit të Dianës.

9 - L. M.: 30 cm; Gj. M.: 41 cm ; Th. M.: 41 cm (Fig. 10):



Fig. 10. Tambure kolonash tetëkëndëshe në tempullin e Dianës. Numri 1 në sfond dhe numri 2 në plan të parë

Gur gëlqeror me i bardhë me grimca të vogla kompakte.
Brinja 17 cm

Tambur kolone tetëkëndëshe, i thyer poshtë. Plani i sipërm dhe faqet anësore janë lëmuar ashpër me gradinë. Plani i sipërm ka pësur një goditje, e cila e përshkon në të

DO NOT COPY

gjithë diametrin, duke formuar një kanal të gjerë e të cekët.

10 - L. M.: 38+ cm; Gj. M.: 46 cm; Th. M.: 46 cm (Fig. 10):
Brinja 19 cm
Gur gëlqeror i bardhë me grimca të vogla kompakte.
Tambur kolone tetëkëndëshe i ngulur pjesërisht në tokë. Faqet janë punuar me gradinë. Plani i sipërm është i lëmuar mirë dhe në qendër të tij shihet një vrimë për kunjë druri 9,7 x 7,5 x 4,6 cm. Këtu shihet edhe një tetëkëndësh i brendashkruar, gdhendur me nje vijë të cekët, që ndjek prerjen e kolonës.

Fragment kolone tetëkëndëshe brenda oborrit të manastirit të Shën Mërisë, në të djathtë të hyrjes perëndimore të kishës.

11- L. M.: 40 cm; Gj. M.: 40 cm; Th. M.: 32 (Fig. 11):



Fig. 11. Fragment kolone tetëkëndëshe në oborrin e manastirit të Shën Mërisë në Apoloni.

DP 47 cm
Brinja 19,5 cm
Gur gëlqeror i bardhë me grimca të vogla kompakte.
Fragment kolone tetëkëndëshe i thyer lart e prapa dhe na ruhen vetëm dy brinjë. Sipërfaqja është lëmuar ashpër me gradinë.

Fragmente kolonash tetëkëndëshe në oborrin e manastirit të Shën Kozmait në rrethinat e Fierit.

12 - L. M.: 50 + cm; Gj. M.: 51 cm; Th. M.: 50 cm (Fig. 12):
DP 47 cm
Brinja 19,5 cm
Gur gëlqeror i bardhë me grimca të vogla kompakte.



Fig. 12. Tambur kolone tetëkëndëshe në manastirin e Shën Kozmait (në rrethin e Fierit).

Tambur kolone tetëkëndëshe i ngulur pjesërisht në tokë. Tamburi ka një ciflosje të madhe në planin pritës dhe ciflosje të vogla përreth. Plani pritës është punuar ashpër. Këtu shihet një vrimë rrethore me diametër 7 cm dhe rreth 6 cm e thellë. Faqet janë të lëmuara.

13 - L. M.: 51 + cm, Gj. M.: 42 cm; Th. M.: 42 cm (Fig. 13):



Fig. 13. Tambur kolone tetëkëndëshe në manastirin e Shën Kozmait (në rrethin e Fierit).

DS 42 cm
Brinja 17,5 cm
Gur gëlqeror i bardhë me grimca të vogla kompakte.
Tambur kolone tetëkëndëshe i ngulur pjesërisht në tokë. Tamburi ka ciflosje të vogla përreth. Faqet janë lëmuar ashpër me gradinë. Në planin pritës shihen tre vrima, njëra për kunjë druri në qendër dhe dy për kapëse të hapura në një aks diagonal me vrimën qendrore. Vrima në mes është 8,5 x 7 x 3 cm. Vrimat anësore janë, njëra 6 x 3,5 x 3,5 cm dhe tjetra 7 x 3,5 x 3 cm.

Blerina TOÇI

DO NOT COPY

CONSIDERATIONS ABOUT THE OCTAGONAL DORIC ORDER IN APOLLONIA

In the ancient city of Apollonia, at the 17 niches stoa, we can find located fragments of columns, as well as a capital which belongs to the octagonal Doric order. The octagonal Doric order is a particularity of the ancient Greek architecture. Its use is documented since the archaic period, but the highest concentration of these findings belongs to the Hellenistic period. The third century B.C. is the period when the octagonal Doric order had the largest expansion in the Greek architecture and its use, during this century, is documented mostly in Epirus and Southern Illyria.

During the study of the 17 niches stoa and its octagonal Doric order, some particularities regarding the position of this order in the ancient architecture of the Hellenistic period had been noted. Observing the use of the octagonal columns in different monuments of the Greek architecture and comparing the Apollonia fragment with them, I reached in some conclusions, which create space for a more objective interpretation, in relation to their use in Hellenistic architecture, in a certain period of time. Apparently,during the Hellenistic period, there has been found a clear place for the use of the octagonal Doric order. We will see it being used as a component element in building, with porches or environments with columns. Its use is documented in laic public buildings, in private architecture and in small religious buildings, too.

monumentet
52/2011 - 2014

Federica POMPEJANO*

DO NOT COPY

STRUKTURA E ÇATISË SË DRUNJTË TË BANESËS SË SKËNDULAJVE, GJIROKASTËR

Procesi i njohjes për konservimin e saj

NJOHJA ME STRUKTURËN

Përshkrim i përgjithshëm i elementeve arkitektonike e konstruktive kryesore të ndërtesës

Banesa e Skëndulajve (Fig. 1; Fig. 2), është një shembull i arkitekturës gjirokastrite, në variantin e saj me dy krahë. E ndërtuar në vitin 1823 në lagjen Palorto, banesa paraqet, me



Fig. 1. Pamja kryesore



Fig. 2 . Fragment nga pamja kryesore

kompozimin arkitektonik të saj, karakteristikat më të zhvilluara të *tipologjisë me dy krahë*, duke përfaqësuar kulmin e zhvillimit morfologjik të banesës gjirokastrite. Banesa është e rrethuar me mure perimetrale të ndërtuara pa llaç lidhës, me një lartësi prej rreth 4m, që ndjekin pjerrësinë e terrenit duke kufizuar oborrin e dytë, prej dy oborreve origjinalë. Muret perimetrale kanë frëngji për kontrollin e zonës përreth.

Skema e kompozimit planimetriko-volumor formohet nga 4 blloqe të vendosura në formën e shkronjës U: dy blloqet e krahëve, sipas rradhës së zhvillimit altimetrik,

* Departamenti i Arkitekturës dhe Studimeve Urbane, Universiteti Politeknik i Milanos

DO NOT COPY



Fig. 3. Pamje nga oda e mirë



Fig. 4. Pamje nga oda e mirë, ansambli musandër-dhipato

katoi, oda dhe oda e mirë (ose *oda e miqve*) në krahun verior (Fig. 3; Fig. 4), si dhe *katoi dhe dy odat* e krahut jugor, blloku qëndror, *nëndivan-divan i poshtëm-çardak (ose divan i sipërm*), që përbën volumin lidhës midis krahëve dhe bllokut të pasëm, i pozicionuar në perëndim, i përbërë nga qilaret e zahiresë dhe nga *stera*.

Muratura është e ndërtuar me gurë kave gëlqerorë të lidhur me llaç gëlqereje dhe përforcuar me breza druri. Brezat e drurit gjatësorë, janë të vendosur në një largësi 80÷120 cm nga njëri-tjetri dhe e përshkrojnë të gjithë muraturën perimetrale. Brezat janë dyfishe, nga jashtë e nga brenda dhe lidhen mes tyre me breza tërthorë.

Ndërtimi i qosheve është realizuar me gurë të skuadruar me përmasa të mëdha, të vendosur me alternime të rregullta, që garantojnë, së bashku me brezat prej druri, qëndrueshmërinë e mureve mbajtëse.

Struktura ka edhe dy mure mbajtëse të brendshme, njëri që përshkon të gjithë objektin në drejtimin gjatësor dhe tjetri në drejtimin tërthor. Së bashku me muret mbajtëse perimetrale, këto mure janë të vetmet që ngrihen deri në kuotën e vendosjes së brezit të fundit të drunjtë, me të cilin lidhet konstruksioni mbajtës i çatisë.

Fasada ballore e dy blloqeve anësore të krahëve, në katin e sipërm, është realizuar me strukturë me skelet druri, çatma. Çatmaja, që përbëhet nga skeleti me shtylla druri i veshur në dy faqet me listela druri dhe e suvatuar, është një strukturë ideale, e lehtë, për realizimin e hapjeve të dritareve me përmasa më të mëdha se ato të kateve të tjera, që sigurojnë komfortin e nevojshëm në dhomat më të rëndësishme të banesës në aspektin social. Çatmaja është përdorur edhe për realizimin e mureve ndarëse të ambienteve të brëndshme, veçanërisht në rastet kur ambiente të caktuara kanë patur nevojë për shtim të ndarjeve.

Dyshemetë e drunjta janë të thjeshta, të realizuara mbi trarë druri të sharruar, me përmasa 12x10 cm, të vendosur çdo 35-50 cm nga aksi në aks, e të fiksuar me gozhdë, në dy ekstremet, me brezin horizontal të drurit në muraturë në të njëjtën kuotë me dyshemenë (Fig. 5). Lidhja e trarëve



Fig. 5. Gozhdë kovaçi

me brezat e drurit në muraturë bën të mundur mbrojtjen e ekstremeve të tyre prej një kalbëzimi të mundshëm dhe, sigurisht, garanton një shpërndarje më të mirë të ngarkesave. Dyshemeja është e realizuar me dërrasa të përafruara, me përmasa 2x20 cm e me gjatësi të ndryshueshme, e të gozhduara

drejt për drejt në trarët kryesorë. Strukturat e ndërkateve nuk kanë trarë dytësorë dhe vetëm në odat e katit të sipërm haset veshja e tavanit me dërrasa dhe listele, të quajtura *çita.*

Rivelim gjeometrik e kenologjik i çatisë prej druri

Analiza morfologjike e strukturës së çatisë

Rilevimi teknologjik i strukturës së çatisë ka mundësuar studimin e teknikës së ndërtimit të kësaj strukture dhe evidentimin e problematikave që kanë lidhje me sjelljen strukturore të saj.

Janë studiuar karakteristikat e mëposhtme:

- Tipologjia e mureve perimetralë në kuotën e vendosjes së çatisë;
- Lloji i lidhjes së trarëve horizontalë me brezin e drunjtë të muraturës, të vendosur në nivelin e kuotës së mbështetjes së çatisë;
- Tipologjia e zgjatimeve të elementeve prej druri;
- Lokalizimi i elementeve të shtuara gjatë ndërhyrjeve të mëvonshme përforcuese;
- Lokalizimi i kanaleve të oxhaqeve;
- Lokalizimi i tavaneve të varura te trarët horizontalë;
- Lokalizimi i pikave të aksesit të çatisë.

Metodologjia e ndjekur ka përdorur gjerësisht paraqitjet grafike, rilevimet e realizuara në objekt, të shoqëruara me fotografi, që kanë mundësuar realizimin e një dokumentimi të plotë të teknikës së ndërtimit të kësaj strukture.

Konstruksioni mbajtës i çatisë përbëhet prej trarëve mbështetës, mahive, pajandave, gërshërëzave - elemente horizontale të pozicionuara përafërsisht në 1/3 e distancës së mbuluar prej mahive, nga elemente të veçanta horizontale të vendosura në drejtim perpendikular me trarët kryesore, sipër tyre, dhe, në përfundim, nga shtatë baballëqe që mbajnë traun e kulmit.

Vendosja e trarëve horizontalë mbështetës në objekt, ndjek llogjikën e përhapur të vendosjes së elementeve, në mënyrë që të mbulohet distanca më e vogël mes mureve. Në bllokun qendror llogjika është e njëjtë, me veçantinë se struktura është e përbërë nga një seri prej tre trarësh horizontalë, që përshkon të gjithë gjatësinë e bllokut qendror (rreth 11m).

Karakteristika që bie në sy menjëherë është mungesa e elementeve lidhëse tërthore mes trarëve horizontalë të bllokut qendror. Secili tra është i lidhur me brezin horizontal të muraturës, por mungon një lidhje tërthore mes tyre. Për më tepër, trarët e fundit, që mbulojnë ambientin poshtë çatisë, të quajtur *qoshk* dhe rampën e shkallëve hyrëse për në katin e dytë, janë të fiksuar në dy trarët horizontalë me përmasa të mëdha, të mbështetur në muret perimetrale të dy blloqeve anësore të krahëve, që mbahen nga kolonada e drunjtë e fasadës kryesore.

Ekstremi lindor i trarëve, të vendosur në mesin e serisë së zinxhirëve të bllokut qëndror, që mbulon hapsirën e çardakut, është i gozhduar në njërin prej trarëve horizontalë kryesorë, në atë të vendosur nga ana e brendshme, të mbajtura nga kolonada e fasadës.

Në të dy krahët, mahitë janë të lidhura mes tyre, në kulm, me anë të gozhdëve. Këtu nuk ka një tra gjatësor, po linja imagjinare e kulmit krijohet prej pozicionimit të tyre pranë, në rend. Në bazë, lidhja mes mahisë e traut mbështetës është e realizuar gjithmonë me kllapë me një dhëmb fiksuar me gozhdë.

Në faqet e çatisë së bllokut qëndror, mahitë paraqiten me zgjatime në një lartësi pothuajse sa 1/3 e hapësirës së dritës që mbulojnë e të përbërë prej dy elementesh të gozhduara mes tyre. Për të mos lejuar deformimin e këtyre mahive të gjata janë vendosur të gozhduar, në pjesën e brendshme, disa elemente gjatësore, *zinxhirët.* Këto elemente gjatësore mbështeten mbi pajandat e sistemeve të bllokut qëndror.

Është interesant pozicionimi i një trau tërthor që mbështetet mbi trarët mbështetës kryesorë që mbulojnë hapësirën e çardakut. Ky element, i përbërë nga dy pjesë të lidhura mes tyre, është i pozicionuar rreth 60-70 cm larg murit lidhës gjatësor të banesës, dhe quhet "lumi". Mbi të, mbështeten shtatë *baballëqet* që mbajnë traun e kulmit.

Ndërhyrjet e bëra në fillim të viteve 2000 kanë parashikuar shtimin e dy *lumeve* të tjera në trarët horizontalë, që mbulojnë hapësirat e odës së musllukut dhe odës së miqve, duke vënë në rrezik skemën statike origjinale të strukturës në këto pika, e duke shkaktuar deformime të dukshme të trarëve mbështetës kryesorë, në të cilët janë varur dy tavanet më të rëndësishëm të banesës, për nga ana dekorative.

Në përfundim, petavrat janë dërrasa me gjerësi të reduktuar, të gozhduara drejtpërdrejtë te mahitë, në distancë 5-8 cm nga njëra-tjetra. Mbulesa e çatisë është e përbërë nga pllaka guri gëlqeror me përmasa të ndryshme, të vendosura pa përdorur kunja metalike apo llaç. Pesha e kësaj mbulese është e madhe, po të marrim në konsideratë trashësinë e këtyre rrasave që varion në 3.5-4 cm.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Teknika e lidhjeve të elementeve të drurit

Mjaft interesante janë mënyrat e realizimit të lidhjeve të elementeve të drurit, që përbëjnë tetë sistemet radiale të shpërndara në pjesën qëndrore të mbulesës.

Lidhjet e lokalizuara janë si më poshtë:

- Lidhja mahi-mahi e krahëve;
- Lidhja mahi-mahi në afërsi të zinxhirit;
- Lidhja mahi-trau i kulmit;
- Lidhja mahi-tra horizontal (Fig. 6);
- Lidhja pajantë-zinxhir (Fig. 7);
- Lidhje pajantë-mahi (Fig. 8);
- Lidhjet baballëk-lumi dhe baballëk-trau i kulmit (Fig. 9; Fig. 10);
- Lidhja në bazë, mes elementëve të sistemit radial të bllokut qendror (Fig. 11; Fig. 12; Fig. 13; Fig. 14; Fig. 15; Fig. 16; Fig. 17; Fig. 18).



Fig. 6. Lidhja mahi-tra horizontal



Fig. 7. Lidhja pajantë-zinxhir



Fig. 8. Lidhja pajantë-mahi





Fig. 9; Fig. 10. Lidhjet baballëk-lumi dhe baballëk-trau i kulmit








DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11; Fig. 12; Fig. 13; Fig. 14; Fig. 15; Fig. 16; Fig. 17; Fig. 18. Lidhja në bazë mes elementeve të sistemit radial të bllokut qendror



Fig. 19 Pamje e brendshme, struktura e drunjtë e çatisë së bllokut qendror të Banesës së Skëndulajve

Lidhjet e elementeve realizohen gjithmonë me gozhdë kovaçi, e në disa raste i shtohen disa tako trekëndore druri që krijojnë tensionin mes elementëve. Këto elemente hasen më shpesh në lidhjet e krijuara në bazën e elementeve, që përbëjnë sistemin radial të bllokut qëndror, e në disa raste në ekstremin e sipërm, që i takon lidhjes mahi-zinxhir.

Përmasat e gozhdëve me seksion katërkëndor të përdorura për këto lidhje janë relativisht të mëdha, gjatësia varion 12-14 cm, ndërkohë që gozhdët e përdorura për fiksimin e petavrave në mahi kanë përmasa mjaft më të vogla (Fig. 19).

Përfundime

Rasti i banesës së Skëndulajve është studiuar si një shembull i rrallë që paraqet të padëmtuara elementet arkitektonike origjinale të kësaj praktike ndërtimore. Pasuria e ambienteve të konservuara kaq mirë është një karakteristikë që do të duhej të ruhej.

Studimi gjeometrik e teknologjik i çatisë ka vënë në pah një morfologji strukturore të jashtëzakonshme (**Fig. 24**), që meriton të konservohet si dëshmi e një kulture materiale dhe e një teknike ndërtimore të rrënjosur thellë në territor. Gjithashtu, është vënë në dukje nevoja e një qasjeje të

DO NOT COPY

vetëdijshme që t'i konsiderojë këto struktura jo vetëm nga pikëpamja teknike, po edhe si dokumente të një historie materiale, frut i mjeshtërive lokale. Këto struktura të drunjta të çative nuk duhet të trajtohen si elemente të pavarura të objektit, por pjesë integrale të këtij të fundit dhe bashkëveprues me elemente të tjera konstruktive të vetë objektit. Në këto kushte, marrëdhënia e ngushtë mes konsolidimit strukturor e restaurimit rezulton të jetë një shembull real, i cili ka nevojë për një qasje metodologjike multidisiplinore. Kjo qasje duhet të përfshihet gjatë redaktimit të ndërhyrjeve të konservimit, që tregojnë ndjeshmëri e respekt ndaj historisë materiale e konstruktive të ndërtesës.

Përktheu: Anisa Lloja



01. Planimetria e katit përdhes



02. Planimetria e katit të parë

DO NOT COPY



03. Planimetria e katit të dytë



05. Pamja nga Perëndimi



06. Pamja nga Veriu



04. Pamja nga Lindja



07. Pamja nga Jugu

DO NOT COPY



08. Prerje gjatësore



09. Prerje tërthore



10. Plani i tavanit të katit përdhes



11. Plani i tavanit të katit të parë



12. Plani i tavanit të katit të dytë

DO NOT COPY



13. 13.1. Planimetri e përgjithshme e mbulesës



14. Perspektiva të mbulesës

DO NOT COPY

BIBLIOGRAFIA

1. Çatia e banesës së Skëndulajve është pjesë e temës kërkimore në kuadër të kursit të doktoraturës *Conservazione dei Beni Architettonici* pranë Politeknikut të Milanos. Titulli i temës kërkimore: *"Struktura e çatisë prej druri tradicionale në Shqipëri. Nga njohja te konservimi"*, PhD, studente: Federica Pompejano, Konsulent: Prof. Stefano F. Musso, Prof. Claudio Chesi.
2. "Rregullore mbi mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e qyteti-muze të Gjirokastrës", *Monumentet*, 1973, 5-6, f. 211-217.
3. Baçe, A., "Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër)", *Monumentet*, 1972, 4, f. 103-139.
4. Baçe, A., Meksi, A., Karaiskaj, Gj., Riza, E., Thomo P., *Historia e arkitekturës shqiptare (Nga fillimet deri në 1912),* Tiranë, 1979.
5. CNR-DT 206/2007, *Istruzioni per la Progettazione, l'Esecuzione ed il Controllo delle Strutture in Legno,* Consiglio Nazionale delle Ricerche, Roma, 2007 (rev. 2008).
6. EUROCODE 5, *Design of Timber Structures.*
7. ICOMS - International Wood Committee, *Principles for the Preservation of Historic Timber Structures*, adottati dalla 12° Assemblea Generale ICOMOS, Mexico, Ottobre, 1999.
8. Italian Ministry for Cultural Heritage and Activities, *"Guidelines for the Evaluation and Mitigation of Seismic risk to Cultural Heritage"* Gangemi Publications, Rome, 2007.
9. Kamberi, Th., "Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës gjirokastrite", *Monumentet,* 1971, 2, f. 157-163.
10. Kosta, S., "Mbrojtja, studimi dhe restaurimi i monumenteve të kulturës në Shqipëri", *Monumentet,* 1988, 2, f. 7-18.
11. Lazimi, L., "Oda e mirë dhe elementet arkitektonike të saj në banesën qytetare gjirokastrite dhe beratase", *Monumentet,* 1989, 1, f. 107-136.
12. Lazimi, L., Doraci, A., "Probleme të mbrojtjes së vlerave urbane të qytetit muze të Gjirokastrës", *Monumentet,* 1989, 1, f. 101-113.
13. *Mjeshtrat dhe arkitektura popullore*, Tiranë, 1976.
14. Osmanoglu, F., "Programi i sektorit të pasurisë kulturore të UNESCO-s për mbrojtjen e vlerësimin e monumenteve", *Monumentet,* 1988, 2, f. 23-26.
15. Pompejano, F., Merxhani, K., "Preliminary studies on traditional timber roof structures in Gjirokastra, Albania", *Vernacular Architecture: Towards a Sustainable Future*, London, 2015, pp. 631 – 636.
16. Pompejano, F., Podesta, S., Stagno, G., "The wooden roofs of Banesa e Skëndulajve in Gjirokastra, Albania: The role of the diagnostic test campaign in the structural safety evaluation", *Advanced Materials Research,* Vol. 778, Switzerland, 2013, pp. 911-918.
17. Pompejano, F., *Traditional Architecture of Gjirokastra. Analysis for the structural reinforcement of the wooden roof of Banesa e Skëndulajve,* Master's Thesis Degree, supervisors Prof. S. Lagomarsino, Prof. S. F. Musso, Department of Civil, Chemistry and Environmental Engineering, University of Genoa, 2012 (E pa publikuar).
18. Republic of Albania, Decision of the Ministry of Education and Culture, "*On the*

protection, restoration and management of the Museum-City of Gjirokastra" (1973).
19. Riza, E., "Arkitektura popullore shqiptare (sprovë për vlerësimin e arritjeve të deritanishme)", *Monumentet,* 1992-99, f. 211-218.
20. Riza, E., "Banesa e fortifikuar gjirokastrite", *Monumentet*, 1971, 1, f. 127-147.
21. Riza, E., "Mbi kriteret për restaurimin e banesave popullore", *Monumentet*, 1976, 11, f. 159-172.
22. Riza, E., "Një shembull i zhvilluar i banesës gjirokastrite (Banesa e Skëndulajve)", *Monumentet,* 1984, 2, f. 77-93.
23. Riza, E., *Banesa Popullore Shqiptare,* Tiranë, 2010.
24. Riza, E., *Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare e shek. XV-XIX,* Tiranë, 2009.
25. Riza, E., *Qyteti-Muze i Gjirokastrës,* Tiranë, 1981.
26. UNI 11035:2010, *Structural timber. Visual strength grading for structural timbers,* Milano 2010.
27. UNI 11119:2004, *Cultural Heritage Wooden Artifacts. Load Bearing Structures - On site inspections for the diagnosis of timber members,* Milano, 2004.

DO NOT COPY

Federica POMPEJANO*

DO NOT COPY

THE TIMBER ROOF STRUCTURE OF SKËNDULATE HOUSE, GJIROKASTRA

The knowledge's process for its conservation

Banesa e Skëndulate is part of the historical center of the museum - city of *Gjirokastra* (*Albanian UNESCO World Heritage*), an unique and well-preserved example of Albanian urban traditional architecture influenced by the ottoman architectural style, situated in a strategic position in the valley of the Drino. *Banesa e Skëndulate* represents not only the typical compositional characteristics of this architecture but also a culture and a lifestyle deeply rooted in its own traditions. As it's known, historic roofings are load-bearing structures made of timber according to an empirical and intuitive design, without structural engineering theory support, and *Banesa e Skëndulate*'s roof shows the ability of the local craftsmen to deal with the support of heavy stone roofing. The knowledge process requires to gain information on the geometrical and mechanical properties of timber members, as well as on the loads that the structure was and will be subjected to. Moreover, in old timber structures, the mechanical properties of timber are affected not only by the duration of load and moisture content, but also by the biological decay. So that, due to the influence of vary issues not considered in the original design, like ageing, load history, biological decay, etc., the usual procedure of design for new timber structures cannot be directly applied in the safety evaluation of the existing timber structures.

Banesa e Skëndulate's roof structure consists of a single main warping covering the building's C-plan composite shape, timber planks and stone slabs of different sizes and thickness, placed without mortar or metal hook connections. The main warping is composed by horizontal beams, struts/ rafters, posts and horizontal longitudinal elements placed about at 1/3 of the span covered by struts. Furthermore, there are seven king posts resting on the horizontal bedding beam arranged transversely to the central set of horizontal beams and supporting the ridge beam every 1.25 m. Elements are connected each other with nails in a very simple heel joint considering the connection between horizontal beams and rafters, and an half-lap joint concerning the connection between rafters and posts located in the central area of the C - shape plan and forming the radial system of posts. In the end, the horizontal beams are nailed to the timber ties system of the stone masonry which reinforces horizontally the walls ensuring the overall behavior. The overabundance of posts is able to contribute to the stability of the system and compensate to the poorness and simplicity of the connections.

The importance of the preservation of traditional timber roofs on their historic buildings is quite evident. In fact, timber roofs are usually more compatible in terms of stiffness and mass with the traditional bearing masonry wall and preserves them through interventions that respects the original conceptual structural design, when it is statically probed, means preserve

* *Department of Architecture and Urban Studies , Polytechnic of Milano*

the uniqueness of the overall constructional concept of the entire building and its historical values.

Consequently, the importance to preserve these timber structures is clearly understandable since otherwise, exceptional structural systems belonging usually to traditional building techniques risk to be lost forever.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KRONIKË E PUNIMEVE RESTAURUESE

KRONIKË E NDËRHYRJEVE KONSOLIDUESE-MIRËMBAJTËSE NË PARKUN KOMBËTAR BUTRINT (2009-2013)

Gjatë kësaj periudhe, në territorin e Parkut Kombëtar Butrint, vëmendja në fushën e monumenteve është përqëndruar në realizimin e projekteve dhe programeve që synonin konsolidimin e një sërë monumenteve, vëzhgimin e gjendjes së tyre, menaxhimin e vegjetacionit dhe sistemimin e peisazhit. Synimi i tyre ka qënë gjithashtu nxjerrja në pah e monumenteve të cilët ishin të kërcënuar nga rritja e pakontrolluar e pemëve dhe vegjetacionit masiv, për të vendosur kështu një ekuilibër midis pasurisë natyrore dhe asaj historike, në territorin e Parkut Kombëtar Butrint.

Muri rrethues përgjatë Kanalit të Vivarit

Për periudhën kohore nga viti 2009 deri në 2012, vëmendja është përqëndruar në konsolidimin e seksioneve të veçanta të strukturës së linjës së murit rrethues përgjatë kanalit të Vivarit, duke filluar nga monumenti i njohur si "shtëpia veneciane" deri në afërsi të Portës së Liqenit dhe pastrimit të vegjetacionit (Fig. 1).



Fig. 1. Plani i përgjithshëm i sitit arkeologjik dhe linja e murit rrethues e konservuar nga viti 2009- 2013

Faza e parë e ndërhyrjeve në këtë pjesë përfshiu pastrimin mekanik të vegjetacionit në monument, ku trungje pemësh kishin depërtuar në brendësi të strukturës dhe në shumë raste u pa si e nevojshme përdorimi i herbicideve për trajtimin apo mënjanimin e tyre. Pas pastrimit në mënyrë mekanike të vegjetacionit dhe shplarjes me ujë të rrjedhshëm për largimin e mbetjeve, vijoi procesi i mbushjes së fugave dhe përforcimi i strukturës së murit me llaç të përgatitur në raportin 3x1 (përzierje llaçi e përdorur prej vitesh në

konservimet dhe restaurimet e monumenteve në Butrint).

Për vitin 2011, puna për konservimin e murit rrethues mesjetar përgjatë kanalit të Vivarit u përqendrua në seksionin në afërsi të Bazilikës së Madhe si dhe vazhdimi i së njëjtës linje muri që shtrihet në krah të Pallatit Peshkopal të Trikonkës (Fig. 2). Procesi i punës në këto seksione filloi



Fig. 2. Pamje e një fragmenti të linjës së murit rrethues përgjatë kanalit të Vivarit, konservuar në verën e vitit 2011

me pastrimin e monumentit nga trungjet masive të pemëve, (tek të cilët ishte injektuar më parë herbicid për tharjen e tyre në mënyrë që ato të mund të largoheshin lehtësisht), si dhe nga mbetjet e dherave të cilat kishin dobësuar strukturën e llaçit origjinal. Më pas u vijua me mbushjen e fugave dhe përforcimin e strukturës me llaç të përgatitur në raportin 3x1.

Gjatë vitit 2012, konsolidimit i murit rrethues përgjatë kanalit të Vivarit vijoi në disa seksione. Ashtu si dhe në vitet e kaluara, procesi i punës filloi me pastrimin në mënyrë mekanike të strukturës e më pas me injektimin nëpër fuga të llaçit të përgatitur në raportin 3x1.

Këto seksione u përfshinë në pjesën midis *Kullës Veneciane dhe Pallatit të Trikonkës*, midis *Pallatit të Trikonkës dhe Shtëpisë Veneciane*, pranë *Shtëpisë Veneciane*, si dhe pranë *Portës së Ujit* (Fig. 3).

Ndërhyrje të rëndësishme në linjën e murit rrethues përgjatë kanalit të Vivarit u realizuan në *seksionin 5a-5r* (Fig. 4). Në këtë linjë muri, u tregua një vëmendje e veçantë, pasi në të vihen re seksione me blloqe të mëdha guri të periudhës helenistike, të rrethuara dhe mbushura nga muraturë me cilësi të lartë të periudhës mesjetare dhe gjithashtu me seksione më të vona ndërtimi me llaç të dobët dhe të një cilësie të ulët.



Fig. 3. Pamje e seksioneve të murit rrethues përgjatë kanalit të Vivarit, të konservuara gjatë vitit 2012



Fig. 4. Muri rrethues përgjatë kanalit të Vivarit në seksionin 5a-5r, konservuar në vitin 2012

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Si fillim, u bë pastrimi i strukturës nga vegjetacioni dhe mbetje të tjera organike, si dhe heqja e trungjeve masive dhe rrënjëve të degraduara.

Pas pastrimit vijoi mbushja e fugave me llaç të ri (në po të njëjtin raport 3x1), si dhe injektimi me llaç të lëngshëm në pjesët e brendshme të strukturave ku kishte boshllëqe si pasojë e degradimit të rrënjëve të pemëve. Puna u nda në dy faza: e para përfshiu seksionin 5r-5m dhe e dyta 5a-5 l (Fig. 5).



Fig. 5. Muri rrethues në seksionin 5a-5 l, pas ndërhyrjeve konservuese

Bazilika e Madhe

Gjatë viteve 2009-2010, u krye konsolidimi i strukturës së mureve të Bazilikës së Madhe, duke u përqendruar me tepër në pjesën e apsidës dhe transeptit (Fig. 6). Puna filloi me pastrimin e rrënjëve dhe vegjetacionit në mur, për të vijuar me mbushjen e fugave dhe konsolidimin e pjesës së sipërme të strukturës prej së cilës ishin shkëputur shumë gurë.

Në vitin 2011 vazhdoi konservimi i strukturës së mureve të Bazilikës së Madhe, duke u përqendruar në hyrjen që ndodhet përballë absidës dhe në arkadat që ndajnë nefin qëndror nga nefet anësore (Fig. 7). Ndërhyrjet konservuese u përfshinë edhe në lartësinë e mureve prej nga ekzistonte dhe rreziku i shkëputjes së gurëve, sepse llaçi i cili i mbante ata të lidhur ishte degraduar.

Gjatë vitit 2012 përfunduan ndërhyjet konsoliduese në Bazilikën e Madhe, të cilat u përqendruan në konsolidimin e pjesës së arkadës jugore, (në të dy anët e saj) dhe pjesës fundore të nefit qëndror (Fig. 8).



Fig. 6. Pamje nga konsolidimi i një pjese të Bazilikës së Madhe



Fig. 7. Vazhdimi i konservimit të Bazilikës së Madhe, verë 2011

DO NOT COPY



Fig. 8. Struktura e Bazilikës së Madhe, pas ndërhyrjeve konsoliduese



Fig. 9. Restaurimi i një fragmenti të murit rrethues të akropolit

Një projekt tjetër i rëndësishëm në fushën e monumenteve që u realizua në vitin 2009 ishte ***"Ringritja e murit të rrëzuar në afërsi të Akropolit"*** (Fig. 9). Duke qënë se terreni në të cilin ndodhej ky mur ishte tepër i vështirë për shkak të pjerrësisë së madhe, u desh që në mënyrë të kujdesshme të bëhej menaxhimi i vegjetacioni masiv dhe grumbullimi i materialeve të shkëputura nga struktura e murit. Problem përbënte njëkohësisht edhe transportimi i materialeve pranë monumentit, çka u realizua duke pastruar shkurret e dendura që mbulonin këtë pjesë të akropolit, për të mundësuar hapjen e një shtegu kalimi deri në afërsi të murit të shembur. Ndërhyrjet u realizuan në të gjithë linjën e murit që arrinte në një gjatësi deri në 30 m. Përzierja e llaçit ishte si zakonisht në raportin 3 me 1, e njëjtë me atë të përdorur edhe në monumente të tjera në Butrint, duke pasur parasysh lagështirën e madhe që ka ambienti. Për ngritjen e murit në lartësi u ndërtua një skelë metalike, përmes së cilës u realizua edhe mbushja e fugave në ato pjesë ku u pa si më e nevojshme mbrojtja e murit ekzistues.

Kalaja e Ali Pashës, në grykëderdhje të kanalit të Vivarit

Në kuadër të programit të ndërhyrjeve mirëmbajtëse dhe për të parandaluar degradimin e mëtejshëm të monumenteve, në këtë vit u realizua ndërtimi i një strukture mbrojtëse (suporti) në kullën veri-lindore të (Fig. 10). Pas konstatimit të çarjes që nga viti 2009 dhe duke parë shpejtësinë e përparimit të saj, u mendua të realizohej ndërtimi i një strukture mbrojtëse në krah të këtij muri.



Fig. 10. Struktura mbrojtëse në kullën veri-lindore të Kalasë së Ali Pashës në grykëderdhje të kanalit të Vivarit

Struktura e përbërë nga baza me gurë, thasë me rërë dhe nga trarë të fortë druri u ndërtua në të gjithë linjën e kullës në të cilën ishte çarja. Një ndërtim i tillë u realizua si përforcim dhe për të parë nëse ajo mund të parandalonte çarjen e mëtejshme të murit. Ndërkohë që brenda çarjes u bë derdhje llaçi për mbushjen e saj.

Gjatë viti 2013, programi për mirëmbajtjen dhe konservimin e monumenteve u përqëndrua në realizimin e projektit për **"konservimin e zonës veriore të qytetit antik (muri mbyllës i Gadishullit të Butrintit)",** i financuar

nga Qendra për Trashëgiminë e Butrintit. Përqendrimi i vëmendjes në këtë pjesë ishte tepër i domosdoshëm, pasi degradimi që kishte pësuar ndër vite rrezikonte të zhdukte përfundimisht gjurmët dhe vlerat e këtij fortifikimi (Fig. 11).



Fig. 11. Vendodhja e murit mbyllës të gadishullit të Butrintit, zona veriore e qytetit antik

Puna filloi me pastrimin e murit nga vegjetacioni i ulët dhe i mesëm, pastrimi nga mbetjet organike si dhe pastrimi i bimësisë në një zonë deri rreth 2 m përreth strukturës së murit. Në vijim u bë heqja e mbetjeve të trungjeve dhe rrënjëve të degraduara të pemëve, pa dëmtuar strukturën e muraturës dhe pa dëmtuar pozicionin origjinal të gurëve të lëvizshëm, si dhe pastrimi i llaçit të degraduar. Puna vijoi me qepjen e frakturave dhe konsolidimin e gurëve të lëvizshëm, injektimin e llaçit të lëngshëm në brendësi të strukturave



Fig. 12. Muri mbyllës në zonën veriore të qytetit, gjatë ndërhyrjeve konservuese

ku kishte boshllëqe, konsolidimin e linjave të dobëta të strukturës, konsolidimin e fugave të fasadës së murit në anën veriore dhe jugore të tij.

Përreth murit, në një hapësirë prej 1.5 m u bë mbushja me gurë, e cila shërbeu si platformë pune dhe njëkohësisht do të shërbejë për të ulur sadopak impaktin e erozionit të ujit të liqenit (Fig. 12).

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KRONIKË E NDËRHYRJEVE KONSERVUESE TË MOZAIKËVE NË BUTRINT (2009-2013)

Gjatë viteve 2009-2013, në fushën monumenteve në Parkun Kombëtar Butrint, një vëmendje e veçantë i është kushtuar konservimit të mozaikëve, ekspozimit, dokumentimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Gjatë vitit 2009, një ndër monumentet që pati ndërhyrje të veçanta konsoliduese-konservuese ishte ***Bazilika e Akropolit***. Në të u trajtuan gjerësisht fragmentet e mozaikut dhe negativat e teserave të ruajtura në pjesën e apsidës, nefit jugor dhe atij qëndror (Fig. 1). Ky projekt synoi ruajtjen e atyre pak gjurmëve që dëshmojnë se dyshemeja e këtij monumenti ose një pjesë e tij ishte e mbuluar me mozaikë.



Fig. 1. Pamje nga një pjesë e apsidës së Bazilikës së Akropolit

Pas pastrimit të vegjetacionit, ku rrënjët e pemëve kishin depërtuar në brendësi të dyshemesë duke dëmtuar së tepërmi strukturën e saj, u realizua konsolidimi dhe bordurimi i pjesëve ku ruheshin këto fragmente. Pas përfundimit të ndërhyrjeve konsoliduese, gjithë sipërfaqja e monumentit u mbulua me një rrjetë të hollë mbrojtëse dhe nga një shtresë e trashë rëre mbi të.

Gjatë vitit 2010, vëmendja u përqëndrua në konservimin e mozaikëve në 2 ambiente të Pallatit Peshkopal të Trikonkës, konkretisht në ambientin XXV dhe në ambientin XVI-W (Fig. 2). Të dy ambientet ishin të mbuluar nga një shtresë



Fig. 2. Vendodhja e mozaikëve të ambientit XXV dhe ambientit XVI në Pallatin Peshkopal të Trikonkës

DO NOT COPY

e konsiderueshme vegjetacioni e llojit të ndryshëm, si dhe nga një shtresë e përzierë me spesor të konsiderueshëm myshqesh, algash dhe likenesh, e cila kishte formuar një krostë koherente biologjike. Pasi u eliminua vegjetacioni dhe krosta biologjike në mënyrë mekanike, u kalua në spostimin e shtresave të rërës dhe rrjetës. Shtresa e parë e rërës ishte hedhur direkt mbi sipërfaqen e mozaikut, një mbulim jo i përshtatshëm dhe i gabuar ky, i cili nuk kishte marrë parasysh kontekstin ambiental në të cilin ndodhen mozaikët, sidomos faktin se gjatë pjesës më të madhe të vitit ata ndodhen nën nivelin e ujit.

Pas zbulimit, filloi pastrimi i sipërfaqes duke përdorur furça dhe mistri, sepse rëra mbi mozaik në prezencë të ujit ishte kthyer tashmë në baltë e cila kishte mbushur lakunat dhe në sajë të vetisë infiltruese të ujit kishte depërtuar edhe nën nivelin e teserave, duke bërë shkëputjen e tyre nga suporti i llaçit. Ndërhyrja pastruese u realizua metër për metër në të gjithë sipërfaqen e të dy mozaikëve.

Puna konservuese u përqëndrua në pastrimin dhe larjen me kujdes të lakunave të shumta. Lakunat e thella u mbushën me copa gurësh dhe tjegullash (duke imituar deri diku shtresat origjinale të përgatitjes) dhe me llaç në raportin 1x2 . Pas ngurtësimit të shtresës së brendshme, shtresa e jashtme u realizua me llaç fin, e cila u la 1-2 mm nën nivelin e teserave, me qëllim leximin më të mirë të formave.

Një fazë e rëndësishme e ndërhyrjeve ishte realizimi i bordurimeve për të ruajtur teserat brenda kontekstit të tyre, duke përdorur një llaç të përshtatshëm si në raportin lidhës-inerte dhe në aspektin kromatik (Fig. 3).

Në mozaikun e ambientit XXV, pas realizimit të bordurimeve u pa e nevojshme që në disa pjesë të statumenit (kalldrëmit) të mbulohej me tjegulla me qëllim me konservimin e saj, si dëshmi historike e një periudhe të caktuar. Kjo ndërhyrje u realizua edhe me qëllim përmirësimin e imazhit estetik të veprës. Pjesa rreth pusit katror u ngrit me gurë të sheshtë në të thatë, deri në nivelin e grykës (Fig. 4).

Në përfundim të këtyre ndërhyrjeve, u bë larja e mozaikëve të të dy ambienteve, duke përdorur detergjent jo jonik (neutro), në përqëndrim ujor 1-2 %, me qëllim eliminimin e depozitimeve sipërfaqësore me natyrë organike apo inorganike.



Fig. 3. Bordurimi dhe mbushja e lakunave me llaç, në mozaikun e ambientit XVI në Pallatin Peshkopal të Trikonkës.



Fig. 4. Pamje e mozaikut të ambientit XXV në Pallatin Peshkopal të Trikonkës gjatë ndërhyrjeve konservuese

DO NOT COPY

Pas përfundimit të operacioneve të sipërpërmendura u realizua mbulimi i mozaikëve të të dy ambienteve. Duke mos përsëritur gabimin paraardhës në mbulim, në rastin tonë mbi sipërfaqen e tyre u vendos një shtresë plastmasi cilësor me qëllim miniminizin e infiltrimit të papastërtive, rrënjëve të bimëve, rërës etj. Mbi të u hodh një shtresë prej gati 10 cm rërë e larë lumi. Mbi rërë u shtrua një rrjetë cilësore plastike me thurje të vogla. Në fund u hodh një shtresë prej gati 20 cm granil i bardhë i pastër.

Gjatë vitit 2012, ndërhyrjet konservuese u përqëndruan në një tjetër ambient të Pallatit Peshkopal të Trikonkës, në ambientin XVIII-E (Fig. 5). Ai gjendej i mbuluar nga një shtresë e konsiderueshme vegjetacioni (bimë të ulta dhe të larta), si dhe nga një shtresë e përzierë po me spesor të konsiderueshëm myshqesh, algash dhe likenesh, e cila kishte formuar një krostë koherente biologjike. Pasi u eliminua vegjetacioni dhe krosta biologjike në mënyrë mekanike, u kalua në spostimin e shtresave të rërës dhe rrjetës. Edhe në këtë ambient shtresa e parë e rërës ishte hedhur direkt mbi sipërfaqen e mozaikut çka e vështirësoi procesin e pastrimit të tij.



Fig. 5. Vendodhja e mozaikut të ambientit XVIII- E (dhoma me maska) në Pallatin Peshkopal të Trikonkës.

Pas zbulimit filloi pastrimi mekanik i sipërfaqes duke eliminuar në këtë mënyrë depozitimet e dheut në sipërfaqe duke evidentuar pjesë-pjesë dyshemenë.

Nga raporti i vitit 2007 dhe dokumentacioni përkatës në të, dihej se një pjesë e konsiderueshme e mozaikut gjëndej nën një shtresë llaçi, çka bëri të nevojshme eliminimin e shtresës së llaçit, me qëllim nxjerrjen në dritë të pjesës tjetër të mozaikut dhe motiveve të tjera nën të. Por, ky proces u realizua në një pjesë të vogël, pasi kjo depozitë mund të shërbejë si një dëshmi historike të një faze tjetër banimi të ambientit.

Në përfundim të ndërhyrjeve, kryesisht me karakter konsolidues, duke patur parasysh kontekstin në të cilin qëndron vepra, me qëllim përmirësimin e kushteve fizike të qëndrueshmërisë dhe zgjatjes së jetës së konservimit in-situ, u realizua edhe pastrimi me solucione kimike i mozaikut (Fig. 6). Duke synuar eliminimin e mëtejshëm të depozitimeve të natyrave të ndryshme, kryesisht elementëve patogjenë të mikroflorës (kryesisht koloni bakteresh, fungus dhe alga), u bë një larje e sipërfaqes duke përdorur detergjent jo jonik dhe biocid respektivisht në raportet 1 dhe 2 % në tretësirë ujore.



Fig. 6. Pamje e mozaikut të ambientit XVIII- E (dhoma me maska), në Pallatin Peshkopal të Trikonkës pas ndërhyrjeve konservuese.

Pas përfundimit të operacioneve të lartpërmendura u realizua mbulimi i mozaikëve të të dy ambienteve. Mbi sipërfaqen e tyre u vendos një shtresë plastmasi cilësor, me qëllim miniminizin e infiltrimit të papastërtive, rrënjëve të bimëve, rërës etj.. Mbi të u hodh një shtresë prej gati 10 cm rërë e larë lumi. Mbi rërë u shtrua një rrjetë cilësore plastike me thurje të vogla. Në fund u hodh një shtresë prej gati 20 cm granil i bardhë i pastër.

Gjatë vitit 2012 u realizua gjithashtu edhe ***konservimi i mozaikëve të nikeve të fontanës së Gimnazit*** (Fig. 7). Të tre mozaikët e nikeve paraqisnin patologji të ndryshme në

një shkallë të konsiderueshme avancimi, kryesisht të natyrës biologjike e kimike por si pasojë e tyre janë shfaqur edhe patologji të natyrës fizike.



Fig. 7. Pamje e mozaikëve të nikeve të fontanës në Gimnazin romak.

Ndërhyrjet konservuese që u realizuan ishin:

- Realizimi i bordurimeve me qëllim mbajtjen e teserave brenda kontekstit të tyre, por edhe për faktin se në të tre mozaikët, bordurimet mungonin ose ishin realizuar në mënyrë dhe material jo të përshtatshëm. Ky operacion u realizua me përdorimin e llaçit të përshtatshëm hidraulik, si në raportin lidhës-inerte ashtu dhe në aspektin kromatik.

- Trajtim i lakunave dhe ritrajtim i atyre të vjetra, të realizuara në mënyrë dhe material jo të përshtatshëm. Ky trajtim u realizua me përdorimin e llaçit të përshtatshëm hidraulik, duke e përdorur në raportin e duhur lidhës-inerte ashtu dhe në aspektin kromatik.

- U realizua edhe mbushja po me të njëjtin llaç të hapësirave ndërmjet teserave (fugave) me qëllim lidhjen sa më të mirë të tyre me njëra-tjetrën.

Pas sigurimit të qëndrueshmërisë fizike *in-situ* të tre mozaikëve, puna vijoi me pastrimin sipërfaqsor të tyre, me qëllim eliminimin e elementëve patogjenë të mikroflorës dhe depozitimeve me natyrë biologjike. Ndërhyrjet konsistuan në:

- Pastrimin e depozitimeve biologjike, duke përdorur solucione me bazë kripërash kuaternare të amonit dhe detergjentëve jo jonikë, respektivisht në përqëndrim 2 dhe 1 % në tretësirë ujore.

- Me qëllim rritjen e cilësisë së pastrimit të sipërfaqes së të tre mozaikëve por edhe për eliminimin e substancave të ndryshme yndyrore e krostave me bazë organike dhe jo organike, u përdorën tretësira neutro të kriprave bi dhe tetrasodike të acidit etilen diaminotetraacetik apo kripra amoni të acidit karbonik.

- Në përfundim të ndërhyrjeve, mbi sipërfaqen e mozaikëve u aplikua me penel një solucion mbrojtës me bazë isopropanoli dhe benzisotiazolini. Ky solucion ka për veti minimizimin e riaktivizimit apo rikrijimit në një shkallë të madhe të depozitimeve dhe patinave biologjike me ngjyrë të errët, të gjelbër, etj., si dhe përmirësim të imazhit estetik të mozaikëve.

- Krahas ndërhyrjeve në mozaikë me përdorimin e solucioneve të ngjashme, u realizua gjithashtu edhe pastrimi nga depozitimet biologjike të muraturës ku ndodhen mozaikët, si dhe pastrimi i fontanës e i ambientit brenda perimetrit të pothuajse gjithë monumentit, nga vegjetacioni e krostat e shumta biologjike të depozituara aty me kohë.

Gjatë vitit 2013 u realizua faza e parë e konservimit të mozaikut të ambientit XXIV-Trikliniumi absidal në Pallatin Peshkopal të Trikonkës.

Para ndërhyrjeve, ambienti gjendej i mbuluar nga një shtresë vegjetacioni (bimë të ulta), si dhe nga shtresë e përzierë myshqesh, algash dhe likenesh, e cila kishte formuar një krostë koherente biologjike. Pasi u eliminua vegjetacioni, si brenda ambientit ashtu edhe në strukturat murale që rrethojnë atë, si dhe krosta biologjike në mënyrë mekanike, u kalua në spostimin e shtresave të rërës dhe rrjetës. Shtresa e parë e rërës ishte hedhur direkt mbi sipërfaqen e mozaikut, një mbulim ky jo i përshtatshëm dhe i gabuar për faktin se gjatë pjesës më të madhe të vitit ai ndodhet nën nivelin e ujit.

Menjëherë pas pastrimit të rërës u evidentua një gjëndje jo e mirë e dyshemesë. Problematika dhe dëmtimet prezente ishin të shumta, komplekse dhe me një shtrirje në pothuajse të gjithë sipërfaqen e mozaikut. Ndër më komplekset ishin ato të natyrës fiziko-statike si rrëzimet, ondolimet, deformimet strukturale dhe shkëputjet të nënshtresave nga njëra-tjetra, lakunat dhe ndërhyrjet antropike.

Në fazën e parë të projektit, ndërhyrjet konservuese u përqëndruan në trajtimin e lakunave (Fig. 8). Fillimisht u

DO NOT COPY

proçedua me pastrimin e lakunave të shumta, proces i cili u përsërit në vazhdimësi gjatë gjithë procesit të trajtimit të tyre. Për trajtimin e lakunave të thella u përgatitën dhe u përdorën dy lloje llaçi. Pas pastrimit dhe larjes të lakunave të thella, pjesa e poshtme u mbush me gurë. Mbi ta u aplikua një shtresë llaçi i trashë në raportin 1:3, duke imituar në këtë mënyrë nënshtresat origjinale të dyshemesë. Shtresa e sipërme u punua dhe u la pothuajse 1-2 mm nën nivelin e teserave, me qëllim leximin më të mirë të formave si dhe përmirësimin dhe rifitimin e aspektit estetik të veprës. Gjithashtu, llaçit iu dha edhe raporti i duhur kromatik. Paralelisht u realizuan një seri bordurimesh duke përdorur llaç të përshtatshëm në raportin lidhës-inerte ashtu dhe në aspektin kromatik.



Fig. 8. Pamje gjatë trajtimit të lagunave në mozaikun e ambientit XXIV-Trikliniumi apsidal në Pallatin Peshkopal të Trikonkës.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KRONIKË E NDËRHYRJEVE RESTAURUESE TË KRYERA NGA DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE - VLORË

1. Xhamia e Gjin Aleksit

Xhamia e Gjin Aleksit ndodhet në qendër të fshatit Rusan dhe përbën një kompleks së bashku me katër tyrbe (Fig. 1). Xhamia e Gjin Aleksit përbëhet nga portiku, salla e lutjeve dhe minareja.

Portiku në anën veriore, i mbuluar me çati druri kufizohet nga një arkadë me harqe të mprehtë e mbi kolona guri (Fig. 2).

Salla e lutjeve ka ploanimetri katrore me përmasa 8x8 m, vëllimi kubik i së cilës mbulohet me kupolë sferike ndërtuar me tulla.

Pas hyrjes në sallë, mund të shihet mafili i mbështetur mbi arkada druri dhe gjurmët e dyshemesë prej druri.

Karshi hyrjes, në ballin juglindor ndodhet mihrabi, i trajtuar si nike.

Dritaret me tre rradhë, me hark ose arkitrarë ndodhen në muret e sallës kryesore.

Në gjendjen e sotme, në faqet e brendshme të sallës dallohen pak shenja të pikturës murale.

Nga ndërtimi planimetrik dhe vëllimor është e tipit me sallë e me kupolë. Për shkak të mungesës së të dhënave, specialistët e kanë pasur të vështirë për vendosjen në kohë të xhamisë.

Bazuar në arkitekturën e zhvilluar dhe përmendja e Xhamisë nga Çelebiu, specialistët janë të mendimit se Xhamia është ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XV.

Punimet restauruese u kryen në vitin 2008 dhe konsistonin në: Punime speciale qepje çarjesh dhe tiranta, suvatim muri dhe ndërtim dyshemeje.

Vlefta e investimit të realizuar 864.600 lekë.



Fig. 1. Kupolat e Xhamisë së Gjin Aleksit.



Fig. 2. Harqet në Xhaminë e Gjin Aleksit.

DO NOT COPY

2. Kisha e Manastirit të 40 Shenjtorëve, Sarandë

Manastiri i 40 Shenjtorëve ndodhet në lindje të qytetit të Sarandës, në majë të kodrës së Gjashtës, në pjesën më dominuese të saj. Manastiri i përket periudhës së Antikitetit të Vonë, shek.VI. Dimensionet e tij janë 40 m gjatësi x 24 m gjerësi (Fig. 1).

Manastiri është ndërtuar dhe rindërtuar gjatë qindra vjetëve. Kati mbitokësor përbëhet nga kisha me shtatë apsida dhe dy nartekse. Në katin e nëndheshëm ose kriptoriku ruhen galeritë (qelat), galeritë me qemerë, qemerët e dyfishtë, afreske të periudhës Bizantine, çisterna uji dhe varre (Fig. 2).

Sot ruhet në gjendje disi të mirë kati i nëndheshëm, kurse kati mbi tokë është dëmtuar rëndë gjatë Luftës së Dytë Botërore nga bombardimi i avionëve anglezë.

Konstruksioni i mbulesës duhet të ketë qënë me qemerë të kryqëzuar, të mbështetur në gjysmëkupolat e shtatë apsidave. Përdorimi i harkut të dyfishtë është realizuar me gurë të punuar njëlloj si të ishin tulla.

Në hyrjen për në ambientin e nëndheshëm gjatësor të mbuluar me qemer unik, nën qemerin e madh të jashtëm, janë inkorporuar dy qemerë katakombalë të mbivendosur njëri mbi tjetrin në dy kate, ku i poshtmi shërben për të hyrë në bazilikën e nëndheshme (Fig. 3).

Punimet restauruese u kryen në vitin 2008 dhe konsistonin në: Rrethimin e monumentit me mur guri dhe zgara metalike të fiksuara me plinta betoni. U realizua vendosja e portës metalike dhe tabelës së informacionit.

Vlefta e investimit të realizuar 2.970.960 lekë.



Fig. 1. Pamje e përgjithshme e Manastirit të 40 Shenjtorëve.



Fig. 2. Afresk në katin e nëndheshëm të Manastirit të 40 Shenjtorëve.



Fig. 3. Bazilika e nëndheshme e Manastirit të 40 Shenjtorëve.

3. Bazilika-Sinagogë, Sarandë

Ndodhet në qendër të qytetit të Sarandës.

Kemi të bëjmë me një kompleks Sinagoge të shek V-VI, ku në fazën e fundit u transformua në kishë (Fig. 1). Interes të veçantë paraqet dyshemeja me mozaikë që mbarte një shandan shtatë – krahësh "menorahi", ku krahas motiveve gjeometrike dhe floreale përfshinte një etrog (qitro pa shije por me aromë) së bashku me një shofar (bririn e dashit), që të dyja janë simbole të rëndësishme hebraike që shoqërojnë zakonisht menoranë dhe janë përdorur gjatë festave fetare.

DO NOT COPY

Baza e fazave kronologjike të monumentit mbeten dyshemetë me mozaikë (Fig. 2). Të paktën tre faza dyshemesh me mozaikë janë identifikuar para realizimit të dyshemesë së bazilikës.

Simbolika e skenave me mozaikë na çon në mendimin e ekzistencës së një sinagoge, në një periudhë më të hershme se sa ndërtesa kristiane. Mendimi është se kemi një konvertim të ndërtesës së kultit hebraik me atë kristian. Elementët më domethënës në simbolikën hebraike janë shandani shtatë krahësh, *menorah.*

Kompleksi hebraik, duke filluar që nga faza e parë, kur dhoma me menorah përbënte vëndin e lutjes dhe duke vazhduar me ndërtimin e bazilikës dhe kovertimin e saj në kishë, ka qënë në funksion për një periudhë prej 100-200 vjetësh dhe u shkatërua nga sllavët në çerekun e fundit të shek. VI.

Punimet restauruese u kryen në vitin 2008 dhe konsistonin në: Rrethimin e monumentit në anën veriore me mur guri, me mur tulle dhe brez të fshehtë mbi mur, si dhe zgara metalike. Rrethimi i monumentit në anën jugore dhe lindore u bë me kangjella metalike dekorative, të fiksuara me bordurë betoni. Gjithashtu, u kryen punime të ndryshme në zyrën e informacionit si dhe për konsolidimin e mureve të bazilikës me llaç e gëlqere.

Vlefta e investimit të realizuar 2.985.600 lekë.



Fig. 1. Pamje e përgjithshme e Bazilikës Sinagogë (rrënojë).



Fig. 2. Mozaik të dyshemesë së Bazilikës.

4. Manastiri i Shën Kollit, Mesopotam, Delvinë

Kisha e Manastirit të Shën Kollit ndodhet në anën jugore të manastirit. Kjo kishë përbën një tip unikal, ajo është më e madhja ndër kishat bizantine të ruajtura në Shqipëri në shek. XI-XIV.

Kisha ka formën e një kubi, me pjesën qendrore që ngrihet më lart, të cilën e kurorëzojnë katër kupola. Mendohet që kisha rrethohej nga të tri anët me galeri ose hajate të hapura me arkada, që u rrëzuan më 1793 (Fig. 1).

Kisha përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit. Naosi ka formë katrore me një kolonë në qendër.Naosi ndahet nga narteksi nga një arkadë me katër kollona. Janë tri volume të ndara që komunikojnë me anë të arkadave.

Sipas studiuesve, më 1510, kisha u godit nga një tërmet që shkaktoi dëme të shumta.

Kisha shquhet për arkitekturë unikale, për dekoracionin e saj me tulla, për relievet skulpturale në muret e jashtme (Fig. 3), për kapitelet, për vlerat artistike, për nivelin e ndërtimit në stilin bizantin, pa përjashtuar ndonjë ndikim romak. I përket shekullit XIII dhe kjo duket nga stema e Anzhuinëve.

Kisha është e mbuluar me kupola dhe kalota sferike, që ngrihen mbi një rrjet kuadratik harqesh mbajtëse dhe harqesh të verbër. Është i vetmi rast në botën arkitektonike bizantine ku 4 kupolat që ndodhen mbi tambur mbështeten në një kollonë të vetme me diametër 48 cm.

DO NOT COPY

Punimet restauruese u realizuan në dy faza. Faza e parë konsistoi në konservimin e bllokut qëndror të absidave. Gjithashtu u bë realizimi i portës dhe zgarës metalike në konakët e rinj. U kryen punime në qoshen veri-perëndimore të manastirit (magazina), si dhe realizimi i soletës b/arme, hidroizolimi dhe termoizolimi i saj. U realizua vendosja e dyerve dhe dritareve me dru masiv si dhe zgara metalike.

Punime u realizuan edhe në konservimin e kishës së Shën Kollit.

Instalimi i unazave metalike u krye nën strehën e tambureve, në nivelin e bazës së tambureve dhe në nivelin e sipërm të mureve anësore. Gjithashtu u realizua edhe konservimi e restaurimi në mbulesën e çatisë.

Vlefta e investimit të realizuar 4.981.800 lekë.

Faza e dytë e restaurimit u realizua në vitin 2009 dhe konsistonte në punime në qoshen veri-perëndimore të manastirit (magazina). U kryen punime restaurimi në kullën veriperëndimore, konservime në kreun e mureve, realizimi shtresës së shkallëve me gurë të gdhëndur, etj.

Gjithashtu u bënë edhe punime në konservimin e kishës së Shën Kollit, si konservim, qepje, injektim në pjesët e degraduara dhe në arkadën e altarit, sikurse u vendosën kolonat dhe tirantat metalike, detajet e fiksimit dhe shtrëngimit. Gjithashtu u bë edhe zmontim mur guri e trajtim i sipërfaqes së suvasë.

Vlefta e investimit të realizuar 4.741.740 lekë.



Fig. 1. Pamje e përgjithshme e Kishës së Manastirit të Mesopotamit.



Fig. 2. Relieve skulpturale në fasadën e Kishës së Manastirit të Mesopotamit.

5. Rrënojat e Tragjasit të Vjetër, Vlorë

Në burimet dokumentare, fshati Tragjas del për herë të parë në vitin 1432 dhe digjet nga forcat gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore. Aktualisht ruhet në gjendje rrënojë. Ai ishte vendosur në të dy shpatet e një kodre në formë patkoi. Në sipërfaqe dallohen rrënojat e banesave, qendra e fshatit si dhe rrënojat e një xhamie (Fig. 1). Ato janë kryesisht banesa me kat, një, dy apo tre kthinëshe. Banesë me kat dhe një kthinëshe ruhet vetëm një në Tragjas dhe formohej nga ambienti përdhes, i pabanuar dhe ambienti i katit i banuar, me shkallë të jashtme (Fig. 2). Shembulli me dy kthina ka një kompozim të shtrirë, duke pasur një katua të vetëm në katin përdhes dhe dy ambiente banimi në kat. Blloku i shkallëve përmban si zakonisht qemerin cilindrik, nën të cilin kalohet në katua. Në katin e banuar, të tre ambientet kanë hyrje të drejtpërdrejtë nga jashtë, pa ndërlidhje së brendshmi. Në qendër është vendosur shtëpia e zjarrit, me vatër në mes, ndërsa në të dy krahët e saj janë dy oda me oxhak dhe përkatësisht me ambient sanitar të veçantë. Muratura e tyre është ndërtuar me mur guri të lidhur me llaç gëlqereje.

Punimet restauruese u kryen në vitin 2008 dhe konsistonin në shtrimin me pllaka guri. Gjithashtu u ngritën mure guri, u bë pastrimi i burimit si edhe restaurimi i çezmës.

Vlefta e investimit të realizuar 2.900.000 lekë

DO NOT COPY



Fig. 1. Pamje e përgjithshme e Fshatit Rrënojë të Tragjasit të Vjetër.



Fig. 2. Ndërtesë në Fshatit Rrënojë të Tragjasit të Vjetër.

6. Kompleksi islamik në lagjen Xher Mëhallë, Delvinë

Objekti më i rëndësishëm dhe më i hershmi i kompleksit islamik të Xher Mëhallës është Xhamia, e cila është një ndërtim i shek. XVI (Fig. 1). Ndërtim i fillimit të shekullit të XVI është edhe hamami, ndërsa krojet dhe ura i përkasin shekullit XVII. Dy Tyrbet duhet të jenë ndërtuar gjatë shekujve XVIII-XIX. Pranë krojeve ka qënë dhe Imareti, i ndërtuar me gurë e tulla, i cili sot nuk ruhet më dhe që duke u vlerësuar nga teknika e ndërtimit, duhet të jetë nga ndërtimet më të hershme të kompleksit, fillimi i shek. XVI. Në qoshen jug-perëndimore ruhet tamburi i minares, i rrëzuar para shumë vitesh.

Xhamia ka qënë e mbuluar me çati katër ujëse, e cila në pjesën qendrore mbështetej mbi një arkadë guri. Tyrbja pranë xhamisë është e ndërtuar me mur guri. Ruhet muratura poligonale deri në nivelin e thembrave të kupolës, e cila është e rrëzuar. Tyrbja mbrapa krojeve ruhet e plotë si konstruksion por nuk ka mbulesën me tjegulla. Hamami është i ndërtuar me mure guri dhe mbulesë me kupola dhe tjegulla.

Në vitin 2009, ky kompleks iu nënshtrua një restaurimi, gjatë së cilit u kryen kryesisht punime në xhami, në disa rrënoja që mendohet të kenë qënë shkollë (e tipit Medrese) për personel shërbesash fetare e publike, si edhe te krojet dhe te tyrbja pranë xhamisë.

Ndërhyrjet përmbanin edhe zëra të tjera, si punime restaurimi brënda në xhami, vendosje zgarash metalike, mbulim i dyshemesë me plastmas dhe rërë. Punime restaurimi janë bërë dhe jashtë objektit të xhamisë, si mbingritja e murit rrethues nga ana jugore, përforcimi i murit mbajtës me mur guri me llaç e breza betoni, konsolidimi i murit rrethues në hyrjen kryesore të xhamisë, si dhe punime restaurimi në ambientet arsimore (shkollë). Gjithashtu, u krye konsolidimi i mureve me llaç gëlqere pas pastrimit, rikonstruksioni i murit rrethues në anën jugore, konsolidimi i mureve të thatë në rrugën e hyrjes për tek objekti, apo edhe konsolidimi i rrënojave me llaç gëlqere në hyrje dhe i hyrjes kryesore.

Punime restaurimi u realizuan edhe në objektin -tyrbe. Injektimi me llaç në fuga e zgavra të sipërfaqes së mureve në pjesët e dëmtuara, vendosja e zgarave metalike, mbulimi i dyshemesë me plastmas dhe rërë.

Punime restaurimi u bënë edhe në objektin- kroje, si pastrim i basenit të ujit, plotësim me mur guri mbi qemer dhe vendosje kornize me pllaka guri.



Fig. 1. Pamje e kupolës së xhamisë, kompleksi islamik në lagjen Xher Mëhallë, Delvinë.

DO NOT COPY

7. Kisha e Shën Gjergjit, Leshnicë e Sipërme

Kjo kishë është e thjeshtë, një nefëshe, e ngritur në një terren të pjerrët në hyrje të fshatit dhe daton shek. XV. Është ndër të parat kisha të ndërtuara pas pushtimit osman. Ka përmasa të brendshme 5,30 x 2,90 m (Fig. 1). Kisha përbëhet nga naosi, hajati dhe ambienti i altarit, i cili përmban absidën rrethore të nxjerrë jashtë naosit dhe një ikonostas të thjeshtë prej druri. Është e mbuluar me çati druri, pa tavan e dritare dhe me dysheme të shtruar me rrasa guri. Është pikturuar nga Ilia Llongoviti (1525) nga fshati Llongo i Dropullit, i cili ka pikturuar edhe kishën e Shën Thanasit në Pecë. Sot ruhet në gjendje të mirë, pasi është restauruar çatia në vitin 2010, nga komuniteti ortodoks i fshatit. Por, nuk ka përfunduar rrethimi dhe shkallaret e gurta. Muret e jashtme janë të ndërtuara me gurë të vendosur në mënyrë të parregullt dhe të lidhur me llaç gëlqereje. Çatia është mbuluar me rrasa guri. Portiku është i hapur, ka një kollonë guri dhe është i mbuluar me çati me rrasa guri. Punimet restauruese u kryen në vitin 2009 dhe konsistonin në restaurimin e plotë të çatisë.

Punimet e tjera të parashikuara në preventiv nuk janë realizuar për mungesë fondesh.

Vlefta e investimit sipas preventivit 3.030.000 lekë. (Me investitor Komunitetin)



Fig.1. Pamje e përgjithshme e Kishës së Shën Gjergjit.

8. Muzeu arkeologjik, Sarandë. (Mozaiku te posta)

Mozaiku ndodhet në katin e parë të ndërtesës së ish Postës (Fig.1).

Është zbuluar në vitin 1968 nga arkeologu Dhimosten Budina dhe i përket periudhës së Antikitetit të Vonë.

Kjo sallë është zbuluar gjatë ndërtimit të godines së PTT (e vjetra). Ajo ka dalë në dritë e fragmentuar dhe paraqet mjedisin e një godine të shek. III m. Kr.. Sipas arkeologëve që kryen gërmimet, në objekt janë vërejtur ndërhyrje për ta shndërruar atë në ndërtesë kulti (bazilikë shek. VI m. Kr.).

Në disa vende mozaiku është i dëmtuar dhe i deformuar, pjesa lindore ndryshon nga ajo perëndimore, kryesisht në të gjenden figura gjeometrike (harqe, katrore dhe spirale) dhe shpendë, më e bukura ndër to është "Palloi që pi ujë në gotë"

Mozaiku në vitin 2009 është restauruar nga specialistë të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe të Universitetit të Bolonjës në Itali. Sot Mozaiku është në gjendje të mirë.

Punimet restauruese u kryen në vitin 2012 dhe konsistonin në punime në sallën e mozaikut (me investitor Bashkinë Sarandë). Gjatë këtyre punimeve restauruese u realizua suvatimi i murit për eliminimin e lagështisë dhe veshja me gipsosanidhë, lyerja me bojë plastike dhe hidroplastike e ambienteve të brendshme, rikonstruksioni i rampës së drurit ku lëvizin vizitorët, vendosja e stendës prezantuese si dhe pastrimi i fadadës kryesore.



Fig. 1. Pamje e përgjithshme e mozaikut.

DO NOT COPY

9. Restaurimi i Godinës së ish-Klubit Labëria, Vlorë

Klubi Labëria është një ndërtim, monument i kategorisë së I-rë dhe ndodhet në qytetin e Vlorës, në qendër të tij. Ky është një ndërtim i fillimit të shek. të XIX (Fig. 1). Ndërtimi përfaqëson tipologjinë e ndërtimeve të kësaj periudhe, me funksione të mirëfillta qytetare për banim dhe paraqitet në gjendjen e sotme me ndryshime, të cilat janë të theksuara në brendësine e mjediseve, në elemente të interierit, etj. Ndërtimi është dy katesh, tip vile, me planimetri sipas gërmës L, me një oborr në formë katërkëndëshi dhe trajtim të jashtëm arkitektonik me shtrirje horizontale, në qendër të të cilit ndodhet dhe mjedisi i papafingos (Fig. 2).

Ndërtimi është me konstruksion mbajtës. Mbulesa është çati druri dhe e mbuluar me tjegulla. Dyshemetë e katit të parë janë të shtruara me pllaka guri, ndërsa në katet ndërmjetëse me dysheme druri. Në të tre katet, ndërtimi ka tavane druri. Kati i sipërm është i ndërtuar me mur çatma.

Punimet restauruese u kryen në vitin 2012 dhe konsistonin në lyerjen e godinës, restaurimin e kanatave, dritareve, dyerve. Gjithashtu u realizuan ndërhyrje mirëmbajtëse në çati, riparime të pjesshme të dyshemesë si dhe suvatime të jashtme dhe të brendshme.

Vlefta e realizimit : 1.672.848 lekë.



Fig. 1. Pamje e hyrjes në godinën e ish-Klubit Labëria.



Fig. 2. Pamje këndore e Godinës së ish-Klubit Labëria.

DO NOT COPY

10. Muret rrethuese të Aulonës Antike, Vlorë

Sistemi fortifikues është ngritur në shek. IV m. Kr., si dhe me shtesa të mëvonshme në shek. VI-VII dhe XIV-XV, i pajisur edhe me kulla përforcuese katërkëndëshe (Fig.1). Muri solid nga pikëpamja konstruktive rrethonte një pjesë të qendrës së qytetit të sotëm të Vlorës dhe formonte një vendbanim të fortifikuar të tipit Kastrum (Fig. 2).

Punimet restauruese u kryen në vitin 2012 dhe konsistonin në punime mirëmbajtëse, ndërhyrje plotësuese, nivelim konsolidimi, pastrim vegjetacioni, disiplinim i ujrave të larta si dhe vendosje të logjistikës.

Vlefta e realizimit: 878.126 lekë



Fig.1. Pamje këndore e mureve rrethuese të Aulonës.



Fig.2. Pamje e përgjithshme e mureve rrethuese të Aulonës.

11. Godina ku ka pasur veprimtarinë Qeveria e Përkohshme e Ismail Qemalit, sot Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Vlorë

Muzeu Kombëtar i Pavarësisë në qytetin e Vlorës, me të gjithë eksponantët e tij, përbën një kompleks me vlera autentike për vizitorët vendas dhe të huaj. Ka shtatë pavione dhe dy holle në të cilët ruhen dhe ekspozohen mjaft objekte dhe dokumente me vlera të veçanta historike. Muzeu i Pavarësisë është ndërtim i fundit të shekullit XIX. Në fillimet e saj godina ka qënë karantinë ushtarake, ndërsa në vitin 1913 ka shërbyer si Seli e Qeverisë së Vlorës. Më 1936, në ambientet e kësaj godine është çelur muzeu i parë arkeologjik shqiptar, sot kryen funksionin si Muze i Kombëtar i Pavarësisë (Fig. 1). Në të gjenden të ekspozuara me dhjetëra objekte, dokumente dhe vepra arti kushtuar Pavarësisë së Shqipërisë (Fig. 2). Muzeu vizitohet nga mijëra vizitorë vendas dhe të huaj në vit. Është restauruar në vitin 2012 me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë. Monumenti është i ndërtuar me konstruksion mur mbajtës.

Punimet restauruese u kryen në vitin 2012 dhe konsistonin në suvatim të jashtëm, vendosje ulluku, horizontalë e vertikalë, punime përforcimi në ballkon, lyerje jashtë e brenda godinës, punime elektike dhe hidraulike si dhe punime rrethimi dhe sistemimi.

Vlefta e realizimit: 2.365.409 lekë



Fig. 1. Pamje e jashtme e godinës ku ka pasur veprimtarinë Qeveria e Përkohshme e Ismail Qemalit.

DO NOT COPY



Fig. 2. Pamje e tryezës së punës së Ismail Qemalit.



Fig. 1. Pamje e fasadës ballore e godinës së ish-Prefekturës.

12. Restaurim i godinës së ish-Prefekturës, Vlorë

Godina ruan vlera ndërtimore të stilit italik. Dallohet për kollonat, tavanet e zbukuruara dhe përdorimin e harqeve (Fig. 1). Deri në vitin 1944 ka qënë qendër prefekture. Në vitet e para pas 1944 ka shërbyer administrata lokale. Në vitet '50 u banua nga shumë familje.

Punimet restauruese u kryen në vitin 2012 dhe konsistonin në restaurimin e godinës, restaurimin e kornizave dekorative si dhe restaurimin e suvasë. Gjithashtu u vendosën dritare druri, dyer druri, grila druri, kangjella metalike për dritaret, u realizua lyerja me plastiko e mureve të jashtëm dhe bordurave të poshtme.

Vlefta e investimit të realizuar 2.900.000 lekë



Fig. 2. Tavan i pikturuar në godinën e ish-Prefekturës.

DO NOT COPY

KRONIKË E NDËRHYRJEVE RESTAURUESE TË KRYERA NGA DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE - KORÇË

RESTAURIMI I GODINËS SË MUZEUT ARKEOLOGJIK, KORÇË

Godina me funksion Muze Arkeologjik është banesë Monument Kulture e kategorisë së parë, e ndodhur në brendësi të Qendrës Historike. Është një godinë trekatëshe me oborr të brendshëm.

Godina ka pësuar disa herë restaurime, si: suvatime, rifugatime e shtesa në periudhën para vitit 1990. Dritaret janë rivendosur mbas vitit 2000.

Gjendja aktuale e monumentit:

-Objekti kishte një amortizim të përgjithshëm të strukturave dhe elementeve arkitektonike.

-Suvaja e tavaneve ishte plasaritur dhe tavanet kishin ulje.

-Ishte evidentuar nevoja për rikonstruksion total të çatisë.

-Dyshemetë e ndërkateve kishin vibrime dhe ulje.

-Kishte plasaritje të suvave të mureve në të dy katet dhe në të gjithë siperfaqet e mureve.

Ndërhyrjet restauruese:

-U krye restaurimi i çatisë dhe tavanit, duke bërë edhe hidroizolimin e çatisë.

-U realizuan instalimet elektrike dhe suvatimet e ambienteve në katin e tretë.

-U vendosen fashaturat e drurit të dritareve.

-Në fasadë u restauruan fugatimet me llaç që ishin të degraduara.

-Në katin përdhes u kryhen punime restauruese në një ambient që do të shërbejë si zyrë, duke realizuar suvatimet e mureve, dyshemetë, oxhakun dhe portën ekzistuese.

Punimet u kryhen nga shoqëria "TPLANI" gjatë vitit 2010, me një fond prej 2.230.920 lekësh.





Para dhe pas restaurimit

DO NOT COPY

Banesa e Pajtim Halimit, Korçë

Monument Kulture i kategorisë së parë. Ndërtesa është dy katëshe me dalje në rrugë. Nga kompleksi i dikurshëm ka mbetur mysafirhania. Rregullsia e suvatimit në muret e jashtme konturohet nga korniza druri vertikale dhe horizontale. Pjesën më të madhe të hapësirës ballore të katit të dytë e zënë dritaret uniforme prej druri.

Është restauruar para viteve '90, në strukturat kryesore si çatia dhe ndërkatet. Në gjendjen e sotme banesa paraqiste probleme: Mbulesa me tjegulla ishte e amortizuar, suvatimet e mureve kallkan të degraduara dhe rrënuara, oxhaku i rrënuar, fashaturat e dritareve të degraduara.

DRKK Korçë, në bashkëpunim dhe me pronarët e kësaj banese, të cilët siguruan fondin, kanë përfunduar restaurimin.

Punimet konsistuan në:

Restaurimin e mbulesës së çatisë;

Vendosjen e tjegullave të reja të vendit njësoj si origjinalet;

Suvatimin e mureve kallkan;

Restaurimin e oxhakut në muraturë, suva dhe kapuç;

Vendosjen e ullukëve për largimin e ujërave të shiut;

Zëvendësimin e fashaturave të drurit;

Lyerjen e mureve të banesës nga jashtë.





Para dhe pas restaurimit

Ura e Shipskës

Ura e Shipskës është urë guri me hark, që lidh Voskopojën me fshatin e Shipskës.

Nga kalimi i mjeteve të rënda, ura kishte filluar të dëmtohej. Në bashkëpunim me komunitetin vendas punimet konsistuan në konsolidimin e konstruksionit për ta bërë atë të kalueshme.





DO NOT COPY

Kisha e Shën Triadhës, Tudas

Kisha e Shën Triadhës, Tudas është kisha familiare e familjes feudale shqiptare të Muzakajve e shek. XIII-XIV. Kisha është e tipit në formë kryqi me kupolë.

Gjatë viteve, siç duket, kisha kishte pësuar dëmtime serioze dhe për këtë qëllim muret perimetrale u përforcuan me një këmishë prej muri të thatë. Gjatë vitit 2013 kjo muraturë e thatë u rrënua, gjë që rrezikonte shembjen e gjithë ndërtesës.

Në bashkëpunim me Mitropolinë e Korçës, u rindërtua këmisha me mur të thatë, një masë e rëndësishme kjo për shpëtimin e kësaj kishe me vlera të pallogaritshme historike dhe arkitektonike, në pritje të ndërhyrjeve të ardhshme restauruese më të kualifikuara.





Para dhe pas restaurimit

Ura e Shën e Premtes, Voskopojë

Ura e Shën e Premtes, Voskopojë është urë e shek. XVIII që lidhte qytetin me Manastirin e Shën Prodhromit.

Nga kalimi i mjeteve të rënda, ura kishte filluar të dëmtohej. Me detyrimin e shoqërisë së automjeteve, shkaktare e prishjes, ura u konsolidua.





DO NOT COPY

Kisha e Shën Mëhillit, Vithkuq

Kisha e Shën Mëhillit, Vithkuq është ndërtuar në vitin 1682 dhe pikturuar më 1728. Naosi është i tipit bazilikal, trenefësh, i variantit me një sistem qemeresh, harqesh e kalotash sferike, me përmasa të brendshme 15.5x9.5 m.

Gjatë vitit 2013, DRKK e Korçës, në bashkëpunim me Mitropolinë e Korçës, kryen punime që konsistuan në mbulesën e hajatit dhe narteksit.

Në vijim, DRKK ka restauruar çatinë dhe mbulesën e saj në pjesën veriore në Kishën e Shën Mëhillit në Vithkuq.

Pjesë e procesit të punës ishin:

- Injektimi me material lidhës në pjesët e sipërme të kupolave, për të evituar dëmtimet nga lëvizjet tektonike dhe nga degradimi i materialeve ekzistuese;
- Lehtësimi i ngarkesave mbi kupolë nga materialet e degraduara;
- Punime nivelimi në kreun e murit perimetral verior;
- Restaurimi i strukturave të drurit të çatisë në pjesët me mbushje;
- Restaurimi i dyshemesë të çatisë në pjesën veriore të naosit dhe komplet narteksin;
- Zbulimi dhe rimbulimi i çatisë me rrasa guri;
- Sistemimi i terrenit në pjesën veriore të kishës dhe zbatimin e kunetës në këtë pjesë, për të larguar ujërat e çatisë;
- Restaurimi i shtresës së narteksit.









DO NOT COPY

Kisha e Shën Marisë, Voskopojë

Kisha e Shën Marisë është kisha më e madhe e Voskopojës, që ka shërbyer dhe si katedrale e qytetit. Nga mbishkrimi mbi portën perëndimore mësojmë se kisha ka përfunduar së ndërtuari dhe është pikturuar në vitin 1712 nga mjeshtrat agrafas Theodhori, Anagnosti dhe Steriani. Mbishkrimet në ikona na njohin me një tjetër piktor ikonograf, Kostandin Jeromonahun. Në vitin 1887 u ndërtua kambanarja nga mjeshtrat Niko, Koli e Anastas Veria. Në gjendjen e sotme kisha nuk ruhet e plotë. Në anën perëndimore ka qënë narteksi, ndërsa në anën jugore zhvillohej, gjatë gjithë gjatësisë, hajati, i cili u shkatërrua nga tërmeti i vitit 1960.

Naosi është një ndërtim bazilikal me tre nefe, i mbuluar me një sistem harqesh, qemeresh e kalotash sferike.

Ndërtimi i kishës është mjaft solid, me muraturë të ndërtuar me gurë të skuadruar e të lidhur me llaç gëlqereje, me fugatura shumë të holla.

Hyrja për në oborr në pjesën jugore është trajtuar në mënyrë monumentale, me harqe e qemere, mbi të cilat ngrihet kulla e lartë dhe elegante e kambanares. Në anën veriore, ngjitur me murin e kishës, është ndërtuar paraklisi i Shën Marenës, i cili është dykatësh.

Në vitin 1999, me kontributin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u restaurua komplet çatia e kishës.

Në vitin 2012 u restaurua kambanarja.

Gjatë vitit 2013, si rezultat i shirave të dendura, një pjesë e çatisë u shemb. Me kontributin edhe të Komunës së fshatit, çatia u rindërtua.

Gjatë vitit 2014 u kryen ndërhyrje emergjente për të shmangur rrezikun e shëmbjes në pjesën veriore të çatisë. Kjo ndërhyrje u krye në prag të stinës së dimrit, me qëllim shmangien e emergjencave dimërore.







DO NOT COPY

Kisha e Shën Marisë, Vithkuq

Kisha e Shën Marisë në Vithkuq është Monument Kulture i kategorisë së parë, miratuar nga Rektorati i Universitetit Shtetëror, me vendim nr. 6, dt.15.01 1963.

Kisha e Shën Marisë përbëhet nga naosi, narteksi dhe hajati. Naosi është i tipit në formë salle njënefëshe me kupolë. Ka përmasa të brendshme 7.90 x 4.80 m.

Naosi lidhet në anën perëndimore me narteksin, i cili është ndërtuar në një kohë më të vonë. Narteksi është mbuluar me çati druri, pa tavan. Po kështu, në një kohë më të vonë është shtruar dhe hajati në anën jugore, i cili është i hapur në ballë me një varg shtyllash druri, mbi të cilat mbështeten trarët e çatisë. Çatia e gjerë me tre kullime uji e fsheh strukturën e brendshme.

Kisha nuk e ruan mbishkrimin që do të na e saktësonte kohën e ndërtimit. Kompozimi planimetrik e volumor i naosit dhe dekoracioni është karakteristik për një periudhë relativisht të hershme të arkitekturës pasbizantine, që i përket gjysmës së dytë të shek. XVII.

Ndërhyrjet konservuese konsistuan në:

-Kontrollin e të gjithë mbulesës së çatisë, duke kryer zbulimin dhe rimbulimin për të eleminuar dëmtimet, të cilat lejonin depërtimin e rreshjeve në pjesën e brendshme;

-Konsolidimin e pikturave murale ekzistuese, si dhe konsolidimin e mureve në brendësi të kishës, në të cilat nuk ka piktura;

-Restaurimin pjesor të strukturës së çatisë në pjesën e hajatit;

-Konsolidimin e muraturës me injektime dhe rifugatime;

-Restaurimin e shtresës së dyshemesë prej guri në pjesën e hajatit dhe të narteksit;

-Pastrimin e bimësisë spontane rreth objektit dhe sistemimin e territorit.





Para dhe pas konsolidimit

DO NOT COPY

Manastiri i Apostujve Pjetrit dhe Pavlit, Vithkuq

Manastiri i Apostujve Pjetrit dhe Pavlit, Vithkuq ngrihet mbi një kodër, që lartësohet në verilindje të fshatit. Nga kompleksi i Manastirit kanë mbetur katolikoni dhe pareklisi i Shën Kozmait dhe Damianoit, jashtë mureve rrethuese të Manastirit. Konakët e Manastirit janë shkatërruar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në vitin 1736 u ndërtua kisha e Shën Kozmait dhe Damianoit, e cila u pikturua në vitin 1750 nga vëllezërit korçarë, Konstandini dhe Athanasi. Në vitin 1759, igumeni i Manastirit, Tarasi, ndërtoi katolikonin kushtuar Apostujve të Shenjtë, Pjetrit dhe Pavlit, i cili u pikturua po nga vëllezërit korçarë më 1764. Një tjetër piktor i shquar i shekullit XVIII, Konstandini nga Shpati, ka kontrubuar në zbukurimin e ikonave të Manastirit. Më 1761 u gdhend ikonostasi me kontributin e voskopojarëve. Për ndërtimin e kishës ndihmuan dhe vithkuqarët e ndodhur në Hungari.

Në vitin 2013 u kryen punime në kishën e Shën Kozmait dhe Damianoit. Kisha ndodhet në buzë të rrëpirës dhe kontraforta që e mbante ishte dëmtuar. Rindërtimi saj shmangu rrezikun e dëmtimit të mëtejshëm të monumentit. Ndërhyrja u krye në bashkëpunim me Mitropolinë e Korçës.

Gjatë vitit 2014 rifilloi procesi i konsolidimit të pikturës murale në kishën qendrore të manastirit.

Piktura murale, për shkak të lagështirës dhe mosndërhyrjes shfaqte dëmtime të shumta. Vërehen shkëputje të pikturës nga grunti, si dhe krijimi i xhepave.

Konsolidimi i pikturës konsiston në përforcimet e buzëve të pikturës, mbushjen e xhepave dhe injektimet në pjesët ku ka shkëputje (Fig. 4). Problem mbetet konservimi estetik në pjesët e rëna të pikturës, që mund të mbushen me llaç të tonuar me pak ngjyrë okër.

Fondi i akorduar është 151.300 lekë nga buxheti i shtetit.







DO NOT COPY



Para dhe pas konsolidimit të pikturës murale.

Ura e Golikut

Ura e Golikut ndodhet në fshatin Golik të Komunës Proptisht të Pogradecit. Është urë me qemer, me një gjatësi prej 17 m, gjerësi 3 m, e lartë 10 m. Është vepër arti e rrugës së vjetër "EGNATIA".

Prej shumë kohësh, Ura e Golikut është dëmtuar nga keqbërësit, të cilët kanë dëmtuar muraturën e gurit të urës, duke krijuar zgavra, të cilat nëse do të vazhdonin të mos riparoheshin do të rrezikonin dëmtimin e madh të urës, madje deri në shëmbje.

Ndërhyrjet konsistonin në:

- plotësimin dhe zëvendësimin e pjesëve të munguara në muraturë, duke bërë ndërthurje të pjesës së re me atë të vjetrën, për të evituar përparimin e dëmtimeve të urës;
- punime përforcuese, si mbushje me llaç dhe fugatime në pjesët vertikale dhe ato horizontale të strukturës të urës (nën harqe);
- U krye pastrimi i vegjetacionit në të gjitha pjesët e mundshme.



Para dhe pas pastrimit

DO NOT COPY

DO NOT COPY